



Universiteti “Fan Noli”, Korçë
Fakulteti i Mësuesisë



Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

“PROFESOR SELMAN RIZA DHE ALBANOLOGJIA”

Me rastin e 100- vjetorit të lindjes (1909-2009)

(Përmbledhja e materialeve të Konferencës)

Korçë, 4 dhjetor, 2009

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

**“PROFESOR SELMAN RIZA
DHE ALBANOLOGJIA”**

Me rastin e 100- vjetorit të lindjes (1909-2009)

(Përmbledhja e materialeve të Konferencës)

Korçë, 4 dhjetor, 2009

**Kjo përmbledhje botohet nën kujdesin e Rektorit të Universitetit të Korçës,
prof. as. dr. GJERGJI MERO**

**KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “PROFESOR SELMAN
RIZA DHE ALBANOLOGJIA”
Me rastin e 100- vjetorit të lindjes (1909-2009)
Korçë, 4 dhjetor, 2009**

**Botim i posaçëm i Universitetit “Fan S. Noli”
Përgatitën për botim: Msc. ANILA MAXHE, Msc. HYSNIE HYSKA**

**Shtypur në Shtypshkronjën “KOTTI”
Korçë, maj 2010**

Seanca plenare

Presidiumi:

Zëvendësministrja e Arsimit dhe Shkencës, Znj. Nora Malaj

Rektori i Universitetit të Korçës, prof. as. dr. Gjergji Mero

Dekani i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës, prof. dr. Hasan Muja

Zëvendësrektori i Universitetit të Korçës, prof. dr. Ali Jashari

Dekania e Fakultetit të Mësuesisë, prof. as. dr. Aleksandra Piluri

Prof.as.dr. Begzad Baliu, prof. dr. Zeqirja Neziri, bashkorganizatorë të konferencës

Fjala e hapjes-Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, prof. as. dr. Gjergji Mero

Fjala përshëndetëse-Zëvendësministrja e Arsimit dhe Shkencës, znj. Nora Malaj

Përshëndetje- dërguar nga kryetari i ASHAK, akad. Besim Bokshi

Përshëndetje -nga Prefekti i Qarkut të Korçës, z. Koço Bello

Referat -nga prof. as. dr. Begzad Baliu, Profesor Selman Riza dhe albanologjia

Seanca II

Drejtues seance: Shezai Rrokaj, Asllan Hamiti, Dhimitri Bello, Rami Memushaj

Kumtesat:

1.Shezai Rrokaj (Tiranë), *Selman Riza-Metodologjia shkencore dhe diletantizmi.*

2.Hasan Mujaj (Prishtinë), *Çështje të studimit të sociolinguistikës në veprën e Profesor Rizës.*

3.Gjovalin Shkurtaj (Tiranë), *Marrëdhëniet e gjuhës së shkruar apo standardit me gjuhën e folur dhe dialektet sipas një ideje të hershme të Selman Rizës: “parimi i enëve komunikuese”.*

3.Asllan Hamiti (Shkup), *Studimet e profesor Selman Rizës për fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes.*

4.Dhimitri Bello (Korçë), *Çështje të gjuhësisë ballkanike në veprën e Selman Rizës.*

5.Bahtijar Kryeziu (Gjilan), *Mendimi i Selman Rizës për kulturën e gjuhës.*

6.Rami Memushaj (Tiranë), *Selman Riza- nga “pangegërishtja” te shqipja standarde.*

7.Zeqirja Neziri (Shkup), *Shkrimtarët e vjetër të shqipes në veprën e Selman Rizës.*

8.Adem Hajdaraj (Prishtinë), *Studimi diakronik i Profesor Selman Rizës për paskajoren.*

Seanca III

Drejtues seance: Gjovalin Shkurtaj, Hysnie Hyska, Bahtiar Kryeziu, Abdulla Ballhysa

Kumtesat:

9.Remzi Pernaska (Paris), *Profesor Selman Riza-gramatikan i shquar dhe filozof i gjuhës*

10.Leonora Husaj (Prishtinë), *Sistemi foljor i shqipes në veprën e Selman Rizës.*

11.Hysnie Hyska, Alma Dulo (Korçë), *Profesor Selman Riza dhe Korça.*

12.Mustafa Ibrahimimi (Tetovë), *Konceptet sociolinguistike të Selman Rizës.*

13.Abdulla Ballhysa (Elbasan), *Vlerësime për profesor Selman Rizën nga bashkëkohës dhe bashkëpunëtorë të tij.*

14.Flutura Çitaku (Prishtinë), *Ndihmesat e profesor Selman Rizës në fushën e terminologjisë së gramatikës.*

15.Shkëlqim Millaku (Prishtinë), *Studimet e Selman Rizës në fushë të morfologjisë.*

16.Xheladin Zymberi, (Prishtinë) *Problemet sintaksore në studimet gjuhësore të Selman Rizës.*

17.Evalda Paci (Tiranë), *Pikëpamje të profesor Selman Rizës për "Mesharin" e Gjon Buzukut*

18.Ali Jashari (Korçë), *Smilari fjalëkrijues i profesor Selman Rizës.*

Përshëndetje nga prof. Dhorë Qirjazi (Selanik)

Begzad Baliu (Prishtinë), *Fjala e mbylljes.*

KRONIKË SHKENCORE

PROFESOR SELMAN RIZA DHE ALBANOLOGJIA

Paraditen e 4 dhjetorit 2009, në Sallën e Konferencave të Universitetit “Fan S. Noli”, në Korçë, hapi punimet konferenca shkencore ndërkombëtare “Profesor Selman Riza dhe albanologjia”.

Konferenca u organizua nga Fakulteti i Mësuesisë i Universitetit të Korçës dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, ndërsa ishin ftuar që kontributet e tyre t’i paraqesin edhe studiues nga Universiteti “Kirili e Metodi” i Shkupit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Evropës Juglindore nga Tetova. Konferenca ishte organizuar me rastin e 100-vjetorit të lindjes së njërit prej albanistëve më të mëdhenj të shekullit XX, Profesor Selman Rizës.

Presidiumin e hapjes së Konferencës e përbënin: prof. as. dr. Gjergji Mero (rektori i Universitetit të Korçës); Z. Nora Malaj (Z/ministria e Arsimit dhe e Shkencës); prof. dr. Ali Jashari (zëvendësrektor i Universitetit të Korçës); prof. asc. dr. Hasan Muja, (Dekani i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës); prof. as. dr Aleksandra Piluri (Dekane e Fakultetit të Mësuesisë të Universitetit të Korçës) dhe Prof. asc. dr. Begzad Baliu (Universiteti i Prishtinës) e prof. dr. Zeqirja Neziri (Universiteti i Shkupit), bashkorganizatorë të konferencës.



Presidiumi i Konferencës Shkencore.

Nderim për shkencëtarin dhe atdhetarin njëkohësisht

Duke paraqitur fjalën e hapjes, Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, prof. Gjergji Mero, theksoi se “Mësimdhënësit e Fakultetit të Mësuesisë të Universitetit “Fan Noli” të Korçës dhe Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës e kanë planifikuar shënimin e 100 - vjetorit të lindjes së Profesor Rizës në kuadër të bashkëpunimit arsimor dhe shkencor për vitin 2009. Shënimi i këtij përvjetori të përbashkët në Universitetin e Korçës mbështetet në faktin se Profesor Selman Riza është formuar për shumë vite dhe ka qenë profesor në Liceun e famshëm të Korçës, ndërsa ka lënë gjurmë të thella në dijen shkencore të institucioneve shkencore dhe arsimore të Prishtinës e të Tiranës dhe përtej tyre, në institucionin e albanologjisë në kuptimin universal të saj”.



Zv/ministrja e Arsimit dhe e Shkencës Z. Nora Malaj në fjalën e saj falënderoi drejtuesit më të lartë të Universitetit të Korçës dhe kolegët e Këshillit Organizues të kësaj Konference, të cilët bashkërisht e bënë të mundur planifikimin dhe organizimin me sukses të këtij tubimi shkencor e me përmasa mbarëkombëtare e ndërkombëtare.



Znj. Nora Malaj duke përshëndetur punimet e Konferencës Shkencore



Pamje nga punimet e Konferencës Shkencore

Dekani i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës, prof. dr. Hasan Muja, përshëndeti në emër të rektorit të Universitetit të Prishtinës, Prof. dr. Mujë Rugovës, ndërsa rektorit të Universitetit të Korçës prof. as. dr. Gjergji Mero i dhuroi një pikturë të sjellë nga mësimdhënësi i Fakultetit të Edukimit piktori akademik Haki Xhakli, e cila do

të vendoset në selinë e Qendrës Ndëruniversitare të Studimeve Ballkanike në Universitetin e Korçës.



Prof. Hasan Mujaj i përcjell konferencës përshëndetjen e Raktorit të Universitetit të Prishtinës, prof. Mujë Rugova.



Portreti i Selman Rizës, vepër e piktorit akademik Haki Xhakli, i dhurohet Universitetit të Korçës



Në emër të autoriteteve vendore konferencën e përshëndeti z. Koço Bello, prefekt i Qarkut të Korçës.

Më pas, prof. dr. Ali Jashari lexoi përshëndetjen që Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akad. Besim Bokshi, i drejtoi Konferencës Shkencore kushtuar 100-vjetorit të profesor Selman Rizës.

Po në këtë seancë referatin “Profesor Selman Riza dhe albanologjia”, e lexoi profesori nga Universiteti i Prishtinës, Begzad Baliu. Institucionet arsimore dhe akademike të hapësirës shqiptare, tha në fillim Baliu, po e shënojnë në mënyra të shumanshme 100-vjetorin e lindjes së njërit prej personaliteteve më të shquara të gjuhësisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Një shekull më parë lindi njëri prej personaliteteve më të mëdha të gjuhësisë shqiptare, Selman Riza. Kur një ditë antropologët dhe studiuesit e tjerë të fushave të tjera të dijes të merren me personalitetin e tij, kujtoj se me të drejtë në karakterin e tij epik, do të gjejnë shumë shkëndija historike të kësaj kohe, të cilat ishin vulosur thellë në shpirtin e tij. Është koha e kryengritjeve të mëdha për pavarësinë e Shqipërisë. Një perandori juglindore po perëndonte dhe një perandori verilindore po krijohet. Edhe e dyta, si edhe e para, horizontin e fundit perëndimor e mbyllte në kufijtë fundorë të hapësirës shqiptare.

Gjakova, vendlindja e fëmijërisë së Selman Rizës, që dy dekada më parë kishte thyer mitin e paprekshmërisë së pashallarëve turq, ishte bërë pikërisht objekt i sulmit, vrasjes, djegies dhe rrënimit material e shpirtëror të popullsisë shqiptare nga xhandarët e ushtarët serbë.

Është e kuptueshme prandaj pse me jetën e tij, si edhe me përkushtimin këmbëngulës kritik në veprën shkencore, ai do të bëhet shembull i përkushtimit atdhetar ndaj tri shtyllave që patën më së shumti ndikim në ndërtimin e vetëdijes kombëtare dhe shtetërore të shqiptarëve të shekullit XX: gjuhës, etnologjisë (Kanuni dhe Skënderbeu) dhe Kosovës.

Janë këto rrethana që ndikuan fuqishëm në krijimin e personalitetit të tij dhe në këto rrethana Profesor Selman Riza ndërtoi gjedhën e tij prej gjuhëtari, shkencëtari, atdhetari, kundërshtari të fashizmit, nazizmit dhe komunizmit.



Prof. Begzad Baliu duke mbajtur referatin “Profesor Selman Riza dhe albanologjia”

Mbi këto parime dhe rrethana të vështira që në fëmijëri prof. Selman Riza u bë pamëdyshje një nga mendjet më të mprehta të shekullit të XX, në mbarë botën shqiptare. Vepra shkencore e tij u shtri në shumë fusha e në shumë lëmi, siç janë gramatika, tekstologjia, terminologjia, kritika gjuhësore, historia e gjuhës, gjuhësia e përgjithshme, gjuha letrare etj.

Në botën shkencore shqiptare personaliteti i Profesor Selman Rizës dhe vepra e tij për një kohë të gjatë, nuk kanë qenë objekt trajtimi dhe madje referimi, në krahasim me shtigjet që ka hapur në fushë të albanologjisë dhe konceptet shkencore që ka përdorur në veprën e tij. Prandaj, konceptet e tij kritike-shkencore krahasuar me metodën kërkimore dhe shkencore të bashkëkohësve të tij, nuk kanë të bëjnë me konfrontimin e koncepteve më të avancuara shkencore të Profesor Selman Rizës, përballë koncepteve të kohës, por me koncepte të natyrës thjesht gjuhësore që insistonin t’i diktonte në fushë të albanologjisë së shekullit XX, e që lidheshin me historinë e gjuhësisë shqiptare, gramatikën e sotme të shqipes, botimin filologjik të veprave të letërsisë së vjetër dhe sidomos metodologjinë e kërkimeve bashkëkohore në këtë fushë.

Le të jetë kjo njëkohësisht arsyeja që të shpresojmë se vepra e Profesor Selman Rizës tashmë bashkëkohësisht do të na prijë në fillim të shekullit XXI. Nëse Selman Riza, bardi i mendimit kritik në shkencën shqiptare, nuk kuptohej dje për shkaqe ideologjike, a do të mund të kuptohej sot përtej shkaqeve gjuhësore. Pavarësisht nga niveli i kuptimit të veprës së tillë, shpresoj që me Profesor Rizën ka ndodhur ajo që përgjithësisht është thënë për poetin Alan Bosque “të duam sepse të kemi sharë”, por uroj që të mos ndodhë tash e tutje ajo që përgjithësisht thuhet për Albert Ajnshtajnin: “të duam për aq sa nuk të

kuptojmë”! E Profesor Riza ishte jo rrallë i pakuptueshëm, jo rrallë i sharë, por më në fund, përgjithmonë i nderuar!”, tha në fund të referatit të tij Begzad Baliu.

Profesor Selman Riza dhe shqipja moderne

Në seancën e dytë, të cilën e drejtuan profesorët: Shezai Rrokaj, Asllan Hamiti, Dhimitri Bello, Rami Memushaj, kumtesat e tyre i lexuan shumë studiues të jetës dhe veprës së Profesor Selman Rizës.

Shezai Rrokaj (Tiranë), në kumtesën e tij “Selman Riza - metodologjia shkencore dhe diletantizmi”, i bëri një analizë kritike, shpjeguese, vlerësuese dhe referuese esesë së Selman Rizës “Diletantizimi dhe zanati”. Në këtë kontekst ai komentoi gjerësisht këtë tekst të viteve ’30, kur u shkruan mjaft artikuj të kësaj natyre, për gjuhën, kulturën, kombin, fenë, atdheun, filozofinë perëndimore a lindore të shqiptarëve, nga personalitete të kohës, si Eqrem Çabej, Branko Merxhani, Krist Maloki, Ernest Koliqi etj.

Hasan Muja (Prishtinë), në kumtesën e tij “Çështje të studimit të sociolingjistikës në veprën e Profesor Rizës”, që në fillim konstatoi se po merrej me linguistin elitar të shekullit XX. Ai u ndal në këndvështrimin sociologjik të metodës së kërkimeve të Rizës: social, rajonal, ekonomik, praninë e huazimeve, sllavizmave si rrjedhojë e ndikimeve të jashtme. Ndarja fizike, krahinore, politike, ekonomike etj., paraqet indeksialitetin e fjalësit dhe rrjedhjavë gjuhësore, mendonte Profesor Riza. Duke vlerësuar pikëpamjet e Rizës për rolin e personalitetit dhe institucionit apo qendrës ekonomike, politike e kulturore në formimin e një gjuhe, dr. Muja kujtoi se në përvijimet e Rizës, dallohet roli i arsimit (Normalja e Elbasanit dhe Liceu i Shkodrës), si dhe përpjekjet krijuese, teorike dhe patriotike të Luigj Gurakuqi e të brezit të tij, ndërsa në kontributet e qendrave ekonomike ai e vendoste qytetin e Shkodrës, e cila pasi nuk arriti të bëhet kryeqytet i shtetit shqiptar, gjuha shqipe, shkodranishtja (pra dialekti i saj) nuk mundi të bëhet gjuhë kombëtare.

Mbi këto parime kontributi i Profesor Rizës përkon me ngritjen e toskërishtes dhe gegërishtes në kryedialekte të vetme e që është jo vetëm arritje e tij e veçantë, por edhe kontributi më i rëndësishëm deri në kodifikimin e saj në vitin 1972. Janë thelbësore në këtë rast dallimet që Riza përcaktoi në mes toskërishtes e gegërishtes: etimologjike, etnografike, folklorike dhe tiparet dalluese fonetike, tha Muja.

Në kumtesën e tij Muja vlerësoi kontributin e Selman Rizës në fushë të krijimit të fjalësit të shqipes dhe sidomos në fushë të terminologjisë, një vlerësim të cilin e theksuan edhe mjaft kumtues të tjerë të kësaj konference shkencore, por tërhoqi vërejtjen Muja, duhet të kemi kujdes në faktin se Riza nuk ishte purist absolut.

Gjovalin Shkurtaç (Tiranë), në kumtesën largvajtëse “Marrëdhëniet e gjuhës së shkruar apo standardit me gjuhën e folur dhe dialektet sipas një ideje të hershme të Selman Rizës: “parimi i enëve komunikuese”, duke kujtuar njohjen e tij personale me Profesor Rizen shumë dekada më parë, në fjalën e tij theksoi se Profesor Riza ishte prototipi që për çdo ditë mendonte se çka do të ju thotë studentëve të nesërmen. Ai fliste para studentëve ashtu siç do të shkruante në kabinet në veprat e tij shkencore. Prandaj ai ishte pesha e fjalës dhe vetë fjala e jeta e tij.

Dy janë idetë që ka shpallur Selman Riza, tha profesor Shkurtaç: e ardhmja e gjuhës shqipe, e kjo do të thotë forma e folur dhe e shkruar, ndërsa e vetmja është ajo e

përbashkëta. Mbështetur në këto teori Selman Riza me kohë hoqi dorë nga pangegërishtja dhe pantoskërishtja. Toskërishtja e folur nga gegët është gjuha e ardhshme standarde e shqipes, ishte konstatimi i Selman Rizës, i kuptuar fillimisht si metaforë, por që u bë realitet. Në të vërtetë, idetë e tij përgjithësisht ishin ‘një metaforë’, që jo të gjithë e kuptonin, prandaj, a është e kuptueshme pse me Selman Rizën pati ndodhur ajo që ka ndodhur me Anjshtajnin, i cili thoshte, sa më shumë nuk po më kuptojnë aq më shumë po më duan. Parimi i enëve komunikuese gjuhë-dialekt, e kjo do të thotë gjuhë e shkruar dhe gjuhë e folur, nuk janë për t’u absolutizuar, por duhet parë me kujdes marrëdhënia e të dyjave. Parimi i enëve komunikuese, në të vërtetë, sot vepron në kuptimin e plotë të fjalës dhe është i kuptueshëm plotësisht, përfundoi Profesor Shkurtaj.

Asllan Hamiti (Shkup), në kumtesën e tij “Studimet e profesor Selman Rizës për fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes”, diskutoi për njohjen e rezultateve dhe veçantitë e tyre brenda dialekteve e në nivel të të dyjave, nga ana e Profesor Rizës, duke i veçuar dy më të rëndësishmet: rotacizmin dhe hundorësinë e n-së. Ndonëse veprën e tij e ka shkruar në pangegërishte, tha Hamiti, aty shihen dukshëm parimet fonetike, morfologjike, problemet më të rëndësishme teorike si dhe diskutimet për to.

Dhimitri Bello (Korçë), në kumtesën e tij “Çështje të gjuhësisë ballkanike në veprën e Selman Rizës”, në fillim përkujtoi se Profesor Riza nuk është marrë gjerësisht me studimet ballkanike, por temat, problemet, dukuritë apo fenomenet që ka trajtuar janë mjaft me interes. Tri janë problemet të cilat janë diskutuar në punimet që kanë të bëjnë me gjuhësinë ballkanike apo përkimet e gjuhëve të saj. Përkimet gramatikore mes shqipes e serbokroatishtes, përkimet ndërmjet shqipes e greqishtes dhe kritikës që i ka bërë Fjalorit të Bariqit. Gjithashtu brenda kërkimeve të tij në fushë të albanistikës (zhvillimit të brendshëm apo të jashtëm të saj), zënë vend të rëndësishëm edhe probleme të tjera më pak të njohura të ballkanistikës. Fjala është për sistemin nominativ të shqipes, konvergjenca rumuno-shqiptare etj. Profesor Bello në kumtesën e tij kontribut të veçantë të Rizës në fushë të ballkanistikës e konsideroi caktimin e disa përbërësve historikë të lëvizjes së nyjës me bazë mijëvjeçare. Mbështetur në konceptet e profesor Bellos për nyjën, sot mund të diskutohen edhe disa dukuri a fenomene mijëvjeçare të strukturave të tjera morfologjike të shqipes në kontekst edhe të gjuhëve të tjera ballkanike apo të ballkanistikës përgjithësisht, që gjerësisht paraqiten edhe në monografitë e tjera historiko-gjuhësore të gramatikës së shqipes.

Bahtijar Kryeziu (Gjilan), në kumtesën e tij “Mendimi i Selman Rizës për kulturën e gjuhës” theksoi faktin se kujtesa për Selman Rizën është një ngjarje kombëtare. Fjala është për personalitetin, të cilin e shquanin akribia shkencore dhe idealet atdhetare. Në vazhdim mjeshtri ynë nënvizoi kontributin e Profesor Rizë në përbashkimin e të dy dialekteve, në kohën kur bëheshin mjaft përpjekje për të nxjerrë edhe standarde të tjera brenda gegërishtes, konvergjenca të skajshme të gegnishtës e toskërishtes dhe madje kosovarishtës. Profesor Kryeziu në fjalën e tij diskutoi edhe disa nga komentet e mëparshme për konceptet dhe përmbajtjen dialektore të shqipes standarde, sipas formulës “shqiponja dhe dialektet e shqipes”, e të cilat jo njëherë janë përfolur në mënyrë të njëanshme. Prej teksteve të mëvonshme, tha Kryeziu, kuptojmë se Profesor Riza ka pranuar disa nga vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë 1972, por jo edhe disa elemente të morfologjisë që kanë të bëjnë kryesisht me gjininë dhe shumësin e emrave e të mbiemrave.

Rami Memushaj (Tiranë), në kumtesën e tij “Selman Riza- nga “pangegërishtja” te shqipja standarde”, u ndal gjerësisht në disa çështje të planifikimit të shqipes, me theks të veçantë statutin dhe korpusin. Për të sjellë një korpus sa më të pasur të diskutimeve të tij Profesor Memushaj u ndal fillimisht te idetë e para të tij, të formuluar në konceptin shqiponja dhe shqipja, por të sintetizuara gjerësisht në monografinë “Tri monografinat e shqipes”.

Në fillimet e tij, theksoi Profesor Memushaj, Selman Riza iu bashkohej atyre që, ndryshe nga Aleksandër Xhuvani bie fjala, konsideronin se gjuha i duhet lënë vetvetes. Përballë koncepteve të tij, gjithashtu ndryshe nga shumë të tjerë, nuk vinte elemente të natyrës politike apo letrare. Konceptet e tij shkonin përtej tyre, ishin më komplekse. Kishte shumë bashkëkohës që i mëshonin faktorit politik, për ta arsyetuar motivin e vendimeve, ndërsa të tjerët faktorin letrar për ta arsyetuar bazën shkencore-historike të një vendimi tjetër. Profesor Riza përjashtoi të parin dhe të dytin. Me të parin nuk u mor, ndërsa të dytin e quante të pamundshëm.

Profesor Memushaj kujtoi konceptet qortuese të Rizës ndaj Resultit për koinenë e përbashkët dhe u përcaktua për formulën dy koka shqiponje dhe dy kryedialekte, një mendim që u quajt fatalist. E vërteta e reaguesit ndaj koncepteve të tij nuk vinin vetëm nga autorët e idesë së përbashkimit me çdo kusht të dialekteve të shqipes, por edhe të atyre që ngulnin këmbë në gegnishte, përkatësisht nëndialektet e saj. Kritikuesit e tij atëherë dhe sidomos më vonë gjatë parapërgatitjeve për të mbajtur Kongresin e Drejtshkrimit, ‘harruan’ se ndërmjet gegnishtes e toskërishtes, shteti shqiptar kishte zgjedhur elbasanishten, përdorej edhe kosovarishtja, ndërsa letrarishtja shkruhej në shkodranishten dhe në një variant jugor të toskërishtes. Profesor Memushaj në mënyrë të veçantë u mor me konceptet e Rizës për parimet e zgjedhjes së leksikut në një korpus të shqipes standarde. Kjo është arsyeja pse planifikimi gjuhësor i fazës së dytë të standardizimit të shqipes letrare nuk mund të merret me mend pa trajtimin e mendimit shkencor të Rizës, tha profesor Memushaj.

Zeqirja Neziri (Shkup), në kumtesën “Shkrimtarët e vjetër të shqipes në veprën e Selman Rizës”, u ndal në disa nga kontributet e Selman Rizës dhënë letërsisë parahumaniste, që në historinë e letërsisë shqipe njihet si letërsia e vjetër.

Selman Riza e bëri albanologjinë shkencë shqiptare në kuptimin e plotë të fjalës, tha në fillim të fjalës së tij profesor Neziri. Ai u mor me letërsinë parahumaniste dhe ishte i prerë se nuk mund të gjendet një vepër para Buzukut. Meshari është shkruar duke u mbështetur në traditën gojore dhe jo në atë të shkruar, shprehej Riza. Ai nuk ka përkrahur idenë e Rokos për botimin e Mesharit në Sarajevë, mendimin e Camajt për botimin e Mesharit në Sarajevë, por ka dalë me idenë se ai është botuar në Dalmaci afër Zarës. Sa i përket studimit të Mesharit, kontributi i Rizës vlerësohet për mendimin e tij se brenda Mesharit ka tri libra: katekizëm, previjarë dhe mesharë. Po kaq i rëndësishëm për Z. Nezirin është fakti se Riza ka dhënë disa ide origjinale edhe në lidhje me tipologjinë e poezisë dhe prozës së shkrimtarëve të periudhës së parë. Te Budi, Riza ka vlerësuar poezinë. Te poezia e Budit ka vlerësuar kontekstin letrar, respektivisht gjininë letrare, duke e quajtur poemë edhe pse nuk pati dhënë argumente të mjaftueshme shkencore, që ishte veçori e punës së tij kërkimore dhe shkencore, sipas metodës pozitiviste dhe filologjike. Në kërkimet e tij Riza ka dhënë mundësi për analizën e tekstit, anën filologjike dhe tekstologjike të saj. Budi ishte përfaqësues i prozës poetike ndërsa

Bogdani i prozës shkencore, vlerësonte Riza. Po kaq i veçantë ishte edhe mendimi i tij për studimet bogdaniene. Kështu, nëse te Buzuku kërkonte të veçohet përkthimi i Mesharit, te Bogdani kërkonte autorësinë e teksteve të tij përballë Pal Hasit.

Adem Hajdari (Prishtinë), në kumtesën “Studimi diakronik i Selman Rizës për paskajoren”, në nismë të fjalës së tij iu referua mendimit të Profesor Ali Dhrimos se Selman Riza është njëri prej intelektualëve më të njohur të shekullit që lamë pas, ndërsa më tej diskutoi gjerësisht konceptet e Selman Rizës për paskajoren, pikëpamjet historike dhe zhvillimin e saj në kontekstin ndërdialektor. Në këtë kontekst Profesor Hajdari solli edhe mjaft shembuj të zhvillimit të saj si emër ndajfoljor, po dhe të pozitës së saj në sistemin foljor.



Autoritetet vendore të Korçës duke ndjekur punimet e Konferencës Shkencore

Albanisti i veçuar i shekullit XX

Në seancën III, të cilin e drejtuan Profesorët Gjovalin Shkurtaç, Hysnie Hyska, Bahtijar Kryeziu dhe Abdulla Ballhysa, kumtesat e tyre i lexuan edhe shumë studiuës, kryesisht të brezit të ri, prandaj edhe veprës së Selman Rizës iu qasen në aspekte më të veçanta.

Remzi Përnaska (Paris), në kumtesën “Profesor Selman Riza – gramatikan i shquar dhe filozof i gjuhës”, fillimisht kujtoi mikun e idealeve të majave shkencore dhe për

miqësinë personale me Profesor Rizën. Në kumtesën e tij më tej profesor Pëarnaska foli për Rizën: gramatikan i gjuhës, gramatikan shqiptar, filozof i gjuhës, filozof i vërtetë, duke e konsideruar atë gjenin tonë që ishte jo vetëm shkencëtar i gjuhës shqipe, por edhe të gjuhës përgjithësisht. Pa dashur që të merrej me ndonjë pamje të re të kontributit të studiuesve shqiptarë në fushë të albanologjisë, Profesor Parnaska tha se Selman Riza është i vetmi gjuhëtarë shqiptar që themeloi shkollën vetjake shqipe. “Gjithë sa u parashtrua më sipër, është vetëm njëri ndër argumentet, që çojnë detyrueshëm në përfundimin se Selman Riza operon si filozof i Logjikës dhe i Gjuhës me kategorinë e pestë të josendeve të sendizuar në logjikë dhe të joemrave të emëruar në gjuhësi. Ai është kështu jo vetëm "filozof i shkencave", por edhe gnoseolog, filozof i mirëfilltë”, tha në fund Profesor Parnaska.

Leonora Husaj (Prishtinë), kumtesën e saj “Sistemi foljor në veprën e prof. Selman Rizës”, e kishte dërguar në formë të shkruar një sintezë rrënjësore të mendimeve të Rizës për sistemin foljor, të provuar në një prej monografive më të mira në studimet morfologjike shqiptare, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore (e shkruar më 1966, e miratuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë më 1967, por, për shkak të përndjekjes së autorit, e botuar me vonë në Tiranë, më 1994). Profesor Selman Riza, shkruante veç të tjerash në kumtesën e saj, e trajton edhe terminologjinë foljore, zgjedhimet, mënyrat, kohët, format, diatezat (veprore, pësore, vetvetore, mesore), formalisht jo-veprore, mesore-njëvetore, duke shëtitur kritikueshëm prej një studiuesi, deri te studiuesi tjetër, të cilët nuk janë të një mendimi, për ta dhënë më në fund mendimin e vet. Ai merret me përkufizimin, tipat leksikorë, strukturën e formave, vetat, numrin, kohët e aspektet foljore, mënyrat (dëftore, habitore, kushtore, lidhore, dëshirore, lidhore-habitore, urdhërore, paskajore, përcjellore dhe pjesore) etj. Sipas tij “vetëm dëftorja shpreh fenomen konstatues e fiktiv ekzistues, ndërsa të tjerat shprehin fenomen potencialisht ekzistues”. Në këtë kontekst, studiuesja Husaj, foljet i trajton në prizmin historik-kritik të traditës gramatologjike, gramatografike bashkëkohore e sintaksore në raport me folësin e veprimin.

Hysnie Hyska, Alma Pogoni (Korçë), në kumtesën e përbashkët “Profesor Selman Riza dhe Korça”, sollën të dhëna mjaft të rëndësishme për aktivitetet atdhetare, shkencore dhe diturake të Selman Rizës gjatë qëndrimit të tij si student apo edhe si profesor në Liceun e Korçës. Ato sollën dëshmi të rëndësishme arkivore, dokumentare, të shkruara dhe të kujtuara ndër bashkëkohës për angazhimet e Selman Rizës dhe vendin e tij në rrethin e liceistëve të Korçës. Në këtë rast ato veçuan dëftesat me notat më të larta, fjalën e tij në darkën e lamtumirës me profesorët francezë, komunikimin korrekt me nxënësit dhe kolegët, sjelljen miqësore dhe korrekte me miqtë, miqësinë e hershme me Kostaq Cipon, lidhja me Mihail Gramenon, Lasgush Poradecin dhe Mitrush Kutelin; përkthimin frëngjisht të një fragmenti nga kënga epike “Martesa e Halilit” për revistën Lyceum etj., shumë prej të cilave nuk dihehin më parë. Në të vërtetë ato sollën dëshmi të reja pa të cilat nuk mund të shkruhet biografia e Selman Rizës.

Mustafë Ibrahim (Tetovë), në kumtesën “Konceptet sociolinguistike të Selman Rizës”, trajtoi kontributin e Selman Rizës në fushë të sociolinguistikës, duke i dhënë rëndësi të veçantë kontributit të tij në fushë të bilinguizmit. Meritë e tij e veçantë, tha në fjalën e tij Ibrahim, është studimi monografik krahasues ndërmjet gramatikës së shqipes dhe serbokroatishtes. Në analizën sintetizuese të tij rreth kësaj vepre, bëri komente të veçanta për termat gjuhësorë që përdori Riza në këtë gramatikë: zanore-vettinguj;

bashkëtingëllore – bashkëtinguj etj. Mbështetur në vlerësimet e tij për kontributin e Rizës në këtë vepër Ibrahimimi e quajti themelues të gjuhësisë krahasuese.

Abdulla Ballhysa (Elbasan), në kumtesën “Vlerësime për profesor Selman Rizën nga bashkëkohës dhe bashkëpunëtorë të tij”, në fillim kujtoi se Selman Riza në jetën e tij studentore ishte emër tabu, që nga brezi i tij mbahej në mend me nofkën kosovari. Në kohën e diktaturës theksoi Profesor Hysa, kishte shumë të dënuar me burg, ndërsa Riza ishte i dënuar në mënyrë të veçantë: me heshtje, të cilën vetëm pas vdekjes, për të mos thënë vetëm ditën e varrimit e thyen Bexhet Reso dhe Aleks Buda. Profesor Ballhysa solli një pasqyrë të pasur të kujtesës së tij dhe në mënyrë të veçantë të vlerësimeve të studiuesve të viteve të fundit për jetën dhe kontributin e tij në fushë të gjuhësisë shqiptare. Me kumtesën e tij, mund të themi se Ballhysa caktoi vendin e Rizës në historinë e albanologjisë.

Flutura Çitaku (Prishtinë), në kumtesën e dërguar me shkrim “Ndihmesat e profesor Selman Rizës në fushën e terminologjisë së gramatikës”, vlerësoi kontributin e profesor Selman Rizës në fushë të terminologjisë shkencore, në fushë të gramatikës përgjithësisht dhe në fushë të morfologjisë veçanërisht. Ajo solli një regjistër të tërë fjalësh e togfjalësish, me të cilat ai ka plotësuar fjalësin e gramatologjisë, leksikografisë dhe në mënyrë të veçantë të terminologjisë shkencore.

Shkëlqim Millaku (Prishtinë), në kumtesën “Studimet e Selman Rizës në fushë të morfologjisë”, u ndal në mënyrë të veçantë në kontributin e Rizës dhënë studimit të nyjës, krahasuar edhe me arritjet e kohës dhe me arritjet e gjertashme. Ashtu si edhe Riza edhe studiuesi i tij Millaku, nyjën e trajtoi në kontekst të zhvillimeve të saj historike, përkatësisht diakronike, e brenda saj edhe vlerën sinkronike. Kumtesa e Millakut ishte një përpjekje serioze për të sjellë një sintezë përgjithësuese për nyjën në kontekstin e gjuhës shqipe e të ballkanistikës, si dhe kontributin e Rizës për përcaktimin e vendit të saj në këtë rrjedhë.

Xheladin Zymeri (Prishtinë), në kumtesën “Problemet sintaksore në studimet gjuhësore të Selman Rizës”, përcaktoi pikat bazë të referencave në jetën shkencore dhe jetësore të Rizës, të cilat ai i tipologjizoi si: dija, glosologjia, veprimi dhe gjuhësia moderne. Pasi kujtoi kontributin e Profesor Rizës në fushë të gjuhësisë së përgjithshme dhe gramatologjisë, ai u mor në mënyrë të veçantë me kontributin e tij në fushë të sintaksës, duke theksuar vlerat stilistike dhe rendin e fjalëve në periudhë. Në këtë kontekst Profesor Zymeri konstatoi se ndërtimet sintaksore nuk janë vetëm arritje të gramatikës së sotme, por edhe të sintaksës së Rizës në mënyrë të veçantë.

Evalda Paci (Tiranë), në kumtesën “Pikëpamje të profesor Selman Rizës për “Mesharin” e Gjon Buzukut”, vlerësoi në mënyrë të shumanshme kontributin e Rizës në studimin e Mesharit të Gjon Buzukut, duke u ndalur fillimisht në konceptet e Rizës për përbërjen tri pjesëshe të tij. Më tej, studiuesja e pasionuar e letërsisë së vjetër Paci u ndal në krahasimin vlerësues të tij në kontekst të botimeve nga Justin Rrota (1939), deri te Eqrem Çabej (1968). Duke kujtuar vlerësimet e Rizës për studimin e Çabej, studiuesja jonë konstatoi se diferencimi i përbërësve të librit ka përcaktuar edhe metodën e qasjes së Rizës në Mesharin e Buzukut, të cilit ai ia kushtoi një pjesë të rëndësishme të kërkimeve shkencore. Në kumtesën e saj në mënyrë të veçantë ajo u ndal në vlerësimet e Rizës për krahasimet me traditën e përkthimeve, vërejtjeve të tij si përkthyes dhe pikëpamjeve të tij për botimin e Mesharit nga Çabej.

Ali Jashari (Korçë), në kumtesën “Smilari fjalëkrijues i profesor Selman Rizës”, u ndal gjerësisht në një varg kontributesh të Profesor Rizës në fushë të leksikut. Në këtë rrjedhë Riza vazhdoi atë traditë që kulmoi në periudhën e Rilindjes Kombëtare me Sami Frashërin, Naim Frashërin, Jani Vreton etj., dhe në periudhën mes dy luftërave botërore me Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvani etj. Megjithatë në parim ai nuk ishte purist, me kontributin vetanak, Riza ndihmoi shumë në shqipërimin e mjaft fjalëve të huaja. Përtej këtij angazhimi, Riza ndihmoi shumë në krijimin e fjalëve të reja e të termave në mënyrë të veçantë, përfundoi Profesor Jashari.

Begzad Baliu (Prishtinë), në Fjalën përmbyllëse tha se kjo konferencë shkencore synonte të përcaktojë kontributin e Profesor Selman Rizës në fushë të gjuhësisë. Gjatë një dite punimesh janë sheshuar kontributet e tij për metodologjinë shkencore, për studimet sociolinguistike, për marrëdhëniet e gjuhës së shkruar apo standardit me gjuhën e folur dhe dialektet, për studimet në fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes, për studimet ballkanike, për kulturën e gjuhës; për shqipen standarde; për shkrimtarët e vjetër të shqipes, për sistemin foljor të shqipes, për vendin e tij në jetën kulturore dhe arsimore të Korçës, për vlerësimet e tij nga bashkëkohësit, për ndihmesat në fushën e terminologjisë e të morfologjisë, për problemet sintaksore, për botimin filologjik të “Mesharit”, për smilarin fjalëkrijues, për konceptet teorike të tij mbi gjuhën dhe historinë e saj, për artin, për historinë, për atdhetarinë dhe përgjithësisht vendin e tij në studimet albanologjike.

Rrjedhimisht, në këtë rast janë sjellë një varg njohjesh të reja, vlerësime dhe kontribute të veçanta, të cilat, të përmbledhura në këtë vëllim të përbashkët do të jenë kontribut i mirë për studimet gjuhësore dhe albanologjike njëkohësisht.

Këshilli organizues:

Ali Jashari, Zeqirja Neziri, Begzad Baliu

Korçë-Shkup-Prishtinë, dhjetor 2009

FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS, MBAJTUR NGA REKTORI I UNIVERSITETIT TË KORÇËS, PROF. GJERGJI MERO

E nderuara znj. Nora Malaj, zëvendësministre e Arsimit dhe Shkencës,
I nderuar zoti prefekt i qarkut të Korçës,
I nderuar zoti kryetar i Bashkisë së qytetit të Korçës,
Të nderuar pedagogë, studentë dhe të ftuar të tjerë,
Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë,

Kam nderin që t'ju përshëndes të gjithëve dhe t'i uroj punime të mbara kësaj konference, që Universiteti i Korçës po organizon në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, si dhe me ndihmën e çmuar të profesorëve të Shkupit, Tetovës, të Universitetit të Tiranës, Elbasanit etj., të cilët i përshendes veçanërisht për gatishmërinë dhe mirëdashjen që treguan për të kontribuar në konferencën shkencore që ne po organizojmë sot, duke i siguruar se ata dhe institucionet që përfaqësojnë do të jenë bashkëpunëtorët tanë të denjë edhe në të ardhmen.

Në këtë fundviti 2009, institucionet akademike të hapësirës shqiptare nuk mund të linin pa kujtuar, vlerësuar dhe nderuar në mënyra të shumanshme 100-vjetorin e lindjes së njërit prej personaliteteve më të shquara të gjuhësisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, prof. Selman Rizën.

Mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës dhe të Universitetit të Korçës e realizuan shënimin e përvjetorit të lindjes së Profesor Rizës në kuadër të bashkëpunimit arsimor dhe shkencor për vitin 2009. Shënimi i këtij përvjetori të përbashkët mbështetet në faktin se Profesor Selman Riza është formuar për shumë vite në Liceun e famshëm të Korçës dhe ka qenë profesor në këtë Lice, ndërsa ka lënë gjurmë të thella në dijen shkencore të Institucioneve shkencore dhe arsimore të Prishtinës dhe të Tiranës.

Profesor Selman Rizës ka hyrë dhe mbetur në të gjitha dimesionet përfaqësuese si model i shkencëtarit dhe njeriut të papërkulur.

Kjo konferencë do të nxjerrë në pah dhe hedhë dritë mbi kontributet e tij për historinë e gjuhës shqipe, për marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me rrethin e gjuhëve indoevropiane dhe ballkanike, për prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës së tij, për gramatikën historike të shqipes, për studimet tekstologjike të autorëve të vjetër shqiptarë, për shqipen standarde, për konceptet teorike të tij mbi gjuhën, për vendin e tij në studimet albanologjike etj.

Prof. Riza ka hyrë dhe ka mbetur ndër ato figura të shquara, që luajti rol sipëror në lëvrimin dhe studimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, në hapjen e horizonteve të reja në studimin e gjuhës dhe të jo pak fushave të saj.

Selman Riza bën pjesë në ata të paktë burra dhe shkencëtarë të mendimit dhe të gjuhës shqipe, të kulturës dhe atdhedashurisë, që me jetën dhe veprën e larmishme i përket të dy anëve të kufirit, pra i përket njëherësh Shqipërisë dhe Kosovës, duke u shndërruar kështu në një urë të fortë kalimi ndërmjet shqiptarëve të dy anëve, madje një promotor përndritës i ndërlidhjes së pashqitshme të tyre.

Pikërisht për këtë arsye Selman Riza me jetën e tij të jetuar heroikisht dhe plot skarifica, në të dyja anët e kufirit, përmes vuajtjesh dhe peripecish të shumta, dhe sidomos vepra e gjerë studimore dhe shkencore, unike dhe origjinale në arritjet e veta, do

të kujtohet dhe nderohet brez pas brezi në Shqipëri dhe kudogjetkë.

Emri dhe fama e prof. Selman Rizës, aty ku e kanë lënë rrethanat dhe atmosfera e përjashtimit absurd, lidhet para së gjithash më shkencën e gjuhës, madje me disa nga fushat e saj më të vështira, ku do të veçoheshin ato të morfologjisë, historike dhe moderne, të kritikës gjuhësore, si dhe të tekstologjisë, gjuhësore dhe letrare.

Botimi i katër veprave të plota, të punës studimore dhe shkencore të Selman Rizës, nga ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, një punë e pashoqe në zbardhjen e dimensioneve të njeriut poliglot, që fliste dhe shkruante 12 gjuhë të huaja, por edhe që e zotronte në majë të gishtave gjuhën shqipe, gjuhën amtare, ku është përfshirë gati e gjithë puna shkencore e tij, me vepra të tilla si "Tri monografina albanologjike", "Gramatikë e serbo-kroatishtes", "Fillimet e gjuhësisë shqiptare", "Diftoret e shqipes dhe historiat e tyre", "Nyjat e shqipes", "Pronorët e shqipes", etj.

Të nderuar pjesëmarrës !

Pa dashur të hyj në detaje të punës e veprës së prof. Selman Rizës, sepse ato do të dalin nga kumtesat që do të mbahen nga profesorët e nderuar, nuk mund të lija pa përmendur diçka nga ajo vepër e madhe që ai na la pas, nga puna e tij që nuk e pushoi asnjëherë, nga emri i tij që do të kujtohet ndër shekuj.

Duke u nisur nga dëshira e përbashkët e dy universiteteve tona të Korçës dhe Prishtinës, ne mendojmë se kjo konferencë do të nxisë kërkimet e përbashkëta studimore për probleme të caktuara historiko-gjuhësore në interes të ndërtimit të një pamjeje sa më të plotë të historisë së albanologjisë, mbështetur në dijen përparimtare që shquante mendimin shkencor të Profesor Selman Rizës, do të afirmojë mendimin shkencor ndërmjet mësimdhënësve të universiteteve të hapësirës shqiptare, të përcjellë kërkimet shkencore në fushë albanologjike, të ndërtojë modelet sinkronike dhe diakronike të një pamjeje historike të zhvillimit të mendimit shkencor në fushë të albanologjisë etj.

Kam bindjen se kumtesat që do të mbahen në këtë konferencë, do të jenë një prurje e re në vazhden e studimeve dhe veprimtarive të tjera shkencore të organizuara në Universitetin e Korçës.

Edhe një herë ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

Faleminderit!

FJALA PËRSHËNDETËSE E ZNJ.NORA MALAJ, ZËVENDËSMINISTRE E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

I nderuar Zoti Rektor i Universitetit të Korçës, Prof. Gjergji Mero

I nderuar Dekani i Universitetit të Prishtinës Prof. Hasan Muja

Të nderuar përfaqësues të Pushtetit vendor,

Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës,

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Prof. Selman Rizës, njërit prej shkencëtarëve më në zë në lëmin e gjuhësisë shqiptare, njëherazi njërit prej luftëtarëve më konsekuentë kundër sistemeve diktatoriale të kohës së vet dhe të përpjekjeve të pandërprera të popullit të Kosovës për flakjen e zgjedhës serbe, më lejoni t'ju përshëndes të gjithë Ju të pranishmëve, në emër të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Prof. dr. Myqerem Tafajit, që sot, në këtë auditor, të kemi mundësi, të gjithë së bashku, të vlerësojmë dhe të sjellim në vëmendjen tonë këtë figurë të ndritur dhe të rëndësishme të albanologjisë shqiptare, siç është figura e prof. Rizës.

Në historinë e albanologjisë bashkëkohëse, një grup studiuesish ndër të cilët shquhen Eqrem Çabej, Selman Riza, Kostaq Cipo, Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli, jo vetëm që e bënë atë shkencë thellësisht shqiptare, por dhe orientuan për kërkime të mëtejshme të gjithë albanologët e huaj. Ndër ta një vend të veçantë zë Selman Riza, tek i cili bashkohet një shkencëtar i shquar dhe atdhetar i madh, njeriu me karakter të fuqishëm dhe i papërkulur ndaj diktaturave, që me vullnet të hekurt arriti në majat e shkencës, të cilës iu përkushtua. Njerëz të tillë janë të rrallë në historinë e çdo kombi dhe duhet të mbeten frymëzues për brezat. “Atdheu fillon te fjala” ka thënë poeti dhe në rrënjët e fjalëve, shkoi si parakusht, Selman Riza.

Për të vlerësuar veprën e një shkrimtari a shkencëtari, për ta analizuar atë me objektivitet detyrimisht duhet të nisësh nga jeta. Vepra nuk lind nga hiçi. Është jeta, rruga e saj e mundimshme, puna dhe sakrificat, pikësynimet e mëdha që e çojnë një njeri drejt suksesit. Përveç këtyre cilësive të domosdoshme, që Selman Rizës nuk i munguan kurrë, jeta i rezervoi shumë peripeci dhe mundime që vetëm një karakter i fortë si Ai mund t'i përballojë me dinjitet dhe stoicizëm. E penguan, por nuk e nënshtruan. Ai ishte bir i denjë i Kosovës martire. Ai ka dy vende në panteonin e kombit, si shkencëtar dhe si patriot, vende që nuk i zë dot kush.

Ai lindi më 25.12.1909 në qytetin e Gjakovës në Kosovë, një qytet me tradita të shquara atdhetare qysh gjatë Rilindjes sonë Kombëtare.

Pasi Kosova u shkëput dhunshëm nga trugu amtar në vitin 1913, me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, edhe Gjakova i kaloi Serbisë.

E gjithë popullsia e Kosovës iu kundërvu, madje në mënyrë të organizuar, me të gjitha energjitë e veta zgjedhës së re serbe, e cila më fort se nënshtrimin, kërkonte shpopullimin e Kosovës nga shqiptarët.

Të gjitha këto ngjarje dhe këto reprezalje, por edhe atë qëndresë heroike të masave popullore ndaj tyre, Selman Riza, ndonëse ende fëmijë i parritur, i përjetoi edhe

në familjen dhe farefisën e vet. Ato lanë mbresa të pashlyeshme edhe në formimin e tij të mëvonshëm si një atdhetar i papërkulshëm dhe veprimtar shoqëror.

E sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, qysh në moshë fare të njomë ai humbet edhe të atin, duke mbetur, veç dhembjes, në vështirësi të mëdha ekonomike, përballuar kryesisht me punën e duarve të së ëmës në avlimend. Shkollën fillore e nis në qytetin e lindjes. Aty njeh dhe adhuron Ibrahim Femiun, mësuesin e Mësonjëtores së Gjakovës, të cilit vite më vonë do t'i kushtojë një nga monografitë e veta, duke e quajtur “pedagog i lindur dhe apostull mëmëdhetar, i cili bashkë me abecenë më mësoi edhe elementet e shqiptarisë”.

Duke e ndier, edhe pse fëmijë, se një formim të shëndoshë për t'u vënë si duhet në shërbim të çlirimit dhe përparimit të Kosovës shqiptare ai mund ta merrte vetëm në Shqipërinë e lirë e jo në shkollat serbe, shumë shpejt, në moshën 13-vjeçare, do të kalojë fshehurazi kufirin shqiptaro-jugosllav dhe bashkë me një grup fëmijësh të tjerë gjakovarë do të vijë në Tiranë. Aty kishte një strehë për të gjithë djemtë e maleve. Kjo ishte shkolla plotore “Naim Frashëri” me konviktin e saj. Ajo numëronte atëherë rreth 130 nxënës, të gjithë me bursë shteti. Midis edukatorëve kosovarë të asaj shkolle, Selman Riza dallon sidomos Sadi Pejanin, të cilit do t'i kushtojë gjithashtu një monografi të vetën, ku e quan “prefektit t'im” “pionierit n'arsimin t'anë filluer t'idesë pedagogjike moderne me frymëzue vegjëlinë me shijen e jetës në natyrë dhe me dashtuninë e punës së krahut”. Në këtë shkollë Selman Riza do të kryejë çdo vit nga dy klasa, duke e përfunduar atë me rezultate të shkëlqyera brenda tre vjetëve e duke u cilësuar nxënësi më i mirë i shkollës.

Për emrin e madh që kishte si shkolla më e mirë e vendit, Selman Riza ëndërronte të vijonte mësimet në Liceun Kombëtar të Korçës dhe me këmbënguljen që e karakterizonte, ia arriti qëllimit. Komisioni francez i Liceut, i cili i përzgjidhte vetë nxënësit që pranonte, e renditi në krye të listës. Edhe në këtë shkollë ai do të jetë me bursë shteti (1925-1931).

Edhe në Liceun Kombëtar të Korçës Selman Riza do të shkëlqejë si nxënësi më sistematik e më këmbëngulës, me një vullnet të jashtëzakonshëm që nuk linte minutën t'i shkonte kot. Shprehja popullore “koha është flori” kishte gjetur te Selman Riza pa asnjë mëdyshje mishërimin e saj më të plotë. Jo vetëm në klasë, por edhe në oborrin e Liceut, Selman Rizën e shikonin të vetmuar qysh në agun e dritës, duke lexuar a duke përsëritur me zë të lartë.

Me një përkushtim të tillë ai i përfundoi me rezultate të shkëlqyera në gjashtë vjet të nëntë vjetët e liceut. Vlerësimet për të në çdo tremujor dhe vit ishin: “Nxënës shumë i i mirë në çdo pikëpamje”, “Nxënës me ngulm të fortë për punë”, “Nxënës i shkëlqyer, vetëm mund ta përgëzosh”, “Nxënës i shkëlqyer, siç ka qenë gjithmonë”. Dhe jo vetëm trupa mësimore e Liceut, por nuk ka ish-bashkënxënës të Liceut të Korçës që të mos e ketë këtë vlerësim për Selman Rizën. Kjo flet për mobilizimin e tij tërësor për mësimin dhe vetëm për mësimin. Ai nuk kishte asnjë kundërshtar çikërrimash, si ndodh rëndom në atë moshë.

Selman Riza kishte ikur nga Kosova me një premtim, me një peng që e kishte marrë me vete si shqetësim të përjetshëm. Të mos e harronte kurrë Kosovën, të mos i harronte kurrë hallet dhe brengat e saj, të punonte me të gjitha energjitë e veta fizike dhe mendore për të.

Siç shprehet vetë Selman Riza më vonë, për veten e vet “qysh atëherë problemin kombëtar ndërballkanik të Kosovës e bëra prokupimin politik (jo numër një, por) të vetëm të krejt jetës sime”.

Pasi përfundoi Liceun e Korçës me rezultate të shkëlqyera, duke u diplomuar në matematikë, Selman Riza vijon studimet e larta universitare. Drejtori teknik francez i Liceut i shkruan ministrit shqiptar të Arsimit të asaj kohe për të :”Selman Riza është një i ri i jashtëzakonshëm i talentuar, shumë serioz, i cili do të mundë me të njëjtën lehtësi të kryejë çdo degë të studimeve universitare dhe unë nuk dyshoj që ai të mos i bëjë më vonë nder atdheut të tij me emrin e vet”.

Kështu, ai fiton të drejtën për të vijuar studimet e larta në Tuluz të Francës, prej nga u kthye i pajisur me një formim të shëndoshë universitar, me dije dhe kulturë të gjerë e me një botëkuptim demokratik, me dy diploma: një për drejtësi dhe një për gjuhë-letërsi. Megjithëse iu ofrua punë në Kryeministri, ai nuk pranoi, por shkoi dhe u bë koleg me ish-mësuesit e tij të shquar, si drejtorin francez Ksavie de Kurvil, mësuesit Leon Perre, Baji-Komte etj., si edhe me shqiptarët Sotir Paparisto, Kostaq Cipo etj. Ai e njihte mirë etjen e madhe të rinisë shqiptare për dije dhe kulturë demokratike, për një edukatë të re. dhe Selman Riza do të emërohet në tetor të vitit 1935 mësues në Liceun e Korçës, në atë lice ku kishte bërë emër si njëri nga nxënësit më të aftë dhe më të zellshëm, në mos më i afti dhe më i zellshmi. Ai do të japë frëngjisht, shqip, latinisht e gjermanisht. Edhe në cilësinë e mësuesit Selman Rizën do ta karakterizonte thjeshtësia, korrektësia, kultura e gjerë dhe logjika e hekurt.

Ndonëse njihte mjaft mirë një numër gjuhësh, si frëngjishten, gjermanishten, italishten, serbokroatishten, latinishten e greqishten e vjetër, kur e pyesnin, ai përgjigjej me modesti se njihte shqipen dhe frëngjishten.

Për gjëra që nuk i dinte, Selman Riza nuk ndiente kurrfarë turpi të pyeste edhe nxënësit e vet, madje i nxiste ata jo vetëm të mos kishin druajtje, por përkundrazi t’i shprehnin lirisht pikëpamjet e veta.

Por duke u interesuar pa masë për t’u dhënë dije dhe edukatë të shëndoshë, Selman Riza nuk do ta harrojë kryesoren: edukimin e nxënësve të vet me ndjenja të larta e të pastra për Atdheun. Ai nuk do të reshte asnjëherë së propaganduari pikëpamjet e veta demokratike, nuk do ta pushonte asnjëherë luftën kundër synimeve pushtuese e aneksuese të Italisë fashiste ndaj Shqipërisë. Atë do ta gjeje gjithmonë e kudo bashkë me nxënësit e tij, në krye të demonstratave demaskuese kundër bashkimit të Shqipërisë në një mbretëri me Italinë fashiste.

E pikërisht për këto pikëpamje dhe për këtë luftë të pakompromis kundër pushtuesve italianë, ai do të arrestohet dhe do të internohet në Itali. I kthyer më në fund nga internimi, ai nuk pranon ta marrë shpërblimin për internime, as të punësohet nga Italia fashiste. Përkundrazi do të shkojë të punojë si sekretar në një firmë private në Durrës.

Po kalvari i mundimeve të tij nuk mbaron këtu. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, Selman Riza do të riburgoset, këtë herë nga diktatura komuniste me kërkesën e autoriteteve jugosllave, pasi gjatë luftës kishte zhvilluar aktivitet si njëri ndër udhëheqësit më të spikatur të Lëvizjes Antifashisteirredentiste në Kosovë. Pasi u mbajt gati dy vjet e ca i pagjykuar, i padënuar në burgjet shqiptare, siç del nga një raport tashmë i botuar në shtypin shqiptar, hartuar nga ish-ministri i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Kadri Hazbiu, dërguar Enver Hoxhës në vitin 1955, Selman Riza u deportua dhe iu dorëzua autoriteteve jugosllave në vitin 1947. Edhe në burgjet jugosllave ai qëndroi i pagjykuar, i

padënuar, deri në vitin 1951, kur u sëmur nga skorbuti dhe u nxor e u dërgua sa më larg shqiptarëve të Kosovës në Sarajevë, ku dha mësim gjuhë frënge. Pak më vonë punoi edhe në Prishtinë ku, sipas kumtesës së prof. Sadri Fetihut me rastin e 50 vjetorit të themelimit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, Selman Riza bëri një punë të jashtëzakonshme për themelimin dhe organizimin e punës së këtij instituti.

Me ndërrimin koniunktural të klimës politike, më 1955-ën, Selman Rizën e përzënë nga Kosova me argumentin se nuk pranon shtetësinë jugosllave, e madje nuk merr pjesë as në mbledhjet e punës së atyre autoriteteve, duke i quajtur ato punë të një shteti të huaj. Kështu e kthejnë në Shqipëri dhe vjen në Tiranë.

Menjëherë pas raportit të lartpërmendur të ministrit Kadri Hazbiu, ku thuhet fare hapur, “Selman Riza të cilin ne ua dorëzuam vetë jugosllavëve”, ai emërohet në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë, në sektorin e gramatikës, ku punoi për njëmbëdhjetë vjet rresht.

Janë të vetmet vite pune të vërteta e të qeta kërkimore, ku Selman Riza do të shpalosë formimin e tij filologjik dhe aftësitë e tij të mëdha shkencore.

Ai do të hartojë aty një numër studimesh monografike për mbarë strukturën e gjuhës shqipe në të dy planet – të sotëm dhe historik. Me monografitë e veta për emrat, përemrat, nyjat dhe foljet, me studimet e tij të thelluara për gjuhën e autorëve tanë të vjetër, Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani e Matrënga, ai dëshmohej si një njohës dhe studiues i përkushtuar i gjuhës shqipe.

Këto studime i përshkon një thellësi dhe aftësi e pazakonshme depërtuese dhe një dashuri e madhe për gjuhën shqipe, këtë thesar të kulturës sonë kombëtare. Ato shënojnë arritje shumëplanëshe, qortojnë një numër tezash e hipotezash të hedhura përpara tij nga studiues të ndryshëm dhe shtrojnë një numër jo të vogël tezash të reja vetjake, të argumentuara me një logjikë të pakundërshtueshme.

Edhe pse i paduruar e madje i padëshirueshëm për qëndrimet e tij jokonformiste, puna e tij bëri që ai të laureohet me Çmimin e dytë të Republikës. E gjithë vepra e Selman Rizës është botuar e plotë, në 4 vëllime më të mëdha në Kosovë.

Me fillimin e të ashtuquajturit “Revolucion kultural” kinez, jehona e të cilit u ndie, siç dihet, edhe në vendin tonë, për shkak të një fletërrufeje që ai bëri për mirorganizimin e punës në Institut dhe për përshpejtimin e përgatitjes së “Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe”, kundër tij shpërtheu një fushatë e tërë fyese e denigruese dhe nën petkun e qarkullimit u internua në Berat, ku punoi si ciceron i muzeut të atij qyteti, derisa doli në pension, më 1968.

Selman Riza vdiq në vitin 1988, i lënë në heshtje dhe i harruar nga diktatura komuniste, e cila kishte porositur të mos kishte as fjalë lamtumire në varrim, as njoftim në shtyp për vdekjen e tij. Por ai vdiq i ngushëlluar nga puna e vet e pandërprerë dhe nga postulati i tij jetësor: “Kush punon për Atdhe, nuk duhet të kërkojë shpërblim”, edhe pse kjo nuk përlligj mosmirënjohjen, e cila fatkeqësisht, sidomos në Shqipëri, ka ndodhur shpesh.

Vetëm një amanet i Selman Rizës kish mbetur pa u realizuar: “Mbetjet e një jete të truar, pa dallim gjithë bashkëkombasve të mi, dëshironj të më prehen atje ku kam lindur: në Kosovën shqiptare. Dhe ky amanet i këtij njeriu të madh u realizua.

“Profesor Selman Riza, - do të thotë kryeministri, në momentin kur do të realizonte amanetin e tij të fundit, përcjelljen e eshtrave për në Gjakovë – është një nga

kolosët e gjuhës sonë të bukur, por është dhe një nga kolosët e atdhetarisë, e dashurisë për Shqipërinë dhe Kosovën, i cili nuk u mposht kurrë. Klika obskurantiste e Enver Hoxhës syrgjynosi Selman Rizën, duke besuar dhe menduar se do ta mposhte. Ai sot është më i gjallë se kurrë. Selman Riza sot kthehet në Kosovën e tij të lirë dhe të pavarur për të cilën ai punoi gjatë gjithë jetës së tij, si pakkush tjetër. Unë dua të shpreh edhe njëherë nderimin tim më të madh për këtë kolos të shkencës dhe atdhetarisë shqiptare, për familjen e tij, por njëkohësisht edhe kënaqësinë time të madhe që ai, në përputhje me dëshirën e tij, kthehet në Kosovën e lirë dhe të pavarur”.

Është nder i veçantë, por edhe detyrim i thellë për të gjithë institucionet e kulturës dhe të shkencës të Shqipërisë dhe Kosovës, të trojeve etnike dhe të diasporës, që viti 2009 të shpallet viti i Selman Rizës, vit i njeriut që sakrifikoi si pak të tjerë për kombin dhe popullin shqiptar, për shkencën dhe kulturën shqipe, për lirinë e fjalës dhe të mendimit, për idealet humane dhe moderne, për begati dhe përparim të qenies shqiptare. Është në nderin e çdo shqiptari, e çdo institucioni shtetëror dhe shoqëror, shkencor dhe kulturor, që të japë ndihmesën e vet për ta çuar deri në fund amanetin e tij, që më tepër se dëshirë ishte dhe është një aspiratë hyjnore e një biri të madh të kombit shqiptar, e një apostulli të pakundshoqshëm të lirisë dhe vlerave njerëzore.

Faleminderit!

**PËRSHËNDETJA E KRYETARIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE E
ARTEVE TË KOSOVËS, AKADEMIK BESIM BOKSHIT, DREJTUAR
KONFERENCËS**

Të nderuar organizues e pjesëmarrës të Konferencës shkencore “Profesor Selman Riza dhe albanologjia”,

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ju përcjell mirënjohjen për organizimin e kësaj Konference shkencor për profesor Selman Rizën në 100-vjetorin e lindjes, vepra gjuhësore e të cilit është një ekspozitë e qëndrueshme e shkëlqimit të mendimit shkencor ndër ne, një shkallë krenuese në të cilën arriti gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Në Korçë Selman Ruza ka krijuar bazat e formimit të tij intelektual, ka krijuar veçantinë e tij, moralin dhe vizionin e tij shoqëror, për të ecur pastaj në rrugën e formimit shkencor e të një veprimtarie të shënuar patriotike.

Të nderuar pjesëmarrës, Akademia jonë e ka shënuar 100-vjetorin e lindjes së Selman Rizës me botimin e vëllimit të pestë të veprave të tij edhe në dorëshkrim, me botimin e një monografie të akademik Rexhep Ismajli për të, me botimin e shënimeve të tij, me rivarrosjen e mbetjeve të tij mortore në qytetin e lindjes, në Gjakovë. Aty është zbuluar edhe busti tij dhe është organizuar një simpozium shkencor.

Presidenti i Republikës së Kosovës zoti Fatmir Sejdiu e ka dekoruar Selman Rizën me Medaljen e Artë të Lirisë. Shënimi i këtij 100-vjetori do të përfundojë me Konferencën shkencore të organizuar nga të dy Akademitë tona më 14 dhjetor në Tiranë.

Konferenca juaj shkencore sjell një zë të nevojshëm nga Korça për respektin dhe nderimin tonë të përbashkët ndaj këtij personaliteti të rrallë që në kushte të rënda të jetës, të përndjekjeve, burgosjeve, të depërtimeve e të ndalesave të së drejtës për botim, krijoi veprën shkencore të kualiteteve kulmore albanistike.

Uroj që kjo Konferencë shkencore të arrijë rezultate të shënueshme në trajtimin e çështjeve që shtron vepra gjuhësore e Selman Rizës.

Ju shkoftë puna mbarë!

Kryetari i ASHAK
Akademik BESIM BOKSHI

Prishtinë, 3 dhjetor 2009

PËRSHËNDETJA E PREFEKTIT TË QARKUT TË KORÇËS, Z. KOÇO BELLO

E nderuara znj. Nora Malaj, zëvendësministre e Arsimit dhe e Shkencës,
Të nderuar drejtues të Universitetit “Fan Noli”,
Të nderuar miq, e të ftuar!

Kam nderin të përshëndes Konferencën Shkencore Ndërkombëtare, për Profesorin e nderuar, Selman Rizën për punën e tij shkencore në fushën e albanologjisë.

Të flasësh për intelektualin e shquar Selman Rizën, si shkencëtar dhe atdhetar të madh, si njeri me karakter të fuqishëm dhe të papërkulur ndaj dy regjimeve të kohës, nga regjimi serb në Jugosllavi dhe nga pushtetarët komunistë në Shqipëri, duhen shumë seanca plenare. Nuk ka penë aq të fuqishme që të shkruajë mbi jetën e profesorit, qysh në fillimet e jetës, si student në Liceun Francez, dhe më vonë si profesor i tij, ku u dallua për bindje demokratike, në organizimin e protestave dhe demonstratave me studentët kundër pushtuesve.

Ëndrra për bashkimin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera të Jugosllavisë me shtetin shqiptar, e shoqëroi gjatë gjithë veprës së tij. Vepra e tij nuk lindi nga hiçi, por është një jetë e gjatë, një rrugë e mundimshme, punë e palodhur që e çoi këtë njeri drejt suksesit të merituar.

Jeta i rezervoi shumë peripeci dhe mundime, por falë karakterit të tij të fortë, ai mundi ta përballojë me dinjitet. E penguan, por nuk e nënshtruan, e internuan, por nuk e vdiqën, por si bir i denjë i Kosovës martire ka dy vende në panteonin e kombit shqiptar, si shkencëtar në historinë e albanologjisë, që me vullnet të hekurt arriti në majat e shkencës, të cilës iu përkushtua, dhe si atdhetar, ku me shkrimet e tij në revistat e viteve '30 në mënyrë të kulturuar e të kultivuar, shprehte idetë përparimtare, që edhe sot meritojnë vëmendje të veçantë.

Janë vepra të rëndësishme albanologjike që mbajnë emrin e tij dhe ngritën në një shkallë të re cilësore gjuhësinë shqiptare si dhe mendimin shkencor. Me punën e tij shkencore luftoi për shkencë e kulturë të pavarur nga politika.

Me logjikë argumentuese, me forcë krijuese dhe origjinalitet të spikatur, profesor Selman Riza shtriu studimet e tij shkencore në fusha të tilla, siç janë gramatika, historia e gjuhës, gjuhësia e përgjithshme etj.

Me kredon e tij të metodave shkencore ai prodhonte punë, duke qenë një gjuhëtar kritik në përmbushjen e një funksioni të rëndësishëm shkencor, duke luftuar diktaturën komuniste që ishte armike e së vërtetës, të përparimit e të lirisë.

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes të profesorit të nderuar Selman Riza, ne kujtojmë veprën e tij, kujtojmë luftëtarin e paepur për çlirimin e Kosovës dhe çështjes shqiptare, kujtojmë ndjekësin e papërkulur dhe pa kompromis për çdo gjë antikombëtare, për të cilën u përdoq gjithë jetën, por nuk u nënshtrua.

Profesor Selman Riza mbetet po aq edhe një nga gjuhëtarët më të shquar në fushën e albanologjisë, ku shkenca shqiptare i detyrohet së tepërmi.

Ju faleminderit.

PROFESOR SELMAN RIZA DHE ALBANOLOGJIA

Fjala hyrëse

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Një shekull më parë lindi njëri prej personaliteteve më të mëdha të gjuhësisë shqiptare, Selman Riza. Kur një ditë antropologët dhe fushat e tjera të dijes do të merren me personalitetin e tij, kujtoj se me të drejtë në karakterin e tij epik do të gjejnë shumë referenca historike të kësaj kohe, të cilat ishin vulosur thellë në shpirtin e tij.

Ditëlindja e tij përkon me kohën e kryengritjeve të mëdha për pavarësinë e Shqipërisë. Një perandori juglindore (osmane) po perëndonte dhe një perandori verilindore (ruse) po rikrijohej. Edhe e dyta, si edhe e para, horizontin e fundit perëndimor e mbyllte në kufijtë fundorë të hapësirës shqiptare.

Gjakova, vendlindja e fëmijërisë së Selman Rizës, që dy dekada më parë kishte thyer mitin e paprekshmërisë së pashallarëve turq, ishte bërë pikërisht objekt i sulmit, i vrasjes, i djegies dhe i rrënimit material e shpirtëror të popullsisë shqiptare nga xhandarët e ushtarët serbë.

Është e kuptueshme prandaj pse me jetën e tij, si edhe me përkushtimin këmbëngulës kritik në veprën shkencore, Selman Riza do të bëhet shembull i përkushtimit atdhetar ndaj tri shtyllave që patën më së shumti ndikim në ndërtimin e vetëdijes kombëtare dhe shtetërore të shqiptarëve të shekullit XX: gjuhës (prej historisë së saj deri te ortografia), etnologjisë (Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe i Skënderbeut) dhe Kosovës. Në këto rrethana u krijua edhe personaliteti i tij¹.

¹ *Autobiografia e Selman Rizës 1909-1959*: Lindur më 1909 në Gjakovë, mbetur vetë i treti vëlla që në vegjëli pa baba e pa shtëpi banimi t' onën, rritur me t' ardhurat e një cope tokë, me qiranë e tre dyqaneve të vegjël dhe me fitimet e punës së parreshtur të nënës në avlëmend.

Kapërcyer ilegalisht kufirin jugosllavo-shqiptar më 1922, mbaruar shkollën plotore gjashtëvjeçare në Tiranë më 1925.

Kryer brenda 6 vjetësh 9 klasët e Liceut e Liceut Kombëtar në Korçë më 1931.

Shërbyer 1 vit në Ministri t' Arsimit si sekretar i dytë i seksionit fillor.

Kryer brenda 3 vjetësh dy fakultetet të letërsisë dhe drejtësisë në Tuluz (Francë) 1932-1935.

Me një ndërprerje 6 muajsh përgatitje studimi për doktoratë në Vjenë (Austri), shërbyer si profesor i frëngjishtes, shqipes, latinishtes, gjermanishtes në Liceun e Korçës 1936-1939.

Për shkak qëndrimi dhe agjitacioni antifashist, në dhjetor 1939 transferohet në gjimnazin e Tiranës dhe në shkurt 1940 internohet në Ventotene (Itali).

Mbas çlirimit nga internimi tetor 1941, hyrë sekretar provat në firmën tregtare "Ai Kruja&Asim Myshqeta", Durrës deri në maj 1949.

Korrik 1942- dhjetor 1943 vepruar haptazi si përfaqësues në gjyq në Prizren, fshehurazi si propagandist kundër rikthimit të dominacionit jugosllav në Kosovë.

Në këto rrethana Selman Riza ndërtoi gjedhën e tij prej gjuhëtari, shkencëtari, atdhetari, kundërshtari të fashizmit, të nacizmit dhe të komunizmit.

Mbi këto parime dhe rrethana, të vështira që në fëmijëri, Prof. Selman Riza u bë pa mëdyshje një nga mendjet më të mprehta të shekullit të XX, në mbarë botën shqiptare. Vepra shkencore e tij u shtri në shumë fusha e në shumë lëmenj, siç janë gramatika, tekstologjia, terminologjia, kritika gjuhësore, historia e gjuhës, gjuhësia e përgjithshme, gjuha letrare etj.

*

Do të kisha dashur këtu që të merrem me vlerësimin e veprës së tij duke u mbështetur në diskutimin e veprave themelore të tij, por hapësira e një fjale si kjo më mundëson eventualisht ridimensionimin e veprave të tij, duke u mbështetur në tipologjizimin e saj në kontekst të zhvillimeve historike e jetësore të tij:

Në përmasa jetësore kemi periudhën e fillimeve të tij shkencore: ortografia, etnologjia dhe Kosova, si dhe një jetë që përplasej ndërmjet lëvizjeve politike shqiptare-jugosllave. Ishte krijuar një personalitet që as të lihej as të mbahej, mes interesave politike jugosllave dhe interesave ideologjike shqiptare.

Në leksikonin e biografive të intelektualëve shqiptarë zor të gjesh një biografi më tragjike se kjo e Selman Rizës: fëmijërinë e jetuar në Jugosllavinë mbretërore, rininë e ndërtuar në Shqipërinë mbretërore, pjekurinë e angazhuar ndërmjet Shqipërisë dhe

Në dhjetor 1943 botuar një trakt me një përmbajtje programatike që mund të quhet Manifest i iridentizimit antifashist, ku objektivi imediat i luftës kundër okupatorit italian, i objektivit të luftës kundër rikthimit të okupatorit jugosllav, e për pasojë luftës së mëtejme për bashkimin e Shqiptarëve të Kosovës me popullin dhe me shtetin shqiptar.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 1944 përgatitur në Tiranë për botim legal një punim prej 200 faqesh me titullin: “Dokumentar i kundërtëzës shqiptare” për të rrëzuar tezën serbomadhe rreth çështjes nacionale në Kosovë.

Në korrik 1944 larguar nga Tirana për në Prizren, në shtator tërhequr familjen nga Prizreni për në Tiranë, në dhjetor kthyer edhe vetë në Tiranë.

Në janar 1945 arrestuar në Tiranë si kosovar antijugosllav dhe në prill po të atij vitit me urdhër të Koçi Xoxës nisur për dorëzim Jugosllavëve, por në udhëtim e sipër kthyer me kundër-urdhër të shokut Enver.

Në janar 1948 nga i njëjti Koçi Xoxe dorëzuar të njëjtëve jugosllavë.

Mbajtur në burgun e Prishtinës deri në gusht 1951, e në këtë datë liruar pa gjykim nga Burgu i Prishtinës, por me banim të detyrueshëm në Sarajevë.

Gjatë viteve 1952, 1953, shërbyer si lektor i frëngjishtes në Universitetin e Sarajevës, dhe gjatë viteve 1954-1955 si punues shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Në dhjetor 1955, me iniciativën jugosllave, por si rezultat i vullnetit t’im të pandryshueshëm për të ruajtur shtetësinë shqiptare, riatdhesuar në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Në janar 1956 emëruar punues shkencor në Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë në Tiranë.

Tiranë 30. XI. 1959.

Selman Riza

Shtojcë: Më 1967 internuar në Berat.

Më 1970 i pensionuar dhe i kthyer në Tiranë pa të drejtë botimi.

Më 1988 vdes në Tiranë.

Kosovës (gjatë Luftës së Dytë Botërore), pas luftës së Dytë, i arrestuar nga Qeveria e Tiranës me urdhër të Qeverisë së Beogradit dhe i mbajtur në paraburgim pa gjyq; i dorëzuar te autoritetet policore jugosllave dhe i mbajtur tri vjet në burg pa gjyq në Burgun e Prishtinës, duke ia lejuar edhe mundësinë për marrje me studime; i internuar në Sarajevë por i lejuar për të mbajtur leksione në Universitetin e Sarajevës; i kthyer në Prishtinë në cilësinë e punonjësit të Institutit Albanologjik, por që përfaqësonte edhe ‘drejtorin teknik’ të tij; i dorëzuar te organet shqiptare me tri “arsye”: 1. se nuk pranonte nënshtetësinë jugosllave (sipas vet autorit); 2. se kërkonte të shkonte në Gjermani (sipas një shënimi të autoriteteve shqiptare që e pranuan në kufi, afër Kukësit) dhe; 3. sepse kishte pranuar të kthehej në Shqipëri me kërkesën e jugosllavëve për të kryer spiunazh të dyfishtë për ta (sipas burimeve të ndërmjetme); i punësuar në njërin prej institucioneve më të larta shkencore shqiptare ky ndërtoi personalitetin më të lartë shkencor në botën shqiptare, duke mbajtur nën rrogë edhe kritikën e konceptet teorike të saj; i dëbuar nga Tirana në Berat pa të drejtë botimi, por i lejuar që të punojë ciceron në Muze; i pensionuar para kohe dhe i nëpërkëmbur nga institucionet politike e shkencore, por edhe i nderuar nga personalitete që përtej përfaqësimit politik të institucioneve shkencore përfaqësonin institucionin moral e kombëtar të biografisë së tyre.

Në të njëjtën kohë Selman Riza ndërtonte modelin e të qenit. Personalitetin e tij ai e ndërtonte edhe në modelin shkencor të veprës së tij: përshkrimin, kritikën, vlerësimin, studimin dhe rindërtimin, kudo ku punoi dhe çdo gjë që ndërmori.

Në shkencën e gjuhësisë, ai u angazhua nga përshkrimi i ortografisë apo i gramatikës e teksteve letrare, deri te kritika historike ndaj bashkëkohësve dhe madje deri te rindërtimi teorik i kursit heterodonist.

Po në të njëjtën kohë dhe në kushte e rrethana të vështira ai ndërtonte institucionin e albanologjisë: nga themeluesi i Qendrës së Vogël të Studimeve Kosovare (në Prizren 1943) te ‘drejtori teknik’ i Institutit Albanologjik të Prishtinës (1953-54) dhe madje te përpjekja për të riorganizuar filozofinë e drejtimit të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë në Tiranë (1967).

Në tipologjinë e strukturës së veprave shkencore të tij vendin e parë e zënë Studimet ortografike: Tri monografia albanologjike, 1944; Fillimet e gjuhësisë shqiptare 1952; Çështja e paskajores (1959); Si duhen emërtuar shqip elementet e parë të anës shqiptimore të të folurit si dhe dy grupet e tyre më kryesore, 1964, me të cilat ai bënte kërkime dhe sinteza ndërmjet historisë së gjuhës, sociolinguistikës dhe madje etnografisë.

Duke bërë kërkime ndërmjet historisë së gjuhës, arritjeve të kohës dhe vlerësimeve të tyre, Profesor Riza, shkruan dhe i boton disa prej atyre studimeve që këtu do të mund të sistemoheshin në syzimin: Studimet kritike e historike-gjuhësore: Për periodizimin e historisë së gjuhës, Përshkrimi i sistemit foljor shqip nga K. Kristoforidhi e S. Frashëri; Çështja e paskajores në shqipe, 1959; Për plotësimin dhe qëndrueshëmimin të terminologjisë shqipe, 1955; Shqyrtimi kritik i disa termineve në vetëvehte dhe në krahasim me të Xhuvanit etj. Fjala është për studimet historiko-gjuhësore me të cilat Selman Riza bën hapat e parë drejt mendimit kritik në fushë të studimeve në historinë gjuhësore dhe letrare të autorëve të vjetër në mënyrë sistematike: Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, 1961; Dy versionet e veprës së Bogdanit, 1962; Diseksioni i tezave mbi tre dorëshkrimet e Katekizmit të Matrëngës, 1962; Vehtësia dhe veprat e Pjetër Budit (1566-1622), 1977; Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe 2002 etj.

Një kapitull më vete paraqesin Studimet teorike-gjuhësore, të nisura së shkruari në fillimet e mendimeve të tij shkencore dhe të përfunduara në fund të jetës së tij, me një shkëputje në mes, me gjasë kur ai merrej ekskluzivisht me gramatikë: Fjala është për studimet dhe sintezat teorike-letrare: “Linguistika, filologjia dhe gramatika deskriptive”, 1955; “Një cikël seminaresh mbi problematikën metodike në gramatikën deskriptive”, 1956; Kurs i një filozofike heterodokse, ose nga logjika e linguistika në “intelektologjinë” e “komunikativistikën” etj.

Studimet gramatikore, një prej dy “dashurive” të tija, janë monumenti më i rëndësishëm që na e ka lënë trashëgim Profesor Riza. Monografitë fundamentale të arritjeve të tij, si “Nyjat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër”, 1968; “Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore”, 1966; “Nyjat e shqipes”, 1958; “Pronorët e shqipes (punim historik-kritik)”, 1959-1960; “Pronorët e shqipes (punim përshkrues-normativ)”, 1960; “Dëftorët e shqipes dhe historiat e tyre”, 1953, paraqesin modelet edhe sot bashkëkohore të kërkimit në fushë të morfologjisë, arritjet e të cilave, shkruante Profesor Riza, në mos janë tejkaluar, së paku janë të nivelit të dijes teorike evropiane.

Studimet etno-historike, filozofike dhe politike, janë një dashuri tjetër e tij, sikur shprehej Riza, e që këtu do t’i quaja tema e madhe e Kosovës dhe e botës që e rrethonte. Është sigurisht kontributi më i panjohur i tij në fushë të letrave: Fjala është për artikujt dhe veprat me karakter polemizues “Serbët dhe kosovarët”, “Manifesti i iredentizmit antifashist”, “Dokumentar i kundërtës shqiptare”; studimi monografik për Kanunin e Lekë Dukagjinit, studimi për “Skënderbeun në letërsinë botërore” e deri te dorëshkrimi i tij i sapobotuar “Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme”, në të cilën është përvijuar në formë të shkruar fati i tij personal dhe shkencor.

Në botën shkencore shqiptare, personaliteti i Profesor Selman Rizës dhe vepra e tij për një kohë të gjatë nuk kanë qenë objekt trajtimi dhe madje referimi, në krahasim me shtigjet që ka hapur në fushë të albanologjisë dhe konceptet shkencore që ka përdorur në veprën e tij. Në këtë drejtim më shumë është përfolur për studiuesin “me prirje të skajshme kulturore e shkencore”, “për kapriciozitetin e tij shkencor e mendor”, “për këmbëngulësinë e tij metodike e shkencore”, përmes të cilave përpiquej të përvijonte të gjitha vlerat shkencore, madje pa përjashtim. Prandaj, konceptet e tij kritike-shkencore lidhur me metodën kërkimore dhe shkencore të bashkëkohësve të tij, nuk kanë të bëjnë me konfrontimin e koncepteve më të avancuara shkencore të Profesor Selman Rizës, përballë koncepteve të kohës, por me koncepte të natyrës thjesht gjuhësore që insistonin t’i diktonte në fushë të albanologjisë së shekullit XX, e që lidheshin me historinë e gjuhësisë shqiptare, gramatikën e sotme të shqipes, botimin filologjik të vepra të letërsisë së vjetër dhe sidomos metodologjinë e kërkimeve bashkëkohore në këtë fushë. Për fat të keq, kompleksiteti i këtyre diskutimeve dhe jo vetëm në një rast të vetëm, nuk është parë duke u nisur nga kodi i koncepteve metodologjike të cilave u përmbahej Profesor Riza, por duke ndërthurur disa elemente arbitrare ekstrashkencore të cilat në një qasje tjetër nuk mendoj se reflektojnë thelbin e çështjes së diskutuar brenda kërkimeve teorike, praktike dhe metodologjike.

Të dhënat e njohura tash së fundi nga dokumentet dhe dorëshkrimet e tij kujtojnë se janë dëshmi të mjaftueshme që Profesor Selman Riza nuk kishte konflikte personale për çështje ekstrashkencore. Përkundrazi. Nëse kishte mosmarrëveshje të caktuara, ato nuk

lidheshin me çështje personale, por me trashëgiminë arsimore dhe shkencore ndërmjet profesor Rizës dhe modeleve që ofronte shkolla shqiptare e kohës. Pra, fjala është për konceptet shkencore të shkollave që përfaqësonin. Vetëm duke u nisur nga këto parime ne mund t'i kuptojmë diskutimet e tyre, një pjesë e të cilave mbeten në dorëshkrim. Profesor Çabej, bie fjala, nisej nga baza historike dhe deskriptive e çështjeve dhe rezultatet i nxirrte duke u mbështetur në përgjithësimet e këtyre çështjeve. Profesor Riza që në fillim, nisej nga problematizimi i çështjeve, prandaj rezultatet e tij dilnin nga rikonstruktimi dhe diskutimi kritik i tyre, duke nxjerr rezultate krejtësisht vetjake.

Nuk është e rastit që në gjysmën e dytë të shekullit XX Eqrem Çabej ndër bashkëkohës do të bëhet bardi i idealistëve të gjuhësisë shqiptare, ndërsa Selman Riza kritiku i saj. Unë besoj se do të kuptohem drejt nëse sot, si edhe disa vjet më parë, më lejohet të konstatoj se në gjuhësinë shqiptare aty ku mbaron shkolla historike e Mahir Domit, Eqrem Çabejt, Idriz Ajetit, Jup Kastratit e të tjerë, maja të dijes shqiptare, aty fillon shkolla kritike e Selman Rizës.

Le të jetë kjo njëkohësisht arsyeja që të shpresojmë se vepra e Profesor Selman Rizës tashmë do të na prijë në fillim të shekullit XXI. Nëse Selman Riza, bardi i mendimit kritik në shkencës shqiptare, nuk kuptohej dje për shkaqe ideologjike, a do të mund të kuptohej sot përtej shkaqeve gjuhësore. Pavarësisht nga niveli i kuptimit të veprës së tillë, shpresoj që me Profesor Rizën do të ndodhë ajo që thuhet për Albert Ajnshtajnin: “të duam për aq sa nuk të kuptojmë”, në mos edhe për Alan Bosque “të duam sepse të kemi sharë”!

E Profesor Riza ishte jo rrallë i pakuptueshëm, jo rrallëherë i sharë, natyrisht tashmë përgjithmonë i nderuar.

SELMAN RIZA: METODOLOGJIA SHKENCORE DHE DILETANTIZMI

Selman Riza është një ndër figurat e mëdha të këtij vendi që, me kontributin që dha, radhitet në plejadën e korifejve, të cilët i japin nder e krenari këtij trualli, duke zënë një vend të rëndësishëm në shtratin kulturor kombëtar.

Pyetjes se ç'gjë i bën këta njerëz kaq të mëdhenj, për të merituar në vite respekt e mirënjohje nga brezi në brez unë mendoj se gjithë kjo te Selman Riza mund të përmblihet në tri fjalë: thjeshtësia, atdhetaria dhe zotësia.

Selman Riza lindi në qytetin e Gjakovës më 25.12.1909. Arsimin fillor e kryen në qytetin e lindjes, ku njihet dhe miqësohet me mësuesin e Mësonjtores, Ibrahim Femiu, të cilit më vonë do t'i kushtojë dhe një monografi në vlerësim të figurës së tij. Në moshën 13 vjeçare vjen në Tiranë në shkollën plotore "Naim Frashëri", ku njihet Sadi Pejanin, të cilit gjithashtu do t'i kushtojë një nga monografitë e veta, duke vënë në dukje zotësinë e tij profesionale dhe frymëzimin që ngjallte për brazat e rinj. Në Liceun Kombëtar të Korçës, ashtu si dhe në shkollat e mëparshme, ai do të shkëlqente për rezultate shumë të mira në mësim dhe për një edukatë shembullore. Studimet në Francë do t'i kryente për drejtësi dhe për gjuhë-letërsi, por nuk pranoi asnjë punë në burokracinë shtetërore. Pasioni i tij ishte mësimdhënia dhe kërkimi, dy veti këto që, së bashku edhe me thjeshtësinë, korrektësinë, kulturën e formimin e gjithanshëm, e bënë këtë njeri krejt të veçantë e tërheqës. Të gjitha këto tipare do të vinin dhe do të dilnin më në pah kur punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si dhe në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë në Tiranë. Në këto dy qendra kërkimore Selman Riza do të shpalosë gjithë formimin e tij filologjik dhe aftësitë e mëdha shkencore. Ai do të hartojë një numër studimesh monografike për strukturën e shqipes, e parë kjo në të dyja rrafshet sinkronike dhe diakronike.

Monografitë e tij për emrat, përemrat, nyjat dhe foljet; studimet e mprehta rreth autorëve të vjetër si: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani e Matrënga, metodologjia e rreptë shkencore e zbatuar në to nëpërmjet debatit shkencor të tezave dhe hipotezave të hedhura nga studiues të ndryshëm, si dhe tezat e reja të hedhura prej tij për çështjet në fjalë me argumente bindëse dhe një logjikë formale të veçantë, dëshmojnë se Selman Riza ishte armiku më i madh i eksperimenteve parashkencore, i empirizmit vulgar e i kompilimeve anonime. Siç do ta shtjellojmë më tej, ai ishte kundër konformizmit në përqasjen e mendimeve shkencore. Ishte kundër diletantizmit në shkencë, kundër pseudoshkencës e pseudoshkencëtarëve, gjë që dëshmohet qartë në përmbledhjen katërvëllimshë të veprës së tij.

Për këtë çështje na ka tëhequr vëmendjen një nga *sprovat* e tij, në formën e një pamfleti me titull "Diletantizmi dhe mjeshtëria"². Ja si e fillon shkrimin autori: "Diletantizmin e gjejmë pa fjalë në çdo vend të botës së qytetëruar dhe në çdo lëmë të diturivët e të mjeshtërivët. Mirëpo mua s'më besohet që diletantizmi të lulëzojë gjëkundi gjetkë si ç'lulëzon përgjithësisht n'Shqipëri dhe n'albanologji posaçërisht. Le që "Shqipot" e kanë shtrëmbëruar domethënien e diletantizmit aqë sa e kanë e bërë një rrezik shoqëror këtë përdorim të mençur dhe të dobishëm të ngesë shoqërore. Dhe me të vërtetë, në qoftëse diletantizmi për të huajtë e qytetëruar është një lloj sporti, pas të cilit

² Marrë nga "Përpyjekja shqiptare", Tiranë, janar, 1938, nr.13, fq 82-84.

jepen vetëm kur lihen të ngeshmë nga ushtrimi i mjeshtërisë që kanë mësuar, shumica e diletantëve t'anë e kanë këtë sport për profesjon".

Përse ndodh që diletantizmi përzihet me mjeshtërinë - pyet autori. Në përgjigje të kësaj pyetjeje ai jep tri argumente. Argumenti i parë ka të bëjë me ngatërrimin e zotësisë profesionale me të ashtuquajturën "zgjuarsi natyrale". Argumenti i dytë flet për ngatërrimin e mjeshtërisë me "virtytin e praktikës" sipas parimit "të mëson puna vetë". Së treti, mungesa e zotësisë profesionale argumentohet me vetë shoqërinë në tranzicion dhe se "me të marrë fund periudha e tranzicionit, në të cilën sot për sot ndodhet vendi ynë, do të shuhet njëherthi edhe faza e profesionistëve t'improvizuar".

Në vijim dijetari Riza rreket të sjellë në vëmendjen tonë edhe faktorët që ndikojnë në gjallimin e diletantizmit në tërë jetën shoqërore. Faktori i parë është ai sociologjik se "nevojët shoqërore ... kënaqen shumë më vonë se sa lindin edhe shumë më ngadalë se sa përhapen". Faktori i dytë është etnologjik se "një popull pa pothuajse kurrëfarë qytetërimi lëndor nuk munt të mos e vëjë në dyshim, bile, të mos e mohojë krejt effikacitetin e përgatitjes teorike". Autori e shpjegon mungesën e zotësisë profesionale me "padurimin shpirtëror edhe me paqëndrueshmërinë fiziologjike mbë një anë edhe m'banë tjetër me mungesën në këtë pikëpamje të traditave kombëtare, të vetiravet të trashëguara". Për të argumentuar këtë ide ai i referohet fjalorit të gjuhës shqipe, ku mungon, bie fjala, thuajse gjithë terminologjia artizanale, e cila duket të jetë trashëguar nga turqishtja e sllavishtja. Selman Riza shprehet se burrat e dheut tonë kishin më shumë qejf "ndeshjet luftarake" se sa "punët modeste dhe monotone të paqes". Me keqardhje ai pohon, duke përdorur një fjalë turke, se "mungon sevdaja për zanatin", e cila është më e shprehur në popuj të tjerë si: Frëngjët, Gjermanët a Bullgarët.

Kjo *sprovë* është njëkrahësisht edhe një amanet i Selman Rizës për brezat e tij dhe ata të ardhshëm: "dashuria e mjeshtërisë është cilësia kryesore, virtyti themelor për kohën e paqes". Duhet përhapur te "të vegjlit e sotmë sevdan e zanatit" Kjo duhet të jetë edhe një nga objektivat e Ministrisë së Arsimit. Ja si shprehet ai: "Po s'u shtumë brezit të ri durimin shpirtëror dhe qëndrueshmërinë fiziologjike, po nuk i futmë ata në mësonjtoren e seriozitetit edhe t'autokritikës në punë; po i lamë të pandehin edhe ata se e ashtuqojtura zgjuarsi natyrale e bën të tëpërtë përgatitjen mjeshtërore; se jo përkatësia profesionale por encyklopedia e përciptë ase dallaveret e akrobaleku janë hapësi magjik q'i i çel dyert e pozitavet llokmë-mëdha; po nuk u shkulmë atyrevet prirjen e trashëguar për hec-e-jaket plot gjallëri të dukëshme por pa pikë jete të brendëshme, për bredhjet gjahëtare nëpër shkenca e nëpër mjeshtëri; shkurt, po nuk çrrënjomë atyrevet shpirtin aventurier dhe karrierist mbë një anë dhe mbë anë tjetër po nuk i bintmë ata se, ndërsa përpëlitet e ambicjes banale na hanë nervat, na prishin gjaknë; ushtrimi i një mjeshtërije, përkundra, me rythmin monoton por qetësonjës, me frymën e egër por të shëndetëshme, me kurajon e përditshme, me bekimin e pemëve ... na jep dorë t'a trajtojmë karakterin, të bëhemi burra, dua të them, edhe t'i zhvillojmë mundësit mendore e ndjenjake, të bëhemi njerzë, dua të them, me një fjalë, po s'i bintmë brezin e ri se vetëm e vetëm ushtrimi i një mjeshtërije i fal jetës përmbajtje edhe kuptim ...", vendi nuk do të zhvillohet e begatohet.

ÇËSHTJE TË STUDIMIT TË SOCIOLINGUISTIKËS NË VEPRËN E PROF. SELMAN RIZËS

Veprimtaria shkencore-gjuhësore e prof. S. Rizës, aq e gjerë dhe aq e thellë, paraqet interes, ndër të tjera, edhe për kërkimet sociolinguistike. Ajo ngërthen në vete një mal të tërë trajtesash dhe indeksorësh që njëkohësisht janë dëshmi të kulturës së lartë jo vetëm gjuhësore, por shumëfushore të këtij studiuesi të spikatur të dijes shqiptare.

Ky formim i gjerë kulturor, i shtrirë edhe në dijet filozofike si p. sh. në hojristikë, d.m.th. në zotësinë për njohje të reja, në aksiologji, gnoseologji, hermenautikë etj. i krijonte atij themelin e heterodoksisë së kundërimit autonom e kritik. Prandaj, në një përfrim vrojtimesh, mund të thuhet se, sic vuri në spikamë edhe akademik Rexhep Ismajli në Simpoziumin e Gjakovës për këtë dijetar, ai ishte Sokrati shqiptar ose Hegeli shqiptar ose Sosyri shqiptar etj.

Profesor Riza gjuhën e studioi në dritën e rrethanave të zhvillimit historik të shoqërisë shqiptare dhe në këtë mënyrë trasoi hullinë e konstituimit të sociolinguistikës që do të ndodhë disa vjet më pas.

I pajisur me horizont të gjerë dituror, i prirur për t'i kultivuar vlerat madhore si shtysa parësore të konsolidimit dhe të avancimit gjithëkombëtar, s'është habi që prof. Riza do të merret me përkushtim të veçantë me hulumtimin dhe unifikimin e gjuhës shqipe, d.m.th. do të merret me vlerën më të lartë të identitetit kombëtar, në ç'fushë la pas vepra me rëndësi të madhe shkencore dhe kombëtare.

Gjuha standarde, procesi i ndërtimit dhe i unifikimit të saj, në shtetet me traditë të hershme kulturore e arsimore si p.sh. në Francë, në Britani të Madhe etj. është parë edhe si çështje sociologjike, politike, ekonomike, arsimore, kulturore etj., d.m.th. është parë si çështje sociolinguistike. Duke e kundruar gjuhën nga ky këndvështrim, prof. Riza vuri një gur me peshë në gjurmimet sociolinguistike me gjithë faktin se, asokohe, sociolinguistika në studimet albanistike ende nuk ishte konstituuar si disiplinë shkencore.

Shikuar nga pikëpamja e etnisë gjuhësore, ai me të drejtë kishte parë pasurinë e të dy kryedialekteve të shqipes, andaj shtroi mbëhinë e përfshirjes së kësaj pasurie në një gjuhë, siç e quante, "të bashktë" për tërë vendin duke e ndjekur kështu ecurinë konvergjente të një letrarishteje dhe, këtë pikësynim të studiuesve dhe të shkrimtarëve të Rilindjes, e shpuri përpara me arritje të reja.

Linguisti elitar Riza me arsye shtronte kërkesën e ndërplotësimit dialektor duke e zhvilluar "një rrymë shkëmbimi toskizmesh që i mungojnë gegënishtes e anasjelltas." 1) Kështu synonte ta ngriste një standard gjuhësor në nivelin gjithëkombëtar. Këndvështrimi sociolinguistik i prof. Rizës vihet re në disa vrojtime në të cilat dukuritë gjuhësore i trajton në dritën e rrethanave shoqërore si p.sh. sociale, rajonale, politike etj., d.m.th. ai ndjek edhe reflekset dhe rrjedhojat e faktorëve jogjuhësorë në evoluimet gjuhësore. Varësisht nga këta faktorë studiuesi ynë heton depërtimin dhe praninë e neohelenizmave në toskërishten, të sllavizmave në të folmet VP dhe VL etj. si rrjedhojë e mbizotërimit dhe e diktatit të gjuhëve të pushtuesve në ligjërimet dhe në administratën e krahinave përkatëse.

Duke e parë gjuhën standarde si prodhim të zhvillimit kulturor, arsimor, social e civilizues, dijetari Riza vë re se diferencat dialektore janë dukuri edhe të kombeve dhe të gjuhëve të unifikuara dhe më të zhvilluara madje me dallime shumë më të mëdha se të

shqipes. Nga ky mendim i prof. Rizës del e nënkuptueshme rëndësia e madhe që ka gjuha standarde, e cila është unike për tërë kombin, është tregues i unitetit dhe i zhvillimit arsimor, kulturor e shkencor të kombit dhe vetëm si e tillë mund të zhvillohet dhe të pasurohet, vetëm si e tillë mund ta ndjekë zhvillimin e shoqërisë dhe të shërbejë si faktor i kombit të bashkuar.

Ndarja politike e kombit dhe si rrjedhojë edhe ndarja fizike, por deri së voni, edhe ndarja rajonale si pasojë e moszhvillimit ekonomik, e mungesës së rrugëve, prandaj edhe e qarkullimit më të kufizuar të njerëzve nga një krahinë në tjetrën, përbëjnë indeksikalitetin e diferencave dialektore dhe leksikore kishte parë me të drejtë prof. S. Riza.

Nga kjo del e kuptueshme se faktorët sociolinguistikë janë pararendës të krijimit të shumë fenomeneve gjuhësore, por edhe të shkrirjes së tyre sidomos në rrethanat e reja të zhvillimit të vendit.

Studiuesi Riza vuri re edhe rolin e madh të arsimit dhe të shkrimtarëve në krijimin e shqipes “së bashkët”. Në këtë aspekt kundrimi ai veçon kontributin e Luigj Gurakuqit, i cili, duke e veneruar drejt rëndësinë shumë të madhe të gjuhës letrare unike për avancimin gjithëkombëtar, zhvilloi veprimtari të çmueshme për t’i përafruar të dy kryedialektet me qëllim të formimit të një varianti standard gjuhësor me interes ballësor për prosperitetin kombëtar.

Prof. S. Riza unifikimin e shqipes mbi bazën e një dialekti e pa edhe nga këndvështrimi sociolinguistik. Në këtë vazhdë bazën dialektore të gjuhës letrare ai e lidh edhe me zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në vend duke theksuar se pasi Shkodra nuk arriti të bëhej kryeqytet i shtetit, nuk do të ketë mundësi që shkodranishtja të merret si bazë e variantit letrar.

Formimin e një letrarishaje në nivelin gjithëkombëtar prof. Riza e ndoqi edhe nga këndi sociolinguistik ashtu sikundër ishte vepruar edhe në rastet e gjuhëve të tjera standarde perëndimore. Dhe, kishte të drejtë kur këtë çështje e shtroi në kontekstin e zhvillimeve të një spektri të gjerë historik, politik, kombëtar, arsimor, ekonomik, kulturor etj. Këta faktorë sociolinguistikë jashtëgjuhësorë i kishte gjetur në Shkodër. Megjithëkëtë, linguisti i një formimi të gjerë dituror- S. Riza kishte vënë në dukje, siç shkruan, “shpërshkodranizimin” e shkrimtarëve dhe të gjuhëtarëve shkodranë si p.sh. Anton Xanoni, Justin Rrota, Ndre Mjedja, Luigj Gurakuqi, Ernest Koliqi etj. në interesin e “panshqiptarizimit” që ishte pikësynim i këtyre gjuhëtarëve e shkrimtarëve zulmëmëdhenj për të sendërtuar një variant të gjuhës standarde si fundament të unitetit gjithëkombëtar.

Pasuria dialektore e leksikore e krijimtarisë gojore krahinash të ndryshme duhet të qëmtohet dhe të ngërthehet në gjuhën standarde si një vlerë e lartë kombëtare që është. Në kërkimet linguistike të prof. Rizës nuk vihen re trajtime të njëanshme ose subjektive mbi baza favoresh rajonale të gjuhës etj., porse ato i shquan objektiviteti shkencor dhe interesi gjithëkombëtar.

Gjithnjë nga pikëpamja sociolinguistike prof. Riza vëzhgon edhe dallimet midis toskëve e gegëve në tëpamje të ndryshme si p.sh. në veshjet popullore, në muzikë, në nyjëtimin e tingujve dhe të intonacionit në variantin e folur të gjuhës, në vallet popullore, ritet e ndryshme të shprehura përmes krijimtarisë popullore etj., prandaj janë të natyrshme edhe veçoritë gjuhësore midis gegërishte dhe toskërishtes, të cilat duhen parë si tipare dalluese brendapërbrenda një gjuhe përkatësisht të dialekteve të saj.

Në hulumtimet albanistike rreth formimit të shqipes standarde të këtij dijetari vihet në dukje edhe vjetërsia e shkrimit të variantit dialektor të gegërishtes, prandaj gegërishtja ishte më e pranishme në interesimet kërkimore të albanologëve të huaj.

Prof. S. Riza procesin e formimit dhe të zhvillimit të shqipes letrare me arsye e ndoqi në kontekstin e rrjedhave politike kombëtare dhe ndërkombëtare të kohës. Ai thekson se pas projekteve antishqiptare të Kongresit të Berlinit veprimtaria atdhetare e lëvizjes kombëtare sa vinte e po thellohej dhe po ngrihej në një shkallë më të lartë të konsolidimit rreth programit gjithëkombëtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila shënoi kthesa të reja në lëvizjen kombëtare. Strategjia e kësaj lëvizjeje shtrihej në tri fusha veprimi: krijimi i shoqërive kulturore brenda dhe jashtë Shqipërisë tek vepronte mërgata shqiptare, botimi i gazetave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe hapja e shkollave në gjuhën shqipe.

Në këtë veprimtari të thukët kombëtare studiuesit dhe shkrimtarët e shquar të Rilindjes Kombëtare vëmendje të posaçme i kushtonin përdorimit dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, të bindur me shumë të drejtë se, duke e avancuar gjuhën shqipe, ndërtonin themelin e zhvillimit dhe të zgjerimit të kulturës dhe të vetëdijes kombëtare. Kështu, nga ana sociolinguistike, gjuha venerohej në lidhje të pandarë me shoqërinë dhe zhvillimi i gjuhës nënkuptonte njëkohësisht zhvillimin e shoqërisë.

Edhe pasurimin e gjuhës shqipe linguisti Riza e kishte parë në rrethanat e zhvillimit shoqëror anësh të ndryshme të truallit gjuhësor, d.m.th. e kishte trajtuar në pikëpamjen sociolinguistike. Pasurinë leksikore-dialektore e kishte hetuar në vise, në shtresa dhe në veprimtari të ndryshme shoqërore dhe argumentonte arsyeshmërinë e vjeljes së kësaj vlere gjuhësore që mund të bëhet pronë e gjuhës standarde. Në këtë veprimtari me interes shkencor, sipas studiuesit tonë, kontribut të çmueshëm mund të japin shkrimtarët toskë e gegë duke e futur në përdorim në shkrimet e tyre pasurinë leksikore e frazeologjike.

Në spektrin e gjerë të interesimit linguistik të prof. Rizës zuri vend edhe çështja e përdorimit të fjalëve të huaja dhe në këtë vështrim pati qëndrim shumë të matur: nuk ishte purist absolut, sepse, siç shkruante, do të krijohej “vobeksim i gjuhës” 2), porse, kur ekzistojnë korrespondueset vetjake, fjalët e huaja, pa ndonjë funksion stilistik-poetik, nuk janë të mbëhishme.

Historia e çdo gjuhe, d.m.th. edhe të shqipes, do hulumtuar në bashkërendim të pandërprerë me historinë e popullit përkatës- vë re S. Riza. Ajo do ndjekur në dritën e proceseve të zhvillimit shoqëror të shtresëzimeve kohore dhe hapësinore në relacionet e brendshme dhe të jashtme të një kombi. E parë çështja nga ky kënd, prof. S. Riza, në kërkimet albanistike, kishte vënë re me arsye edhe një fakt: zhvillimin dhe përdorimin e variantit popullor të gjuhës, i cili variant kishte rrugë të gjatë përdorimi- rreth dymijëvjeçare, andaj gjuha e Buzukut dhe e autorëve të tjerë pas tij nuk mund të quhet si shqipe e vjetër kur të mbahet parasysh “popullorçja”, siç e quan autori, porse “si shqipe e re”. 3)

Në të folmet e ndryshme të truallit gjuhësor të shqipes mund të gjenden mbijetime ose relikte të shqipes paraletre, të cilat nuk mund të vihen re në tekstet e shkrimeve të para të shqipes- konstaton prof. Riza. Nga këto relikte, pas gjurmimesh historike-krahasimtare, mund të hetohen indeksorë fonetikë, morfologjikë etj., të cilët janë me shumë interes për të vërtetuar kryetrajtat e fenomeneve të ndryshme gjuhësore si dhe refleksat evolutive në rrjedhën e kohës. Prandaj, nga ky aspekt, konstatimi i prof. Rizës që favorizon primatin e gjuhës së folur, del shumë i bazuar.

Varianti i gjuhës së folur madje i viseve më anësore dhe më pak të zhvilluara, si në fazat më të hershme, ashtu edhe sot, paraqet lëndë me shumë rëndësi për hulumtimet sociolinguistike ashtu sikundër edhe për dijet e tjera gjuhësore.

Veprimtaria shkencore e prof. S. Rizës meriton studim të veçantë për t'u parë arritjet e mëdha që ky dijetar i sintetizoi në gjuhësinë shqiptare.

**MARRËDHËNIET E GJUHËS SË SHKRUAR APO STANDARDIT ME GJUHËN
E FOLUR DHE DIALEKTET SIPAS NJË IDEJE TË HERSHME TË SELMAN
RIZËS: “PARIMI I ENËVE KOMUNIKUESE”**

Me profesor Selman Rizën kam pasur vetëm lidhjet e natyrshme pedagog - student në lëndën *"Hyrje në historinë e gjuhës së shkruar shqipe"* (në vitin 1963-64) dhe si udhëheqës të një teme vjetore *"Lëkundje gjithëgjuhësore në veprat e K. Kristoforidhit gegërishte"*, në vitin e dytë. Nuk kam pasur rast të punoja bashkë me të në sektorin e gramatikës e të dialektologjisë, për arsye se, në vitin 1967, kur unë u emërova në Instituti si punonjës shkencor i ri, i ndjeri ishte larguar nga ai vend pune (me atë motivacion dhe me ato pësime që tashmë dihen).

Si studiues, për aq sa më lidhin fushat që studioj me trashëgiminë e botuar në kohën e vet si dhe në veprat e S. Rizës të botuara, së pari në Prishtinë, pastaj edhe ndër ne, kam gjetur shumëçka me interes dhe jam i bindur se, përveç sa ka zgjidhur e shqyrtuar kënaqshëm vetë ai, në shkrimet e tij ka edhe ide e teza pune me vlerë, që meritojnë të rimerren e të shpihen më tej në kushtet e me të dhënat e sotme.

Në kumtesën time modeste do të rrekem të trajtoj pikërisht ndonjë nga idetë e prof. Rizës rreth gjuhës letrare shqipe të njësuar dhe marrëdhënieve të gjuhës së shkruar me gjuhën e folur, duke u mbështetur në studimet e tij, por edhe në disa mendime të shprehura në ligjeratat që kam pasur fatin e mirë t'i dëgjoj prej tij. Kam pasur gjithmonë zellin për të mbajtur shënime dhe, gati gjithmonë, isha i "pajtuar" në bankë të parë që të dëgjoja e të mbaja shënim sa më mirë.

1. Një meritë të pamohueshme dhe me vlerë për kohën tonë kanë shqyrtimet e hapëta dhe me dije të sigurta të prof. S. Rizës ndaj rolit të folësit në bashkësinë shoqërore ku ai bën pjesë. Ai kishte mendimin se *"e ardhshmja e gjuhës letrare shqipe nuk është tjetër veçse toskërishtja e folur prej gegëve"*. Këtë ide, që prof. Riza mëntonte të na e nguliste mirë në mendje qëkur ishim studentë, e kam pasur kurdoherë për zemër dhe, në shkrime e diskutime të mëparshme, jam përpjekur edhe ta zbatoj. Në diskutimin tim rreth referimeve të fushës së sociolinguistikës, mbajtur në Seminarin XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në verë të vitit 1996, kam thënë: *"Lidhur me këtë fushë të sociolinguistikës, e cila është vërtet tërheqëse dhe e kohës, unë do të kisha dëshiruar që të ishin përmendur disa çështje më madhore që nuk u prekën në referime apo në trajtesa të veçanta. ...do të ishte mirë të ishin përmendur së paku mendimet e tre burrave të shquar në gjuhësinë shqiptare, të cilët unë mendoj se janë pararendës të sociolinguistikës, ndonëse atëherë nuk kishte dalë edhe si një disiplinë me emrin që ka sot sociolinguistika"*. E kisha fjalën për të ndjerët Atë Justin Rrota, prof. Eqrem Çabej dhe prof. Selman Riza. Në atë diskutim, (natyrisht krejt të shkurtër dhe të ndërtuar gati fluturimthi), duke pasur parasysh një ide të hershme e të vlefshme të Selman Rizës, kam theksuar sa vijon:

"Së dyti, dua të përmend këtu një mendim që lidhet me normën dhe me problemet e normës. Unë do të kisha dëshiruar të ishte cituar e të ishte menduar për t' u thelluar një ide shumë interesante e të ndjerit prof. Selman Rizës, i cili diku në veprat e tij (pasi kishte hequr dorë nga ideja e tij e pangegërishtes etj. dhe u kthye në mendimin se

toskërishtja mund të shërbejë si bazë e gjuhës letrare) ka thënë se në të ardhshmen "Gjuha letrare shqipe nuk do të jetë gjë tjetër përveçse toskërishtja e folur prej gegëve" një gjë që mua më duket se duhet ta mbajmë shumë mirë parasysh sepse ndonjëherë harrojmë se çfarë do të thotë ajo. Do të thotë atë që... njerëzit, duke folur gjuhën letrare nisen nga një bazë, e cila është një normë e caktuar, e cila është kryesisht në formë piketash, po nuk ekzistojnë dy njerëz që ta flasin gjuhën standarde (gjuhën letrare) tërësisht njësoj as edhe sikur ata të jenë vëllezër binjakë...Njerëzit, vartësisht nga mjedisi ku lindin, por edhe nga puna që bëjnë, nga profesioni, arsimi dhe nga marrëdhëniet që kanë me njerëz të ndryshëm pësojnë ndryshime edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe i pasqyrojnë këto ndryshime. Synojnë ta flasin mirë, ta zbatojnë normën, por diçka e pengon këtë. Çfarë? Edukata, niveli arsimor, kultura, shoqëria, konceptet etj. të gjitha këto e shtyjnë përpara ose e pengojnë individin."³

Më vonë, në shqyrtimet e mia rreth marrëdhënieve gjuhë letrare-dialekt do të shtyhesha shumë më tej sesa kam shprehur në atë diskutim. Në variantin më të gjerë të librit tim "Sociolinguistika", kam trajtuar enkas e mjaft gjerë pikërisht ngjyresën krahinore të gjuhës letrare, duke prurë edhe shumë të dhëna nga hulumtimet e vëzhgimet e mia tashmë shumëvjeçare në lëmin e dialektologjisë, pastaj edhe të sociolinguistikës, por duke pasur kurdoherë si pikënisje kundrimin: nga dialekti tek gjuha apo, me një formulë të sociolinguistikës së sotme italiane, duke mëtuar të kalojmë nga "dialektologjia hapësinore" në "dialektologjinë urbane".⁴ Aty, me sa ka qenë e mundur nga hulumtimet e derisotme, i kam dhënë rëndësi pikërisht nxjerrjes në pah të ngjyresës krahinore si fazë e ndërmjetme drejt gjuhës letrare. Unë i mbahem mendimit se zhvillimi i sotëm i të folmeve popullore apo përgjithësisht i dialekteve shqiptare nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe kaheve të përgjithshme kulturore dhe mendore të bashkësisë shoqërore shqiptare shtetërore e më gjerë. Në mënyrë të veçantë ka luajtur rol arsimimi masiv, shtimi i peshës së mjeteve të informimit masiv (shtypit, radio-televizionit) dhe i lirisë së fjalës publike. Disa prej dukurive që ndeshen në këtë zhvillim gjuhësor ne i kemi pasë përfilluar disi qysh në vitet '70 në trajtimet e marrëdhënieve të sotme gjuhë letrare-dialekt në disa treva veriore të zonës së Koplikut⁵, pastaj edhe më gjerë në kundruellsinë e trajtave dialektore dhe letrare në të folmen e qytetit të Lezhës⁶. Aty kam shprehur bindjen time (por që s'është e s' ka si të ishte vetëm e imja) se vetëm një gjuhë e vetme, vetëm një varietet standard me një normë të njëjtë drejtshkrimore të përbashkët për të gjithë bashkëkombasit shqiptarë dhe me një strukturë gramatikore e leksikore të përcaktuar nga norma të gjalla e të studiara mirë, mund të përballojë nevojat kaq shumë të shtuara të shprehjes dhe të krijimit që u dalin sot shqiptarëve, se vetëm një gjuhë e tillë, e fuqishme dhe e përpunuar, po edhe e mbrojtur përkushtimisht nga rreziqet gjithashtu aq të shumta po edhe të shtuara dukshëm në ditët tona, mund të shpërfillë edhe ndarjen në shtete, edhe mbylljen e kufijve ndërmjet shqiptarëve të Republikës së Shqipërisë nga trojet shqiptare jashtë saj në shtetet fqinje apo në diasporë; është pikërisht

³ Shih: Gj. Shkurtaj, *Diskutim rreth referimeve të fushës së sociolinguistikës*, në Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Përmbledhje e ligjeratave, referimeve, kumtesave dhe diskutimeve, Tiranë, 18-31 gusht 1996, Toena, Tiranë, 1996, f.1096-1097.

⁴ Gj. Shkurtaj, *Ngjyresa krahinore si fazë ndërmjetëse drejt gjuhës letrare*, në "Sociolinguistika", Pjesa II, Shqyrtime thelluese dhe mbështetëse, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 205-228.

⁵ Gj. Shkurtaj, *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut* (mbështetur në të dhëna të zonës së Koplikut), "St. fil.", 1969, nr. 4, f. 162.

⁶ Gj. Shkurtaj, *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, "St. fil.", 1981, nr.3, f. 155-163 dhe *Shtresësime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në "St. fil.", 1984, nr. 2, f. 75-93.

kjo gjuhë jona e përbashkët që ka treguar e tregon se kombi ynë shqiptar ka qenë dhe është një dhe i vetëm, qoftë edhe pse i ndarë në disa shtete në Ballkan e në gati të gjithë botën në formë diaspore. Sa kohë që edhe shqiptarët e shprishur nëpër dhera të tjera vijnë ta quajnë vetën të tillë, sa kohë që edhe ata, njësoj si ne në trojet tona të moçme, ndonëse janë larg me trup, përbetohen e shprehen për shqiptarinë dhe vijnë t' i duan gjuhën shqipe e traditat shqiptare, e kemi për detyrë që t' i përfillim e t' i lidhim të gjithë sa janë në një fill të përbashkët të komunikimit: në gjuhën shqipe të njësuar e të përpunuar sa më hijshëm.

Ideja e S. Rizës për toskërishten e folur prej gegëve, nuk parakupton asnjë ndërhyrje a qëndrim subjektiv (e, aq më pak, të mbështetur në shpjegime jo-shkencore e të mveshura me mllefe vendoriste (lokaliste). Sipas mendimit tim ajo është një ide e mbarë dhe frymëgjatë, që nuk parakupton asnjë mospranim a kundërshtim të bazës dialektore toske të gjuhës letrare shqipe, por vetëm atë lëmim, përimitim e pasurim të ditëpërditshëm dhe afatgjatë që folësit nga trevat e ndryshme shqiptare do t' ia sjellin natyrshëm e dalëngadalë kësaj gjuhe tashmë të njëjtë e përbashkët për të gjithë. Me fjalë të tjera, toskërishtja e folur prej gegëve e prof. Selman Rizës (dhe e të gjithë atyre që ia kanë dashur e ia duan të mirën përbashkësisë shpirtërore e kulturore të kombit shqiptar) nuk është tjetër veçse "*ndërveprimi apo bashkëveprimi ndër dialektor*" i formuluar më pas nga A. Kostallari porse, me dallimin që, ndërsa në referatin e Kostallarit e në studime të tjera të tij e të tjerëve, "*bashkëveprimi* merrej si një pikënisje e mbarë (por realisht e paqenë a, në mos tjetër vetëm sa për të thënë) tek autori ynë e kemi kryesisht si pikëmbërritje. Kam bindjen se një ide e tillë, sadoqë e papërfilluar në kohën kur qe shprehur, mbetet gjithnjë në fuqi dhe, madje, do të marrë jetësinë e mishërimit e vet sot e tutje, sidomos në dritën e asaj çka fituan shqiptarët si komb pas Luftës së Kosovës. Zbatimi në masë të gjerë e pa asnjë mëdyshje i gjuhës letrare shqipe të njësuar në Kosovë e më gjerë në trojet shqiptare kompakte ballkanike në Maqedoni, në Mal të Zi etj., pas hapjes së kufijve e në kushtet e vajtje-ardhjeve e shkëmbimeve të gjithësferëshme ndërmjet qendrave të mëdha me rrethinat, do të përbëjë një pikëmbërritje jo vetëm të lakmueshme e të tumirueshme, po edhe të vetmen që ka mundësi ta shpjegjë gjuhën letrare shqipe në lartësitë e një standardi të njëjtë, të vetëm e të përbashkët për të gjithë shqiptarët në trojet kompakte ballkanike e në diasporë. Natyrisht, krahas dhe në konkurrencë me standardin (apo gjuhën letrare zyrtare) do të ecin edhe variantet e tjera jostandarde, dialektet e të folmet krahinore si dhe diferencime e timbre karakteristike për bashkësi të caktuara shoqërore brenda bashkësisë etnike shqiptare.

2. Parimi i enëve komunikuese në marrëdhëniet gjuhë-dialekt

Gjuha letrare standarde dhe të gjitha varietetet e ndryshme brenda saj kanë qenë dhe do të mbeten kurdoherë në lidhje e ndërveprim me njëra-tjetrën dhe, po të shprehemi me një figurë letrare, ato janë si lëngjet në "enët komunikuese". Edhe kjo është një nga idetë e hershme e sipas meje frymëgjata të Selman Rizës. Në studimin "Mbi kriteret e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe", në sythin me titull "Shqyrtim kritik", duke argumentuar në mënyrë kritike ndarjen e E.Çabejt mbi karakterin ndarjen e shqipes në periudhën parahistorike = të pashkruar dhe historike të shkruar, S.Riza ka shkruar: "Teza e prof.E. Çabejt mbi karakterin parahistorik të epokës parashkrimore të çdo gjuhe stërmadhon rëndësinë e gjuhës që shkruhet, e për pasojë shpërnjeh rolin e gjuhës që flitet.

Këtë interpretim prej nesh të kësaj teze të tij e përforcon pohimi tashmë i njohur i vetë autorit se një gjuhë marrka një fizionomi të veçantë vetëm kur u shkruaka, e për pasojë se një gjuhë e pashkruar nuk paska një pamje të posaçme.

Tani është e vërtetë se në historinë e kulturës së çdo populli, gjuha e shkruar, larg së luajturi për gjithnjë vetëm rolin origjinar të pasqyrueses pasive të gjuhës gojore, vajti përkundrazi duke u pamvarësuar e ndryshuar përherë e më shumë e më thellë nga gjuha gojore.

Më përgjithësisht, është e vërtetë se gjuhës deri atëherë vetëm gojore të çdo populli pasqyrimi shkrimor ia tejshkriu kufinj të përdorjes e ia shumëfishoi mundësitë e zhvillimit gati deri në pambarim.

Por është gjithashtu një fakt se, edhe mbas krijimit të gjuhës së shkruar, gjuha gojore e çdo populli vazhdoi të përdoret gjithnjë makar në rrethana pa krahasim më pak botore, e madje edhe të zhvillohet më tej makar në një masë pa krahasim më modeste se gjuha e shkruar.

Prandaj, në vend që të stërmadhojmë rëndësinë e gjuhës letrare, e për pasojë në vend që të shpërnjohim rolin e gjuhës së folur, le të pranojmë pa asnjë rezervë se gjuha letrare dhe gjuha e folur kanë secila arsyen e qenies dhe meritën e shërbimit në sferën përkatëse të kumtimit shoqëror; e për pasojë le të pohojmë lirisht se dualizmi gjuhë letrare- gjuhë e folur është karakteristikë pozitive e çdo populli të kulturuar.

Natyrisht, edhe dualizmi gjuhë letrare- gjuhë e folur nuk është për t'u absolutizuar në radhën e vet; por, përkundrazi është për t'u kuptuar dialektikisht si një bashkësi e vetme dy palë mjetesh alternative të kumtimit shoqëror në dispozicion të çdo populli të kulturuar.

Prandaj edhe njëri nga detyrat qendrore të studimit të gjuhës së shkruar duhet ta përbëjë pikërisht studimi i marrëdhënieve të saja me gjuhën gojore- marrëdhënie këto që janë nga më të ndërlikuarat e madje më kontradiktoret, siç mund të shihet qoftë edhe vetëm nga vërejtjet e kundërvërejtjet e mëposhtme:

Në qoftë e vërtetë se gjuha e shkruar dhe gjuha gojore nuk kanë si të ndryshojnë njëra nga tjetra në tërë përbërjen e tyre, është gjithashtu një fakt se deri në materialet e përbashkëta ato gati kurdoherë paraqesin nga një anë të panjëjtë. Pastaj, në qoftë e vërtetë se as në krye të kohës gjuha e shkruar nuk ka qenë thjeshtësisht pasqyruese pasive e gjuhës gojore, por përkundrazi ka qenë diçka shumë më tepër se vetëm kaq; është gjithashtu një fakt se në çdo stad zhvillor të gjuhës së shkruar hasen materiale të gjallë (d.m.th. materiale ende të palëvruar letrarisht) të gjuhës gojore.

Më përgjithësisht, në qoftë e vërtetë se gjuha e shkruar dhe gjuha e folur formojnë një lloj sistemi dy enësh komunikuese, herë e shkruara si model tërheqës duke pikuar në gojoren, herë gojorja si burim ushqyes duke rrjedhur në të shkruarën; është gjithashtu një fakt se këto të pikura e të rrjedhura, edhe në mos përfshifshin trupa të huaj të njërës gjuhë në tjetrën, përbëjnë shtresa të dallueshme në secilën prej tyre⁷.

Ajo çka vjen nga anët dhe rrethinat (periferitë), qoftë edhe e turbullt apo e pakulluar, herë do të zbrapset nga vrulli më i fuqishëm i ujërave të gjuhës letrare të njësuar, herë (përkundrazi) do të shkrihet, përzihet e, me kohë, do të kthjellohet në përbërjen e gjuhës letrare të përbashkët. Gjatë më se 40 vjetve, qysh nga "Konsulta e

⁷ Shih: S.Riza, *Mbi kriteret e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, në "Studime albanistike", Rilindja, Prishtinë, 1979, f.115-116.

Prillit" në Prishtinë (1968) dhe sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), u pa shumë qartë se si, gjuha letrare shqipe standarde (apo zyrtare) sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja geqe, që, ndërsa mbështetet tek norma e shkruar dhe mëton ta zbatojë gjuhën letrare, e realizon atë mjaft mirë, porse me një ngjyresë fonike gegizuese (p.sh. shqiptimi i /ë/ si /ê/: *bêj, nê:n, bêra, rêra, zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë "qethje" sado të pjeshme të bërë nga "Rregulat e drejtshkrimit", tërheq nga hipertoskizmi (p.sh. shqiptimi me / ë/ të prapme i fjalëve me /e/: *vënd, mëndje, mëndo, qëndër, fëmër, zëmër* etj.). Për arsye të përmasave të kësaj kumtese nuk po zgjatem në shembuj të tjerë, por ata mund të ishin të shumtë. Po ndalem vetëm në një pohim që më intereson të theksohet si dhe sa duhet: ndaj këtyre dy kaheve, që janë të dukshme, të prekshme dhe të ditëpërditshme, gjuhësia shqiptare po e po, (por edhe krejt shoqëria shqiptare e sotme në të gjuitha hapësirat kombëtare) duhet t' i hapë sytë më mirë. E quaj me vend që, pikërisht në dritën e asaj ideje dorëmbarrë e të vyer të të ndjerit prof. Selman Riza, ne sot duhet të marrim parasysh më mirë e më shumë marrëdhëniet e normës së kodifikuar dhe të "goditjeve" që vijnë në dyert e saj nga krahinat apo, thënë ndryshe, t' ua vëmë veshin më shumë "thyerjeve" që po shtohen e që synojnë të fitojnë statusin e normës. Teorikisht, e kemi thënë dhe e përsërisim shpesh se "normat e çdo gjuhe janë të gjalla e në lëvizje", porse praktikisht po tregohemi të mefshët e të pazotët për t' i shqyrtuar ashtu siç meritojnë edhe prurjet që mund të mos jenë njësoj me normën drejtshkimore, por që përbëjnë një prirje të përshtashme ndaj zhvillimit të gjuhës shqipe të sotme. Mbyllja vetëm në "guaskën" e asaj që është parashikuar si normë para 40 vjetve, mbështetur në treguesit e atëhershëm, sot, në dritën e disa trysnive që na sjellin zbatimet (në fakt: moszbatimet a thyerjet) e ditëpërditshme do të ishte jodobiprurëse. Le të kujtojmë, ndër të tjera, betejën e humbur të dallimit të numërorit tre/tri sipas gjinisë. Të gjithë po e shikojmë se si, pas bjerrjes së plotë të dallimit të dy (mezanore të shkurtër) dhe dy; (me të gjatë) që ka mbetur vetëm në gegërishten, po tretet si krija në ujë edhe dallimi tre (për meshkujt) dhe tri (për femrat). Sot pothuajse gjithandej thuhet tre për të dy gjinitë. Kësaj bjerrjeje i ndihmon shumë edhe ndikimi prej gjuhëve të huaja që nuk e kanë një dallim të tillë në morfologjinë e tyre. Kjo do të ishte një trysni mirëfilli toske, në thelb e pamirë, por detyrimisht e përfillshme sepse po përgjithësohet. Nga ana tjetër, nuk mund të mos i bëjmë udhë shtimit të shumës me -a (*mësues, student, profesor, shofer, oficer* etj.) që vjen nga arealja geqe, por që po gjen përdorim të gjerë e pëlqehet si një shumës më i qartë ndaj formave përkatëse me -ë, që këshillon norma e sotme morfologjike e drejtshkimore. Edhe më e qartë del kjo trysni gegizuese në fjalët me -ë fundore (*kalë, djalë, djathë* etj.). Tashti edhe toskët nuk i shqiptojnë më me -ë ato fjalë, prandaj edhe në praktikën shkimore të sotme, gjithandej po shtohen "gabimet" drejtshkimore pikërisht për kategori të tilla.

Me këta shembuj desha të them se koha do ta bjerë që, edhe ndonjë çështje e normës së sotme gjuhësore, jo vetëm në drejtshkrim, po edhe në ndonjë dukuri tjetër, siç është, p. sh. paskajorja geqe, të diskutohen nga specialistët e gjuhësisë, duke shqyrtuar e parë jo vetëm ç'është thënë e zgjidhur mirë, po edhe ndonjë gjë që duhet rishikuar për të gjetur zgjidhje më të mirë. Sigurisht, diskutime të tilla duhet të bëhen dhe koha ka ardhur të bëhen, porse ato nuk kanë të bëjnë më me themelin e gjuhës letrare të njësuar e të vetme për të gjithë. Këta dhjetë vjetët e fundit kujdesi i shtetit dhe i institucioneve shqiptare për gjuhën ka rënë së tepërmi. Janë çelur edhe shumë sektorë pune joshtetërorë, gjithçka është në udhën e privatizimit e të ndryshimeve. Kjo udhë do të vazhdojë, por një

gjë duhet të mbetet përherë e "paprivatizuar". Ajo është gjuha shqipe, gjuha jonë e përbashkët, që na dallon e na mban gjallë si komb më vete, si popull i lashtë e me kulturën e vet të vlefshme e të denjë për t'u mbajtur gjallë edhe më tej. Për hir të kësaj bashkërie shpirtërore e kulturore themelore që përfaqëson gjuha shqipe për popullin shqiptar, sot më tepër se kurrë, pas ndryshimeve të bëra në Ballkan e, sidomos, pas luftës në Kosovë, që u mbyll me fitoren e NATO-s e me kthimin e kosovarëve në shtëpitë po edhe në shkollat e institucionet e tyre arsimore, shkencore e kulturore, puna me gjuhën shqipe nuk mund t' i lihet vetëm shkollës dhe instituteve shkencore që e studiojnë. Puna e tyre do të vazhdojë dhe duhet të ketë të gjithë ndihmën e përkrahjen e nevojshme, por është koha që të ndërmerren edhe një varg masash të tjera shtetërore e joshtetërore.

Mendoj se nuk duhet mënuar më asnjë grimë e të krijohet edhe një organizëm me karakter joshtetëror, por që të jetë i përhershëm e mbarëkombëtar dhe të ketë atributet e mbikëqyrjes e të drejtimit të gjithë punës për ruajtjen, vlerësimin, studimin dhe mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha hapësirat shqiptare. Siç është p.sh. Këshilli i Lartë i Frankofonisë për gjuhën frënge, i cili e shtrin veprimtarinë e vet në Francë dhe në të gjitha hapësirat frëngjishtfolëse, si në Zvicër, në pakicat frankofone të Italisë së Veriut etj. dhe në të gjitha vendet e tjera ku flitet e shkruhet gjuha frënge deri në Kanada.

Hapja e kufirit me Kosovën dhe me trevat e tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi si dhe lidhjet me qendrat e diasporës shqiptare historike e të reja në Evropë, në Amerikë e gjetkë shtrojnë me doemos detyra të reja e shumë të mëdha për gjuhën shqipe.

Kumtesa ime është më e gjatë, por unë po e mbyll këtu, duke shprehur bindjen e plotë se teza e prof. Selman Rizës për rolin ndërtues e pasurues të folësve gegë në gjuhën letrare shqipe të njësuar, sipas metaforës së lëngjeve në enët komunikuese mbetet jo vetëm një këndvështrim i shprehur bukur, po edhe një tezë frymëgjatë ndaj ardhshmërisë së gjuhës shqipe të njësuar, një tezë me rëndësi madhore ndaj së cilës unë mendoj se është pikërisht çasti t' i kthehemi me të gjithë seriozitetin që lyp një tezë pune e formuluar nga një gjuhëtar e atdhetar si ai.

Prof.ASLLAN HAMITI (Universiteti “Shën Qirili dhe Metodi”, Shkup)

**STUDIMET E PROFESOR SELMAN RIZËS
PËR FONETIKËN DHE DREJTSHKRIMIN E SHQIPES**

Të nderuar pjesëmarrës të Konferencës,
Kolegë e miq,

Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe në emër të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit t’Ju përshëndes dhe t’Ju uroj punë të mbarë.

Është detyrë sa shkencore aq edhe atdhetare të organizohen tubime përkujtimore për veprimtarët tanë të shquar. Me këtë Fakulteti i Mësuesisë i Universitetit të Korçës dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës po japin një ndihmesë të madhe për të shënuar 100-vjetorin e lindjes së profesor Selman Rizës.

Prof. Selman Riza ishte gjuhëtar, shkencëtar, atdhetar, kundërshtar i fashizmit, nacizmit dhe i komunizmit. Veprat e prof. Selman Rizës janë nga ato që koha nuk ua bjerr, por ua shton vlerat. Shpresoj se në këtë Konferencë Shkencore Ndërkombëtare që keni organizuar në 100-vjetorin e lindjes së profesor Selman Rizës, jo vetëm që do të vështrohen nga shumë pikëpamje veprat e këtij kolosi të madh dhe do të ndriçohet veprimtaria e këtij personaliteti të shquar të shkencës dhe të kulturës shqiptare, por do të ketë edhe prurje të reja albanistike.

Urojmë punë të frytshme dhe suksese të mëtejme në realizimin e detyrave të reja që shtrton koha e sotme, shkenca jonë e re.

Profesor Selman Riza (1909-1988) është atdhetar, pedagog dhe gjuhëtar i njohur. Ai me të drejtë çmohet si njëri ndër intelektualët e shquar shqiptarë të shekullit XX.¹ Siç dihet, profesor Selmani pati një jetë shumë të vështirë me plot vuajtje në burgje dhe internime, i penguar në veprimtarinë shkencore dhe botuese në kushte dhe rrethana të përjashtimit absurd. Por, edhe pse në kushtet e përndjekjes politike gjatë gjithë kohës, tërë jetën ia kushtoi çlirimit kombëtar, shkencës albanologjike dhe ngritjes së përgjithshme kulturore të kombit tonë. (Citojmë) *“Gjithmon’ e-jetës kam synue e do të synoj me kontribuue, makar modestisht, në mposhtjen e kompleksit t’inferioritetit të bashkëkombasvet ndaj Ballkanasvet tjerë.”*

Ai është një ndër gjuhëtarët e rrallë shqiptarë që ka studiuar tërë strukturën e gjuhës shqipe, në rrafshin historik dhe bashkëkohor. Vepra shkencore e prof. Selman Rizës shtrihet në shumë lëmi, siç janë gramatika, tekstologjia, terminologjia, kritika gjuhësore, historia e gjuhës, gjuhësia e përgjithshme, gjuha letrare etj. Me veprimtarinë patriotike, pedagogjike e shkencore gjuhëtari ynë ka dhënë ndihmesë të madhe për të ngritur gjithnjë e më lart piramidën e përbashkët kombëtare.

Shkrimet e prof. Rizës janë tejet përmbajtjesore. Për të zbërthyer mendimet e teksteve të tij duhet një përkushtim i madh mendor e profesional dhe një përqendrim i veçantë. Pikërisht për këtë arsye, në kumtesën tonë të shkurtër kemi parapëlqyer të citojmë thëniet e tij e jo t’i përflasin ato.

Profesor Selman Riza veprat e tij i shkruan në një gegërishte letrare dhe është ithtar i saj, ose siç e quan një *“gegënishte e re ose pangegënishte”* në bazën e së cilës do

të qëndrojë e folmja e Shkodrës, e gërshtuar edhe me elemente gjuhësore të elbasanishtes dhe të kosovarishtes.

Në “Parëthânen e përbashktë” të “Tri monografinave albanologjike” profesor Riza thotë: *“Leximi i këtyre tri monografinave albanologjike do të jetë i vështirë për këta dy shkaqe. Për shkak të trajtimit, me një rigorizmë pak a shumë shkencore, të landëvet të tyne dhe për shkak të shqipes sime që është një gegënishte e ré: pan/gegërishtja e themeluese prej meje. Në vënd që për të parështrë dhe përligjë këtë pangegënishte, të shërbehesha prej shkodranishtes o prej së kështuqajtunës gjuhë së mesëme, jam shërbye shí prej përftesës sime. Jam sjellë kështu për të vù kombinatën t’ime linguistike në provën e yjarmit që është përdorja praktike. Shpresonj që këjo sjellje e ime po n’atë kohë guximtare dhe e ndershëme, do të më fitojë dashamirësinë e save ndër né janë studjuntarë seriozë dhe lexues të durueshëm...”*

Profesor Riza dallon qartë togun semantik, si bashkim tingujsh që ka një kuptim të caktuar nga togu tonik, si bashkim tingujsh që shqiptohen me një theks të vetëm, pra tani që e quajmë fjalë fonetike. Ai dallon për mrekulli fjalët e theksuara nga fjalët e patheksuara, duke vënë në dukje se e njëjta fjalë mund të jetë herë e theksuar e herë e patheksuar, varësisht nga roli që ka në fjali. Po kështu, autori ynë qartë dallon se zanoret dhe fjalët e theksuara kanë prirje të ruhen të plota, ndërsa të patheksuarat pësojnë një dobësim tingullor, sidomos në gegërishten. (citojmë) *“Së këndejmi vjen vetvetiu që edhe alterasjonet fonetikë do të jenë shumë më të shenjueshëm në gegërishte se sa në toskërishte. Ky ndryshim kryyedialektuer është madje kaq me rëndësi sa që mund të thuhet se ndërmjet dy kryedialektevet të shqipes, në fonetikë, kemi soll dy të vetëm ndryshime kryesorë: rhotacizmën e toskënishtes me pasojën e çndërhundësimit të vetëtingujvet edhe të stërfuqishëmin theksim të gegënishtes me pasojën, përgjithësisht, të dobësimit tingullor e, veçanërisht, të zhdukjes, ose gati, të ë-s.”* Me një saktësi shkencore profesor Selman Riza shpjegon bindshëm edhe trajtat e plota të theksuara të përemrave vetorë dhe dëftorë krahas trajtave të shkurtra të patheksuara të tyre.ⁱⁱ

*“Shqipja e këtyre tri monografinave përmban zgjidhjen e problemit t’ânë gjuhësuer, zgjidhje e cila ví(l)en aktualisht vetëm për Gegëninë, kurse virtualisht dhe për Shqipninë. Në praktikë dështimi i së kështuqejtunës gjuhë së mesëme për t’u bâ letrarishtja e Shqipnisë dhe në teori konsideratat linguistike, folkloristike dhe letrare përmbi kryedialektin juguer të shqipes, më dhanë shkas që këtë problem ta zgjidhi aktualisht vetëm për Gegëninë. Toskët, pos atyne t’Italisë, përdorin, që prej më se një gjysmë qindvjetshi e tëhu, një të bashktë gjuhë shkrimi kurse për Gegët e bashkta gjuhë shkrimi është ende sot e kësaj dite fort larg së qenuni një punë e kryene, Gegët, po thom, deri sot, kanë folë vetëm për një problem gjuhësuer Shqiptar dhe jo për një problem gjuhësuer Gegë”.*ⁱⁱⁱ

Konstatimi se gegërishtja është më e larmishme sesa toskërishtja e ka frymëzuar prof. Rizën për të sajuar një gegërishte letrare. Edhe në krijimin e gegërishtes letrare profesor Riza dëshmon se ka një përgatitje të lartë teorike. Ai ka një mendim të drejtë se jo vetëm ndërmjet dy dialekteve të shqipes, si variante territoriale të një gjuhe të përbashkët, por edhe ndërmjet gjuhëve indoevropiane ka shumë brumë gjuhësor të përbashkët. Duhet bërë përzgjedhja e materialit gjuhësor me një arsyetim të rreptë shkencor, duke pranuar vetëm gjërat që sjellin diçka të re për nga vlera e tyre shenjuese ose gramatikore.

Në bazën e pangegërishtes letrare ai përfshin elementet e përbashkëta gjuhësore të mbarë shqipes (gegësishtes e toskërishtes), disa elemente të njësura gege dhe në disa raste nga ndonjë e folme e veçantë gege. (Citojmë) *“Ndëngegënishtja jugore do të japë bashkëtingujt (sot: bashkëtingëlloret) qiellzorë q dhe gj; dhe vetëtingullin (sot: zanoren) e gjysmëzâshëm ê (sot ë); veriperëndimorja, vetëtingullin e ndërhumdshëm: â, të cilin dy tjerët kanë tejtrajtue në: ô, si dhe imperfektin më: -nja; verilindorja do të japë dezinencën: -n të participavet t’adjektivuen etj. etj. ”*Profesor Selmani për gegërishten letrare propozon edhe dy inovacione të guximshme: emrat ambigjenë të ruajnë gjininë e njëjësit edhe në shumës (p.sh. ai shkruan “inovacion të guximshëm”)^{iv} dhe të mos përligjet rimarrja e kundrinës.

Periudha prej vitit 1956-1967 është periudha më frytëdhënëse në veprimtarinë shkencore të Prof. Selman Rizës. Në këtë periudhë të shkurtër rreth 11-të vjeçare dha shumë për shkencën shqiptare.

Veprat e veta prof. Selman Riza i shkroi në kohën kur ende mungonte një drejtshkrim i njësuar i shqipes dhe është e arsyeshme që edhe ai të kishte pikëpamjet e veta. Gjithsesi vlen të vëmë në pah një gjë: në vitet e vona të jetës së vet, Selman Riza, në një numër të vogël faqesh të shkrimeve të tij ka bërë ndryshime, duke pranuar për një pjesë të mirë zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit, me një përjashtim, i cili përbën një qëndrim shkencor konsekuent të tij: mospranimin e ambigjinitetit, pra ruajtjen e gjinisë mashkullore edhe në shumës, tek emrat me shumës në-e (*male të lartë, mendime të drejtë*).

Ai ka qenë i mendimit se me bashkëveprimin e mëpastajmë të gegërishtes letrare dhe të toskërishtes letrare, me përzgjedhjen e elementeve të përbashkëta në bazë të kriterëve të shëndosha shkencore të krijohej shqipja standarde: *“për të sendërtuar një gjuhë të bashktë shkrimi për mbarë Gegëninë”* dhe ku është e mundur të njëjtësimi të të gjegjësimi të drejtpërdrejtshëm me toskënishten letrare“.

“Porse mue m’âsht mbushë mendja se edhe me Shkodrën kryeqytet, shkodranishtja, prap se prap, nuk do të kishte mundë me u bâ letrarishtja e Shqipnisë. Po për ç’farë shkaku vallë? Për shkaku madhuer t’ekzistencës së një toskënishtje popullore, folkloristike dhe letrare, e cila gjindet së gjithash kaq larg prej shkodranes... letrarishten e njëjtë për krejt Shqipninë do ta bâjë të mundëshme vetëm e vetëm një gegërishte e afëruene prej toskërishtes.”^v

“Me caktue në praktikë drejtëshkrimin e shqipes âsht një punë edhe me zgjidhë në theorí problemin gjuhësuer të Shqipnisë... nuk âsht një punë tjetër. Madje i pari hap i madh drejtë së bashkës gjuhë shkrimi qe aj që gjuhëtarët dhe shkrimtarët e Shqipnisë bânë në vitin 1908 në qytetin e Monastirit tue themelue të sodshëmen abecë të shqipes.”^{vi} Këtë vepër kushtuar drejtëshkrimit, autori e shkruan jo në shkodranishte e as në elbasanishte, por në një gjuhë shumë të përafërt me shqipen e sotme letrare“.

Në monografinë për drejtëshkrimin, autori dallon qartë tejshkrimin (transkriptimin) nga drejtshkrimi (ortografia). (citojmë) *“Me tejshkrue të folunët do të thotë me tejmbartë atë tingullisht prej goje në kartë. Në fillet e saj tejshkrimi dhe drejtshqiptimi ishin një, ndërsa më vonë u dalluan, sipas autorit, për tri shkaqe:*

“1. tue grupue tingujt jo simbas veshit por simbas mëndjes, jo simbas akustikës por simbas logjikës;

2. tue mos shenjue gjithëmonë ndryshimet tingullorë që mund të pësojë një fjalë ... më një fjalë;

3. tue u shtëmangë vetëdijtunisht e qëllimisht prej shqiptimit populluer.”

Problemet e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras ose me vizë në mes sipas prof. Rizës lindin në rend të parë nga “grupzimi i tingujvet jo simbas veshit por simbas mendjes – për të cilët tejshkrimi i drejtëpërdrejtshëm dhe drejtëshkrimi tingulluer janë në ndryshim e madje në kundërshtim njëri me tjetrin...”^{vii}

Gjuhëtari ynë i shquar që atëherë na bën me dije se është e pamundur që të shënohen as edhe me drejtshkrimin që për bazë ka parimin fonetik të gjitha nuancat tingullore të të folurit. Pra, shkronjat përfaqësojnë fonemat e gjuhës e jo tingujt e panumërt të ligjërit. (Citojmë) “Edhe me të vërtetë, edhe drejtëshkrimi më tingulluer, edhe alfabeti më i diferencuen i botës nuk mund të shenjojë çdo ferk të hollë të shqiptimit, nuk mund të pasqyrojë me besnikë absolute gjendjen tingullore të një gjuhe së gjallë. Me besnikinë absolute, me të cilën, për shëmbëll, regjistrohet zani i këngëtarit prej fonografit. Sidomos për sa përket vetëtingujvet (tani: zanoreve), do vû ré se çdo shkronjë përfytyron vetëm typin themeluer të çdo vetëtingulli. Në shqipe, e-ja, fjala vjen, mund të jetë e theksuene e e patheksuene, gojore e hundore, e shkurtë, e mesëme e gjatë; e mbylltë e e hapte...”^{viii} Pikërisht për këtë, disa popuj, si grekët e lashtë, zanoret e shkurtra i shkruanin me shkronja të posaçme, ndërsa të gjatat me shkronja të veçanta. Kjo u qëndroi provave të mëvonshme të fonetikës tradicionale dhe eksperimentale si dhe të fonologjisë.

Përveç parimit fonetik që është mbizotërues në shkrimin e shqipes, prof. Selman Riza shpjegon bindshëm edhe zbatimin e parimit morfologjik. (Citojmë) “Drejtëshkrimi tingulluer që po aj tingull të shenjohet gjithëmonë e gjithëkund nepërmjet po t’atij shenji, analiza logjike kërkon që po ajo fjalë të përfytyrohet kurdo e kudo nepërmjet po t’atij përfytyrimi.”

Si njohës i 12 gjuhëve, profesor Riza flet edhe për dallimin ndërmjet gjuhës popullore dhe gjuhës letrare, për mospërputhjen ndërmjet tejshkrimit të gjuhës popullore dhe drejtshkrimit të letrarishtes së dy gjuhëve klasike: greqishtes e latinishtes si dhe problemet që kanë anglishtja e frëngjishtja për shkak të drejtshkrimit etimologjik a historik.

Në çështjen e drejtshkrimit të shqipes prof. Selman Riza, pasi përlligj pohimin se drejtshkrimi i shqipes është fonetik në toskërishten letrare e do të jetë edhe në pangegërishten e tij, shqyrton tri çështje kryesore të drejtshkrimit në të dy dialektet (citojmë):

“I. - hiati dhe mjetet e ndryshëm për mënjanimin e tij;

II. – ndërhumdësija, toniciteti dhe gjatësija e vetëtingujvet dhe shenjimi i tyre me anë të theksavet të ndryshëm;

II. – vetëtingulli: ë.”

Toskërishtja letrare për Rizën ka një drejtshkrim tipik tingullor. Këtë e mundësuan disa rrethana të volitshme: se të folmet toske janë mjaft unike, se Dangëllia pati fatin të lind dy shkrimtarët e njohur Naim e Sami Frashëri, që shkruan vepra me vlerë me zbatimin e drejtshkrimit tingullor, me një fjalor dhe stil popullor. (Citojmë)

“...në Toskëni leximi i shijuen i një vepre letrare është një punë që bâhet dhe prej një filloristi, që mos thom edhe prej një ish-analfabeti, Shka nuk mund të thuhet kurrqysh, për shëmbëll, për shumicën e madhe të prodhimevet të Shkodranëve, tek të cilët klasicizma, që të mos thom retoricizma, greko-latine e sidomos latine ka ushtruar një të rrastë influence antikvizuese e aristokratizuese jo vetëm në poezi por edhe në prozë.”^{ix}

Gjuhëtari ynë është i mendimit se edhe gegërishtja letrare duhet të mbështetet në një drejtshkrim tingullor, por për të zbatuar këtë parim dalin shumë vështirësi, sidomos në shkrimin e dytingujshave (togjeve të zanoreve) *ue, ye, ie* si *uë, yë, ië* apo si të monoftonguar në zanore të gjata *ū, ŷ, ī*. Problem të veçantë do të paraqiste shkrimi i ë-së, meqë në gegërishte nuk përdoret në rrokje të theksuar, ndërsa në rrokje të patheksuar ka denduri të rrallë përdorimi. Rënia e saj në pozitë fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, prandaj në gegërishte ajo do të shënonte se zanorja paraprake nuk është e shkurtër, por e gjatë ose së paku e mesme.

Profesor Selman Riza studion edhe disa dukuri fonetike në shqipen, siç janë hiati dhe mjetet e ndryshme për mënjanimin e tij, epenteza, elizioni, krasisi (shkrirja), vetitë nyjëtimore, akustike e funksionale të tingujve si dhe mënyra e shënimit grafik të tyre, për zanoren *ë* në shqipen, evoluimin e *ë*-së në toskërishten letrare etj. Për shpjegimin e këtyre dukurive autori sjell shumë shembuj nga të folmet geqe e toske si dhe nga shkrimet shqipe. Këto dukuri janë shpjeguar aq bindshëm saqë edhe tani i qëndrojnë kohës.

Prof. Selma Riza propozon të shënohet theksi te çiftet e fjalëve të tipit *drejtóri – drejtorí* për të mënjeluar dykuptimësinë. Lidhur me zanoren *ë* që atëherë prof. Riza me të drejtë ka konstatuar se: *“jo vetëm si shkronjë për shkak të dypikëshit por edhe si tingull për shkak të një ndëgjueshmenije që ndërton gjatë një shkalle së gjânë, vetëtingulli ë përmbân problemin kryesorë të çështjes gjuhësore të Shqipnisë.”^x*

Fonema /ë/ në gjuhën shqipe ka shumë larmi timbresh, në rrokje të theksuar nuk e gjejmë në gegërishte (sepse kemi /â/ ose /ê/ hundore), ndërsa në pozicion të patheksuar ka përdorim shumë të dendur në toskërishten, ndërsa përdorim të rrallë në gegërishten: në të folmet e Veriut nuk e gjejmë as në pozitë nistore e as në pozitë fundore.

Gjuhëtari ynë për shkrimin e /ë/-së jep edhe disa zgjidhje përgjithësuese, duke u përpjekur të mbajë një baraspeshë ndërmjet drejtshkrimit etimologjik a historik dhe tejtshkrimit të drejtpërdrejtë të shqiptimit popullor. *“Po u pranua këjo zgjidhje e ime e problemit kryesuer të drejtëshkrimit të shqipes, atëherë n’orthografinë e shqipes do të kemë prû siguri e njëjtësi me një pikë rreth së cilës, deri sod, sikurse pamë pak prandej, kanë mbretinue dyshimi pothuejse në të gjithë shkrimtarët e gjuhëtarët t’anë dhe ndryshimi prej njënit te tjetri e madje prej një faqe në tjetrën po t’atij shkrimtari o gjuhëtari t’ânë.”^{xi}*

Në përfundimin e studimit për drejtshkrimin e shqipes vetë prof. Selmani pohon se (citojmë): *“Nuk po më rrihet pa pohue qysh tash se mue nuk po don me mu dukë e mundshëme as madje e dëshërueshëme që orthografija e gjuhës sonë të fiksohet me përpikërinë pedante, me rreptësinë rigoriste...”^{xii}*

Riza është i vetëdijshëm se për gjithë shqiptarët duhet të kemi një gjuhë letrare të njësuar. Por, si do të arrihet kjo?

1. ... tue u njëjtësue: do të njëjtësojmë gegërishten letrare me toskërishten letrare tue mënjanie evolutat partikulariste (të pjesshme);

2. ... tue u gjejësue, pra duke gjetur format e barasvlershme morfologjike. Duke parë dualizmin dialektor dhe njëjtësinë e shqipes: (citojmë) “ndryshimet ndërmjet toskërishtes letrare dhe pangegënishtes letrare do të jenë të një natyre vetëm e vetëm fonetike”.^{xiii} Me mënyrën gjenetike, historike - ,thotë autori, - themelohet bindja e njëjtësisë së shqipes. Me mënyrën përshkruese, përkatësisht numëruese stërmadhohet përshtypja e dualizmës dialektale.^{xiv} (citojmë) “Në konkluzion mund të thuhet prâ se ndërmjet toskërishtes letrare dhe pangegënishtes të sendërgjuene prej meje nuk do të ketë ndonjë ndryshim të një natyre morfologjike o syntaktike”.^{xv}

“Bashkëpunimi i ndëngegënishtevet do të siguronte mundësina të mëdha për të sajue një gegërishte letrare diku krejt të njëjtë dhe diku drejtë për së drejti të gjeqjshme me toskërishten letrare“

“Toskënishtja letrare ka të drejta të fituese, të cilat mund të nderohen më një masë të gjânë në saje të rrethanës që gegërishtja letrare âsht endé e papërcaktuene përfundimtarisht; rrethanë, këjo, prej së cilës duhet me u shërbye tue trajtue një gegërishte letrare që të jetë gati gati pasqyrimi besnik i toskërishtes letrare.”^{xvi}

Këtë paraqitje tonë të shkurtër do ta përmbyllim me një poezi të pavdekshmit Selman Rizës:

Prof. Selman Riza (1909-1988)

“Dardani e vjetër
Kosovë e Re!
Ke qen’ shqiptare
Shqiptare je.
Dimën e verë
Sa t’jetë jeta
Ka me përshëndet
Me “Tungjajeta”...
- Prof. Selman Riza.

ÇËSHTJE TË GJUHËSISË BALLKANIKE NË VEPRËN E SELMAN RIZËS

Do ta nis kumtimin me diçka të cituar nga Ali Dhrimo për prof. Selman Rizën:

“Selman Riza ishte si një diamant shumëfaqësh, të cilin nga çdo anë që ta kthesh, rrezaton me një ngjyrë tjetër....., njeriu që do të orvatej të mblidhte gjithë mendimet e Selman Rizës, do t’i ngjante një foshnje, e cila në një ditë me shi shtrin doçkat të mbajë shiun që bie.”

Në fakt edhe unë e kam pasur tepër të vështirë që në rrjedhën e shiut të qëmtuar nga Prof. Riza të grumbulloja dhe t’i ndaja ato studime që lidheshin me gjuhësinë ballkanike. Dhe studime të krahasuara rreth lidhjes gjuhësore ballkanike dhe problematikës së këtyre gjuhëve, nga ato materiale që ne kemi qëmtuar, janë të pakta. Por me punimet e shumta monografike për mbarë strukturën e gjuhës shqipe në planin sinkronik dhe atë diakronik, kemi mundur të gjejmë edhe hulumtime dhe teza konkrete, që lidhen me dukuri gjuhësore ose tipare karakteristike të vlefshme për studimet ballkanologjike në tërësi.

Selman Riza në lidhje me gjuhësinë ballkanike ka një punim, të miratuar prej Sektorit të Gramatikës dhe Komisionit përkatës me temë: “Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten” në shqip dhe në frëngjisht, për ta paraqitur në Kongresin I të Ballkanistikës, ose siç u quajt Kongresi i Studimeve të Evropës Juglindore, në Sofje më 1966. Artikulli i shtypur edhe në formën e një broshure, nuk arriti të lexohej në këtë kongres, se vetë autori nuk u lejua të shkonte, pasi kumtesa ishte hequr nga lista me një urdhër të rektoratit të Universitetit të Tiranës. Ky punim arriti që të shihte dritën e botimit shumë vonë, vetëm në serinë e veprave të Rizës në Veprën V⁸ si dhe në Studime 10.

Që mund ta konsiderojmë, me një farë lidhjeje me gjuhësinë ballkanike, është edhe një shqyrtim kritik (S. Riza, Vepra IV) mbi fjalorin serbokroatisht- shqip, të Henrik Bariq, botuar nga Akademia Jugosllave e Shkencave dhe Arteve më 1950. Selman Riza nuk pajtohet me mjaft probleme të karakterit teorik që shoqërojnë fjalorin për gjuhën shqipe në tërësi, për pasurinë e saj, sidomos pjesa që lidhet me dy dialektet kryesore të shqipes ku sipas Bariqit paska dy gjuhëna letrare regjionale (“gjuhë gegishte na severu dhe gjuhë toskërishte na jugu”) që janë kaq të ndryshme ndërmjet veti sa që gegët toskërishten “memezi e kuptuekanë”. Në fjalor janë bërë edhe mjaft vërejtje për leksema të veçanta të fondit autokton dhe atyre të huazuar.

Këto dy probleme, që vetëm sa i përvijua, do të gjejnë vend në ndonjë punim në të ardhmen.

Ne do të ndalemi shkurt vetëm rreth studimeve në sistemin nominativ të shqipes, që lidhen me disa nga dukuritë tipike ballkanike, dhe konkretisht tek bashkëpërkimi formal i rasave gjinore e dhanore si dhe në prapavendosjen e nyjës shquese.

Dukuria e bashkëpërkitimit formal të gjinore me dhanoren, është vënë re qysh prej Mikloshiçit. S. Riza është marrë pjesërisht në punimin e tij historik: “Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit”. Ai ka trajtuar konvergjencën strukturore rumuno-shqiptare, dhe më konkretisht, me të ashtuquajturën nyjë të përparme të emrit në gjinore

⁸ Riza, S. Vepra V. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Botime të veçanta CIV. Libri 43. Prishtinë, 2009.

kundrejt jo më pak të ashtuquajturës njëj pronore (artculul posesiv sau genetival) të rumanishtes. Pavarësisht mospërputhjes së plotë, Riza thekson: “qysh nga shekulli XVIII e tëhu “nyjës pronore ose gjenitive” rumune rasat e zhdrejta i janë bërë të papërdorshme, kurse në shqipe “nyja” përkatëse nuk njeh ndonjë kufizim të tillë. Asgjëmangu, në esencën e strukturës së tyre, “nyja pronore ose gjenitive” e rumanishtes dhe “nyja e një emri në gjindore” e shqipes përbëjnë sigurisht të njëjtën shfaqje gjuhësore.

Edhe me të vërtetë, si në shqipe ashtu edhe në rumanishte, të kështuquajturat nyja emrash në gjinore as për nga funksioni shques as për nga sintaksa e përkimit nuk janë të këtilla d.m.th. nyja, por janë përkundrazi dëftorë të një karakteri e funksioni *sui generis* (i llojit të vet).

E në këto dy gjuhë i përbashkëti karakter *sui generis* i këtyre dëftorëve qëndron edhe këtu që ata praktikisht kanë përbërjen fonetike të nyjave të shquara, e në anën tjetër këtu ata përsëritin pleonastikisht (në mënyrë të tepërt) emrin e plotësuar nga emri në gjinore.

Në të njëjtat gjuhë i përbashkëti funksion *sui generis* i këtyre dëftorëve qëndron edhe këtu që ata, duke përsëritur pleonastikisht emrin të plotësuar nga emri në gjinore, shërbejnë për të dalluar makar tërthorazi dy trajta përndryshe të padallueshme të një emri, e pikërisht dy trajtat e tija në gjinore e dhanore”. Dhe e mbyll këtë trajtim duke u shprehur:

“Pra, nuk ka dyshim se na këtu kemi të bëjmë me një konvergjencë strukturore shqiptaro- rumune nga më të interesshëmet.” Autori nuk na e shpjegon me imtësi këtë në planin historiko- krahasues pasi nuk e ndien veten “kompetent” për këtë problem.

Një ndër dukuritë tipike gjuhësore ballkanike është edhe ajo e prapavendosjes së nyjës shquese, edhe pse dukuria ndeshet edhe në gjuhë të tjera i.e. jashtë Ballkanit, si p.sh. në armenishte, në gjuhët skandinave, madje edhe në gjuhë të tjera i.e. dhe jo- ie. Por dukuria ndeshet kryesisht në gjuhët ballkanike të cilat u përkasin grupeve të ndryshme të familjes i.e., siç janë shqipja, rumanishtja, dhe bullgarishtja e maqedonishtja. Në grupin e gjuhëve romane, ku bën pjesë rumanishtja, nyja shquese është e paravendosur, dhe në gjuhët e grupit sllav në përgjithësi nuk e kemi të zhvilluar nyjën shquese. Kjo natyrisht që ka tërhequr vëmendjen e shume studiuesve, nga të cilët mund të përmendim: J. Kopitar (1829), Mikloshiçi: 1861, Sandfeldi: 1930, Tagliavani: 1924, Çabej: 1963, Schaller-i: 1975, Solta: 1980, Bokshi: 1984, Banfi: 1985, Feuillet-i: 1986 etj., të cilët kanë dhënë edhe mendime që lidhen me burimin e dukurisë. Kështu, përveç burimit të shqipes, që mbrohet kryesisht nga disa studiues shqiptarë kemi edhe hipotezën e substratit, ndikimi i latinishtes vulgare, ndikimi sllav, grek si dhe hipoteza e një zhvillimi të pavarur si dhe hipoteza të tjera që janë dhënë nga shih Sandfeld: 1930.

“Nga gjuhëtarët shqiptarë, shprehet Bokshi⁹, vetëm Selman Riza vjen në përfundimin se në gjuhën shqipe nyja shquese ka qenë prepozitive. Krijimin e nyjës dhe pozitën e saj proklitike ndaj emrit dhe mbiemrit ai e konsideron të një lashtësie “më se dymijë vjeçare”. Nyja e përparme, sipas tij, “nuk është asgjë tjetër, veçse një mbeturi mbijetuese ose një relik (.....) i shqipes së lashtë në shqipen e vonë d.m.th. afërsisht në shqipen që nga pragu i mbijetësës së vonë e tëhu”. Si kohë më të saktë të aglutinimit të nyjës ai shënon shek. VIII-IX. Ndërkaq, si kohën e krijimit të nyjës ashtu dhe kohën e aglutinimit të saj S. Riza e ka deklaruar pa e argumentuar. Në parathënien e punimit *Nyja*

⁹ Bokshi, B. Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike. Tiranë 2008

e shqipes (BUSHT SSHSH,2,1958), S. Riza na njofton se kishte bërë gati një monografi historike për nyjat. Fati i kësaj monografie nuk dihet. Megjithëkëtë, autori thotë se në këtë punim përshkrues “kurdoherë kemi parasysh dhe kemi shfrytëzuar konstatimet dhe konkluzionet e monografisë historike”. Këto përfundime S. Riza i kishte publikuar më 1953 në veprën *Dëftorët e shqipes dhe historiat i tyre* (Prishtinë):

Mendimin e vet se shqipja e lashtë kishte vetëm një të paravendosur Riza e ka mbështetur:

1. Te nyjat e parme të mbiemrave, për të cilën shënon: “Na mendojmë se për shqipfolësin e dikurshëm mbiemrat *i mirë* etj. kanë qenë mbiemra pikërisht të *substantivuar në funksion ndajshimi*, d.m.th. kanë dashur të thonë pikërisht: *i miri* etj. e për pasojë se për shqipfolësin e dikurshëm nyja e parandëjtuar ka qenë plotësisht caktuese (kështu që në shqipen e dikurshme, mbiemrat domosdo kanë qenë të panyjshëm, siç janë në të gjitha simotrat e gjuhës sonë)”

2. Në rastet kur nyja e përparme e ka ruajtur edhe sot “vlerën e saj caktuese”, siç janë:

a. nyja para numërorëve themelorë, kur përdoren si emra: “kanë ardhur (që) të tre, (që) të tria”;

b. nyja para përemrave të pakufishëm *gjithë, tërë*, të cilët “kurdoherë paranyjëzohen pa u paranyjëzuar dot: të gjithë, të gjitha, të tërë, të tëra (kurse të mirët, të mirat etj.)” dhe

c. nyja e përparme në shprehjet *të mi vëllazën, të tu motra* etj., e cila, sipas Rizës, nuk është e mbiemrave *mi, tu*, por e emrave *vëllazën, motra*, të cilët “i cakton së përparmi”. Këtu ai fut edhe shprehjet *i biri, e bija, të bijt* etj., të cilat vërtet sot duan të thonë: *biri i tij, i saj, i tyre* etj., por në të cilat elementet *i, e, të* – historikisht (e morfologjikisht) janë domosdo nyja të parandëjtura emrash”¹⁰

Si dëshmi për lashtësinë “më se dymijëvjeçare” të nyjës së përparme në gjuhën shqipe S. Riza merr këto momente:

1. Përbërjen fonetike të nyjës së përparme si të dëftorëve të thjeshtë brenda pronorëve të tipit *ynë, jonë, tanë, tonë* etj. ku, sipas tezës së H. Pedersenit, që u pranua nga Riza, “nyjat e përparme *y-, (j)o-, ta-, to-* etj. janë aglutinuar me vazhduesit e pronorëve primarë *-n-* etj.”;

2. Përbërjen fonetike të dëftorëve të thjeshtë si të nyjave të përparme, që del, sipas Rizës, “tek dëftorët në bashkëvjajtje me emrat në gjinoren e re p.sh. *kali i Pjetrit më pëlqen më shumë se ai i Palit* e sidomos në të vjetrën p.sh. *Pali bleu një kalë të mirë, por i Pjetrit më pëlqen më shumë*”¹¹.

Selman Riza mendon pra se emrat në shqipen e lashtë kishin një të përparme shquese *të vëllazën, të thonj* etj. (= vëllezërit, thonjtë etj.) e se mbiemrat qëndronin midis nyjës e emrit kur ishin në funksion të epitetit: *të mi vëllazën, të mi thonj, të mëdhenj thonj* etj. mbiemri me një të përparme shquese mund të përdorej në funksion të ndajshimit e atëherë zinte vend prapa emrit: *të thonj të mëdhenj* (thonjtë (ata) të mëdhenjtë), siç ishte gjendja në greqishten e vjetër: *ho kalos pojmen* ‘bariu i mirë’, *ho pojmen ho kalos* ‘bariu imiri’¹², si mundësi kjo e gjuhëve i.e. e jo si ndikim.

Se si ndodhi kalimi i nyjës nga prepozicioni në postpozicion S. Riza nuk na sqaron. Për këtë ai shënon: “Rrethanat e kalimit të nyjës së caktuar nga sintaksa parandëjtuese në

¹⁰ Nyjat e shqipes, Studime albanistike, f. 157- 8. si dhe Dëftorët e shqipes dhe historiat i tyre. Studime albanistike 1953 f. 443-444.

¹¹ Nyjat e shqipes, Studime albanistike, f. 162

¹² Po aty, f. 144

prapandejtuesen- mbeten në albanistikë ende për t'u shpjeguar me një mënyrë shkencërisht të kënaqshme”¹³. Por, ndërsa nuk ka përgjigje për sqarimin e procesit të pospozicionit të nyjës, S. Riza jep mendimin për krijimin e nyjës së përparme të mbiemrit: “Në shqipen e vonë, si nyjat e shquara ashtu edhe mbiemrat u pëmbysnë sintaktikisht d.m.th. u bënë të prapandejtueshëm që kishin qenë në shqipen e mëtejme..... “ dhe atëherë mbiemrat e prapandejtuar nuk u ndien më si të substantivuar në funksion ndajshtimi, por përkundrazi si të pasubstantivuar në funksion epiteti”, duke e ruajtur rrënjësor qëmoti në ndërgjegjen gjuhësore të shqipfolësve”, por tani pa funksion shques: *thonjtë të mëdhenj*”¹⁴. Kjo “përmbyse sintaksore”, që sipas autorit, “do të ketë përbërë karakteristikën kryesore të kalimit nga shqipja e mëtejme në të vonën”, do të ketë ndodhur në shek. VII- IX të e.re. Ndërkaq në tri punimet ku S. Riza e shqyrton çështjen e pozitës së nyjës nuk arsyetohet pse u përcaktuan këta shekuj si kohë e prapavendosjes dhe e krijimit të nyjës së përparme të mbiemrave dhe nuk jepen arsytet pse “u përmbushë sintaktikisht” nyjat dhe mbiemrat.

Për nyjën e përparme të gjinore S. Riza ka mendimin se ajo nuk ka qenë një shquese prepozitive kur u krijua nyja në gjuhën shqipe, por ka qenë përemër që ka marrë vetëm formën e nyjës, ndërsa kuptimin edhe sot e ka të dëftorit. Kjo është dhe arsyeja që ai këtë nyjë e quan “dëftorth”. Nga shembujt e përdorimit të gjinore si: “*Pali bleu një kalë të mirë, por i Pjetrit më pëlqen më shumë... Ky kalë është i Palit*” etj., S. Riza përfundon se trajtat *Palit*, *Pjetrit* etj. që “shqipja e vonë i njeh vetëm si rasa dhanore, në shembujt e sipërm janë përkundrazi gjindore relikto të shqipes së vjetër”. Dëftorthi në këta shembuj është “në rasën emërore e në funksion subjekti”, kurse *Palit*, *Pjetrit* etj. janë “trajta të emrit në rasën gjinore e në funksion plotësi”. Për Rizën, kur para “dëftorthit” përdoret përemri: *ai i Palit* etj. apo emri: *kali i Palit*, atëherë “të dhënat gjuhësore: *i Palit*.... pushojnë së qeni të analizueshme si trajta dëftorthi në emërore dhe si trajta emri në gjindoren e vjetër, për të përbërë së bashku nga një gjinore të re emri”, kështu që “dëftorthi” këtu përmbush “funksionin e një morfeme lakore”¹⁵.

Nga teza e S. Rizës na ka dalë i qëndrueshëm mendimi për pozitën burimore prepozitive të nyjës shquese në gjuhën shqipe në renditjen nyjë- mbiemër- emër (të mëdhenj thonj) e lidhur me të, edhe për pozitën e mbiemrit para emrit. Për krijimin e nyjës së përparme të mbiemrit dhe të gjinore S. Riza u fut në shtigje të pamundura e dha mendim të paqëndrueshëm. Është e kuptueshme se, duke mos pasur përgjigje për arsyen e kalimit të nyjës shquese në pospozicion dhe të kalimit të mbiemrit para emrit, S. Riza nuk mund të kishte përgjigje të saktë as për krijimin e nyjës së përparme.

¹³ Po aty, f. 158

¹⁴ Pronorët e shqipes. BUSHT SSHSH 2, 1959, 3, 1960 dhe Studime albanistike, f. 311, 299.

¹⁵ Nyjat e shqipes, Stud. Alban., f. 161-162.

MENDIMI I SELMAN RIZËS PËR KULTURËN E GJUHËS

*Gjuha është një nga shfaqjet
kryesore të jetës së një populli
Selman Riza*

Shkencat e albanologjisë ka kohë që me përgjegjësi e kompetencë të plotë po i shënojnë përvjetorët e ngjarjeve të rëndësishme e të personaliteteve të dalluara të kësaj fushe. Parvjet, në Shqipëri e në Kosovë, u organizuan disa tryeza, sesione, konferenca e simpoziume shkencore kushtuar Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, me rastin e 35-vjetorit të mbajtjes së tij, u shënuar përvjetori i 90-të i lindjes së akademik Idriz Ajetit etj., kurse vitin e kaluar gati në të gjitha trojet shqiptare u përkujtuan: 100-vjetori i Kongresit të Manastirit, 100-vjetori i lindjes së albanologut më të madh shqiptar – prof. Eqrem Çabej, po edhe 40-vjetori i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968), pa lënë anash, sigurisht, as dhe 130-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878) - si datë historike shumë e rëndësishme kombëtare, e që të gjitha këto me të drejtë bënë që ai vit, viti 2008, kur merret parasysh edhe Shpallja Pavarësisë së Kosovës dhe nënshkrimi i protokollit për pranimin e Shqipërisë në NATO, si dy ngjarje epokale të pritura me vite e shekuj, të quhej vit i mbarë e vit i madh i shqiptarëve dhe për shqiptarët. Por as ky vit, të cilin gati po e lëmë pas, nuk mbetet prapa atyre të mëparshëm. U organizuan tryeza e konferenca shkencore për 90-vjetorin e lindjes së gjuhëtarit të njohur, akademik Shaban Demiraj, kurse këto ditë kur edhe po mbahet kjo Konferencë shkencore, në mendjet e intelektualëve shqiptarë s'ka se si të mos sillet emri i të madhit tonë - prof. Selman Rizës, me rastin e 100-vjetorit të lindjes dhe tani të riatdhesimit të mbetjeve mortore të tij në Gjakovën heroike, ku ai edhe bëri hapat e parë të jetës së tij.

Ky tubim shkencor, krahas atyre që u mbajtën ose do të mbahen në Shqipëri e në Kosovë, i organizuar për lakmi nga Fakulteti i Mësuesisë i Universitetit të Korçës dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, ku barrën kryesore të organizimit të tij po e mbajnë rektori prof. Gjergji Mero dhe zëvendësrektori i UK-së, prof. Ali Jashari, dekani i Fakultetit të Edukimit, prof. Hasan Mujaj dhe profesori i papërtësë i këtij fakulteti të UP-së, prof. Begzad Baliu, si dhe profesor Zeqirja Neziri nga Universiteti i Shkupit, na jep rastin dhe kënaqësinë të gjithë neve që edhe nga këtu, nga ky qytet që lidhet mirëfilli me shumë ngjarje që patën rëndësi kombëtare dhe më gjerë, të sjellim edhe një herë në vëmendjen e opinionit shkencor e shoqëror të kombit tonë vlerat e rëndësishme të veprës së prof. Selman Rizës dhe personalitetit të tij si dijetar, si mësues, si qytetar i veçantë - i dy shteteve, tek i cili akribia shkencore dhe idealet më të larta kombëtare e demokratike rrezatojnë edhe përtej kohës kur ai jetoi e veproi.

Që në krye të këtij shkrimi do të thoshim se të paktë janë ata intelektualë e dijetarë të cilët patën aq pak mundësi jete e pune normale e të kenë punuar aq shumë si prof. Selman Riza. Ai pati “fat shumë të keq, politikisht i përndjekur edhe në kohën e Italisë, edhe në ish-Jugosllavi, edhe në Shqipërinë komuniste” - siç theksoi këto ditë akademik Rexhep Ismajli. Ishte vetëm 13 vjeç, siç dihet tanimë, kur u largua nga familja dhe erdhi këmbë në Korçë, ku sot po flasim për shëmbëlltyrën e tij. Erdhi për të mos i parë e përjetuar ato vuajtje të vazhdueshme të bashkatdhetarëve të tij në Kosovë nga

shtypja dhe shfrytëzimi i egër serb. Rrahja e babait të tij nga forcat e regjimit të atëhershëm, duke e poshtëruar atë në praninë e gruas e të fëmijëve të tij, ishte edhe një shkas më shumë që ai t'ia mësyjë, siç thonë edhe sot shqiptarët e Kosovës, nënës Shqipëri - qytetit të Korçës, ku pasi mbaroi shkollën fillore 6-vjeçare për vetëm tre vjet, liceun francez nëntëvjeçar për vetëm gjashtë vjet, shkon për studime në Tuluzë të Francës, ku gjatë tre vjetëve (1932-1935) mbaron me sukses të shkëlqyeshëm dy fakultete, atë të gjuhës frënge dhe fakultetin e drejtësisë, e i cili me t'u kthyer në Shqipëri, me dekret të Mbretit Zogu, emërohet profesor në Liceun Francez në Korçë.

Prof. Selman Riza mbetet një shembull i madh në shkencën shqiptare, për botën intelektuale dhe për gjuhësinë tonë, për metodën e arsytimit e të kërkimit shkencor të pavarur, mënyrën e vështimit e të trajtimit të dukurive gjuhësore. Se ç'largpamës ishte prof. Riza, për gjuhën e kulturën tonë të përbashkët, flet edhe kjo e dhënë. Ai diku në veprat e tij - siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaç, pasi kishte hequr dorë nga ideja e tij e pangjegërishtes (traktat i gjerë i botuar më 1944 – B.K.), i cili, pavarësisht nga propozimet konkrete që bën (të pranueshme ose jo, ku kishte shtruar me mprehtësi të madhe shumë çështje teorike), jep mendimin se toskërishtja mund të shërbejë si bazë e gjuhës letrare, duke u shprehur se në të ardhshmen "Gjuha letrare shqipe nuk do të jetë gjë tjetër përveçse toskërishtja e folur prej gegëve"¹⁶. Dhe po u analizua më detajisht ky mendim i prof. Rizës, s'ka se si të mos rezultojë e vërteta se "vetëm një gjuhë e vetme, vetëm një varietet standard me një normë të njëjtë drejtshkrimore e të përbashkët për të gjithë bashkëkombësit shqiptarë... e mbrojtur përkushtimisht nga rreziqet gjithashtu aq të shumta po edhe të shtuara dukshëm në ditët tona"¹⁷ mund të kryejë denjësisht misionin e saj që ka. E ky koncept i kahershëm i prof. Rizës, i përfolur edhe nga prof. Shkurtaç, a nuk ishte edhe një gur më shumë në kullën e përbashkët të shqipes letrare, të shqipes standarde, si një shenjë e përbashkët e kulturës sonë, jo vetëm gjuhësore, sado që "gjuha letrare shqipe standarde (apo zyrtare) sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja geqe, që, ndërsa mbështetet tek norma e shkruar dhe mëton ta zbatojë gjuhën letrare, e realizon atë mjaft mirë, porse me një ngjyresë fonike gegizuese (p.sh. shqiptimi i /ë/ si /ê/: bêt, nê:n, bêra, rêra, zêri etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë "qethje" sado të pjesshme të bërë nga "Rregullat e drejtshkrimit", tërheq nga hipertoskizmi (p.sh. shqiptimi me / ë/ të prapme i fjalëve me /e/: vënd, mëndje, mëndoç, qëndër, fëmër, zëmër etj)"¹⁸.

Edhe pse fushat kryesore të albanistikës, ku prof. Selman Riza la gjurmë të pashlyeshme si: 1. Shqipja e shkrimeve të hershme; 2. Morfologjia historike dhe 3. Kritika gjuhësore; ai kurdoherë mbajti parasysh edhe aspektin e kulturës gjuhësore: shqyrtimin e funksionimit të gjuhës në kontekstin kulturor të kohës si gjuhë letrare, me kërkesat kryesore të tij: qartësinë maksimale logjike dhe kuptimore të shprehjes, saktësinë e shprehjes e të koncepteve dhe efektivitetin e shprehjes. Krahas këtyre tipareve, shprehjen e tij e shquajnë edhe veçori të tjera, si: zgjedhja e fjalës dhe e shprehjes, krijimi i fjalëve dhe i termave si nevojë e pasurimit të gjuhës dhe e shprehjes precize të nocioneve të caktuara në shqipe dhe inversioni i shpeshtë i gjymtyrëve në fjali. Veç këtyre aspekteve, në punën e tij prej shkencëtari të mirëfilltë, prof Riza shquhet edhe në krijimin e neologjizmave, paçka nuk janë të shumtë neologjizmat e tij që u futën në

¹⁶ Prof.dr. Gjovalin Shkurtaç, Një tezë e Selman Rizës për gjuhën letrare shqipe (internet)

¹⁷ Prof.dr. Gjovalin Shkurtaç, Po aty.

¹⁸ Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç, Po aty.

përdorim të përgjithshëm, por që me to mëton të tregojë rrugën se si duhet të formohen ato fjalë¹⁹.

Kulturën e tij të gjerë e të mprehtë për gjuhën, prof. Riza e shpreh edhe gjatë hartimit të veprës “*Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*” të hartuar në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, e i cili në vitet e vona të jetës së vet, “duke e marrë kushedi me ç’rast në dorë variantin e daktilografuar, në një numër të vogël faqesh të tij ka bërë ndryshime, duke pranuar kështu për një pjesë të mirë zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit, me një përjashtim, i cili përbën një qëndrim shkencor konsekuent të tij: mospranimin e ambigjinitës, pra ruajtjen e gjinisë mashkullor edhe në shumës, tek emrat me shumës në -e (male të lartë, mendime të drejtë...)”²⁰ (e jo male të larta, mendime të drejta... – siç e kemi të kodifikuar tani), gjë që edhe sipas nesh, meqë gjuha është një strukturë e hapur në kuptimin modern të konceptit të Humboldt, një gjë e tillë edhe mund të normëzohet. Ashtu siç ngjau me rrafshimin e dallimit të numërorit dy (me zanore të shkurtër, për gjininë mashkullore) dhe dy (me të gjatë, për gjininë femërore, që ka mbetur vetëm në gegërishten), mund të tretet dallimi tre (për meshkujt) dhe tri (për femrat), ku sot pothuajse gjithandej thuhet tre për të dy gjinitë. Këtij rrafshimi sigurisht se i ndihmon shumë edhe ndikimi i gjuhëve të huaja që nuk e kanë një dallim të tillë në morfologjinë e tyre. Kjo do të ishte një trysni mirëfilli toske, në thelb e pamirë, por detyrimisht e përfillshme sepse po përgjithësohet. Nga ana tjetër, hetohet tendenca formimit të shumës me -a, si te shembujt: *mësues, student, profesora, shofer, oficer* etj., që vjen nga ndikimi i gegërishtes, por që po gjen përdorim të gjerë e pëlqehet si një shumës më i qartë ndaj formave përkatëse me -ë, që këshillon norma e sotme morfologjike e drejtshkrimore. Edhe më e qartë del kjo trysni gegizuese në fjalët me -ë fundore (*kalë, djalë, djathë* etj.). Tashti edhe toskët nuk i shqiptojnë më me -ë ato fjalë, prandaj edhe në praktikën shkrimore të sotme, gjithandej po shtohen “gabimet” drejtshkrimore pikërisht për kategori të tilla²¹.

Sipas gjedheve të lartshënuara, kemi bindjen se nuk do të bëhej mëkat, që edhe disa emra të përgjithshëm, si: *çam, lab, prind, nip* e ndonjë tjetër i këtij lloji që, siç dihet, kanë dy forma të shumës, ku njëra formë sajohet duke i prapavënë njëjësit të tyre mbaresën -ë ose -a (*çamë, labë, prindë, nipa*), siç përdoren kryesisht në gegërishte, kurse forma tjetër e shumës të këtyre emrave sajohet me mbaresën -ër (*çamër, labër, prindër, nipër* etj.), si në toskërisht, ose edhe një tip tjetër emrash të përgjithshëm: *drapër, gjarpër* dhe *gisht*, që në shumësin e pashquar dalin si: *drapinj* dhe *drapërinj, gjarpinj* ose dhe *gjarpërinj, gishta* dhe *gishtërinj* etj., përdorimi i të cilëve nuk bie ndesh me normën letrare²², më mirë është të kodifikohen me format që i karakterizon një ekonomizim gjuhësor. Pra, kujtojmë ne, më mirë është të thuhet: një *çam* - disa *çamë*, një *lab* – disa *labë*, një *prind* – disa *prindë*, një *nip* – disa *nipa*, sesa: disa *çamër, labër, prindër, nipër*, ashtu siç do të shqiptoheshin më lehtë edhe format e emrave: *drapinj, gjarpinj, gishta*, sesa *drapërinj, gjarpërinj, gishtërinj* etj., e që edhe ky parim mendojmë se mund të përputhet me mendimin e prof. Rizës “për rolin ndërtues e pasurues të folësve gegë në gjuhën letrare shqipe të njësuar”, si një mendim e “tezë frymëgjatë ndaj ardhshmërisë së gjuhës shqipe të njësuar, e formuluar nga një gjuhëtar e atdhetar si ai”.

¹⁹ Prof. Selman Riza, *Studime albanistike*, “Rilindja”, Prishtinë, 1979 (Parathënie).

²⁰ Gj Shkurtaç, po aty.

²² Grup autorësh, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, faqe 27 dhe 28.

Prof. Riza, i vetëdijshëm se një popull, pa një standard unik gjuhësor nuk mund të ketë as kulturë të mirëfilltë gjuhësore, që në vitet e 50-ta, kur në Tiranë e në Prishtinë mbaheshin konsulta gjuhësore të njëpasnjëshme për një gjuhë letrare mbarëkombëtare, për një kulturë shkrimi të njëjtë, tregohet mjaft parimor, duke theksuar shprehimisht se duhet “*me shti në përdorim fjalët dhe shprehjet që gjinden në cilindo dialekt të shqipes. Fjalori i shqipes është i përbashkët pamvarësisht prej dallimevet dialektore dhe kryedialektore në lîamin; e fonetikës dhe të morfologjis. Të folmet popullore do të jenë burimi i gjithanshëm për pasurimin e fjalorit të gjuhës së shkrimit të shqiptarëve*”²³.

Se prof. Riza kishte për zemër zgjidhjen e problemit të një gjuhe letrare dhe pasurimin e pastrimin e saj, si dëshmi të një kulture gjuhësore më të lartë e të pranueshme nga të gjithë shqiptarët, e ndeshim edhe te kapitulli “*Pasunimi dhe pastrimi i gjuhës shqipe*”, paraqitur te vepra “*Fillimet e gjuhësisë shqiptare*” (Prishtinë, korrik 1952), botuar para Mbledhjes së gjuhëtarëve (nëntor 1952), ku si kërkesa - ide themelore “prej Rilindjes e tËhû” kishte këto:

“1. rishvlerësimin e asaj pjese të thesarit gjuhësor e cila me kohë pat ra në harresë në të folmën shqiptare por që fatlumas gjindesh e ruejtun në veprat e vjetra të shkrimtarëve shqiptarë,

2. ndërzymimin a kombinimin e fjalëve të thjeshta ndërmjet veti o me grimca foljore për të formue fjalë të reja a neologjizma, dhe

3. gegëzimin e toskizmvat e anasjelltas, si dhe përgjithësimin e krahinorizmvat, e që qëllimi ishte pikërisht me krijue një të vetëme gjuhë shkrimi për të gjithë Shqiptarët”²⁴.

Se ç’qëndrim kishte prof. Selman Riza ndaj kulturës së gjuhës, po i zëmë ngojë edhe këto fjalë të studiuesit tonë të njohur, Ali Dhrimo, se ai “nuk ishte si disa gjuhëtarë që merren me gjuhësi e gjuhë si me një “zanat” çfarëdo, vetëm në zyrë e në klasë, kurse në jetën e përditshme nga gjuha e tyre nuk dallojnë nga një qytetar i rëndomtë. Ai jo vetëm fliste me një gjuhë gati po aq të kujdesshme e të krehur, sa kur shkruante, por përpiquej vijimisht t’i bënte të vetëdijshëm edhe bashkëbiseduesit e vet, pa marrë parasysh shkallën e formimit dhe specialitetin e tyre, se si t’i përdornin drejt mjetet e gjuhës sonë, duke kërkuar që formulimi i tyre të ishte logjik dhe pa shtrembërime të papranueshme formash... Ai është, vazhdon Dhrimo, i vetmi gjuhëtar ndër ne që e ka kaluar në sitën e vet të imët e të rreptë shkencore tërë strukturën e kësaj gjuhe dhe në të dy planet, historik dhe bashkëkohor”²⁵.

Sigurisht se katër vëllimet e mëdha të AShAK të botuara në dekadën e fundit (1996 - 2004) dhe botimi i vëllimit V, ku përfshihen disa dorëshkrime të prof. Rizës në rreth 600 faqe, si dhe një monografi me titull “*Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*”, të cilën nga AShAK qe angazhuar ta përgatit akademik Rexhep Ismajli (ngase me dorëshkrimet e profesorit tonë, sipas amanetit të tij do të merrej akademik Ismajli), do ta plotësojnë edhe më opusin shkencor aq voluminoz e me vlera aq të larta shkencore të profesor Selman Rizës. Po edhe referatet e kumtesat e paraqitura në sesione, tryeza, konferenca e simpoziume shkencore, si dhe shkrimet e shumta nëpër revistat e gazetat tona, ashtu si dhe emisionet dokumentare në televizionet shqiptare me specialistë rizanian

²³ Cituar sipas Rexhep Ismajlit, *Drejtshkrimet e shqipes*, AShAK, Prishtinë, 2005, faqe 79.

²⁴ Riza: 1996, 307. (cituar sipas R. Ismajlit, Vepra e cituar, faqe 83-84)

²⁵ Ali Dhrimo, Zbërthyesi “elektronik” i shqipes”, gaz. “Koha ditore”, Prishtinë, 28 nëntor 2009, faqe 47, (nga Kujtesë: Selman Riza dhe studimi “Pesë autorët me të vjetër të gjuhës shqipe”).

- do të thoshim, po hedhin e do të hedhin dritë edhe më shumë në punën e palodhshme që ka bërë prof. Riza për të mirën e shkencave albanologjike, të kombit e të atdheut tonë. Me organizimin e aktiviteteve të shumta shkencore, gjithandej ku jetojnë shqiptarët, ne kujtojmë se së paku edhe kështu po lahet një borxh i vogël që ka dija shqiptare ndaj figurës së madhe e poliedrike të prof. Selman Rizës: edhe si atdhetar, edhe si gjuhëtar e edhe si njeri i pashoq i nënqiellit tonë.

SELMAN RIZA – NGA “PANGEGËNISHTJA” TE SHQIPJA STANDARDE

Në trashëgiminë e pasur gjuhësore të Selman Rizës, një vend të rëndësishëm zënë çështjet e planifikimit gjuhësor, në të dyja aspektet: të statusit dhe të korpusit të “së bashkës gjuhë shkrimi për gjithë Shqipninë”, sikundër e quan. Këtyre çështjeve ai iu përkushtua në fazën e parë të veprimtarisë së tij si gjuhëtar, duke i parashtruar idetë e para në shkrimin “Shqiponja dhe shqipja”, të botuar më 1936²⁶. Por në mënyrë tërësore pikëpamjet e tij për planifikimin gjuhësor ai i shtjelloi në veprën “Tri monografia albanologjike”, e cila, për nga thellësia e mendimeve dhe mënyra e argumentimit të tyre mbetet një model që, për mendimin tonë, nuk është arritur ende në studimet sociolinguistike shqiptare.

S. Riza u përfshi në polemikat e kohës për çështjen e gjuhës në moshë fare të re, duke u renditur në krah të atyre që e shihnin të largët krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët. Ky pesimizëm, i cilësuar më pas si “teoria e pritjes”, është qortuar si e tillë që ia linte “kohës të vendosë gjithçka deri në shkrirjen e plotë të dialekteve”²⁷. Ideja themelore e mbështetësve të kësaj rruge ishte se dialekteve të shqipes do t’u duhej të ecnin edhe për një kohë të gjatë krahas njëri-tjetrit si dy qetë në parmendë para se të shkriheshin në një gjuhë të vetme²⁸. Duke i parë me gjakftohtësi dhe nga largësia e 70 vjetëve, del se pesimizmi i autorëve në fjalë nuk ishte i pavend. Si intelektualë që formimin filologjik e kishin marrë në universitete të njohura të Europës, mbështetësit e kësaj rruge nuk ishin pa një njohje të proceseve të standardizimit të gjuhëve të Ballkanit dhe të Europës. Mendimin e tyre ata e mbështetnin në argumente të rendit gjuhësor, letrar dhe politik. Në kushtet e një tradite letrare të degëzuar që në fillimet e saj sipas dialekteve dhe kur shteti shqiptar mbulonte vetëm gjysmën e trojeve etnike, krijimi i një gjuhe të përbashkët letrare ishte vërtet një utopi.

Për kapërcimin e gjendjes kur shqipja lëvrohej në dy variante, në variantin letrar tosk, që paraqitej si variant mbidialektor, dhe në variantin shkodran, që ishte nëndialektor, Selman Riza mendonte se kishte tri mundësi:

- “1. Të ngrehim njërin dialekt në lartësinë e një gjuhe shkrimi të përbashkët...;
2. Të gatuajmë bashkë një idiomë eklektike nga brumi i të dy kryedialekteve; dhe
3. Të privilegjojmë një nëndialekt, për hir të një shiuate gjeografikisht të mesëme...”²⁹

Duke u bashkuar me ata që mendonin se i duhej lënë kohës të vendoste gjithçka deri në shkrirjen e dialekteve, S. Riza ndoqi një rrugë të ndryshme nga ajo e Aleksandër Xhuvanit, që punonte për ngritjen e elbasanishtes në gjuhë letrare të vendit, dhe e Namik Resulit, që ishte kundër pritjes së pafund. Sipas Rizës, “shkaqet për të cilat një dialekt ia

²⁶ S. Riza, *Shqiponja dhe shqipja*, Tri monografia albanologjike, Shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1944, f. 221–228.

²⁷ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20–25 nëntor 1972)”, vëll. I, Tiranë, 1973, f. 61.

²⁸ A. Xhuvani, *Përmi themelim të një gjuhe letrëtare shqipe*, Vepra gjuhësore, 1, Tiranë, 1988, f. 9; po ai, *Gjuha e letërsia shqipe*, Vepra gjuhësore, II, Tiranë, 1988, f. 415.

²⁹ S. Riza, *Shqiponja dhe shqipja*, Tri monografia albanologjike, vep. e cit., f. 225.

merr anën... dialektit tjetër” janë politikë ose letrarë. Duke mos u marrë me faktorin politik, dmth. me shtetin, ai ndalet hollësisht te faktori letrar. Ai vë në dukje se, edhe sikur Arbëria të kishte pjellë një vigan letrar, si Dantja ose Petrarka, ky nuk do të kishte mundur të “mposhte pa tjetër shituatat e kristalizuar, gjendjet e bëra të ngurta nga kalimi i kohës dhe nga përpjekjet kolektive”³⁰. Sepse, nëse Dantja dhe Petrarka e patën këtë fat, kjo ndodhi ngaqë me ta nisi edhe tradita e shkruar e italishtes. Kurse letërsia shqiptare në mesin e shek. XX kishte një moshë gati 400-vjeçare. Prandaj këtë rrugë të krijimit të gjuhës së bashkë të shkrimit ai e mendonte të pamundur.

Rruga tjetër për krijimin e një gjuhe letrare shqipe si një lloj koineje kishte përkrahës jo të paktë. Një ndër ta qe N. Resuli, i cili propozonte që gjuha e përbashkët shqipe “të krijohej duke zgjedhur trajta nga të dy dialektet” në përputhje me disa parime bazë³¹. Letrarishtja e përbashkët e propozuar prej tij do të kishte, ndër të tjera, nazalizëm të zanoreve *a* dhe *e* të theksuar para hundoreve si dhe jorotacizëm. Këtë zgjidhje S. Riza e qorton ashpër, duke shkruar se gegëtoskënishtja eklektike e Resulit “e përbëne prej elementesh toskërishte edhe prej elementesh gegërishte asht një çorbë”³². Përpjekjet për ta sendërtuar këtë gjuhë eklektike, sipas tij, s’ishin “gjë tjetër përveçse një mozaikë pa shijë, një amalgam pa karakter, një mëmëligjë e pacilësuarshëme, një *monstrum linguisticum*”³³. Edhe sikur të ndodhte, kjo gjuhë hibride “do të pranohej me vështirësi të madhe dhe mbase nuk do të përgjithësohej kurrën e kurrës”. Sipas Rizës, “të gatuarit bashkë të dy kryedialektevet për të trajtuar një idiomë eklektike duhet luftuar a priori si një kombinim artificial ase si një përzierje arbitrare”³⁴.

Për të gjitha këto arsye, ai zgjedh një rrugë tjetër, atë të ngritjes edhe të dialektit gegë në nivelin e variantit letrar toskë. Për këtë zgjedhje ai përcaktohet që më 1936-ën, kur thotë: “*Shkabën e flamurit e kemi me dy krerë. Gjuhën e kombit do t’a kemi me dy kryedialekte*”³⁵, pohim që, i marrë jashtë kontekstit historik kur është nyjëtuar, është vlerësuar si një “përfundim fatalist”³⁶ apo si një tezë që i “binte ndesh prirjes së përgjithshme konverguese të varianteve letrare të shqipes”³⁷.

Por, po të vihet në kontekstin historik kur është thënë, ky pohim nuk përbën një herezi, përkundrazi, rruga e krijimit të një varianti letrar pangegë duket se ishte zgjidhja më e mirë e mundshme për atë kohë. Sikurse u vu në dukje më sipër, prof. Riza rolin vendimtar në krijimin e gjuhës letrare të përbashkët ua njeh faktorit letrar dhe faktorit politik. Nga këta të dy, faktori letrar, për shkak të dy traditave letrare shumë të vjetra, nuk mund ta luante këtë rol. Edhe faktori politik, në rastin e shqipes, mund të luante vetëm një rol ndihmës. Në të vërtetë, gjuhët standarde krijohen kur piqen kushtet e duhura për një gjë të tillë, dmth. kur puqen bashkë një varg faktorësh politikë, shoqërorë dhe kulturorë. Po gjuhëtarët a mund të krijojnë gjuhë letrare? Për këtë le të ndalemi njëherë në situatën gjuhësore të Shqipërisë në kohën kur S. Riza shkroi librin “tri monografia albanologjike”.

³⁰ Po aty, f. 227.

³¹ N. Resuli, cituar sipas S. Rizës, *Tri monografia...*, f. 171.

³² S. Riza, *Tri monografia...*, f. 182–183.

³³ Po ai, *Shqiponja dhe shqipja*, art. i cit., f. 226.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty, f. 228.

³⁶ A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, SF, 1970, 2, f. 10.

³⁷ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe” (20–25 nëntor 1972), vëll. I, Tiranë, 1973, f. 270.

Në vitet '30–'40 të shekullit të kaluar, lëvrime i shqipes karakterizohej nga një shpërpjesëtim i dukshëm traditash letrare. Ndërsa nëndialektet toske kishin 70 a njëqind vjet që ishin shkrië në një variant letrar ndërdialektor, me nëndialektet geqe një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Gegërishtja veriperëndimore, e përfaqësuar nga shkodranishtja, “me një të lashtë lavrim gjuhësuer dhe me një të shkëlqyeshëm lulëzim letrar”, qe larguar nga nëndialektet e tjera veriore, duke u bërë e vështirë për t’u lexuar jashtë mjedisit shkodran. Elbasanishtja, e shpallur si gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar, por e kundërshtuar me të madhe nga rrethet letrare shkodrane, që e patën quajtur atë “gjuhë mushke”, ashtu edhe nga toskët, sipas S. Rizës, nuk përmbante “në vetëveti as aq landë fjalori, as aq trajta gramatikore sa nevojiten për të përba (pa pjesëmarrjen masive të ndëngegënishteve tjera) një mjet të mjaftueshëm kumtimi kulturuer”³⁸. Ndërsa kosovarishtja ishte “letrarisht e paqenun dhe gjuhësisht ende e panjoftun mirë”³⁹.

Për sa i përket ligjërimit të folur, Riza vëren se nëndialektet geqe kishin pësuar një “phonetic decay”, dmth. në to rrëgjimet e tingujve kishin shkuar “pakrahasueshëm më shenjueshëm se sa nëndialektet e toskënishtes”⁴⁰. Dihet se në kushtet e mungesës së shkrimit dhe të kontakteve krahinore e ndërkrasinore liria e ekzekutimit të formave gjuhësore nuk njeh kufi. Sidomos larg kishte shkuar në këtë pikë varianti veriperëndimor i gegërishtes. Pikërisht, në ligjërimitin e folur të Shkodrës e mbështeti shkrimin e letërsisë fetare Urdhri i Jezuitëve, që e filloi veprimtarinë e vet në Shkodër aty nga mesi i shek. XIX, pasi kjo qe rruga më e mirë për të përhapur në popull doktrinën fetare⁴¹. Si rrjedhim, me braktisjen e traditës shkrimore të autorëve të Veriut, shkodranishtja e shkruar u largua shumë jo vetëm nga toskërishtja letrare, aq sa edhe toskët e shkolluar e kishin vështirë ta lexonin e ta shijonin, po edhe nga varianti jugor i gegërishtes.

Në përputhje me idenë mbizotëruese në atë kohë se dialektet e shqipes do të ecnin për një kohë të gjatë krahas njëri-tjetrit para se të njësoheshin, Riza mendonte se zgjidhja e problemit gjuhësor do të ishte jo krijimi i një gjuhe letrare të përbashkët, siç mendonte N. Resuli, po ngritja e gegërishtes në lartësinë e toskërishtes. Pra, për të shkuar te shqipja letrare e përbashkët, duhej duke krijuar më parë një variant letrar verior, pastaj ky variant, me mbështetjen e shtetit, do të bëhej gjuhë letrare e gjithë kombit. Për këtë arsye, ai vendosi që “këtë problem ta zgjidhi aktualisht vetëm për Gegëninë”.

“Konstatimi se ndëngegënishtet kanë evolue me një mënyrë fort asynkronike dhe divergjente ndërmjet veti, – shkruan ai, – më kanë frymëzue me idenë... për të sendërgjue një gegënishte letrare e cila të jetë përfundimi i bashkëpunimit të ndëngegënishteve të ndryshme simbas kriterit, ku të jetë e mundëshme, të njajtësimi dhe, ku të mos jetë, të gjegjësimi të drejtpërdrejtshëm me toskënishten letrare.”⁴²

Duke propozuar një zgjidhje të ndryshme dhe origjinale të problemit të gjuhës letrare, Selman Riza vihet në rolin e *planifikuesit të statusit* të pangegërishtes; duke e sendërtuar sistemin e pangegërishtes, bëhet *planifikues i kodit* të këtij varianti letrar; dhe, duke i zbatuar me rreptësi normat e këtij kodi në shkrimet e tij të periudhës 1944–1955, ai vihet në rolin e *zbatuesit* në praktikë të pangegërishtes.

³⁸ S. Riza, *Fillimet e gjuhësisë shqiptare* (1952), Vepra, I, Prishtinë, 1996, f. 314.

³⁹ S. Riza, *Tri monografina...*, f. 116.

⁴⁰ S. Riza, *po aty*, f. 112.

⁴¹ N. Resuli, *Grammatica Albanese*, Patron Editore, Roma, 1985, p. XXX.

⁴² S. Riza, *Tri monografina...*, f. 5.

Pangegërishtja e sendërtuar nga Selman Riza ishte në të vërtetë një variant letrar që e afronte shumë gegërishten me toskërishten letrare. Ai e ndërtoi atë “tue mënjatue evolutat partikulariste” dhe duke marrë prej nëndialekteve geqe dukuritë që e afronin më shumë këtë variant letrar me toskërishten letrare. Kështu, pangegërishtja hiqte dorë nga shënimi i gjatësisë së zanoreve; ajo ruante ë-në e patheksuar në të gjitha pozicionet, duke iu afuar një gjendjeje jo të largët kur nuk kishte pasur “ndonjë ndryshim ndërmjet dy kryedialektevet të shqipes”⁴³. Si rrjedhim, ndryshimet kryesore mes dy varianteve letrare ishin të rrafshit fonetik: rotacizmi i toskërishtes dhe hundorësia e gegërishtes; gegizma *ue* dhe toskizma *ua*; “shpërzanimi (shurdhimi) në toskërishte i bashkëtingujve *b, d, g* etj. kur gjinden në fund fjale; gjegjësjë sporadike geg. *o* tosk. *a* dhe ndonjë tjetër ndryshim cikërrimtar”⁴⁴. Sipas I. Ajetit, “anët pozitive të pangegërishtes... duken sheshazi te elementet që e bëjnë atë shumë të afërt me koinenë jugore, në plan të drejtshkrimit, në fushën e fonetikës, të gramatikës e të fjalëformimit”⁴⁵. Dhe vërtet, shkrimet e Rizës në këtë variant letrar nuk paraqesin asnjë vështirësi në të lexuar. Ideja se Riza është i vështirë buron jo nga ortografia e veçantë apo format gramatikore që përdor, por nga terminologjia e ndryshme dhe leksiku i tij i veçantë.

A do të kishte pasur sukses projekti i pangegërishtes në Shqipërinë politike sikur të ishte ruajtur statukuja e paraluftës? Analiza e të gjitha rrethanave të kohës të shpie në përfundimin se nuk kishte gjasa të pranohej. Nuk do të pranohej, sepse shteti shqiptar e kishte një gjuhë zyrtare, me të cilën ishte hartuar legjislacioni dhe tekstet shkollore, dhe nuk mund ta ndryshonte. Veç kësaj, edhe po ta pranonin toskët, ky variant letrar nuk do të tumirej nga vetë gegët: as nga përkrahësit e elbaskanishtes, as nga qarqet letrare shkodrane, të cilat ishin mjaft të dashuruara me variantin e vet letrar dhe mjaft refraktare ndaj përpjekjeve për afrim të dialekteve, gjë që e kishin dëshmuar me qëndrimin e mbajtur ndaj gegërishtes jugore, të cilën e kishin kundërshtuar e stigmatizuar ashpërsisht.

Në Shqipërinë e pasluftës, me pranimin e toskërishtes letrare si gjuhë zyrtare, përpjekja e Selman Rizës as u përmend më⁴⁶. Pranimi i toskërishtes si gjuhë zyrtare e zbehu rolin e gegërishtes dhe ia rrudhi kësaj funksionet, pasi kjo pushoi së përdoruri si gjuhë e administratës dhe e shkollës, pra humbi funksionin administrativ, që kishte qenë më vendimtar për përhapjen e saj. Standardizimi i gegërishtes në kohën kur elbaskanishtja shërbente si gjuhë zyrtare, do të kishte qenë diçka normale. Por, në rrethanat e reja, kur, krahas gjuhës zyrtare, përdorëshin edhe dy variantet letrare geqe, kjo përpjekje do të ishte një vepër jonormale dhe pa ndonjë dobi, për të mos thënë një shpenzim i panevojshëm energjish njerëzore dhe vlerash materiale.

Ndryshe nga Shqipëria politike, ku pas shpalljes së Pavarësisë shqipja u bë gjuha zyrtare e shtetit shqiptar, në trojet shqiptare në Jugosllavi gjuha shqipe u pranua si gjuhë zyrtare rajonale vetëm pas Luftës II Botërore, kur shteti jugosllav, duke hequr dorë nga

⁴³ *Po aty*, f. 91.

⁴⁴ S. Riza, *Tri monografina...*, f. 119.

⁴⁵ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20–25 nëntor 1972)”, vëll. I, Tiranë, 1973, f. 271.

⁴⁶ Lidhur me këtë, ne nuk pajtohemi me mendimin e R. Ismajlit për “injinorimin hileqar të projektit të Rizës nga planifikuesit e gjuhës në Tiranë në vitet ‘50” (shih: R. Ismajli, *Në gjuhë dhe “për gjuhë”*, DUKAGJINI, Pejë, 1999, f. 63). Jo vetëm në këtë rast, po në gjithë veprat e fundit të këtij gjuhëtari, të bie në sy një prirje e tij për të sulmuar vend e pa vend politikën gjuhësore të Tiranës zyrtare, duke ngatërruar pa të drejtë gjuhëtarët me politikanët e regjimit komunist. Një qëndrim i tillë mohues është një fyerje për gjithë brezin e gjuhëtarëve të gjysmës së dytë të shek. XX, të cilët krijuan shkencën shqiptare të gjuhësisë dhe e ruajtën atë me një sukses të pabesueshëm nga infektimi me ideologjinë komuniste.

politikat asimiluese dhe ndalimit për më se tridhjetë vjet të mësimi në gjuhën amtare, njohu barazinë e gjuhës shqipe në administratën shtetërore dhe lejoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe”⁴⁷.

Po në ç’variant u shkrua gjuha shqipe në këto troje? Duke analizuar copëza shkrimesh të vitit 1949 dhe të fillimit të viteve ‘50, R. Ismajli vëren se më 1949

“përdorej një gegnishte e quajtur e mesme, mund të thuhet pa elemente që do ta shënonin si ‘shkodranishte letrare’ apo si ‘elbasanishte, assesi jo si ‘kosovarishte, po më parë si një gegnishte e përgjithshme që në punë të drejtshkrimit afrohej shumë me toskërishten letrare: nuk ka theksa, po përdoret zanorja ë fundore, nuk shënohen zanoret hundore etj. Meqenëse kjo mënyrë shkrimi vërehej dhe në tekstet e Redaksisë (së revistës ‘Jeta e Re’–R.M.) të vitit 1949, mund të mendohet se i tillë ishte orientimi i përgjithshëm”⁴⁸.

Mirëpo rezoluta e mbledhjes së 14–15 nëntorit 1952 për caktimin e gjuhës së shkrimit të shqiptarëve në RFJP vendosi të ndiqej një rrugë tjetër që i thellonte disidallimet me variantin letrar toskë, gjë që duket edhe nga vetë teksti i rezolutës:

Me qenë se pakica kombtare shqiptare e RFPJ flet një dialekt të gegënishtes, gjuha e shkrimit për në nuk mund të jetë veçse gegënishtja. N’anë tjetër, mbassi as shkodranishtja as elbasanishtja nuk kanë qenë të zonjat me u përgjithësue si gjuhë shkrimi për gjithë Gegët, asnjana sosh nuk mund të mirret si gjuhë shkrimi për shqiptarët e Jugosllavis. Mâ në fund me qenë se aq mâ pak ka mundësi që gjuha e jonë letrare të zhvillohet vetëm prej dialektit t’anë, për këto arsye është nevoja që na për gjuhë shkrimi të Shqiptarvet në RFPJ të përcaktojmë një gegënishte në të cilën vijnë me bashkëpunue nëngegënishtet e ndryshëme simbas njëj kriteri të caktuem: simbas kriterit të mënjanimi t’evolutavet partikulariste (tejtrajtimeve të përbashkëta) të nëndialekteve të ndryshëme të gegërishtes. Në këtë mënyrë do t’i japim një shkas të fuqishëm zhvillimit të mëtejshëm të të gjitha mundësinave ende të pashfrytsueme të kosovarishtes dhe të dibranishtes, tue përvehtësue në të njëjtën kohë gjithçkah është të përshtatshëm në shkodranishte dhe n’elbasanishte.”⁴⁹

Pra, pas Luftës së Dytë, në Kosovë u paraqit mundësia për standardizimin e gegërishtes, si një pangegërishte e dalë nga shkrirja e nëngegërishteve në një *koine* dialektore. Nga përmbajtja e rezolutës, kuptohet se ajo përshkohet tej e ndanë nga ideja e S. Rizës për “pangegënishten”, ndonëse gjuha e saj dëshmon një largim nga gjuha e demonstruar në “Tri monografina...” dhe e përdorur prej Rizës deri më 1955, kur autoritetet jugosllave e dëbuan në Shqipëri.

Por si rrjedhim i trysnisë së pushtetit jugosllav që synonte krijimin e “drejtshkrimit të veçantë dhe të gjuhës letrare për shqiptarët e Jugosllavisë, në mënyrë që të dalloheshin nga ata të Shqipërisë”⁵⁰, në periudhën nga viti 1955 e deri te “Ortografija e gjuhës shqipe” e 1964-ës u vu re një devijim nga projekti i 1952-shit, që rezultoi në

⁴⁷ Shih R. Ismajli, *Në gjuhë dhe “për gjuhë”*, f. 64.

⁴⁸ R. Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë 2005, f. 53.

⁴⁹ R. Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f. 429.

⁵⁰ B. Horvat, *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb, 1989, f. 94 (cituar sipas R. Ismajlit, *Gjuhë standarde dhe ...*, f. 183)

largimin jo vetëm nga mënyra e të shkruarit më 1949 (rishfaqen theksat, nyja e pashquar shkruhet jo *një*, po *nji*), po edhe nga pangegënishtja e “Tri monografinave” (pranohet ambigjenia, të cilën Riza nuk e kishte pranuar, fjalët me *ë* pastheksore jofundore shkruhen pa të kur del në rrokje të hapur (*nxansi, fjalza, i dohti, e ndershmja, randsi* dhe jo *nxanësi, fjalëza, i dobëti, e ndershmja, randësi* si te Riza etj.).

Por nga fillimi i viteve ‘60 kjo prirje e nxitur nga Beogradi ia lë vendin lëvizjes për njësimin dhe thjeshtimin e ortografisë, që mbështetej në arsyetimin se “gjuha shqipe asht një, kudo që të flitet, pa marrë parasysh se ka dy kryedialekte e disa nëndialekte”⁵¹. Kjo politikë e afrimit gjuhësor u mishërua në Ortografinë e vitit 1964, si projekti i drejtshkrimit të gegërishtes që konkretizoi afrimin e dy kryedialekteve të shqipes. Në këtë projekt ndiqet orientimi “që të marrin zgjidhje çështjet drejtshkimore me synime konvertuese, që në instancë të fundit favorizojnë zgjidhjen pozitive të gjuhës letrare shqipe, duke përfunduar në të ardhmen në një fizionomi njëformëshe”⁵².

Ortografia e vitit 1964 është njëherazi edhe përpjekja e fundit për njësimin e gegërishtes. Më pas, në rrethet intelektuale të Kosovës e të Maqedonisë erdhi duke u forcuar bindja se për afrimin e varianteve të gjuhës së shkruar duhej njësuar drejtshkrimi, gjë që u konkretizua në vendimin e Konsultës së Prishtinës të prillit 1968 për të pranuar pothuajse plotësisht të “Projektin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (1967) të Tiranës.

Pra, edhe në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi projekti për krijimin e një varianti letrar pangegë dështoi. Sipas R. Ismajlit, që u ka kushtuar mjaft vend përpjekjeve për standardizimin e gegërishtes, “... një nga mungesat kryesore të projektit të Selman Rizës ishte ajo e forcës shoqërore që do të qëndronte prapa tij për ta shtyrë më tej në jetën shoqërore. Pa të është iluzore të bëhet çkadoqoftë në një fushë të tillë”⁵³. Ndryshe prej tij, ne jemi të mendimit se ky pohim vlen për Shqipërinë politike, ku ky projekt nuk do të kishte pasur mbështetje, por jo për Kosovën dhe trojet shqiptare në Jugosllavi, ku deri më 1964 u ndoq ideja e Rizës për një gegërishte letrare. Heqja dorë nga projekti për standardizimin e gegërishtes në këto troje erdhi jo si rrjedhim i trysnisë politike të Beogradit, që ishte i interesuar për thellimin e ndarjes gjuhësore të shqiptarëve, as i ndikimit të Tiranës zyrtare, e cila nuk kishte kurrfarë mundësie të ndikonte, por për shkaqe të tjera, të cilat ne i kemi shpjeguar gjetkë⁵⁴.

Megjithëse pangegërishtja e Selman Rizës dështoi, vepra e tij për çështjet e planifikimit mbart vlera ende të pazbuluara, njohja e të cilave është me rëndësi për këdo që vendos të shkruajë për problemet e planifikimit gjuhësor të shqipes. Studimi i asaj pjese të veprës që trajton problemet e mësipërme ndihmon për të krijuar një ide të qartë për evolucionin e mendimeve të tij sa u përket çështjeve të planifikimit gjuhësor. Nga ana tjetër, studimi i gjithë korpusit të veprës së Rizës do të ndihmojë të shihet se si e ka shkruar ai shqipen në periudha të ndryshme të veprimtarisë së vet krijuese, duke siguruar në këtë mënyrë një dëshmi të tërthortë për evoluimin e mendimeve të tij rreth problemit të gjuhës së shkrimit.

Përpjekjet e Selman Rizës për krijimin e një koineje letrare gjithëveriore përkojnë me periudhën kur shqipja lëvrohej në tri variante letrare. Deri më 1952, kur boton në Prishtinë veprën “Fillimet e gjuhësisë shqiptare”, ai vijon të mbrojë tezën e “dualizmit

⁵¹ R. Ismajli, *Në gjuhë dhe “për gjuhë”*, f. 166.

⁵² I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, art. i cit., f. 278.

⁵³ R. Ismajli, *Në gjuhë dhe “për gjuhë”*, f. 62.

⁵⁴ Shih: R. Memushaj, *Planifikimi gjuhësor si aspekt i sociolinguistikës*, Studime albanologjike, I, Tiranë, 1996, f. 66–68.

kryedialektuer, pa u heqë porse dorë prej qëllimit me reduktue këte dualizëm në minimum”⁵⁵. Për periudhën tjetër mungojnë të dhënat. Mënjanimi me dhunë nga jeta shkencore prej vitit 1967 e deri në fund të jetës nuk na jep mundësi të ndjekim evoluimin e ideve të këtij pionieri të sociolinguistikës shqiptare për problemin e planifikimit të shqipes. Për qëndrimin ndaj gjuhës standarde që u miratua në Kongresin e Drejtshkrimit mësojmë vetëm nga një e dhënë që sjell Ali Dhrimoja, një ndër njohësit më të mirë të jetës dhe të veprës së Selman Rizës. Kur një nga kolegët e tij e pyeti: “Pse nuk shkruan e flet gegënisht si na, po toskërisht?”, Riza iu përgjigj: “Unë nuk shkruaj dhe nuk flas as gegërisht, as toskërisht: unë shkruaj gjuhën që do të vijë.”⁵⁶

Gjithsesi, zbrazëtia që krijohet nga rrethana e përmendur më sipër, mbushet, siç u tha më sipër, nga leximi i veprës së Rizës. Ai vetë shkroi në disa variante letrare: deri më 1944 shkroi toskërisht; pastaj, nga viti 1944 e deri më 1953, përdor pangegërishten e sendërtuar prej tij e tij për t’u rikthyer nga viti 1958 te toskërishtja letrare. Sikurse pohon A. Dhrimoja, ai “shkroi në gjuhën letrare edhe përpara Kongresit të Drejtshkrimit, edhe si pensionist, pas Kongresit të Drejtshkrimit, megjithëse nuk u ftua në atë kongres”⁵⁷.

Shkaku pse S. Riza hoqi dorë nga projekti i vet, nuk qe frika e tij nga politika, pasi ky “heretik” i gjuhësisë shqiptare nuk e njohu kurrë frikën, por analiza dialektike që ai u bëri zhvillimeve kombëtare e gjuhësore të pasluftës në trojet shqiptare. Ai nuk ishte një gjuhëtar i mbyllur në kullën e fildishtë. Pra, mendimi i tij gjuhësor ka evoluuar përkritazi me evoluimin e rrethanave politiko-shoqërore në trevat shqiptare, gjë që e pohon edhe vetë në shtojcën e monografisë, duke thënë se “pikëpamjet e mija rreth problemit gjuhësor të vëndit t’ënë” nuk kanë “mbetur të pandryshuara gjatë gjithë ndërkohës 1936–1944”⁵⁸. Sa objektive qenë analizat e S. Rizës për problemin gjuhësor, për këtë vlen të vihet në dukje që, megjithëse pa kurrfarë komunikimi me Kosovën, qëndrimi i tij përputhet plotësisht me qëndrimin e studiuesve dhe të lëvruesve të shqipes në trojet shqiptare përtej kufirit shtetëror, të cilët, duke nuhatur synimet përçarëse të Beogradit, vendosën të hiqnin dorë nga projekti për kodifikimin e drejtshkrimit të gegërishtes dhe të njihnin “njëzëri si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vëndit ëmë”⁵⁹. Pra, kushdo që përpiket të shohë me sy kritik fazën e dytë të planifikimit gjuhësor të shqipes, atë të standardizimit, nuk mund të thotë diçka me vlerë, nëse nga ndjekja e mendimit teorik dhe e ligjërimit të shkruar të Selman Rizës nuk arrin të kuptojë pse ky gjuhëtar kaloi nga ideja e një shqipeje me dy variante letrare te pranimi i një gjuhe të vetme standarde shqipe.

Zhvillimet historike e kulturore në mbarë trojet shqiptare që nga shpallja e Pavarësisë e deri në fund të viteve ‘60 të shekullit të kaluar përbëjnë atë tok rrethanash të papërsëritshme që shpunë në standardizimin e shqipes. Po të mos kishin qenë këto rrethana fatlume, sot do të kishim dy gjuhë zyrtare dhe 3–4 variante letrare, situatë gjuhësore që do t’i kishte lënë pa punë “antistandardistët” tanë që po botojnë libra kundër gjuhës standarde të shkruara në gjuhën standarde (!). Rasti i shqipes provon se

⁵⁵ S. Riza, *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*, Vepra, vëll. 1, f. 315.

⁵⁶ A. Dhrimo, *Heretiku i gjuhësisë shqiptare*, Për shqipen dhe shqiptarët, vëll. II, INFOBOTUES, Tiranë, 2008, f. 459.

⁵⁷ A. Dhrimo, *Gjuha dhe publicistika*, Për shqipen dhe shqiptarët, vëll. II, INFOBOTUES, Tiranë, 2008, f. 105.

⁵⁸ S. Riza, *Tri monografina...*, f. 223.

⁵⁹ *Konkluzat e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës*, 1968 në R. Ismajli, “Drejtshkrimet e shqipes”, Prishtinë, 2005, f. 521.

standardizimi i gjuhës së kombeve me një traditë jo të vjetër shkrimi nuk mund të ndjekë rrugët në të cilat ka ecur standardizimi i gjuhëve me një traditë të lashtë, ku rolin themelor e kanë luajtur figura të shquara. Pra, standardizimi nuk mund të ishte projekt i një individi apo i një grupi individësh, po fryt i një marrëveshjeje me bazë shumë të gjerë, ku u përfaqësuan të gjitha trevat shqipfolëse, e cila u bë e domosdoshme kur e kërkuan faktorë të caktuar historikë e shoqërorë. Nga ana tjetër, shkenca sociolinguistike ka treguar se shtetet kombëtare kanë një nevojë të ngutshme për një gjuhë standarde, që të përmbushë të gjitha nevojat e komunikimit, si gjuhë e administratës, e shkollimit, e shkencës, por edhe e letërsisë dhe e fesë. Dhe standardizimi i shqipes ndodhi pikërisht në një çast kur e kërkonin nevojat kombëtare dhe jo kur e deshën gjuhëtarët apo politikanët, siç rrahin të na mbushin mendjen kritikët pleq a rioshë të standardit neve që i kemi përjetuar këto zhvillime si studentë, si mësues dhe si studiues të gjuhës.

Gjuhët letrare të përfutuara nga shkrimi vetvetiu e dialekteve janë konstrukte abstrakte vetëm në kokën e gjuhëtarëve, të cilave nuk u përgjigjet asnjë lloj realiteti gjuhësor. Konstrukte abstrakte do të mbeten edhe gjuhët dialektore që po përpiqen të sendërtojnë në ditët tona disa mendje provinciale. Prandaj nisma të tilla, si ato për standardizimin e gegërishtes a krijimin e kosovarishtes letrare, të përkrahura moralisht a financiarisht nga qarqe antikombëtare e antishqiptare apo ato për modifikimin e njëanshëm të gjuhës standarde, si teoria e “realizimit policentrik të standardit të shqipes”⁶⁰, sipas së cilës në të ardhmen do të kemi tri variante të standardit, përkatësisht në Tiranë, Prishtinë e Tetovë, për të përfunduar të marrëveshja më e fundit e dy Akademive, të Shqipërisë dhe të Kosovës për mosshkrimin e ë-së së patheksuar në shumë pozicione, për të reduktuar përdorimin e fonemës *nj* dhe për të futur infinitivin, nuk do të kenë sukses. Sot në trevat shqipfolëse veprojnë shumë qendra shkencore që merren me shqipen, siç janë institutet e gjuhësisë në të dy anët dhe universitetet në trojet etnike e në diasporën historike. Pa pjesëmarrjen e këtyre qendrave shkencore, me përfaqësim të secilës në çdo projekt që ka të bëjë me shqipen standarde, këto projekte janë të paracaktuara të dështojnë. Ashtu si dështuan për shkaqe madhore kombëtare pangegërishtja e Rizës dhe gegërishtja e përbashkët e Prishtinës, ashtu do të dështonte edhe çdo sipërmarrje tjetër e këtij lloji. Mjafton një vizitë në Panairin e Librave në Tiranë për të parë se në çfarë varianti shkruhen librat shqip dhe cili variant lexohet prej shqiptarëve.

Shqipëria dhe Kosova janë sot candidate për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe çdo shtet që pranohet në Bashkimin Europian duhet të përfaqësohet aty me një gjuhë standarde. Teorikisht, Kosova, si shtet i pavarur, mund ta kishte rastin të përfaqësohej me një gjuhë tjetër. Por, duke u larguar gjuhësisht nga Shqipëria, Kosova do të rrezikonte ekzistencën e vet, pasi “gjuha kosovare” do të ishte mishërim i planit të vjetër të Serbisë dhe një ringjallje e shpresave të saj për gllabërimin e kësaj krahine shqiptare. Kosova, ndonëse e pavarur, është vetëm një degë e trungut shqiptar dhe pikërisht kjo e bën të vështirë përpjekjen për ta prerë këtë degë nga trungu i vet etnik. Duke u paraqitur të dy shtetet shqiptare dhe trevat shqipfolëse jashtë këtyre shteteve me një gjuhë të vetme, shtohen gjasat që brezat e rinj të politikanëve europianë të na shohin si një komb i vetëm, gjë që mund të rezultojë në të ardhmen në rikonfigurime të reja politike, që do t'i përfshinin gjithë shqiptarët në një njësi të vetme administrative.

⁶⁰ R. Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005, f. 143.

Pra, vështruar nga perspektiva e së ardhmes, zërat për referendum, rishikim a përmbyse të standardit janë jo vetëm në dëm të çështjes kombëtare, po edhe një shpenzim i kotë energjish, që buron ose nga mosnjohja e teorisë së planifikimit gjuhësor dhe e planifikimit gjuhësor të shqipes ose nga analizat e politizuara të këtyre proceseve. Kushdo qofshin këta, gjuhëtarë, turistë gjuhësie a publicistë, dhe cilatdo qofshin qëllimet e tyre, nuk do të mund t’ia ndryshojnë rrjedhën shqipes standarde. Dëmi i vetëm që mund të bëjnë është se, aty ku kanë ndikim, vonojnë fazën e tretë të planifikimit, *implementimin* e standardit, duke i marginalizuar dhe penguar shqipfolësit e ndikuar prej tyre nga pjesëmarrja aktive në jetën kombëtare.

Për ta konkretizuar dobinë e leximit të veprës së Rizës për gjuhëtarët, po ndalemi vetëm në idenë e tij për mënyrën se si duhet zgjidhur “problemi gjuhësuer” në fushën e leksikut:

“Leksikologjikisht, më një anë ndryshimet kryedjalektale do të pakohen tue zhdukë barbarizmat e njanit kryedialekt në të mirë të shqiptarismave gjegjëse të tjetrit edhe, sa për barbarizmat dublikate, simbas mundësive, diku tue mbajtë vetëm njanën prej çdo pale e diku tue zhdukë të tanë barbarismën dublikate në të mirë të një arkaisme o neologjisme. N’anë tjetër njajtësinat krydjalektale do të shumohen jo tue ba pa nevojë e pa punë lara lyra gegënishten me toskizma e me gegizma toskërishten por tue dhanë shkas një rryme shkëmbimi toskizmash që i mungojnë gegërishtes e anasjelltas.”⁶¹

Po të shfletosh fjalorët që botohen sot, të bien në sy mjaft probleme të natyrës parimore. Sot po botohen fjalorë “diglosikë” gjuhë standarde–dialekt, të cilët i shpjegojnë përdoruesit se në gegërishte *nënë* thuhet *nanë*, *rërë* thuhet *ranë* etj., sikur gjuha standarde dhe gegërishtja të ishin dy gjuhë të ndryshme. Në ndonjë fjalor tjetër nuk lihet barbarizëm pa u futur, edhe pse shumë prej tyre janë zëvendësuar prej kohësh me fjalë shqipe. Madje, edhe në fjalorët normativë të shqipes, të hartuar nga grupe leksikografësh me përvojë, gjejmë trajta të ngushta nëndialektore ose krahinore, si: *njashtu* për *ashtu*, *njaty* për *aty*, *qashtu* për *ashtu*, *qajo* për *ajo* (FGJSSH, 1980), *njëtash* për *tashti* (FGJS, 2006) etj., për të cilat Riza do të thoshte se e bëjnë “lara lyra gegënishten me toskizma e me gegizma toskënishten”.

Vetëm këta pak shembuj mjaftojnë për të treguar se sa me vlerë është për praktikën leksikografike ndjekja e parimeve të parashtruara nga S. Riza. Këto janë arsyt pse leximi i veprës së tij dhe në veçanti i librit “Tri monografina albanologjike” është me dobi të madhe për atë që merret me gjuhësi. Nga studimi i saj do të kuptohen si duhet rrjedhat e planifikimit gjuhësor të shqipes dhe do të orientohet drejt edhe puna për stabilizimin e kodeve të ndryshme të gjuhës standarde.

⁶¹ S. Riza, Tri monografina..., f. 113.

Prof. **ZEQIJA NEZIRI** (Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi”, Shkup)

SHKRIMTARËT E VJETËR TË SHQIPES NË VEPRËN E SELMAN RIZËS

Motra dhe vëllezër,

Të dashur miq,

Jemi mbledhur sot në Korçën e lavdishme ta nderojmë njëren prej figurave më të rëndësishme dhe njërin prej studiuesve më të mëdhenj shqiptar të bërjes së shkencave albanologjike, sidomos të gjuhësisë shqiptare. Jam i gëzuar dhe ndiej një kënaqësi të veçantë që jam pjesëmarrës i këtij manifestimi dhe njëri prej pasuesve të studimeve albanologjike, në fushën e letërsisë shqiptare, për çka qenësisht ishte i angazhuar edhe i nderuari ynë profesor Selman Riza.

Selman Riza, siç e dimë të gjithë jetoj dhe veproj në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, në kohën e bërjes dhe të konsolidimit të shkencës albanologjike, të cilës ia kushtoi gjithë potencialin e vet racional studiues dhe me të cilën ndau edhe fatin e vet jetësor. Profesor Selman Riza, kryesisht ka studiuar procese të jetesës së gjuhës shqipe ndër shekuj, duke nisur me paraqitjen e shkrimeve të para në këtë gjuhë dhe trajtuar tema që kanë pasur të bëjnë me mëvetësinë dhe veçantinë e saj në gjirin e gjuhëve të tjera europiane. Për ndihmesën e tij në fushat e gjuhësisë shqiptare u fol edhe në këtë tubim, ashtu si është folur në studime të tjera të shumta të organizuara gjithandej ndër mjedise shqiptare si në këtë vit jubilar të 100-vjetorit të lindjes së tij ashtu edhe në raste të tjera.

Selman Riza duke trajtuar tema të gjuhësisë shqiptare, është e natyrshme të ketë dhënë edhe një ndihmesë në studimet letrare, edhe pse me to nuk është marrë në kuptimin e studiuesit të letërsisë, por të atij të gjuhësisë, sepse shkrimet e autorëve të ndryshëm i ka parë kryesisht nga aspekti linguistik. Në këtë kontekst edhe ndihmesa e tij në fushën e letërsisë është e konsideruar, bile mund të thuhet se është e kufizuar vetëm në dy periudha të saj. Sikurse edhe ndihmesa e profesor Çabejit, me të cilin bashkudhëtuan dhe bashkarisht ndihmuan në formimin, bërjen dhe konsolidimin e shkencës albanologjike.

Interesimi kritik shkencor i profesor Selman Rizës në fushën e letërsisë shqipe prek disa çështje që kanë të bëjnë me fazën nismëtare të saj. Ai ka prekur dy periudha të historisë së letërsisë shqipe të periudhës së Pararilindjes Kombëtare: periudhën e Mesjetës dhe periudhën e Barokut, të cilat në kohë kapin shekuj të ndryshëm: parahumaniste dhe pashumaniste.

Periudhës së parë i përket studimi hyrës në *Krestomacinë* e tij të njohur të shkrimeve të vjetra shqipe, kurse të dytës i përket autorët e parë të teksteve të shkruara në gjuhën shqipe, për të cilët, sipas modelit të atëhershëm pozitivist, për secilin prej tyre bëri studime të veçanta monografike. Këta janë: Gjon Buzuku, Lekë Matranga, Pjetër Budi, Frang Bardhi e Pjetër Bogdani. Kështu ai, duke studiuar udhën e zhvillimit evolutiv të gjuhës shqipe dha një ndihmesë të konsiderueshme edhe për letërsinë shqipe të kësaj periudhe, pra të fazës së saj nismëtare.

(1) Vlen të theksohet se për periudhën parabuzukjane, profesor Selmani është i prerë: nuk ekzistojnë shkrime të këtilla. Kjo bindje e tij tregon rreptësinë shkencore që ai kërkonte të mbillte në studimet shqiptare, domethënë studiuesi duhet të flasë me gjuhën e argumenteve të verifikuara e të dëshmuara. Meqë periudha parabuzukjane mendonte ai, nuk ka arritur të sjellë ndonjë dëshmi më të fortë se ato copëza, grimca gjuhësore, atëherë mbështetur në rrethanat e kohës është e kotë të harxhohet energji të merremi me të përderisa mungon diçka më tepër se ato fragmentëtha. Këtë e bënte edhe për një qëllim tjetër, që studimet të thellohen në studimin fundamental, nga të gjitha aspektet e veprave të autorëve të Barokut, të cilëve si e thamë i kushtoi nga një studim më vete.

(1.1.) Te Buzuku, meqë është autori i parë, është e natyrshme të shtrohen edhe çështje të historikut të shqipes dhe të analizës së tërësisë përmbajtjesore të veprës. Në këtë drejtim edhe do të ketë mospërputhje mendimesh me studiuesit bashkëkohës, në radhë të parë me profesor Çabejin dhe pasues të tij në drejtim të çështjes: a është Buzuku autori i parë që shkruan shqip, apo ai ka ndjekur një rrugë tanimë të nisur dhe ai është dashur ta shtrojë e trasojë. Natyrisht se në mungesë të artefaktit, si historik – arkeologjik, ashtu edhe të kulturës gjuhësore ai mbronte pikëpamjen se para Gjon Buzukut dhe *Mesharit* të tij, deri në kohën e tij dhe edhe sot, nuk kemi ndonjë vepër në gjuhën shqipe, ndaj edhe duhet të pajtohemi me fatin se para kësaj periudhe, në mënyrë të argumentuar shkencore nuk mund të flitet për shqipen si gjuhë të shkruar. Meqë, është kështu atëherë shkenca shqiptare duhet të merret me studimin e fazave pasbuzukjane të gjuhës shqipe dhe në bazë të saj, sipas metodës së analogjisë hipotetike ta ndërtojë pamjen e saj edhe në periudhën paraprake.

Selman Riza, në kundërshtim me profesor Çabejin, për ekzistimin e traditës mesjetare të shqiptarëve, është i mendimit se është i papërligjshëm dhe kombëtarisht i papranueshëm ngulmimi i studiuesve për ta çuar traditën letrare të shqipes dy-tre shekuj para Buzukut. Ai është i mendimit se para Buzukut nuk ka ekzistuar ndonjë shkrim madhor në gjuhën shqipe, duke e arsytuar edhe me përpjekjen e pandërprerë të popujve fqinjë ballkanikë (grekë e serbë) të përkrahur edhe nga qendra të huaja të asgjësojnë dhe të zhdukin gjithçka që ka të bëjë me të kaluarën kulturore të shqiptarëve dhe këta t'i nxjerrin të zhveshur nga çfarëdo lloj tradite të kultivuar të vetëdijes kombëtare (Riza, 2002: 25). Në këtë drejtim konstaton se periudha shkrimore parabuzukjane duhet të pëmbyllet në traditën gojore, sepse te Buzuku “teknika gojore ka prirje të mbizotërojë shkrimoren” (Riza, 2002: 37; Neziri, 2006: 85).

(2) Të gjitha studimet e tij kanë strukturë të njëjtë dhe interes të njëjtë të studiuesit: jeta, vepra, ndihmesa për kultivimin e gjuhës dhe sistemi i grafisë së secilit veç e veç, duke vlerësuar shkallën nismëtare të të parit (Gjon Buzukut) dhe ndjekjen e kësaj udhe nga pasuesit: Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani. Për interes kohe do të ndalemi vetëm në pikëvështrimet e tij për Gjon Buzukun dhe Pjetër Budin.

(2.1.1.) Sa i përket Buzukut ka prekur çështje të atmosferës kohore, të vendlindjes e të vendshkollimit të Buzukut, si dhe çështjen e vendbotimit e të llojit të librit, çështje këto të cilat ishin më të avansuara e më të aktualizuara në studimet buzukjane dhe secili studiues, sipas bindjeve të tij përpiquej të jepte ndihmesë të qëndrueshme në definimin e tyre. Në këtë kontekst edhe profesor Selmani përkrahte pikëpamjen se Buzuku nuk ka jetuar dhe nuk është shkolluar në mjedis shqiptar. Pra mbante anën e Mario Rokut, pjesërisht të Martin Camajt sipas të cilëve këto dhe vendshërbimin i vendoste diku në Dalmaci “në një

mjedis sllav – shqiptar” (Riza, 2002: 29; Neziri, 2006: 51) dhe ishte i prirur të anojë për në anë të Zarës ose të Splitit (Riza, 2002: 30, 31).

Veprimtarinë e Buzukut e ndërlidhte me urdhërin françeskan (Riza, 2002: 31; Neziri, 2006: 53). Duke harruar se arbëreshët e Zarës, në Arbënesh, janë vendosur rreth 180 vjet pas botimit të *Mesharit*. Për vendbotimin e *Mesharit*, mban pikëpamje të afërt me Domin e Shuteriqin, por nuk i shmanget mjedisit dalmat, hipotetifikisht duke anuar kah Dubrovniku (Riza, 2002: 30; Neziri, 2006: 70). Është interesante teza e Selman Rizës se Buzuku ka gjasa të jetë vetëfinancues i librit të tij. Këtë pikëpamje ai e mbështet në ngjeshjen “tipografike të pazakonshme si të fjalëve brenda rreshtave, ashtu të rreshtave njëri me tjetrin, gjithashtu edhe të titujve të fragmenteve me tekstin e këtyre” (Riza, 2002: 30; Neziri, 2006: 74). Nga ky këndvështrim ai e shpjegonte edhe përdorimin e grafemave cirilike në *Mesharin* e Buzukut.

(2.1.2.) Në aspektin tipologjik Selman Riza, duke ecur gjurmëve të Rokut dhe duke iu referuar përmbajtjes brenda së cilës “janë përfshirë dy tekstet bazë të kultit romak”, mban qëndrim se titulli i *Mesharit* duhet të jetë sintagmatik: *breviar – (katekizëm – ritual) – meshar*” (Riza, 2002: 28; Neziri, 2006: 77). Pra, e konsideronte një lloj libri kompromis liturgjik. Në këtë drejtim do të nënvizojmë, mbështetur edhe në studimet tona personale të krahasimit të *Mesharit* tonë me mesharë kroatë: titulli meshar është në harmoni të plotë me kërkesat teorike letrare të hartimit të librave liturgjike të kohës.

(2.1.3.) Do vërejtur në këtë pikë se përgjithësisht studimeve buzukjane, përfshirë këtu edhe studimin e Buzukut kanë një dobësi të madhe metodologjike: krahasimet mesharë ndër popuj të tjerë gjithmonë janë bërë me vepra (mesharë) të periudhës pasbuzukjane dhe jo të asaj parabuzukjane. Ndaj edhe rezultatet janë ato që janë: është krijuar një lloj konfuzioni.

Selman Riza, si edhe pjesa më e madhe e studiuesve të kohës së tij, edhe pse angazhoheshin për vërtetim kritik shkencor të lëndës dhe literaturës shkencore, në rastin e *Mesharit* të Buzukut, duke i besuar fjalës autoritare të studiuesit harronin se nganjëherë ajo mund të keqinformojë e të çorientojë, si ngjet rasti me Mario Rokun. Ky përkundër ndihmesës së madhe që e dha në disa fusha të shkencës albanologjike të paraluftës së Dytë Botërore, nuk është parë nga këndvërtimi kritik se ai na del përkrahës i teorisë klerikale të Zhorzh Bedijesë e të Teodor Benfeit të shekullit 19 e të fundit të këtij shekulli, viktimë e të cilës ishte edhe Alojz Shmausi (Neziri, 2006: 53, 149). Sipas kësaj teorie zhvillimi kulturor i shqiptarëve i detyrohet shkencës sllave, sidomos të asaj serbe. Si rrjedhojë Mario Roku këmbëngulte vendlindjen, vendshkollimin, vendshërbimin, si dhe modelin e mesharit të Buzukut i vendoste në Bosne dhe titullin e tij e lidhte me një “serb – boshnjak” (Neziri, 2006: 136). Harronte me këtë rast se në literaturën kishtarë ortodokse nuk ekzistojnë libra me përmbajtje dhe emërtim të këtillë. Në këtë grackë kishte rënë edhe Selman Riza, si edhe shumica e studiuesve të tjerë shqiptarë. Edhe pse ky është i pari që kishte vërejtur se *Meshari* i Buzukut në aspektin përmbajtësor dallonte shumë nga mesharët e rëndomtë. Në literaturën kishtarë katolike njihen dy lloje mesharësh: të pastër dhe të përzierë (Badurina, 433; Neziri, 2006: 116 - 117). *Meshari* ynë i përkiste tipit të dytë, ndaj edhe Selman Riza e kishte emërtuar *breviar – (katekizëm – ritual) – meshar*.

(2.2.) Lekë Matranga

(2.3.) Frang Bardhi

(2.4.) Është e rëndësishme të theksohet se një veçori atipike për studimet shqiptare të viteve të gjashtëdhjeta që vjen nga studimet e Selman Rizës. Me interes për konferencën tonë është të përmendet edhe vlerësimi i vetëm i vjershërimit të Pjetër Budit në kontekst të gjinisë letrare. Këtë vjershërim ai e konsideron *poemë*, edhe pse nuk ndalet më thellësisht të argumentojë se cilët janë faktorët shkencorë bindës, në të cilët e mbështet arsyetimin e vet. Përkundër faktit se përkufizimin e mbështet duke analizuar përmbajtjen e vetëm *këngës së nëntë* (Budi, 1986: 147 – 177) të vjershërimit të Budit, njëren prej tri këngëve më të gjata, duke theksuar se vjersha ka hyrjen dhe degëzimin: pjesën e parë e të dytë. Në vazhdim tërë vëmendjen e përqendron në analizën e versifikacionit të vjershërimit të Budit, që dëshmon edhe për orientimin metodologjik pozitivist: të studimit të faktorëve përbërës tekstorë të vjershërimit.

(2.4.2.) Në pjesën e studimit për Budin më tepër merret me vendin e pamjaftueshëm që i është dhënë në historinë e letërsisë shqipe (Domi, 1959: 202 - 218) duke nënvizuar se ai zë njërin ndër vendet më të rëndësishme të historisë së letërsisë dhe të të kulturës së shkrimit shqip në fillim të shekullit të 17-të (Riza, 2002: 106).

(2.5.) Pjetër Bogdani

(2.6.) Është për t'u nënvizuar se Selman Riza krijuesit e përmendur (Buzukun, Matrangën, Budin, Bardhin e Bogdanin) i sheh në plan krahasimtar duke i vënë njërin përballë tjetrit dhe duke e vlerësuar rolin dhe vendin e secilit në krijimet letrare shqiptare. Për shembull, në fushën e prozës thotë se “Budi mbetet përfaqësuesi më tipik i prozës periodike”, kurse Bogdani përfaqësuesi “më bindës i prozës shkencore të nivelit europian” dhe në këtë kontekst në letërsinë shqipe “Bogdani u bë konsolidues i autoritetshëm e lavrues i mëtejshëm i traditës letrare të Buzukut, Budit e Bardhit” (Riza, 2002: 141).

Do vërejtur gjithashtu se, përgjithësisht studimet shqiptare të kësaj kohe, përfshirë këtu edhe këto të profesor Selman Rizës, mbi shkrimtarët e vjetër shqiptarë vuajnë shumë në aspektin metodologjik, që është pasojë e orientimit të përgjithshëm pozitivist të tyre. Te Buzuku p.sh. me këmbëngulje kërkohet autori prej të cilit ka gjasa ai ta ketë përkthyer *Mesharin*, te Budi po ashtu, meqë ai vetë ka përmendur Pal Hasin, rrjedhimisht kërkohet të veçohen pjesët poetike të Budit nga ato të Pal Hasit. Kësaj sfide e këtij provokimi metodologjik shkencor nuk ka mundut t'i shpëtojë as profesor Selman Riza, i cili si te Buzuku edhe te Budi, një numër goxha të madh faqesh ia kushton kësaj çështjeje tekstologjike, e cila për tërësinë e personalitetit të autorëve nuk është parësorja.

Gjithnjë, në kontekst të studimeve të atëhershme albanologjike, gjuhësore e letrare, profesor Selman Riza kërkonte që studimet shqiptare të mbështeten në dëshmi dhe argumente të forta shkencore, nqs duan të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata. Si pasojë, bashkë me profesor Çabejn, secili në drejtime të ndryshme, ndihmuan të ndërtohet e të formohet, të konsolidohet e të krijohet shkolla shqiptare e studimeve albanologjike.

Prof. **ADEM HAJDARAJ** (Universiteti i Prishtinës)

ANALIZA DIAKRONIKE E PROF. SELMAN RIZËS PËR PASKAJOREN

Prof. Selman Riza (1909) nga Gjakova është, pa dyshim, njëri ndër intelektualët e dalluar të shekullit që lamë pas.

Në fushë të gjuhësisë njihet me këto vepra: “Emrat në shqipen (1964), Tri monografia albanologjike (1952), Gramatikë e serbokroatishtes, Fillimet e gjuhësisë shqiptare (1958), Pronorët e shqipes (1960), Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, Kristomaci e thjeshtë gjuhësore (1961), Emrat në shqipe -Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit (1965), Studime albanologjike, I (1979), Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare (1994)⁶². Ky autor mjaft drejt e ka shtjelluar sistemin foljor, si në aspektin sinkronik, ashtu edhe në aspektin diakronik, duke i shtjelluar një nga një kategoritë gramatikore të foljes; numrin, vetën, kohën, mënyrën dhe diatezën. Shikuar nga kjo anë, ne e kemi vërejtur një analizë të thukët të mënyrave të pashtjelluara, gjegjësisht mënyrave pavetore, si i quan ai (paskajores, përcjellores dhe pjesores) në rrafshin diakronik.

Ali Dhrimo, këto ditë, në shkrimin “Zbërthyes elektoral i shqipes”, kështu e ka dhënë portretin e prof. Selman Rizës: “Selman Riza është pa mëdyshje një ndër mendjet më të mprehta të shek. XX në mbarë botën shqiptare. Ai bashkoi me veprën e vet forcën e argumentit me logjikën e hekurt dhe kritikën e rreptë shkencore, guximin shkencor dhe vetëmohimin për kombinime me objektivitetin e së vërtetës. Dhe të gjitha këto ai i arriti përmes një rruge të vetme: punës së përkushtuar”⁶³.

Në këtë punim jemi ndalur në shqyrtimin e paskajores në rrafshin diakronik. Prof. Selman Riza paskajoren, në shqipen e sotme, e sheh historikisht si një emër foljor, që më vonë i mori të gjitha tiparet gramatikore të një mënyre foljore. Si shembuj autori i jep: do dalë, do falë, “kështuqë –vazhdon ai- punën e emrit foljor ardhhtë e kryen formimet e pastajme: të dalë, dalje⁶⁴. Sipas autorit, paskajorja shërbente edhe si pjesore, “duke u bërë, si vëren ai, gjithnjë e më e kufizuar, derisa nga këjo mënyrë mbeti gjallë vetëm në disa ndërtime reliktores, siç është pikërisht shembuj i jep: do dalë” dhe pa dalë etj., duke u mënjanuar kështu nga përdorja e përgjithësuar në mbarë gjuhën shqipe, e për pasojë edhe në gegërishte, ku ajo u zëvendësua nga mënyra lidhore⁶⁵. Këtu autori ka të drejtë, veçanërisht kur këtë zëvendësim nuk e sheh si ekskluziv, po si alternativ dhe si inovacion: s`mundem me shkue me s`mund të shkoj.

Duke bërë analizë të hollësishme për paskajoren e shqipes në të dy dialektet, konstaton, me të drejtë, sa i përket paskajores, toskërishtja të jetë më analitike se gegërishtja dhe se “krejt si gegërishtja, ashtu edhe toskërishtja ka infinitivin e saj”. Për të vërtetuar këtë prof. Riza merr shembullin e toskërishtes: Duhet punur pa reshtur, me ç`rast foljet punuar dhe reshtur, janë përdorur në këtë kontekst” në mënyrë” të

⁶² Rexhep Ismaili, po aty, f.VI

⁶³ Koha ditore, 28 Nëntor, 2009, f.47

⁶⁴ Sh. S. Riza, Sistemi foljor, Tiranë, 1994, f.146

⁶⁵ Po aty, f.146

pakufishme”. Nga ana tjetër konstatimi se “në shqipe infinitivi ekziston “edhe atëherë kur nuk është i shoqëruem prej prepozicionit me “është i drejtë dhe qëndron edhe sot e gjithë ditën, sepse në të dy dialektet thuhet: Duhet punuar pa pra (T) dhe Duhet punue pa pra (G). Për këtë konstatim autori mbështetet te mendimi i Anton Xanonit: “Grimca do n`formë pa kufi len jashtë fjalëzën “me”: Do bâa kshtu; Do shkrue kio ktu”⁶⁶.

Sa i përket funksionit sintaksor, gjegjësisht karakterit mënyror të paskajores së ripërtërirë vetëm në dialektin gegë, autori me të drejtë konstatonte se ajo është veshur “me një shkallë të gjerë funksionuese sintaktike, ky dialekt i shqipes ka krijuar edhe një paskajore të dytë funksionale nga më të ngushtat, paskajoren: emër foljor asnjansë i veprimi, prirë prej parafjalës, pikërisht qëllimore, p.sh. për të la(n). Ndërtimin e kësaj paskajoreje autori e sheh në këto relacione: togfjalëshi nominal të la(m)e, si një togfjalësh i substantivuar, që më në fund “sjellja e saj sintaktike ka qenë ajo e një emri çfarëdo, p.sh. për (një) të të lam petkave”⁶⁷. Me kundrinën këtu (petkat), autori e shpjegon këtë paskajore si tregues, që në mënyrë të tërthortë e tregon karakterin foljor të saj. Prof. Selman Riza e jep qartë edhe rrjedhojën përfundimtare nga: për (një) të lam petkat (togfjalësh emëror) në për të lam petkat. Nga ana tjetër, autori, me të drejtë, konstaton zhvillimin paralel në të dy dialektet për mundësinë, siç thotë ai, “për të bashkëmbartur trajtat e shkurtra të vetorëve të patheksuar”: T. Për t`i la(m) petkat; G. Për me i la(m) petkat, ose edhe me pjesëzën u: T. Për t`u la(m) këmbësh e duarsh G. Për me u la(m) kamsh e duersh.

Me të drejtë edhe sot mund të tumiret konstatimi i drejtë i profesorit tonë se në gegërishten letrare përdorej një paskajore e rinovuar në gjymtyrë të varur kushtore. Këtë e konkretizon me shembujt e marrë nga sintaksa e Justin Rrotës: “Në vend që me punuem, kërkon pijetoret;”Me dijtë njeriu kur vdes, ia ban vorrin vetes.

T`i kthehemi edhe një herë bindjes së autorit për përdorimin e paskajores së gegërishtes pa prepozicionin, gjegjësisht pjesëzën me, për të cilën autori mendon se kjo rrjedh nga përdorimi i infinitivit me –pa, si formë antonimike. Këtë mjaft bindshëm e konkretizon me shembujt: “Nuk rri pa folë; “Punon për botën pa ia dijtë kush për nder”; ”Mos u nis pa u pa me mue”. “Në vijim të rrethanës se e përkundërta e fjalëzës mohues –pa, konstaton autori, është fjalëza pohuese, apo së pakti shoqëruese: -me, u bâ dalkadalë zakon me vu fjalëzën –me para infinitivit aq sa këjo fjalëz pak kah pak u bâ pjesë lansuese e infinitivit, pos në rasën e foljes due”. Prof.Selman Rizës nuk i shpeton pa e vënë në dukje edhe se në disa të folme popullore gege përoret edhe një infinitiv me të dy prepozicionet (-pa dhe –me), si në fjalitë: “Nuk e lâ pa me shkue”; ”nuk e lâ pa me thânë”⁶⁸.

Prof. Selman Riza trajtimin në sinkroni të formimit të infinitivit në latinishte, si edhe në gjuhët neolatine në tërësi vjen te konstatimi shkencërisht i qëndrueshëm edhe sot e gjithë ditën: Që trajta punue ka zënë origjinalisht infinitivi i shqipes”. Rrjedhimisht del

⁶⁶ Po aty

⁶⁷ Po aty, f.146

⁶⁸ Selman Riza, Vepra, I, po aty

pra se kjo u bë në bazë të participit (pjesores), duke ua paravënë fjalëzat; -me ose -pa (me punue, gjegjësisht pa punue)⁶⁹.

Më në fund edhe konstatimi i prof.Rizës se trajtat me foljen due+ pjesoren (due me punue), të gegërishtes, gjegjësisht dua të toskërishtes +lidhoren (dua të punoj) “nuk përmbajnë në vetvete një ndryshim kryedialektal”, është në përputhje me studimet historike të gjuhësisë shqiptare të mjaft autorëve të kësaj fushe, si të prof. Çabejt, Shaban Demirajt Idriz Ajetit, Mahir Domit etj. Prandaj kemi arsye që prof Selman Rizën ta radhisim ndër lëvruesit më të dalluar në fushë të historisë së gjuhës shqipe. Kjo vërehet në studimet e thelluara përkitazi me sistemin foljor dhe atë emëror, jo vetëm në rrafshin diakronik, por edhe në sinkroni dhe në rrafsh të tjera.

⁶⁹ Po aty

Prof. **REMZI PERNASKA** (Paris)

SELMAN RIZA – GRAMATIKAN I SHQUAR DHE FILOZOF I GJUHËS

Nga njëra anë, Shqipëria, - Gjakova, vendi i lindjes dhe Korça, vend i formimit - dhe, nga ana tjetër, Franca dhe Austria i dhanë botës shqiptare dhe asaj jashtëshqiptare një kolos si Selman Riza.

Selman Riza – Gramatikan i shquar shqiptar

Vepra shkencore e Selman Rizës është e madhe si jeta e tij. Ai la një numër të adhureshëm punimesh, ku shtroi probleme nga më të thelbësoret si për gjuhësinë shqiptare, albanologjinë, sidomos për vetë albanistikën, ashtu edhe për gjuhësinë e përgjithshme, për filozofinë e gjuhës, për filozofinë vetë, la një kontribut vërtet të pashlyeshëm me thellim, e intensitet të menduari, ku shquhet si studjues dhe kërkues jo vetëm këmbëngulës dhe vijues, por edhe i hollë, i mprehtë, veçanërisht jokonformist i skajshëm.

Ndër punimet e botuara, kryet e vendit e zënë shtatë monografite e ciklit kushtuar pjesëve të ligjëratës në gjuhën shqipe: *Diftorët e shqipes dhe historiat e tyre*, Prishtinë, 1953, *Nyjat e shqipes*, punim historiko-kritik; *Nyjat e shqipes*, punim përshkrues normativ, BUSHSh, seria e ShSh, Tiranë, 1958, n° 2. *Pronorët e shqipes*, punim historiko-kritik BUSHSh, seria e ShSh, Tiranë, 1959, n° 2-3; *Pronorët e shqipes*, punim përshkrues normativ BUSHSh, seria e ShSh, Tiranë, 1960, n° 3; *Emrat në shqipe: sistemi i rasave dhe tipat e lakimit*, punim historik me dy shtojca kritike, Tiranë, 1965; *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, punim përshkrues normativ, Tiranë, 1994, 316 f., njëra nga kryeveprat e Selman Rizës, njëri nga punimet më të mira të gjuhësisë shqiptare.

Nuk do të merremi me parashtrimin e arritjeve të mëdha shkencore në këto monografi, por do të vërejmë që radha e hartimit të tyre flet për një plan të menduar qysh herët, shumë kohë para hartimit të tyre.

Vetëm kaq dhe lejon me të madhe të pohohet se ai la gjurmë të pashlyeshme në albanistikë, sepse gjerësia e veprës së tij rrok shqipen e shkrimeve të hershme, morfologjinë historike dhe bashkëkohore të saj, kritikën gjuhësore, sepse thellësia dhe denduria e mendimit të tij shkencor, arritjet konkrete në fushat e sipërshënuara, e renditin atë në ballë, në krye të autorëve, në "çetën e profetëve", prej të cilëve dallon sepse është gjithandej gjuhëtar, madje edhe kur punon në fushë të filologjisë.

Figura shkencore e Selman Rizës del e cinguar po të mos theksohet edhe fakti se krahas albanistikës, së cilës i kushtoi shumë energji, ai interesohej dhe merrej edhe me gjuhësi të përgjithshme, me gjuhësi përfaqëse, dhe, me sa dimë, është i vetmi shqiptar që, në planin gjuhësor, përqasi dy gjuhë, shqipen me sërbo-kroatishten, në veprën *Gramatikë e sërbo-kroatishtes*, Prishtinë, 1951.

Nga ana tjetër, figura shkencore e Selman Rizës del e cinguar po të mos theksohet edhe fakti se krahas albanistikës, i kushtoi shumë mund e punë edhe gjuhësisë së përgjithshme, filozofisë së gjuhës dhe filozofisë së mirëfilltë.

Selman Riza – filozof i Gjuhës

Botimi i *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*⁷⁰ dhe i vëllimit të pestë të veprave të tij⁷¹ na hap horizonte të reja, na bën të kuptojmë atë që nuk kishim mundur të kuptojmë, atë që është implicite në veprat albanistike të "Auroritetit të parë të morfologjisë shqipe", të "Mjeshtrit të madh të gjuhësisë shqiptare"⁷².

Ndër këto punime kryet e nderit e zënë shkrimet për një shkencë të re të konceptuar prej atij vetë: *Nga logjika dhe linguistika në "intelektologjinë" dhe "komunikativistikën"*⁷³, kjo e fundit e konceptuar si interkomunikativistikë. Vepra *Mendime...* vende-vende flet për autorin e saj si filozof të gjuhës, për më tepër si filozof të mirëfilltë. Ky thesar i vlefshëm teorik duhet t'i përçohet sa më parë botës kulturore shqiptare, dhe jo vetëm asaj.

Është vendi këtu të vihet në dukje puna tejet e lavdërueshme e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, veçanërisht e akademik Rexhep Ismajlit, për botimin e *Veprave* të një vargu albanologësh, ndër të cilët edhe të pazëvendësuarit Selman Riza. Shkrimet e mia për Selman Rizën u detyrohen shumë analizave të Rexhep Ismajlit dhe Ali Dhrimos.

Dhe ja tani me botimin e këtyre librave ai na i kthjellon gjërat, të cilat aty i jep në mënyrë eksplicite.

Tani që janë botuar shënimet e lëna për këtë shkencë të re, mund të kuptohen në tërë shtrirjen dhe thellësinë e vet thëniet ndezëse të Selman Rizës: "Gjithmon' e jetës kam synue e do të synoj me kontribue, makar modestisht, në mposhtjen e kompleksit të inferioritetit të bashkëkombasvet ndaj Ballkanasvet tjerë, mun të Bashkëballkanasvet ndaj Evropjanëvet perëndimorë"⁷⁴ dhe "Haram na qoftë marrja nga të huajt kur të marrunavet prej tyre nuk i mbishtojmë diçka tonën, të vlefshëme edhe për ata"⁷⁵. Dhe ai ua kthen me të madhe atyre "turrën e huasë", si thoshte dikur në *Tri monografina albanologjike*.

Dhe nuk jemi veçse në fillimet e njohjes me teorinë e tij për Intelektologjinë dhe Komunikativistikën.

Në pamundësi të një vështrimi gjithëpërfshirës, po lejohe mi që nga gjithë vepra albanistike e Selman Rizës të ndalemi shkurtazi vetëm te dy shkrime të tij : "Shqyrtimi kritik i klasifikimit të fjalëve në pjesë të ligjëratës (si praktikë gramatografike) dhe parashtrimi i përmbledhur i një togu tezash për zgjidhjen e bashkërenduar të problemevet pezull"⁷⁶, dhe "Dy orvajtje për të përpunuar : një

⁷⁰ Selman Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009.

⁷¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, Selman Riza, *Vepra*, 5, Prishtinë, 2009.

⁷² R. Ismajli, "Në 100vjetorin e lindjes së Selman Rizës", S. Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009, f. 13.

⁷³ S. Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009, f. 506, shënimi 6305 : Çdo tejbartje midis ndërgjegjgjore, kushtëzohet nga destinatari i tij. Prandaj, shkenca përkatëse duhet emërtuar "interkomunikativistikë" (e jo komunikativistikë).

⁷⁴ S. Riza, "Në marzh të 'Shqyrtimit kritik mbi fjalorin e Bariqit'", *Jeta e re*, Prishtinë, 1954, 2, f. 130; R. Ismajli, "Në 100vjetorin e lindjes së Selman Rizës", S. Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009, f. 8.

⁷⁵ S. Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009, f. 59 shënimi 249.

⁷⁶ E. Angoni, *Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Tiranë, 2009; f. 158-169.

intelektologji dhe një Signoteknikë, mbas dy analizash kritike mbi : logjikën e Aristotelit dhe gjuhësinë sosyriane"⁷⁷, sepse në to, më shumë se gjetiu, dalin në mënyrë explicite ato mendime e teza madhore që në gjithë veprën e profesorit janë në mënyrë implicite dhe që na japin të drejtën morale e shkencore ta radhitim gjenin tonë jo vetëm si gjuhëtar të shqipes, por edhe të gjuhësisë së përgjithshme filozofiko-teorike, si filozof të gjuhës, dhe, për më tepër, t'i caktojmë në këtë të fundit një vend nderi, për arsyen e thjeshtë se edhe aty është krejtësisht origjinal, krijon shkollë, në kuptimin drejtim të ri.

Kumtesa e pranishme do të merret vetëm me shkrimin e parë, gjithë duke pasur parasysh edhe të dytin. Në *Shqyrtimin kritik të klasifikimit të fjalëve në pjesë të ligjëratës (si praktikë gramatografike) dhe parashtrimin e përmbledhur të një togu tezash për zgjidhjen e bashkërenduar të problemeve pezull*, pasi i bën vështirë kritik të shpejtë gjendjes së trajtimit të pjesëve të ligjëratës në gramatografinë e tri gjuhëve indoeuropiane më përfaqësuese, të frëngjishtes, të gjermanishtes dhe të rusishtes, parashtron një tog tezash, që, sipas tij, do të zgjidhnin problemin e klasifikimit homogjen të pjesëve të ligjëratës në çdo gjuhë.

Si përherë, e fillon trajtimin me shqyrtim kritik. Ai nisat nga vrojtimi i dyfishtë se "Në gramatografitë kombëtare të indoeuropianishtes moderne, *klasifikimi i fjalëve në pjesë të ligjëratës* - në vijat e tij të trasha - vazhdon *traditën* gramatikore të *lashtësisë* greko-latine; - traditë kjo, të cilën, siç dihet e karakterizon operimi me *kriteret konceptionale dhe prosedetë analitike të logjikës formale*"⁷⁸ dhe se "Në radhën e vet, logjika formale është shkenca (jo *përshkruese*, por) *normative* mbi të menduarit të rrokur (jo në realitetin e tij gjithmonë pak a shumë të diferencuar etnikisht, por) në karakterin e tij prezumisht gjithënjëzësor"⁷⁹.

E tani, kuptohet se "Në këto rrethana, klasifikimi tradicional në pjesë të ligjëratës i fjalëve të kësaj apo asaj indoeuropianishteje moderne nuk mund të mos vuante nga mjaft kontradikta kriteriale dhe inkonveniente empirikë"⁸⁰, se "Numri i llojeve të fjalëve luhet në historinë e gramatografisë, si dhe tek gramatikanët tanë (...) "⁸¹, si edhe "Kështu shpjegohen edhe përpjekjet që gramatografët e indoeuropianishtes moderne kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë me qëllim që, makar në kuadrin e traditës gramatografike lashtogreke, të përfillin në maksimum specifikat kategoriale të gjuhëve përkatëse, duke u udhëhequr nga kriteret metodologjike *secili* sa më *adekuat* në vetëvehte dhe *të gjithë* sa më të bashkërenduar midis tyre"⁸².

Këto vrojtme e çojnë në përfundimin : "Por, simbas nesh, këto përpjekje ende sot e kësaj dite nuk janë kurorëzuar në përgjithësi me ndonjë sukses plotësisht të kënaqshëm", ndaj u bën analizën kritike tri klasifikimeve të ndryshme të bëra prej tre përfaqësuesve më me autoritet : A. Doza (A. Dauzat, *Grammaire raisonnée de la langue française*, Paris, 1952, f. 48-49), V. Jung, *Kleine Grammatik der deutschen Sprache*, 1955, f. 102-103) dhe L. V. Shçerba, V. V. Vinogradov, AN, SSSR, *Gammatika ruskogo jazyka*, Moskva, 1960, f. 19)

⁷⁷ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, Selman Riza, *Vepra*, 5, Prishtinë, 2009, f. 7-25.

⁷⁸ E. Angoni, *Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Tiranë, 2009; f. 158.

⁷⁹ *po aty*.

⁸⁰ *po aty*.

⁸¹ *po aty*, f. 159.

⁸² *po aty*, f. 158.

Dhe kështoj, rruga për një klasifikim krejt të ri, krejt vetjak, është e hapur. Dhe, në kreun *Parashtrim i përmbledhur etj.*, jep në formë të përmbledhur tezat për klasifikimin e vet të fjalëve në pjesë të ligjëratës. Ne po i citojmë ato ashtu si i ka formuluar autori vetë, sepse ato janë gdhendur prej tij me ekonomi të skajshme.

Ai mendon se "Fjala e vështuar (jo në analizën e saj *morfematike*, por) në strukturën e saj *tërësore* (si njëra nga 3 njësitë fonetiko-semantike të çdo gjuhe epëtuese : 1. *fjali*, 2. *fjalë*, 3. *morfemë*); fjala e vështuar kështu, përbën *objektin* (jo të morfologji-sintaksës, *alias* gramatologjisë, por) të *leksikologjisë*"⁸³.

Ai vëren se kërkesa metodologjike elementare për klasifikimin e një ose mësenjëplanshëm të ekzemplarëve të këtij objekti ka mbetur e paplotësuar kënaqshëm ose e papërfillur fare dhe se kjo gjendje nuk është e rastit, por që kushtëzohet nga gjendja analoge ekzistuese në logjikën formale, ku gjithashtu ende sot mungon një klasifikim adekuat i koncepteve më pak të përgjithshëm në përkatëset kategori më të përgjithshme. Dhe këtu ai kritikon klasifikimin e këtillë të koncepteve në dhjetë kategori prej Aristotelit⁸⁴, në katër grupime të dymbëdhjetë kategorive prej Kantit, si edhe kategoritë konceptuale të materializmit dialektik (lënda, ndërgjegjja, cilësia, sasia, kundërthënia, domosdosia dhe rastësia, forma dhe përmbajtja, etj) "Për shkak të karakterit të tyre *filozofik tepër të përgjithshëm* përkatësisht *universal tepër të pakufizuar*".

Dhe për të gjetur një bazë të re logjike për klasifikimin e fjalëve në pjesë të ligjëratës, bën një "orvatje" për të ndarë më parë konceptet në lloje konceptesh, pastaj fjalët në lloje fjalësh.

Konceptet e përgjithshme të mendjes njerëzore që pasqyrojnë *drejtpërsëdrejti* të nxjerrat e përgjithshme nga realiteti objektiv (dhe jo të *dhënat e veçanta* të këtij të fundit) janë ndarë në katër kategori :

"1) vetë *sendet* (jo si sende të veçantë por si *klasa* sendesh) duke përfshirë brenda sendeve ose *gjëravet* edhe *gjë të gjalla* dmth *bimët, frymorët dhe vehtjet*; - kategori *objektive* këjo, së cilës (nëpër kategorinë *logjike*, me të drejtë, *konceptuale* përkatëse) i përgjigjet kategoria gjuhësore e *emravet*;

2) *fenomenet*, të bartur nga sendet, të cilëvet (fenomene) u përgjigjen *foljet*;

3) *vetitë* të vetë sendeve përkatësisht të fenomeneve të sendeve, të cilavet (veti) u përgjigjen *mbiemrat* prkt. *ndajfoljet* (e cilësisë);

4) *raportet a marrëdhëniet* midis sendesh, fenomenesh dhe vetish të cilavet (marrëdhënie), ku ato çfaqen (jo me *morfema*, por) me fjalë, u përgjigjen *parafjalët* prkts. *lidhëzat*"⁸⁵.

Më tej, ai vëren se "këto katër kategori qëndrojnë (jo mbi një plan të vetëm, por) mbi dy plane të kundërdrejtshëm: kundrejt kategorisë së vetme të *sendeve* (nënkuptueshëm brenda sendeve duke përfshirë edhe bimët, frymorët e vetat) qëndrojnë tri kategoritë të *fenomeneve, vetive dhe marrëdhënieve*; më shkurt: 'tri kategoritë e *jo-sendeve*', dhe se "mendja njerëzore – edhe me një *jo-send* mund të operojë *posikur të kishte të bënte me një send*; më shkurt, mendja njerëzore praktikon edhe sendëzimin e

⁸³ *po aty*, f. 162.

⁸⁴ S. Riza, *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Pejë, 2009, f. 505, shënimi 6281 : Vërtetësitrat e stërzmadhuara janë kundërvëdrtetësitrat më agresive. i. LES vices DE LA LOGIQUE D'ARISTOTE ET LEs Faillites DES LOGIQUES ANTIARISTOTELIONES

⁸⁵ *po aty*, f. 163-164.

jo-sendeve; - *sendëzim jo-sendesh* ky, të cilit në përfaqësimin gjuhësor i përgjigjet *emërzimi i emrave*".

Mbas dallimit të sendeve nga jo-sendet, edhe vetë jo-sendet duhen dalluar më tej në jo-sende të *pasendizuar* e në jo-sende pikërisht të *sendizuar*, paralelisht mbas dallimit të emrave nga jo-emrat, edhe vetë jo-emrat duhen dalluar në jo-emra të *pasendizuar* e në jo-emra përkundrazi pikërisht të *emërzuar*.

Dhe ja tani e reja që Selman Riza sjell në logjikë, përkatësisht edhe në gjuhësi: "Tani, sadoqë jo-sendet e sendizuar *gjenetikisht* kanë të bëjnë me secilën nga tri kategoritë e jo-sendevet të pasendizuar, dhe *praktikisht* janë të barazueshëm me kategorinë e sendevet, prapëseprapë ata (jo-sendet e sendizuar) përbëjnë një kategori më vehte, e pikërisht të pestën kategori të të nxjerravet të përgjithëme nga realiteti objektiv"⁸⁶. Autori ynë, me këtë kategori të pestë, e ka prekur logjikën dhe gjuhësinë në thembër të Akilit.

Ajo që ne kërkonim dhe që ishte implicite në të gjitha studimet e monografitë e veta gramatikore, ajo që ndoshta Agnia Desnickaja nuk kishte mundur të përkapte në disertacionin e mbrojtur prej Selman Rizës para një komisioni, ku bënte pjesë A. Xhuvani, M. Domi dhe ajo, ndaj edhe pat thënë se për të gjykuar disertantin duhet të jesh mbi të, tani thuhet qartë prej vetë krijuesit, themelvënësit të një disipline të re : të *intelektologjisë* dhe *komunikativistikës* : "Për më tepër shkruesi i këtyre radhëve mendon prej shumë kohësh se teza e tij mbi egzistencën e kësaj kategorie së pestë në një anë të *jo-sendevet të sendizuar* në botën objektive e n'anë tjetër të *jo-emrave të emërzuar* në planin gjuhësor; e për pasojë teza e tij mbi dallimin parimor sistematik të jo-emrave të paemërzuar p.sh. "(korie) i *ndërgjegjshëm ecën shpejt që* (t'arrijë me kohë)" nga jo-emrat përkatës përkundrazi të emërzuar : "*ndërgjegjshëmëri, ecje, shpejtësi, qëllim*" - janë të një rëndësie madhore e madje vendimtare si për teorinë "intelektologjike" të kategorivet konceptuale, ashtu për praktikën gramatografike të pjesëve të ligjëratës"⁸⁷.

Dhe, konkretisht, në klasifikimin e fjalëve në pjesë të ligjëratës operon me këtë kategori të vet të pestë.

Pasi kritikon përkufizime të të tjerëve, jep përkufizimet e veta: "Folje quhet lloji i atyre fjalëve që çfaqin nga një fenomen të *pasendizuar*"; "Emër quhet lloji i atyre fjalëve që çfaqin qoftë nga një *send* (duke përfshirë brenda sendevet ose gjëravet edhe *gjëtë e gjalla* dmth. *bimët, frymorët dhe vehtjet*) qoftë nga një jo-send të *sendizuar*".

Për konceptin e numrit, niset nga formulimi "Numër: *raport* i një sasie ndaj një tjetre, marrë si skaj krahasimi e që quhet *njësi*"⁸⁸. Shihet, pra, që për të "edhe fjalët e numrave janë fjalë raportesh, por raportesh të një tipi nga më të pasaçmit"⁸⁹ dhe "posaçëmia e theksuar e tyre qëndron këtu që nga kushdo (me përjashtim ndoshta të profesionistëve të matematikës në ushtrim e sipër të profesionit të tyre) një numër kuptohet jo si një raport matematik, e për pasojë si *një krahasim i dygjymtyrshëm*, por përkundrazi si *një rezultat i vetëm* i këtij krahasimi. Dhe për të vërtetuar se numrat janë raporte të një posaçëmie të theksuar, i drejtohet shumësit të emrit, i cili tregon se "sendi përkatës është tue u kundruar në dy a më shumë njësite të tij; - çkah do me thënë se skajesa e shumësit të një emëni nuk caktueka *sasinë e saktë* të njësitevet të sendit të

⁸⁶ *po aty*, f. 169.

⁸⁷ *po aty*.

⁸⁸ *Larousse universel en 2 volumes*, Paris, 1923.

⁸⁹ E. Angoni, Selman Riza *gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Tiranë, 2009; f. 167.

kundruem"⁹⁰. Dhe për të dalë nga pacaktuarësia e dy a më shumë njësiteve të një emri, ky i fundit shoqërohet nga *fjalët e numrave* ose *numërorë* që nuk kanë veçse këtë funksion të mirëfilltë, e, për pasojë, *pluralizmi morfematik* i një emri dhe shoqërimi i këtij të fundit me një numëror janë dy veprime vërte krejt të ndryshëm, por prapëseprapë paralelë, si e provon edhe ndërtimi gramatikor, p.sh., i turqishtes, ku emrat në shumës, kur shoqërohen nga një numëror, nuk bashkëbartin mbaresën e shumësit p.sh. kalemLER (lapsA), kurse BESH kalem (= pesë lapsø. Dhe përfundon: "Pra, shprehja e *caktuar* e raportit të më se dy njësitevet – kryhet: ... në gjuhët indoeuropiane edhe me numërorët edhe me morfemat e pluralizimit p.sh. PESH lapsA"⁹¹.

U ndalëm pak më shtruar te fjalët e numrave, sepse mendojmë se i gjithë ky parashtrim lejon që shumësi i emrave të konceptohet si fjalë më vete.

Autori ynë e mbyll shkrimin e vet duke vënë re se, nga njëra anë, "... kundrejt fjalëve quajtese (me 5 llojet e tyre: 1. të *emrave*, 2. të *foljeve*, 3. të *mbiemrandajfoljeve*, 4. të *parafjalë-lidhëza-numërorëve*, dhe 5. të *jo-emrave të emëruar*) – qëndrojnë fjalët dëftuese (me 3 strukturat gramatikore : 1. të *emrave*, 2. të *mbiemrandajfoljeve* dhe 3. të *numërorëve*"⁹² dhe, nga ana tjetër, "Përveç fjalëve quajtese dhe fjalëve dëftuese, fjalorin e një gjuhe e përbëjnë edhe t'ashtuquajturat *pjesëza*, në fakt disa të dhëna gjuhësore, të cilat në zhvillimin e kaluar kanë qenë *fjalë të plotvlershëme*, kurse në gjendjen bashkëkohore, gjithë duke pasë ruajtur paraqitjen drejtshkrimore të fjalëve të plotvlershëme, përmbushin nga një *funksion morfematik ndihmës*"⁹³.

Për të shumica e pjesëzave kanë qenë *fjalë quajtese*: *do* (të jem, të isha), *të* (jem), *le* (të jem), *me* (qenë), *duke* prkt *tue* (qenë), *kam* (qenë), *jam* (përgjigjur, etj. dhe vetëm dy pjesëza fjalësh dëftuese: 1. *nyjën* e parme dhe 2. *dëftori i gjinorese së re*.

Grafikisht, tezat e mësipërme mund të paraqiten edhe kështu:

{[pjesë të ligjëratës(1 (2 fjalë quajtese (me pesë llojet e tyre: emra, folje mbiemrandajfolje, parafjalë-lidhëza-numërorë, jo-emra të emëruar)2 + fjalë dëftuese (me tri struktura gramatikore : të emrave, të mbiemrandajfoljeve dhe të numërorëve)1] + [pjesëza të ligjëratës]}

Selman Riza, pasi ka bërë paraprakisht klasifikimin e fjalëve në lloje të fjalëve dhe pjesë të ligjëratës, ripohon se "Fakti i veçantë se na, ... , kemi operuar edhe me konceptin e '*strukturës gramatikore*', nuk çbën faktin e përgjithshëm se këtë klasifikim na në përgjithësi e kemi kryer nga të vetmet pozita të laksikologjisë", ndaj në rreshtat e fundit të këtij shkrimi metodologjik-programatik saktëson: "Mbasi teoria gjithëgjuhësore e klasifikimit të fjalëve në lloje fjalësh dhe pjesë të ligjëratës të jetë parashtruar në Hyrjen e tekstit sintetik, atëherë *trajtuesi morfologjik i llojeve të fjalëve dhe i pjesëve të ligjëratës – këta të fundit mund t'i rigrupojë simbas kriteresh thjeshtë empirikë*"⁹⁴ (nënvizimi është i yni).

Ky tog tezash, - që u hartua për t'u diskutuar ndër çështjet problemore të gramatikës së shqipes në Komisionin e Gramatikës, gjatë viteve 1965-1966, ku profesori ynë do të referonte për "Kriteret e klasifikimit të pjesëve të ligjëratës dhe

⁹⁰ S. Riza, *Gamatikë e serbo-kroatishtes*, Prishtinë, 1952)

⁹¹ E. Angoni, *Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Tiranë, 2009; f. 167-168.

⁹² *po ai, po aty*; f. 168..

⁹³ *po ai, po aty*, f. 168.

⁹⁴ *po ai, po aty*, f. 169.

klasifikimi i tyre në gjuhën shqipe", si edhe për "Kriteret e përcaktimit të rasave dhe numri i tyre në gjuhën shqipe"⁹⁵ dhe që paracaktohej për hyrjen e Gramatikës Akademike, që do të hartohej prej një grupi autorësh, - i hapi punë me kolegë shqiptarë dhe me mendimin sundues në gjuhësi të përgjithshme që i sheh ato si kategori leksiko-gramatikore. Edhe këto teza u përdorën si argument për dënimin dhe largimin e tij nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Por, nga ana tjetër, të guxosh të hedhësh teza për klasifikimin e fjalëve në pjesë të ligjëratës, t'i klasifikosh ato ndryshe nga ç'bën gjuhësia e përgjithshme, kjo do të thotë të matesh shtatë herë dhe të presësh vetëm një herë. Dhe autori ynë, për arsye e rrethana nga më të ndryshmet, ishte matur shtatë herë para se t'i parashtronte ato.

Këto teza hyjnë në hullinë e shkencës së intelektologjisë dhe të komunikativistikës që ai themeloi e që ne do ta trajtojmë një herë tjetër.

Gjithë sa u parashtrua më sipër, është vetëm njëri ndër argumentet, që çojnë detyrueshëm në përfundimin se Selman Riza operon si filozof i Logjikës dhe i Gjuhës me kategorinë e pestë të josendeve të sendizuar në logjikë dhe të joemrave të emërizuar në gjuhësi. Ai është kështu jo vetëm "filozof i shkencave", por edhe gnoseolog, filozof i mirëfilltë.

⁹⁵ "Pasqyra e çështjeve problemore të gramatikës së shqipes", Selman Riza, *Vepra*, 5, Prishtinë, 2009, f. 67-68

SISTEMI FOLJOR NË VEPRËN E PROF. SELMAN RIZËS

Selman Riza është studiues i disa fushave gjuhësore, siç janë: çështje të alfabetit, të drejtshkrimit, të historisë së gjuhës, sidomos të periudhës letrare të dokumentuar dhe i gjuhësisë aplikative. Ai mbeti studiues i thelluar sidomos në fushën e gramatografisë shqipe në gjerësinë e në thellësinë e saj, në çështjet më të rëndësishme, siç ishin: sistemi emëror, sistemi mbiemëror, përemëror dhe ai foljor në pikëpamje diakronike e sinkronike.

I lindur në Gjakovë më 1909, i shkolluar në Tiranë e Korçë, i përndjekur, i arrestuar e i internuar për shkaqe politike-patriotike e kokëfortësie nga autoritetet nazifashiste e regjimi komunist, shumë kohë mbeti i mënjanuar nga jeta shkencore, arsimore, madje si ciceron i thjeshtë lokal, por kurrë pa e lëshuar punën shkencore.

Vepra Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore (e shkruar më 1966, e miratuar nga IGJL më 1967, por, për shkak të përndjekjes së autorit, e botuar me vonesë në Tiranë më 1994) është kryevepra e monografive të S. Rizës. Në të trajtohet sistemi foljor i letrarishtes bashkëkohore.

S. Riza e trajton edhe terminologjinë foljore, zgjedhimet, mënyrat, kohët, format, diatezat (veprore, pësore, vetvetore, mesore), formalisht jo-veprore, mesore-njëvetore, duke shëtitur kritikueshëm prej një studiuesi, deri te studiuesi tjetër, të cilët nuk janë të një mendimi, për ta dhënë më në fund mendimin e vet. Në kapitullin Sistemi foljor i letrarishtes shqipe bashkëkohore, S. Riza merret me përkufizimin, tipat leksikorë, strukturën e formave, vetat, numrin, kohët e aspektet foljore, mënyrat (dëftore, habitore, kushtore, lidhore, dëshirore, lidhore-habitorë, urdhërore, paskajore, përcjellore dhe pjesore), Sipas tij “vetëm dëftorja shpreh fenomen konstatues e fiktiv ekzistues, ndërsa të tjerat shprehin fenomen potencialisht ekzistues”⁹⁶. Në këtë kontekst, foljet i trajton në prizmin historik-kritik të traditës gramatologjike, gramatografike bashkëkohore e sintaksore në raport me folësin e veprimin.

Sa u përket formave foljore, prej S. Rizës e mësojmë se përkah fjalët ka më shumë emra se folje, ndërsa përkah format ka më shumë folje se emra. Në pjesën e dytë trajton klasifikimin e foljeve në zgjedhime, kriteret, zgjedhimin: vokalik, konsonantik e vokalik-konsonantik (hyr-a), format e thjeshta – themelore (harro-nj, hap) e jo-themelore (do të harronj, do të hap), pastaj format e pathjeshta të mënyrave urdhërore e pjesore të cilat kanë vetëm një kohë. Ndërkaq, tetë të tjerat i kanë nga një, dy e katër çifte kohore.⁹⁷ Prej kohëve ai pranon: në dëftore: e tashme/e përtashme (hap-kam hapur), e pakryer/e parpakryer (hapja-kisha hapur), e kryer/e parkryer (hapa-pata hapur), e ardhmja/e paraardhmja (do të hap-do të kem hapur). Ndërkaq “habitorja ka dy çifte kohore: e tashmja/e partashmja (hapkam-paskam hapur) dhe e pakryera/e parpakryera (hapkështa-paskështa hapur).”⁹⁸ Gjithashtu i pranon format e rregullta vokallike e konsonantike veprore e joveprore, pastaj format e parregullta të tre zgjedhimeve.

⁹⁶ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 131.

⁹⁷ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 183.

⁹⁸ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 210.

Për klasifikimin e foljeve në zgjedhime ka disa punime, teza e mendime, ndarje e nën ndarje, sipas kriterëve të ndryshme. Sipas një teze, zgjedhimi ka të bëjë kryesisht me sistemin e mbaresave e jo me ndryshimet e temës, të cilat mund të jenë të rregullta si në foljet marr, mor-a, heq, hoq-a, dhe të parregullta: ha, hëng-ra, shoh, pashë..., për klasifikimin e foljeve në zgjedhime duhet folur për temat themelore të foljes. Tek folja dallohen tri tema: tema e kohës së tashme, tema e së kryerës së thjeshtë dhe ajo e pjesores.

Në përmbyllje, S. Riza konstaton se foljet shqipe të strukturës së parregullt përbëhen: në një anë – prej tetë të parregulltave me nga dy rrënjë (njëra vokaliqe, tjetra konsonantike: vinj/erdha, ka/pata, jam/qesh). Në anën tjetër, prej të parregulltave të tri zgjedhimeve: vokaliqe: 1) -ua/ue,- ye, -ie (bluaj, ndiej, lyej); 2) nga-s, -et, -sim, itni, -sin; 3) di, -, -, -më, -ni, -në; konsonantike: 1) mat/s, mate/ur; 2) flas/flet/folur; 3) kërcita/krisa, dhe vokaliqe-konsonantike: (me zgjerim) luaj/luajta, di/dita⁹⁹.

Sa i përket formimit të foljeve, Selman Riza i nxjerr foljet me parashtesim (pavarësisht nga zgjedhimet), prapashtesim dhe folje me shtesim të dyanshëm, brenda zgjedhimit vokalik (lejuar, luftuar, besuar), atij konsonantik (u zgjebur, u kujdesur, shëndoshur).

Prof. Selman Riza i pati në dorë shkrimet e shumë gjuhëtarëve, si shqiptarë, ashtu edhe të huaj, atëherë ai si analist jo vetëm që bëri krahasime midis tyre, por ishte kritik ndaj tyre, duke u munduar vazhdimisht të bëjë plotësime dhe përmirësime në rregullat dhe vështrimet e tyre. Kështu për Kristoforidhin S. Riza ka konsiderata të larta. E quajti “shqipfolës i lindur e gjuhëtar i gjithë jetës”¹⁰⁰. Për Sami Frashërin, pos theksimit të punës gjuhësore të Samiut, kudo që preken çështjet gramatikore, S. Riza i bën edhe vlerësime kritike, herë pozitive, herë negative edhe në sistemin foljor.

Siç është theksuar më sipër, S. Riza i çmon lart dy gjuhëtarët e fundit të sh. 19, Kristoforidhin e Samiut, megjithë vërejtjet kritike serioze, duke i quajtur komplementarë të njëri-tjetrit. Të metat arsyetohen me mungesën e gramatologjisë e gramatografisë së mirëfilltë shqiptare.

Në monografinë e vet Sistemi foljor, S. Riza e çmon lart A. Xhuvanin si gjuhëtar i shquar e i shumanshëm, që dha kontribut të çmueshëm në afrimin ndërdialektor në shqip, pastrimin dhe pasurimin e shqipes, si gramatolog progresiv, madje edhe më përparimtar se A. Xanoni, sa i përket inventarizimit dhe kategorizimit të trajtave foljore.¹⁰¹ Sipas prof. Selman Rizës, Gramatika e I. D. Sheperit paraqet një hap përpara në krahasim me gramatikat e përparme, megjithëse në shumë pika jo ta tejkalojë atë të Samiut.

Një vështrim të gjerë kritik, po aq sa edhe të gramatikanëve të shekullit të mëparshëm Samiut e Kristoforidhit, S. Riza, pos të tjerave i ka bërë edhe Gramatikës shqipe të K. Cipos, të botuar më 1949. Si anë pozitive nga S. Riza merren: njohja e diatezës vetvetore, përkufizimi i drejtë i foljeve kauzative, por jo të bëra me mjete leksikore, kuptimi i drejtë i mënyrave dhe i kohëve të foljes, por me lajthitje të dorës së dytë. Pastaj, S. Riza e ndan mendimin e vet se: “paskajorja e vetëmjaftueshme e shqipes së vjetër është ajo që dha si paskajoren perifrastike të gegërishtes parbuzukjane, ashtu përsjelloren e tashme të mbarë shqipes, gjithashtu pjesoren e partashme të dyja diatezave po të mbarë shqipes”¹⁰².. Ndërkaq, sa i përket terminologjisë së përdorur, “Cipoja nuk

⁹⁹ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 245.

¹⁰⁰ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 27.

¹⁰¹ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Rilindja, Prishtinë 1997, f. 60.

¹⁰² Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Rilindja, Prishtinë 1997, f. 71.

kursethet nga ndërkombëtarizmat”¹⁰³, përkundër Samiut e Xhuvanit, punë kjo e kritikueshme nga S. Riza.

Në përkufizimin e foljes, “Selman Riza i merr për bazë tri kritere: përkufizimin e pjesëve të ligjeratës, kategoritë gramatikore-shprehëse të marrëdhënieve të veprimit dhe përkufizimi nuk do të thotë përshkrim.

Që në fillim, Riza e kritikon përzierjen e konceptit emër me folje. “Përkufizimi tradicional i foljes duhet kritikuar jo vetëm për mosdallim të vetë foljes nga emri prejfoljor, por edhe për faktin se në këtë përkufizim të foljes si një pjesë e vetme e ligjeratës – qëndrojnë dy koncepte të ndryshme të veprimit dhe gjendjes ose qenies”¹⁰⁴. Prandaj, duhet pasur kujdes në paraqitjen e një emri foljor të veprimit dhe foljes. Në anën tjetër, theksohet se folja nuk është pjesë kryesore e ligjeratës, por emri, meqë kryefjala është ajo, që e kryen veprimin dhe e paraqet lidhjen e ngushtë midis veprimit e “subjektit”. “Fakti se përkufizuesit jo-tradicional, në fillim operojnë vetëm me konceptin e veprimit përkitazi të procesit, nuk i ndalon që brenda të njëjtëve përkufizime të përfshijnë edhe konceptin e dytë të gjendjes”¹⁰⁵. Në anën tjetër, prof. Selman Riza vlerëson se të gjitha rezultatet shkencore dalin nga realiteti objektiv. “Kjo gjë na shpie te fenomenet që barten nga sendet, pra fenomenet u përgjigjen foljeve”¹⁰⁶.

“Gramatikisht folja përbën, në parim, qendrën e fjalisë. Folja është motori që të jep urdhrat, rregullon strukturën, duke lidhur subjektin me caktuesit dhe plotësit”¹⁰⁷.

Po të krahasojmë konceptin e foljes të Rizës me të autorëve të tjerë, sidomos kur thonë se “folja është bërthamë e fjalisë”, menjëherë vijmë te një jobaraspeshë midis tyre.

Duket se “prof. Selman Riza më shumë rendësi i jep konceptit të emrit sesa foljes”¹⁰⁸. Prandaj, mendoj se përkufizimi i dhënë më lart vetëm sa na drejton më shumë kah pikëpamja sintaksore dhe na largon prej asaj morfologjike.

Te përkufizimi i foljes: “Selman Riza e merr foljen si farë fjalësh që shfaq një fenomen të pasendëzuar”¹⁰⁹.

“Me dallimin e fenomeneve të sendëzuara (p.sh. veprim, gjendje) nga të pasendëzuarat (veproj, gjendem) bëhet i tepërt përshkrimi nga gjuhëtarët modernë i foljeve brenda përkufizimit të tyre”¹¹⁰.

Ndarjen e foljeve në tipa leksikorë, Selman Riza e bëri sipas farëve objektive të fenomeneve. Në parim i përfill vetëm dallimet objektive. Sipas kësaj “Selman Riza i dalloi 7 tipa leksikorë të foljes”¹¹¹ e ato janë:

Folja “qenë”, folje të gjendjes, folje të lëvizjes, folje të veprimit të pa-ushtueshëm mbi sendet, folje të veprimit të ushtueshëm mbi sendet, foljet me kuptim leksikor të pavetëmjaftueshëm dhe foljet me kuptim leksikor të shlyer.

Selmani është më i veçantë në klasifikimin e foljeve sipas kuptimit leksikor, sepse i grupon foljet sipas vetive të përgjithshme të tyre bashkë me funksionin e tyre¹¹².

¹⁰³ Po aty, f. 77.

¹⁰⁴ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 82.

¹⁰⁵ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 82.

¹⁰⁶ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 83.

¹⁰⁷ S. Riza, vepër e cituar f. 85.

¹⁰⁸ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 85.

¹⁰⁹ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 84.

¹¹⁰ S. Riza, vepër e cituar, f. 84.

¹¹¹ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 85.

¹¹² S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 85.

Mendoj se klasifikimi i këtillë, i bërë nga S. Riza është më i drejtë dhe më i qëndrueshëm sesa mendimi i autorëve të tjerë. (L. Husaj). Meqë një folje përmes shërbimit brenda fjalisë shumë lehtë mund të ketë një funksion tjetër. Gjithashtu, Selman Riza theksoi se në gramatologjinë tradicionale kombëtare të gjuhëve indoevropiane moderne, keqpërdorej termi “formë” për termin “morfemë”. Ndërsa, këto ishin tërësisht të kundërta. Kështu “Formë e një fjale është ajo e dhënë (globale), dy të nxjerra (analitike) bazale dhe jobazale, të së cilës shfaqin secila nga një kuptim të dallueshëm”¹¹³. Po ashtu, u cek se dy të nxjerrat analitike (bazale dhe jobazale) të një forme të një fjale i paraqesin morfemat. “Duhet marrë në konsideratë se morfema (bazale ose jobazale) qëndron ndaj formës si pjesa ndaj së tërës. Kështu më vonë do të gjejmë keqpërdorime të termit formë për termin morfemë jobazale ose formant. P.sh: djeg-a / djeg-ur / dogj-i.”¹¹⁴

Selman Riza, në klasifikimin e foljeve në zgjedhime e zbaton “temën”, “fundjet” dhe “mbaresat”. Kjo tregon se këto terma u përdorën në vend të morfemës bazale dhe morfemës jobazale. Ndërsa, koncepti i rrënjës haset vetëm te foljet e parregullta dyrrënjëshe dhe njërrënjëshe. Kështu, vërejmë se Selman Riza më tepër ka konsideratë ndaj temës, fundjeve e mbaresave, sesa rrënjës së foljeve.

Gjatë punës së tij, S. Riza e merr për bazë paskajoren, si te foljet e rregullta, ashtu edhe të parregullta.

Veçanti e S. Rizës është se e bën dallimin e foljeve sipas formës në folje të thjeshta dhe folje të pathjeshta. Të thjeshtat ndahen në të thjeshtën themelore, të thjeshtën kriteriale dhe jokriteriale. Ndërsa, teoria e strukturës së foljeve të pathjeshta duhet mbështetur në fjalëformim, më drejt: fjalë-ndërtimin.

* “Termi temë përdoret në vend të emërimit adekuat: morfemë bazale. Dy termat: parashtesë, prapashtesë janë shkurtime të volitshme të emërtimeve të plota: morfemë jobazale para ngjitur bazales dhe morfemë jo-bazale prapa ngjitur bazales.”¹¹⁵

Po kështu, S. Riza e pranon “të nxjerrën bazale dhe jo-bazale”¹¹⁶ për analizën morfematike, kryesisht i nxitur nga pikëpamja morfologjike. P.sh. Te forma globale ujku, ujk– (e nxjerra bazale) ka kuptim leksikor; kurse “–u” (e nxjerra jo-bazale) shfaq kuptimin gramatikor. Në trajtimin e foljeve të pathjeshta, Selman Riza e merr për bazë në trajtimin e foljeve të pathjeshta morfemën jobazale, të cilën e sugjeron si parashtesë dhe prapashtesë. Natyrisht se Riza përmes temave të tjera dhe parashtesave, saktësisht prapashtesave na jep folje. P.sh.: Udhë > udhëtoj, i ri > përtërij, poshtë > poshtëroj, grumbull – uar, i ligësht(i) – uar, ndal – uar. “Nga dy morfemat e një forme njeriu morfemën bazale të kuptimit leksikor mund ta parafytyrojë si diçka pasive, kurse morfema jo-bazale e kuptimit gramatikor mund të parafytyrohet si diçka aktive”¹¹⁷. Prandaj, parashtesat dhe prapashtesat janë ato që na ndihmojnë të prodhojmë fjalë të prejardhura.

¹¹³ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 102. -E nxjerra (analitike) bazale e një forme e paraqet kuptimin leksikor, ndërsa e nxjerra jobazale e së njëjtës formë të së njëjtës fjalë shfaqet në gjuhën tone më vonë. (F. 102).

-E nxjerra (analitike) jobazale shfaq kuptimin gramatikor të kohës, vetës, numrit, diatezës, etj.

¹¹⁴ Selman Riza, vepër e cituar 2, f. 103.

¹¹⁵ Selman Riza, *Vepra 2*, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë 1997, f. 279, 292.

¹¹⁶ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 102.

¹¹⁷ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 104.

Selman Riza i vëzhgon parashtesat dhe prapashtesat gjatë formimit të foljeve të prejardhura brenda zgjedhimit vokalik apo konsonantik. Kështu, sipas tij, “prapashtesat e foljeve të pathjeshta janë komponente sufiksale në planin fjalë-ndërtues, kurse në planin formëndërtues ato hyjnë në përbërjen e temës”¹¹⁸.

Foljet e pathjeshta të tipit të përbërë, d.m.th. “foljet e ndërtuara me dy gjymtyrë leksikore barabar rëndësiplota, që janë në një numër më të vogël”¹¹⁹.

P.sh. Buzëqeshur, dëmshpërblyer, udhëhequr.

Në studimin e vet për foljet, Selman Riza i ka paraqitur foljet si “fjalë të zgjedhueshme të së njëjtës gjuhë, që bashkëbartin një lloj formantesh dhe shprehin pesë lloje raportesh: vehtjen, numrin, kohën, mënyrën dhe diatezën”¹²⁰. Selman Riza i ka vënë në “tri veta dhe në dy numra foljet e shqipes. Tri vehtjet foljore nuk përkufizohen dot pavarësisht nga përkufizimi i përemrave vehtjorë”¹²¹. Gjithashtu “dy numrat foljorë nuk mund të përkufizohen në pamvarësi nga përkufizimi i njëjësit dhe shumësit të përemrat vehtjorë, si dhe tek emrat”¹²².

Në studimin aktual për folje të S. Rizës (Vepra 2), “tri vehtjet foljore të numrit njëjës dhe tri vehtjet foljore të numrit shumës, e për pasojë gjashtë situatat vehtjoro – numërore të ndryshme shfaqen nëpërmjet gjashtë formanteve gjithashtu të ndryshëm: -em, -esh, -et, -emi, -eni, -en, dallueshmëri morfologjike e përsosur kjo e cila nuk haset në mbarë sistemin foljor letrar aktual shqip”¹²³. Si pasojë e kësaj që të gjashtë situatat vetore – numërore shfaqen përmes formanteve të ndryshme sikurse janë në diatezën pësore dhe në veprorë.

Kohët dhe Aspekti: Pasi Selman Riza e nxjerr foljen nga fenomeni, atëherë edhe kohën e jep në relacion me fenomenin. Dhe si e tillë koha e tregon zgjatjen e një fenomeni. Ndërsa, te pozicioni e kemi, në një anë çastin e fenomenit dhe në anën tjetër çastin kur flitet për të. Sipas referimit të Selman Rizës “gjuha shqipe i ka 8 pozicione kohore, që ndahen me tej”¹²⁴.

I. “Koha e tashme me një shkallë të vetme.

II. Kohën e kaluar me pesë shkallë: Të pakryemen, të kryemen, të partashmen, të parpakryemën dhe të parkryemen

III. Koha e ardhshme është me shkallën e ardhshme dhe me shkallën e parardhshme”¹²⁵.

Aspekti - vjen nga latinishtja “aspectus” = pamje, dukje e foljeve. “Është dallimi i tyre në pakryemjore dhe kryemjore”¹²⁶. Kësaj duhet shtuar edhe kuptimi jokryesor i aspektit të foljeve, si dallim në folje të fazës nistore, vazhdimore, mbarimore.

Përfundimisht, dy aspektet e kohës së kaluar janë: e pakryera dhe e kryera.

Duke pasur në konsideratë momentin (pozicionin) para së tashmes, Selman Riza i praktikon edhe kohët e së shkuarës, të cilat emërtohen si të partashme. Këtu merren foljet: kapnja, kapa, kam kapur.

¹¹⁸ Selman Riza, *Vepra 2*, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë 1997, f. 280.

¹¹⁹ Selman Riza, vepër e cituar, f. 300.

¹²⁰ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 104-105.

¹²¹ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, f. 106.

¹²² Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, f. 107.

¹²³ S. Riza, vepër e cituar f. 107.

¹²⁴ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 114.

¹²⁵ Po aty, S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 114.

¹²⁶ Selman Riza, *Vepra 2*, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosoves, Prishtinë 1997, f. 118.

S. Riza e arsyeton si të partashme vetëm kohën e kryer, kam kapur. Kjo trajtë e pathjeshtë e kohës së partashme përbëhet nga mënyra pjesore, e prirë nga koha e tashme e foljes ndihmëse kam.

Gjatë bisedës së lirë përdoret aspekti kryemjor i kohës së kaluar për të shprehur të ardhmen. P.sh.: Ti në çast nisu, se edhe unë erdha fill mbas teje ¹²⁷.

Gjithashtu, te Selman Riza “dy aspektet e kohës së parkaluar janë: e parpakryemja (kisha mbajtur) dhe e parkryemja (pata mbajtur)”¹²⁸. Prandaj, nëse koha e tashme është ajo që shërben në përcaktimin e pozicionit kohor të aspekteve të kohës së kaluar, koha e shkuar do të shërbejë për përcaktimin e të dy aspekteve të kohës së parkaluar¹²⁹.

Si koha e parpakryeme, ashtu edhe koha e parkryeme është kohë korrelative, meqë përdoren në lidhje me ndonjë aspekt të kohës së kaluar.

Koha e ardhme: Selman Riza variantin e së ardhmes te gegët: kam me shkruje dhe te toskët: kam për të shkruar i merr si detyrim të ardhshëm e jo si variante te sakta të së ardhmes. “Këtë e arsyeton me ekzistencën e trajtës: do të shkruaj, trajtë e së ardhmes dhe në gegërisht trajta e do të shkruaj, e cila vërtetohet edhe nga letërsia popullore e folklori si edhe përdorimi i rregullt në popull”¹³⁰.

Pastaj, duke u mbështetur në dy koncepte, në atë të realitetit dhe atë të ekzistencës, Selman Riza dallon këto mënyra të foljes:

- Mënyrën dëftore (Folësi shpreh një fenomen për ta konstatuar si efekt ekzistues).
- Mënyrën kushtore, mënyrën lidhore, mënyrën dëshirore, mënyrën lidhore-habitore dhe mënyrën urdhërore.

Te mënyrat, folësi shpreh nga një fenomen për ta prezumuar si potencialisht ekzistues, d. m. th. si qëndrues në këtë apo atë raport ndaj ekzistencës efektive.¹³¹

Mënyrë dëftore : “Selman Riza e riemërton si mënyrë kumtore, duke e arsyetuar se folja e mënyrës dëftore ka karakter kumtues”¹³². Folja vihet në këtë mënyrë, kur “ekzistenca e fenomenit përkatës mendohet si diçka efektive. Pra si një e dhënë e konstatuar, e cila në mendjen e folësit nuk shoqërohet nga ndonjë cilësim kufizues, por paraqitet si diçka gjithanshmërisht e plotvlershme”¹³³.

Mënyra habitore: Në bazë të Selman Rizës, “folësi, foljen e vë në këtë mënyrë për të shprehur vetëm këtë rrethanë se ndodhja e fenomenit përkatës është në mospajtim ose kundërshtim me pritjen e tij. Prandaj kjo ndodhje e çudit ose e habit. Selman Riza, i jep kuptim referativ kësaj mënyre”¹³⁴. Kjo ndodh atëherë kur fenomeni është kumtuar nga një tjetër folës. P.sh.: Paska dalë në qarkullim një fjalor i gjuhës ruse. “Kuptimi referativ s’është i njëjtë me të parin sepse rikumtuesi mund të mos provojë habi, por fjalinë e riprodhon me rezerva.

Mënyra kushtore: Selman Riza, “foljen e vë në këtë për të treguar se ndodhja e fenomenit përkatës varet nga plotësimi paraprak i një kushti, të cilin folësi e paraqet qoftë si të paplotësuar, qoftë si të plotësuar. Kushti ndodhet në fjalinë e varur në periudhën

¹²⁷ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 120.

¹²⁸ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 121.

¹²⁹ Po aty, f.121.

¹³⁰ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 124.

¹³¹ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 131.

¹³² Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 133.

¹³³ Selman Riza, *vepër e cituar*, f. 132.

¹³⁴ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 133.

përkatëse dhe folja e fjalisë kryesore i vihet në kushtore. P.sh.: Do të vij po të kem kohë”¹³⁵.

Mënyra lidhore: Selman Riza si mënyrë kumtore e quan dëftoren, atëherë si jokumtore e merr mënyrën e habisë, kushtit, dëshirës dhe urdhërit. Kurse “me mënyrën nënrendore të një foljeje, folësi ekzistencën e fenomenit përkatës e bën objekt të një cilësimi kufizues të përgjithshëm”¹³⁶. Sipas Selman Rizës kjo “ekzistencë e fenomenit njihet si jo e dhënë. Megjithatë synohet që kjo ekzistencë të jetë si e dhënë”¹³⁷.

Mënyra lidhore përdoret në fjalitë e varura kundrinore, qëllimore me përemër lidhor, kushtore, etj., po ashtu përdoret edhe në fjalitë e pavarura. Siç është rasti te pyetëse – çuditëset, ose shprehja e një urdhëroreje, shprehje e një dëshire, etj.¹³⁸ “Kjo mënyrë përdoret në fjalitë e varura dhe fjalitë e pavarura”¹³⁹.

Mënyra dëshirore: Selman Riza, foljen e vë, në këtë mënyrë kur ekzistencën e fenomenit përkatës e bën kundrinë të një dëshirimi, më drejt të një urimi apo nëme nga ana e tij.¹⁴⁰ Nganjëherë trajta e dëshirores e paraqet kushtin joreal, në veçanti kur është e paraprirë nga parafjala “në”.

P.sh.: O burrani! O Shqiptarë!, se në daçim’ e në u-përpyjekçimë, do të jemi një nga më të mirët’ e nga më të ndrituarët e kombeve t’ Evropës,.....(Sami Frashëri).¹⁴¹

Mënyra lidhore-habitore: Selman Riza konstatoi se mënyra lidhore-habitore, “për shkak të trajtës së habitores të paraprirë nga pjesëza “të” e lidhore, është quajtur nga Kostaq Cipo si mënyrë lidhore-habitore”¹⁴².

Selman Riza mendon se “folësi e vë foljen në këtë mënyrë për të shprehur me forcë karakterin, sa të dëshiruar, aq edhe ireal të ekzistencës së fenomenit përkatës”¹⁴³.

Mënyra urdhërore: Në bazë të S. Rizës, “folja në këtë mënyrë përdoret për të kumtuar vullnetin vetjak të dëgjuesit, që ky të kryejë një veprim. P.sh.: Puno!; Ose të vihet në një gjendje, p.sh.: rri drejt.”¹⁴⁴ Përderisa, në mënyrën lidhore, mohimi i fenomenit është në kundërthënie me mundësinë, dëshirën, nevojën, përkundrazi në mënyrën urdhërore mohimi i foljes tregon vullnetin e folësit se dëgjuesi shmanget nga veprimi që kryen.

Në disa gjuhë, ky koncept i mënyrës ndalore për urdhëroren mohuese merret si prohibitiv, ndërsa trajta e lidhore, e prirë nga pjesëza “le”, si: p.sh.: le të punojë njihet nga Selman Riza thjeshtë si urdhërore në dy trajtat e saj për njëjës in e shumës in. Mirëpo nuk e riemërton me ndonjë emër tjetër, siç është rasti tek autorët e tjerë. (Jussiv). Gjithashtu, sipas përdorimit të kësaj trajte në gjuhën shqipe, Selman Riza i jep kuptim për-lejues ose e pranon si urdhërore duhunore.¹⁴⁵

Selman Riza i merr parasysh këto diateza: diatezën veprorë, diatezën pësore, diatezën mesore, diatezën vetëvehtjore, diateza me kuptim vepror por me formë joveprorë dhe diateza pësore përkitazi mesore njëvetore. Në diatezën veprorë – “bartësi i

¹³⁵ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 135.

¹³⁶ Selman Riza, vepër e cituar, f. 137.

¹³⁷ Selman Riza, vepër e cituar, f. 138.

¹³⁸ Po aty, f. 138.

¹³⁹ Selman Riza, vepër e cituar, f. 138.

¹⁴⁰ Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 141.

¹⁴¹ Selman Riza, vepër e cituar, f. 141.

¹⁴² Selman Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 142.

¹⁴³ Selman Riza, *Vepra 2*, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë 1997, f. 142.

¹⁴⁴ Po aty, f. 143.

¹⁴⁵ Selman Riza, vepër e cituar, f. 144.

një fenomeni është prodhues i të njëjtit fenomen jashtë vetës. Atëherë folësi e vë foljen përkatëse në formën e diatezës veprorë, e cila është forma diatetike themelore (unë kapa) dhe dallohet me anë të treguesit diatetik zero”¹⁴⁶. Diatiza pësore – “Folja vihet në diatezën pësore, kur fenomeni përkatës prodhohet jo nga bartësi i tij, (si në diatezën veprorë), por nga dikush tjetër. E si pasojë, kur bartësi i fenomenit e pëson, pra ndjen mbi vete efektin (negativ) të veprimit të tjetërkujt. Pësimi shprehet me formën e foljes përkatëse, me treguesin patetik “u”, p.sh: u kapa nga ndjekësit”. Diatiza mesore - është kur bartësi i fenomenit prodhon brenda vetes ose për vetveten.

Diatiza vetëvehtjore- folja vihet në diatezën vetvetore (refleksive), kur fenomeni përkatës, edhe prodhohet, edhe pësohet nga bartësi i tij, p.sh.: Ti kështu nuk ç’ fajësohesh dot = (e ç’ fajëson vetveten).¹⁴⁷ Diatiza me kuptim vepror, por me formë joveprorë, i përfshin foljet e diatezës veprorë për nga kuptimi, por joveprorë për nga forma, p.sh.: u përgjegjur, mbetem, mbetësia ndaj mbeta, mbetësia. Diatiza pësore, përkitazi mesore njëvetore – “Në këtë diatezë mund të vihet çdo folje pos foljes qenë”¹⁴⁸, p.sh.: duhet të kihët parasysh. “Konstatim i S. Rizës ka qenë se tash së voni folja pasur ka zënë të përdoret si njëvetore dhe foljet duhet të jenë në vetën e dytë të njëjësit, me kuptim të papërcaktuar, si: duhet, lypet”¹⁴⁹. Dy diatizat e fundit janë risi për autorët e tjerë në raport me S. Rizën, të cilët i veçojnë vetëm 4 diatizat e para.. Për klasifikimin e foljeve sipas funksionit dhe kuptimit, Selman Riza bazohet në disa koncepte psikologjike-morale për të ashtuquajturat

folje ndihmëse mënyrore, që i pagëzon si folje marrëdhënore të pavetëmjaftueshme.¹⁵⁰

Pra, ai bazohet: - në konceptin e të dashurit, në konceptin e të mundurit, në konceptin e dukurisë morale të detyrimit shoqëror dhe në konceptin e të lënit. Selman Riza thekson se foljet dashur, mundur – nuk janë ndihmëse të foljes shëtitur, as nuk shfaqin ndonjë mënyrë zhvillimi të foljes shëtitur. “Në të vërtetë, foljet: dua, mund, duhet, shfaqin vullnetin, aftësinë, nevojën, në lidhje me një fenomen të dytë”¹⁵¹. Kështu fenomeni paraqitet si i vendosur, i mundur, i duhur.

Në grupin e foljeve ndihmëse mënyrore radhiten edhe foljet ndihmëse aspektive, të cilat funksionalisht janë të pavetëmjaftueshme. “Roli i këtyre foljeve qëndron në faktin se secila shfaq nga një etapë ose fazë të procesit zhvillor”.¹⁵² Gjatë zgjedhimit analitik, foljet kam dhe jam, tradicionalisht emërtohen herë folje ndihmëse patjetër e herë folje ndihmëse kohore¹⁵³. Selman Riza ishte i pari që i konceptoi këto folje si marrëdhënore të pavetëmjaftueshme, duke shprehur synim, mundësi, lejim, nevojë, detyrim, domosdoshmëri dhe dashje.

Selman Riza i paraqet edhe foljet me kuptim leksikor – “të shlyer”. Kuptimi leksikor origjinal i këtyre foljeve duhet kompensuar me një kuptim morfologjik ndihmës.

¹⁴⁶ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishës shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 156

¹⁴⁷ Selman Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishës shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 159.

¹⁴⁸ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 161.

¹⁴⁹ S. Riza vepër e cituar, f. 161

¹⁵⁰ Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 90.

¹⁵¹ Po aty, f. 90.

¹⁵² Po aty, f. 91.

¹⁵³ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 92.

Kështu trajtat: kam dhe jam të foljeve pasur dhe qenë, origjinalisht kanë dashur të thonë: posedoj dhe ekzistoj.

Selman Riza e bën dallimin sipas reksionit të foljeve dhe i merr në konsideratë foljet transitive dhe intransitive.¹⁵⁴ (Tejvajtëse – jo tejvajtëse). Ky kategorizim është bërë sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë një kundrinë të drejtë në fjali.

Paskajorja, përcjellorja dhe pjesorja u quajtën “mënyra pavetore” nga Selman Riza. Paskajorja dhe përcjellorja njohin 2 kohë, ndërsa pjesorja vetëm një.¹⁵⁵

Selman Riza e konsideron paskajoren si më të vjetrën krahas pjesores e përcjellores. Ai e argumenton këtë me faktin se paskajorja është përdorur qysh herët në shqipen e vjetër. Në këtë kohë paskajorja ka shërbyer edhe si pjesore.

Selman Riza “është mbështetur në paskajoren +dal, që duket se ka qenë një emër foljor, e cila i mori të gjitha tiparet gramatikore të një mënyre foljore, p.sh. do dalë, pa dalë”¹⁵⁶. Fillimisht “paskajorja përdorej në mbarë shqipen si paskajore, ndërsa më vonë ajo kishte një përdorim më të kufizuar, kështu që në fund mbeti vetëm në disa ndërtime reliktoze, kurse në gegërisht është zëvendësuar me mënyrën lidhore”¹⁵⁷. Pos paskajores së ripërtëritë vetëm në gegërishte, ky dialekt e krijoi edhe paskajoren e dytë, të tipit: për të la(m).

“Paskajorja për të la(m) njihet si emër foljor asnjans i veprimit, që paraprihet prej parafjalës qëllimore për”¹⁵⁸.

S. Riza pati shprehur mendimin se paskajorja ishte më e lashta për nga funksionimi si formë e pashtjelluar. Duke qenë se në gegërisht përdoren të dy format: infinitivi dhe koniuktivi, në toskërisht ky infinitiv është zëvendësuar me koniuktivin.

“Funksionalisht paskajorja mund të zëvendësohet me mënyrën lidhore, ndërsa përcjellorja mund të zëvendësohet me cilëndo mënyrë të shtjelluar, varësisht nga mënyra e foljes në fjalinë nënrenditëse”¹⁵⁹.

Te përcjellorja vërtetohet karakteri mënyror.

Përcjellorja brenda së nënrenditurës paraqet një rrethanë shoqëruese, e cila mund të përcaktohet si rrethanë e kohës, shkakut, mënyrës, kushtit, etj., ndonëse përcjellorja e përdorur në raporte të bashkërenditura gjendet në trajtat e tilla, si: duke parë e duke bërë.¹⁶⁰

Sipas S. Rizës gjuha shqipe njeh vetëm pjesoren e partashme¹⁶¹. Pjesorja e partashme nuk përbën ndonjë veprim, mënyrë foljore të mirëfilltë. Pjesorja, bashkë me trajtat përkatëse të foljeve ndihmëse përbën kohët e pathjeshta të mënyrave të mirëfillta.¹⁶² Në këto rrethana kuptimi i pjesores është i barazueshëm me kuptimin e temës foljore përkatëse, pra me kuptimin leksikor të foljes përkatëse.¹⁶³

Selman Riza e jep pjesoren e partashme të dalë nga paskajorja e tashme, por kjo paskajore e ka zëvendësuar pjesoren e shqipes së hershme.¹⁶⁴ Më pas ka vazhduar procesi

¹⁵⁴ Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 94.

¹⁵⁵ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 146.

¹⁵⁶ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 146.

¹⁵⁷ Po aty f. 146.

¹⁵⁸ Po aty, f. 146

¹⁵⁹ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f.148.

¹⁶⁰ Po aty, f. 150.

¹⁶¹ S. Riza, *Vepra 2 - Sistemi foljor i letrarishes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 150.

¹⁶² Po aty, f. 151.

¹⁶³ Po aty, f. 151.

¹⁶⁴ Selman Riza, vepër e cituar, f. 153.

i kalimit nga foljorizimi në një mbiemër të mirëfilltë. kuptimi. S. Riza e veçon pjesoren me kategorinë e kohës dhe atë e paraqet si pjesore të partashme¹⁶⁵. “Në tërësi, forma e pashtjelluar si pjesorja është pjesë përbërëse e formave analitike me komponentin e foljeve ndihmëse, si dhe është pjesë përbërëse e formave sintetike”¹⁶⁶. S. Riza e argumenton këtë më lart. Natyrisht, Selman Riza e sheh se “pjesorja e partashme është e adjektivushme, por vetëm e foljeve tej-vajtëse të drejta. Përfundimisht, S. Riza i jep përparësi paskajores, duke e nxjerr pjesoren nga paskajorja. Në anën tjetër, S. Riza i shton pjesëzën u paskajores e jo pjesores”¹⁶⁷, meqë pjesorja e partashme është e njëjtë me paskajoren reliktoje, pra me temë të paskajores inovuese dhe përcjellores

Selman Riza i klasifikon foljet e parregullta në zgjedhime. Foljet e parregullta ndryshojnë prej atyre të rregulltave veç në trajtat e thjeshta¹⁶⁸.

Ai konstaton se format e pathjeshta nuk dallohen në të rregullta e të parregullta. Ndryshe nga gramatikanët e tjerë, Selman Riza e bën dallimin e foljeve të parregullta në: vokaliqe, konsonantike, vokale-konsonantike dhe folje të parregullta të dyrrënjëshme. Për grupin e foljeve të parregullta “vokale-konsonantike”, autori e përdor emërtimin “Foljet dyzgjedhimshe”¹⁶⁹. Më pas u dalluan në njërën anë “foljet dyzgjedhimshe konsonante-vokaliqe”, e në anën tjetër, “foljet dyzgjedhimshe vokale-konsonantike”. Në përgjithësi, Selman Riza, të gjitha foljet dyzgjedhimshe, madje edhe ato konsonante-vokaliqe i quajti “vokale-konsonantike”¹⁷⁰.

Selman Riza për folje të parregullta i merr këto folje: Nga – rë, ngja – rë, shka – rë, Vra – rë. Po kështu, edhe “zgjedhimi i vokalikes pre – rë është barazuar me zgjedhimin pres dhe konsonantikes prit –ur.”¹⁷¹ Prof. Selman Riza vë në dukje se disa folje si vokale-konsonantike apo vokaliqe janë në zhdukje e sidomos te ato që kanë karakteristikë mungesën e infiksit -n- nga temat përkatëse.

Selman Riza i merr për bazë disa veçori strukturore të foljet e parregullta vokaliqe, si: “pabarazinë midis karakteristikave: ua (ue), ye, ie të të tashmeve dhe karakteristikave: o, e, jë të të kryerave përkatëse. P.sh: blua – nj / blo – va; lye – nj / le – va; pastaj ndërhyrja e reflekseve: as, et, it të infiksit +at në format përkatëse. P.sh: ng –as (nga +nga-at-io), ng – et, ng – it – ni, ng – it – nja dhe mos-marrja e infiksit n në të tashmen, p.sh: di, (ti, ai) di”¹⁷². Kështu që për folje konsonantike, Selman Riza i deklaroi këto folje: mat, mbet, pyet, pres, ku janë përfshirë edhe foljet: shes e zbres. Në grupin e foljeve me reflekset –as, -et, -it, vendosen edhe foljet: Fol – ur, kall – ur, thirr – ur, brit – ur, klith –ur, prek – ur. Të një veçorie konsiderohen foljet: krisur, plasur, kërcas, pëlças, rrëshq –as, trok – as. Konsonantike të një grupi konsiderohen foljet, si: rrjepur – ropa; rrjedhur – rrodha, vjedhur – vodha. Ndërsa, të një grupi janë foljet: djegur, ndjekur, pjekur, veçse e ndeshim procesin e qiellzorizimit.¹⁷³

¹⁶⁵ Selman Riza, vepër e cituar, f. 146-150.

¹⁶⁶ Oda Buchholz, Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, VEB Verlag Enzyklopädie, Leipzig 1987, f. 173-177.

¹⁶⁷ S. Riza, *VEPRA 2 - Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 200-209.

¹⁶⁸ Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Prishtinë 1997, f. 219.

¹⁶⁹ Po aty, f. 233.

¹⁷⁰ Po aty, f. 233.

- Shpjegim – Folja “Ngjas” e ka kuptimin e foljes “ndodh”.

¹⁷¹ Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Prishtinë 1997, f. 220.

¹⁷² Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 245.

¹⁷³ Po aty, f. 229.

Konsonantiket me “e” brenda tematike të pandryshueshme janë: çelur, derdhur, ecur, heshtur, mbetur, mekur, prekur, ndeshur, shkelur, velur, ndrequr, shprehur, etj. Ndërsa, konsonantiket me “e” të shndërrueshme në “i” janë: fshehur – fshihni, lehur, ndezur, ngrehur – ngrini, veshur – vishni, përgjigjur – përgjigjem.¹⁷⁴ Foljet: rrahur dhe njohur, janë të njëjta, sepse zanorja brenda tematike a, o, u metafonizohet në e në dëftoren e tashme. Ndërsa në të pakryerën e dëftores dhe urdhërores kjo kalon në i. P.sh: Rrah – rreh – rrihni; njoh – njeh – njihni.

“Të një kategorie merren konsonantiket me -l, -ll, -rr, -tog-tingujshin brenda tematik je e shndërrojnë në i ose o”¹⁷⁵. Siç janë: mjel – ë - milni - mola, mbjell- ë - mbillni – mbolla, ndjellë, sjellë, vjellë, shtjellë. Pokështu janë foljet: çjerrë, nxjerrë, tjerrë, etj. Kurse, konsonantiket dalë dhe marrë janë të njëjta. Megjithëse folja marrë e shton veçorinë e kalimit të karakteristikës “rr” në “r”. P.sh. Dal –ë - dilni - dola, marr – ë – merrni – mora.

S. Riza i ka veçuar foljet: quanj, banj, gjenj, si folje të parregullta vokalike-konsonantike. “Folja quanj është emërtuar vokale-konsonantike, ndërsa banj është emërtuar konsonanto-vokalike. Kjo ka ndodh për shkak se folja quanj duhet të ketë qenë vokalike: qua-nj, qo-va, qua-rë; kurse folja banj duhet të ketë qenë konsonante fillimisht e më vonë tema e tyre në të tashmen e në paskajore ka kaluar si vokalike”¹⁷⁶

“Variante të vokale-konsonantikeve me zgjerimin tematik +jt- dhe karakteristikën -ua, janë: Luanj, ruanj, quanj, vuanj. Edhe pse folja luajt është e ngjashme me foljen loz, për nga kuptimi, megjithatë për nga forma këto nuk pajtohen aspak. Kurse të zgjerimit tematik -jt- janë: mbajta, bëzâjta, vërejta, rrojta.

Të zgjerimit tematik t dhe pa ndonjë ndryshim në temë janë: di – dita – ditur, arrij – arrita - arritur, mbërrij – mbërrita – mbërritur. Megjithëse këtu mund të vendosen edhe disa forma, si: ngre – ngrita – ngritur, fle – fjeta – fjetur. Këto, “pos zgjerimit tematik, pësojnë ndryshim në temën e pazgjeruar”¹⁷⁷. Më e dalluar nga këto është forma gjenj – gjeta – gjetur, sepse e nënkupton foljen gjendem, trajtë që e ka grupin nd në mbarë format joveprore. Për folje vokale-konsonantike merret edhe folja mund, e njohur në të folmet dialektore si muj, mujta.

Selman Riza i vendos në të njëjtin grup foljet: “hy – nj dhe bë – nj, si vokale-konsonantike, që e ruajnë karakteristikën n në të kryerën. Si vokalo-konsonantike me mbaresë paradigmatiche n dhe zanore brendatematike a është folja: lë, lë-më, li-ni, lë-në. (li-nja); la-shë, lënë.

Të formës sigmatike, krahas la-shë, konsiderohen edhe foljet dy rrënjëshe: jap – dhashë; shoh – pashë.¹⁷⁸ E veçantë është edhe vokale-konsonantikja: ha – hëngra – ngrënë, meqë forma e metatizuar ngrënë hynte në tipin e paskajoreve: dhënë, lënë, zënë, etj.¹⁷⁹ Ndërkaq, te vokale-konsonantikja them shohim se e-ja do të jetë rezultat metafonizmi i një o-je të mëparshme.¹⁸⁰ Ndërsa joveprorja është thuhet, që lidhet me dy zanorshin ua. P.sh: them – thua – thotë. Gjithsesi, vokale-konsonantikja dua ndryshon

¹⁷⁴ Po aty, f. 229.

¹⁷⁵ Po aty, f. 231.

¹⁷⁶ Selman Riza, vepër e cituar, f. 232-233.

¹⁷⁷ Po aty, f. 235.

¹⁷⁸ Po aty, f. 237.

¹⁷⁹ Po aty, f. 238.

¹⁸⁰ Po aty, f. 238.

nga folja them. Natyrisht, folja dua e pëson alternancën në do, por paskajoren e bën me (desh-) dash – ur.

Në gjuhën e sotme shqipe, krahas foljeve të parregullta të njërrënjëshme, gjejmë edhe format e të parregulltave të dyrrënjëshme. Çështja është se ekziston një folje, e cila më pas paraqitet në dy ose më shumë tema të ndryshme.

Folje të tipit dyrrënjor në shqipe janë: Ardhur - erdha -vinj, urdhërorja: eja (ni). [Ose trirrënjor].

-Dhënë -dhashë -jap, ---- jepni.

Mandej dihet dy rrënjëshja: ndënj - ur, ndënja, parë – pashë – shoh; pasur, pata, kam. Pasiqë “foljet kam e jam janë të vetmet që përfundojnë me mbaresën m, njëjtë sikur them, atëherë edhe folja jam i nënshtrohet të njëjtit proces sikur kam”¹⁸¹. Pastaj, tipi i foljes bie rezulton me dy kuptime në pjesore, si rënë dhe prurë. Gegërishtja e ka formën: pru (-m), prun-a, për pjesore.

Veçoritë strukturore të të parregulltave dyrrënjëshe: Më specifike janë dyrrënjëshet: eja (-ni), vinj, erdh-a, ardh-ur; ka dhe pata të dyrrënjëshes: kam; është (âsh-të) dhe ish – a të dyrrënjëshes jam; (qeshë – qenë).¹⁸²

S. Riza ka përparësi për folje të parregullta në raport me të tjerët, sepse S. Riza është më i detajuar dhe më i saktë në parashtrimin e problemit dhe kategorizimin e tij.(L.Husaj).

“Foljet e shqipes klasifikohen në zgjedhime, nënzgjedhime dhe klasa, në mënyrë të shkallëzuar, bazuar në temat dhe fundjet ose mbaresat e formave kyçe”¹⁸³. Fillimisht Selman Riza i ndan foljet në zgjedhimin e parë: vokalik, në zgjedhimin e dytë: konsonantik dhe zgjedhimin e tretë vokalo-konsonantik, ku çdo zgjedhim ndahet në nga dy nënzgjedhime. Më pas nënzgjedhimi ndahet në nga dy klasë.

Sipas fundjes së paskajores, ekziston:

Nënzgjedhimi i parë, që i përfshin foljet te të cilat është paskajorja me mbaresën -rë [geg. -m] ose me mbaresën -uar, -yer [geg. -ue (m), -ye (m)].

Nënzgjedhimi i dytë (i zgjedhimit të parë) bëhet sipas asaj që paskajorja u del në mbaresën: -ur [geg. -un, -ë] ose në mbaresën: -ë. Secili nënzgjedhim ndahet në klasa, sipas barazisë ose pabarazisë tematike, në vetën e parë njëjës të së kryerës dhe të tashmes të dëftores. Të parat i takojnë klasës barazore, kurse të dytat i takojnë klasës jobarazore, të nënzgjedhimit përkatës.¹⁸⁴

Në gjuhën shqipe janë të njohura edhe disa folje, format e të cilave janë pjesërisht të zgjedhimit vokalik dhe pjesërisht të zgjedhimit konsonantik. Prandaj foljet e tilla janë quajtur si vokalo-konsonantike nga Selman Riza.

“Një karakteristikë tjetër që ndikon në radhitjen e grupeve zgjedhimore është shkallëzimi i rregullsisë apo shkallëzimi i prodhorësisë”¹⁸⁵.

“Tipin prodhimtar {sot} (atë në temë në -o, e me barazi tematike në vetën e parë njëjës të së tashmes dhe të kryerës dëftore) të foljeve vokalice do ta përfaqësojnë me foljen: harr O – nj, harr O – va, harr – UAR. Ndërsa, tipi i një prodhorësie të kufizuar dhe të

¹⁸¹ Po aty, f. 242.

¹⁸² Selman Riza, *VEPRA 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 247.

¹⁸³ Selman Riza, vepër e cituar, f. 167.

¹⁸⁴ Po aty, f. 167.

¹⁸⁵ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 171.

kushtëzuar (i pandryshueshëm) i foljeve konsonantike përfaqësohet me foljen: hap, hap – A, hap – UR”¹⁸⁶.

Më vonë, zgjidhet edhe problemi i ndarjes së foljeve në shqipe në dy zgjedhime .

1. Zgjedhimi vokalik – ku hyjnë foljet me temë në zanore, sidomos foljet me karakteristikën dikur mbarëparadigmatike o.

2. Zgjedhimi konsonantik – ku hyjnë foljet me temë në bashkëtingëllore si edhe dy grupe strukturore foljesh të reja, si: për – dor – ur, vend – os –ur.¹⁸⁷

Nocioni i rregullsisë dhe i parregullsisë nënkupton karakterin (më shumë ose më pak të thjeshtë) të strukturës përkatëse, kurse prodhorësia apo joprodhorësia e një tipi strukturor është forca ose dobësia numerike e shfaqjeve të tij të tashme e të ardhshme.¹⁸⁸

Kështu, te foljet vokaliqe: harrUAR, harro-VA, harro-NJ qëndron rregullsia e paplotë, mirëpo te foljet konsonantike: hap-UR, hap-A, hap qëndron rregullsia e përsosur.¹⁸⁹

Në zgjedhimin vokalik vendosen foljet: harroj, ankoj, bekoj, kthej, dëfrij, gatuaj, lyej, fyej, laj, fshij, shtyj, etj. Si folje të parregullta brenda këtij zgjedhimi vokalik merren: vras, ngarë, ngjarë, shkarë, gërga(m).¹⁹⁰ Kurse zgjedhimi konsonantik i përfshin foljet: hap, humb, këput, tret, pyes,¹⁹¹ rris, pres, klith, kërcas, rrëshqas, mjel, mbjellë, sjell-ë, vjell-ë, etj. Te disa folje konsonantike, alternimi -s:-t është fare i natyrshëm.

Të zgjedhimit vokalik-konsonantik janë ato folje, temat e të cilave dalin pjesërisht në zanore (dyzanore) e pjesërisht në bashkëtingëllore. Foljet e tilla janë emërtuar si “të përzierë” apo vokale-konsonantike. Të tilla janë: [bë (n)j], bër –a / bân-a; fshiva, fryva, mba+jt-a, rro+jt-a, luajta, quajta”¹⁹². Kështu, përballë formave të zgjedhimit vokalik, siç janë: shkruar – shkrova; bluar – blova – blua (n)j, zgjuar – zgjova – zgjua (n)j, përdoren edhe format e zgjedhimit vokale – konsonantike: shkruajtur ose shkrojtur, shkruajta ose shkrojta.

S.Riza zgjerimin analogjik –jt- të temës së kryerës dhe paskajores te zgjedhimi vokale-konsonantike e shpjegon në këtë formë: Tingulli –j- është i imagjinuar, ndërsa tingulli -t- është një përhapje analogjike.¹⁹³

Siç duket, foljet e zgjedhimit vokalo – konsonantik, kohë më parë ishin vokaliqe, ndërsa sot janë të zgjedhimit vokale – konsonantike. E veçantë është folja: ikë (n)j; ika, ikur, e cila dikur ishte konsonantike¹⁹⁴.

S.Riza i trajtoi si folje vokale-konsonantike, duke u mbështetur në temën e formës (paskajores): bënj-bëra. Natyrisht se kriteri i separacionit te Selman Riza në vokaliqe, konsonantike dhe vokalo-konsonantike është më gjithëpërfshirës dhe më i natyrshëm për klasifikimin e foljeve në zgjedhime, se sa kriteri i autorëve të tjerë.

Zgjedhimi vokale-konsonantike i propozuar nga Selman Riza është më i veçantë nga të gjithë zgjedhimet e autorëve tjerë, sepse kriteri dallues i zgjedhimit vokale-konsonantike nuk merret parasysh nga autorët tjerë. (L. H)

¹⁸⁶ Po aty, f. 168.

¹⁸⁷ S. Riza, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë 1997, f. 169.

¹⁸⁸ Po aty, f. 173.

¹⁸⁹ Po aty, f. 171.

¹⁹⁰ Po aty Selman Riza, vepër e cituar, f. 174.

¹⁹¹ Duket se “pyes” do të ketë dale nga trajta + *pyet* – *io* nëpër format +*pyet* – *i* , + *pyetj*; ndërsa alternimi e:i te “pres:prita” nuk motivohet (shpjegohet) historikisht. (S.Riza, f. 177).

¹⁹² Selman Riza, vep. e cituar, f. 178.

¹⁹³ Po aty, f. 179.

¹⁹⁴ Po aty, f. 180.

SELMAN RIZA DHE KORÇA

Formimi intelektual, por edhe njerëzor i gjuhëtarit Selman Riza, e ka zanafillën e vet në bangat e Liceut Kombëtar të Korçës, institucionit më të njohur arsimor të fillimit të shek. XX, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në Ballkan e më gjerë. Ishte Liceu Kombëtar i Korçës nga i cili morën dritën e diturisë plejada e intelektualëve më të njohur shqiptarë, prej aty u formuan diplomatët, gjuhëtarët, publicistët, mjekët, juristët, inxhinierët e matematicienët e ardhshëm të vendit tonë. Mes emrave të njohur të ish-liceistëve: Mahir Domi, Vedat Kokona, Gjergji Canco, Koço Glozheni, Nonda Bulka, Xhuvi Bino e shumë e shumë të tjerë, radhitet edhe emri i ish-liceistit Selman Riza.

Dëshira e hershme e nxënësit Selman Riza ishte të ndiqte studimet në Liceun Kombëtar të Korçës, njëra nga shkollat e mesme më cilësore e me në zë në atë kohë. Në vitin 1925 komisioni i profesorëve francezë të Liceut të Korçës e renditi atë në krye të listës së nxënësve të përzgjedhur për të ndjekur mësimet në këtë lice. Liceu Kombëtar i Korçës ishte një institucion i vërtetë shkencor, merita kryesore për këtë i përket, në radhë të parë personelit drejtues, pedagogjik e administrativ të shkollës, për të cilin si qeveria franceze, ashtu edhe qeveria shqiptare treguan kujdes të veçantë. Në këtë shkollë ato dërguan gjegjësisht drejtorë francezë me kulturë të gjerë dhe aftësi organizative si Manburjan (Manboyran), Baji –Komte (Bailly-Comte), Leon Perre (Leon Perret), Ksavier de Kurvil (Xavier de Courville), drejtorë administrativë shqiptarë me përvojë të madhe e përgatitje të shëndoshë profesionale si Sotir Papakristo e Pertef Pogoni, por edhe mësimdhënës të përkryer si A. Brezho (A. Bregeault) e Kostaq Cipo.

Që prej fillimit të liceut, Selman Riza u dallua si nxënës i zgjuar, i palodhur, sistematik e këmbëngulës, me vullnet të jashtëzakonshëm. Vlerësime e përgëzime të tilla si: “*Nxënës shumë i mirë në çdo pikpamje*”, “*Nxënës me ngulm të fortë për punë*”, “*Nxënës i shkëlqyer vetëm mund ta përgëzosh*”, “*Nxënës i shkëlqyer siç ka qenë gjithmonë*” etj., lexohen në të gjithë regjistrat që ruhen në arkivin e Liceut Kombëtar të Korçës si edhe në dëftesat shkollore që ruhen në familjen e Selman Rizës, i cili thaujse për çdo lëndë e provim zë rregullisht vendin e merituar “i pari”. Në vitin 1931 mbaron po me përfundime të shkëlqyera, në gjashtë vjet të nëntë klasat e Liceut, mundësi kjo që iu jepej vetëm liceistëve shumë të talentuar. Ja si i shkruan Leon Perre, drejtor teknik i Liceut, ministrit të Arsimit në përfundim të provimeve të pjekurisë në vitin 1931, ku Selman Riza u diplomua shkëlqyeshëm në lëndën e matematikës: “*Selman Riza është një i ri tepër i talentuar, shumë serioz, i cili do të mundë me të njëjtën lehtësi të kryejë çdo degë të studimeve universitare, dhe unë nuk dyshoj që ai do t’i bëjë më vonë nder atdheut me emrin e tij.*”

Me përkushtimin dhe dëshirën për dijen S. Riza do t’i justifikonte më së miri vlerësimet e shumta. Studimet e larta për letërsi dhe drejtësi në Tuluzë të Francës do ta pajisnin me një kulturë të gjerë filologjike e shkencore. Ai kishte njohuri të thelluara jo vetëm të gjuhës shqipe, por edhe të frëngjishtes, gjermanishtes, italishtes, serbokroatishtes, latinishtes, greqishtes së vjetër, të cilat i zotëronte si gjuhën e nënës.

Pasi kryen studimet e larta, kthehet në Shqipëri, Selman Riza, që me punën dhe me përfundimet e arritura kishte lënë përshtypjet më të mira si një intelektual i ri e me plot

vullnet, pëlqeu ndërmjet të gjitha kërkesave punën e mësuesit, me dëshirën e zjarrtë që t'i vinte njohuritë dhe energjitë e tij në shërbim të shkollës, aq më tepër bash në Liceun Kombëtar të Korçës, që e kishte rritur, që e kishte mësuar dhe edukuar, që ishte një shkollë e mirënjohur, e vlerësuar për kohën më shumë se çdo shkollë tjetër në Shqipëri, prandaj edhe ai e çmoi, e deshi dhe e kujtoi, e nderoi dhe i qe mirënjohës gjatë gjithë jetës. Ishte ky një vlerësim e nder i madh që i bëhej një intelektualit të ri e të sapodiplomuar. Në fillim punoi si mësues i frëngjishtes dhe i shqipes, më vonë edhe si mësues i latinishtes dhe i gjermanishtes.

Nxënësit e çmonin dhe e nderonin shumë për kulturën e gjerë që e shpaloste pa u kursyer e me mjeshtëri. Mësimi i tij ishte i kthjellët, i rrjedhshëm e me logjikë të pastër, me nivel të lartë jo vetëm shkencor, por edhe metodik. Vetëm ai e dinte se sa kohë i merrte puna e madhe për shqyrtimin e shumanshëm e të hollësishëm të çdo hartimi, edhe kur e vlerësonte me notë të mirë. Kurrë nuk mjaftohej me ndreqje gabimesh drejtshkrimore. Me shënimet dhe vërejtjet e tij të kujdesshme i hapte horizont nxënësit. Ish -liceisti, Xhuvi Bino sjell në vëmendjen tonë mbresat e lëna nga profesor Riza : “ Erdhi profesor ne lice më 1935. Shpejt, fjalët e mira që thuheshin për të nga ata që e kishin njohur kur ishte nxënës, u konfirmuan në radhë të parë për peshën që mbajti në botimin e vetëm të Lyceum-it ku pasqyrohej niveli i ngritur i kësaj shkolle. Emri i tij u rrit edhe më në sytë tanë me studimin filologjik që botoi në një vëllim serioz me titull “Tri monografi albanologjike”. Megjithëse nuk arrinim t’i kuptonim mirë të gjitha ato që thuheshin në të, e lexonim me ëndje librin e profesorit tonë që bëri bujë kur u vu në qarkullim.

Karakteri i tij kompleks dhe jo i zakonshëm na bëri që në fillim t’i ndiqnim me kërshtëri dhe vëmendje të madhe mësimet që na jepte. Personaliteti i tij dominues shpejt na imponoi jo vetëm bindje, por dhe respekt. Filluam ta çmonim e ta deshim për njohuritë e tij të shumta, për bagazhin e madh kulturor që e shpaloste pa u kursyer çdo çast. Shpjegimet e tij çuditërisht interesante, thellësia e atyre që thoshte, humori i tij i mprehtë e gjithnjë me vend, shija e herëpashershme për paradoksin na kënaqnin pa masë. Megjithëse i ri në punë, pati zotësinë të shoqërojë mësuesinë- shkencë me mësuesinë- art, prandaj ne e kujtonim me mall dhe më vonë kur nuk na jepte mësim. Orët e tij as që i ndienim si kalonin. Veçanërisht korrigjimin e hartimeve e bënte ashtu si nuk na e kishin bërë më parë. Ishim mësuar vitet e tjera të merrnim fletët e hartimit me ndonjë ndreqje të lehtë drejtshkrimi aty- këtu dhe rëndësi t’i jepnim notës që na qe vënë. S. Riza na porositi të shkruanim në gjysmën e faqes e gjysmën tjetër ta linim për korrigjime. Sa kohë i merrte atij puna e madhe që bënte në çdo hartim? Atë e dinte ai, por ne i shihnim faqet tona të mbushura me korrigjime, jo vetëme ndreqje gabimesh ortografike, por edhe rregullime frazash e paraqitje më të mirë, më koncize, më artistike të asaj që deshim të thoshim.”¹⁹⁵

Autoriteti i prof. Rizës mbështetej në dashurinë dhe përkushtimin për punën, në qëndrimin e pastër moral, në marrëdhëniet e shëndosha me nxënësit, të cilët i trajtonte të barabartë nga ana shoqërore dhe, jo vetëm që i lejonte, por edhe u krijonte mundësi e i nxiste që të shprehnin lirisht mendimet e tyre. Me zgjuarsin të rrallë, por edhe punëtor i jashtëzakonshëm, këmbëngulës në punë, i drejtë, i arsyeshëm e i qetë. Armik i betuar i arrogancës dhe i mendjemadhësisë. i çiltër, realist, reformator e demokrat i mirëfilltë.

¹⁹⁵ Xhuvi Bino, “ *Një mozaik për Liceun Kombëtar*”, Kotti, Korçë, 1999.

Ja pra, pse ish- nxënësit e kanë çmuar, nderuar e adhuruar kaq shumë profesor S. Rizën, dhe jo vetëm ata. Vlerësime të larta kishin për të edhe kolegët e tij, jo vetëm shqiptarë, por edhe francezë, përfshirë edhe drejtuesit e shkollës. Drejtori francez i Liceut do të thoshte për të në vitin 1937: “Me diturinë dhe shpjegimin e përkushtuar, profesor S. Riza bënte xhelozë jo vetëm profesorët shqiptarët, por edhe ata francezë, për shkak të mbresave të pashlyeshme që linte te nxënësit si profesor iluminist me thellësinë dhe enciklopedizmin e tij”¹⁹⁶ Ndërsa njëri nga kolegët e tij në Lice, përkthyesi i shquar i frëngjishtes V. Kokona, duke kujtuar vitet e Liceut veçon figurën e S. Rizës: “Në darkën e shtruar për largimin e profesorëve francezë, ku ishin të pranishëm drejtori i Liceut De Kurvil, Kostaq Cipoja, Ligor Serafimi, Selman Riza, Fejzi Dika, Enver Hoxha dhe unë, fjalën e lamtumirës e mbajti S. Riza, ish- nxënës i shkëlqyer i këtij liceu dhjetë vjet më parë dhe tani profesor po aq i shkëlqyer i frëngjishtes. Fjalimi i tij, në një frëngjishte të përkryer, u prit me admirim nga të gjithë, sidomos nga De Kurvili i cili tha se duhej të matej mirë për t’iu përgjigjur ashtu si duhej këtij fjalimi të bukur të Rizës. Ne, që e njihnim prej kohësh, mburreshim për këtë arsimtar të rrallë që na zbardhte faqen.”¹⁹⁷

Liceu i Korçës formoi elitën e rinisë shqiptare të viteve ‘20-’30. Përveç mësimi të shqipes, frëngjishtes, latinishtes, matematikës, gjeografisë etj., në këto klasa u lëvrua përkthimi, publicistika e letërsia. Sigurisht që Selman Riza, liceist e më vonë profesor, do të ndikohej nga veprimtaritë e pasura kulturore të liceut, të cilat ishin tharmet e veprimtarisë së tij të mëvonshme në fushën e publicistikës, gjuhësisë e përkthimit. Nga ana tjetër, atmosfera kulturore e atdhetare në qytetin e Korçës së atyre viteve ndikoi në brumosjen e intelektualit dhe patriotit të ardhshëm. Selman Riza u njoh shumë shpejt e u miqësua me mjaft intelektualë e atdhetarë jashtë mureve të Liceut. Ndërmjet tyre veçojmë edhe shoqërinë e miqësinë e ngushtë me Mihal Gramenon, publicistin e shquar, shkrimtarin dhe një nga veprimtarët më në zë të lëvizjes atdhetare e demokratike shqiptare. Me Selman Rizën ai takohej e bisedonte rregullisht në librarinë “Dhori Koti” për çështje nga nga më të ndryshmet, por në radhë të parë për gjendjen e mjeruar të popullit, këtej e matanë kufirit, si edhe për letërsinë. Mihal Gramenoja çmonte shumë mendimet e këtij intelektual të ri, jo vetëm për letërsinë në përgjithësi, por edhe për krijimet letrare dhe publicistike që kishte botuar a që i kishte në dorë. Miqësia e hershme me prof. Kostaq Cipon (për të cilin shprehet se “*e kam pasur mësues të madh të shqipes e njëherazi frymëzues të fortë të shqiptarizmit.*”), shoqëria e miqësia e ngushtë me poetin e madh lirik Lasgush Poradecin, si dhe lidhja e fortë me Mitrush Kutelin ndikuan në personalitetin dhe emancipimin e përgjithshëm kulturor e shpirtëror të tij.

Një ngjarje e rëndësishme në veprimtarinë e Liceut kombëtar të Korçës ishte edhe botimi i revistës “Lyceum” në korrik të vitit 1936. Si sekretar redaksie Selman Riza mbajti peshën kryesore në përgatitjen dhe botimin e numrit të vetëm të kësaj reviste të përkohshme tremujore. Ai shkruan në parathënien e saj se redaksia me programin e saj synonte, ndër të tjera, “t’u sjellë nxanësve, por edhe gjithë rinisë shqiptare një ndihmë të vlefshme njohurish e gjykimesh në lamën shkencore, filozofike, letrare e artistike, me u dhanë të kuptojnë të rinjve shqiptarë mbi domethanjen e vërtetë të një qytetnimi perëndimor”. Revista synonte gjithashtu “ta bajë të njoftun nder të huej këtë vend të harruem për shumë kohë, historinë e zakonet e tij, pamjet e kangët e tij, përparimin e

¹⁹⁶ Engjëll Angoni, “*Selman Riza, gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*”, Toena, Tiranë, 1999.

¹⁹⁷ Vedat Kokona, “*Endur në tisin e kohës*” Botimet Kokona, Tiranë, 2005.

t'ardhmen e tij, jetën e vërtetë të njëj Shqipnije, e cila për ata humbet tepër shpesh në mjegullën e legendës”.

Selman Riza spikat në faqet e kësaj reviste edhe si përkthyes. Të dy pjesët e përkthyer në frëngjisht, “Besa- ou la parole qu’il donna a sa mere” dhe fragmenti nga “Martesa e Halilit” shpërfaqin edhe një herë atdhedashurinë dhe dëshirën për ta bërë të njohur kulturën shqiptare në Evropë. Ja se si shprehet përkthyesi S. Riza tek paraqet në frëngjisht këtë fragment: “Në daçi për së largu m’e pa ma së miri fizjonomi e një kombi (kendojna folklorin) dhe n’daçi m’e kndue një të përkohshme, ku folklorit arbnuer t’i jetë lëshue kryet e vendit, hapni “ Lyceum—in”, kangë kreshnike, kangë dashnije, landa asht e begatëshme, veçse zbulohet me të vështirë. Nji turmë e madhe shqiptarësh janë sot për sot anëtarë të dalldisun të një modernizme qinq për qind. Të tanë ktyndet u vjen marre me i pohue përpara Evropianeve sendet e moçme t’Atmes së lashtë. Këjo marre asht nji marri. Mirë po edhe kur të zbulohet thesari i skutun, puna mbetet e zorëshme, prej copash aq të bollëshme kah sasiya sa të ndryshme kah vetja, cilat duhet zgjedhun qi t’i bajnë veshit të të huejit përshtypjen e volitëshme? Prandaj sidomos në kët made, presim miradijshëm landë të parë dhe kritikë ndriçuese prej kah mos. Do t’a kemi ba at tonën po mujti kjo freskë fragmentare me zgjue interesim për nji gurrë poezijet qi nuk meriton me qenë as kaq e panjoftun prej të huejvet as kaq e harueme prej shqiptarëve.”¹⁹⁸ Në fjalët e profesorit dhe intelektualit çmohet mbi gjithçka kultura dhe krijimtaria e një populli evropian, por të panjohur në dyert e Evropës. Tregues i kulturës së tij të thellë dhe njohjes së vlerave që përmban folklori ynë është edhe qëndrimi i tij përkundrejt mendimeve snobe të pseudointelektualëve për fetishizimin e këtyre vlerave të rralla. Gjithmonë prof. Selmani me kompetencë shkencore dhe argumente promovonte këto vlera folklorike si një tharm i domosdoshëm në kultivimin e mëtejshëm të filologjisë dhe gjuhësisë shqiptare.

Të qenit liceist dhe profesor në Lice është vetëm një nga përmasat e figurës së gjithanshme të gjuhëtarit dhe atdhetarit Selman Riza. Liceu me ndikimin e tij perëndimor dhe qyteti i Korçës i dalluar për nivelin e tij kulturor luajtën një rol të rëndësishëm në përvijimin e kësaj figure të shquar të gjuhësisë shqiptare, por edhe të kulturës sonë në tërësi.

¹⁹⁸ Lyceum, Nr.I, Korrik, 1936, f. 50-51.

KONCEPTE TERMINOLOGJIKE NË GRAMATIKËN E SERBOKROATISHTES TË SELMAN RIZËS

E gjithë veprimtaria shkencore e Selman Rizës përshkohet nga dashuria e pakufishme për gjuhën amtare duke lënë gjurmë të pashlyeshme në studimet albanologjike. Me të drejtë mund ta konsiderojmë si një nga themeluesit e gjuhësisë së re shqiptare. Ndhimesa e Selman Rizës në shkencat e albanologjisë është shumë e gjerë. Ai solli ndihmesa me vlerë në studimin e tekstologjisë, në historinë e gjuhës shqipe, madje edhe letrar. Ndhimesë të çmuar ka dhënë edhe, për zbulimin e rrugëve të zhvillimit të saj. Puna e tij studimore, që e kishte filluar që nga viti 1944 me botimin e veprës “Tri monografite albanologjike” vazhdoi gjatë viteve 1951-1955, ku me të dhëna e me ndihmesa të shumta vetjake trajton probleme të rëndësishme të gjuhës letrare shqipe. Gjatë kësaj periudhe 5 –vjeçare ai na dha, përveç disa artikujve botuar në gazeta këto vepra të mbetura në dorëshkrime, si: *"Gramatikë e serbo-kroatishtes"*, *"Fillimet e gjuhësisë shqiptare"*, *"Diftoret e shqipes dhe historiat e tyre"*, *"Fillimet e gjuhësisë shqiptare"*, *"Pozita e toskërishtes"*, *"Problemi gjuhësor dhe zgjidhja e tij"*, *"Hyrje në fjalorthin terminologjik"*, *"Një shqyrtim kritik mbi fjalorin e Bariçit"*, *"Relacion i zgjeruar mbi ribotimin kritik të Gjon buzikut nga Eqerem Çabej"* etj.

Selman Riza në gjithë veprimtarinë e tij shkencore është shquar edhe si gjuhëtar kritik që spikatin veçanërisht në punimet e tij kryesore: *"Njykat e shqipes"* (1985), *"Pronorët e shqipes"* (1960), *"Emrat në shqipe, sistemi i rasave dhe tipet e lakimit"* (1965), *"Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore"* (1994). (Angoni 1999:54-55).

Të gjitha këto gjurmë të shqyrtimeve shkencore edhe sot e kësaj dite mbeten modelet më të larta si arritje dhe shenjëzime të verifikimit dhe interpretimit të faktologjisë gjuhësore dhe letrare të gjuhës shqipe. Botimi i katër veprave të plota, të punës studimore dhe shkencore të Selman Rizës, nga ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, paraqet një punë të pasqyrore në zbardhjen e dimensioneve të njeriut poliglott, që fliste dhe shkruante 12 gjuhë të huaja, por edhe që e zotëronte në majë të gishtave gjuhën shqipe, gjuhën amtare, ku është përfshirë gati e gjithë puna shkencore e tij.

Ndhimesa e Selman Rizës në terminologjinë gjuhësore

Nisur për nga vlerësimi dhe prurjet e prekshme në këta lëmenj të gjerë të shkencave gjuhësore dhe tekstologjike, Selman Riza ka dhënë ndihmesën e tij edhe në fushën e terminologjisë shkencore. Duke qenë anëtar në disa komisione, ai mori pjesë në përpunimin e terminologjisë së gjuhësisë dhe të disa shkencave të tjera, natyrore e teknike (si: termodinamika, optika, akustika, elektromagnetizmi, mekanika, elektromekanika etj.), si dhe në hartimin e fjalorëve gjegjësisht shumëgjuhësh. Luftoi me këmbëngulje për pastrimin e terminologjisë së këtyre shkencave nga huazimet e panevojshme, si dhe për pasurimin e tyre me terma të rinj, madje ai krijoi edhe një numër të mirë termash, formuar me mjetet e vetë shqipes. Ai u dallua veçanërisht me vendosjen e një terminologjie sa më të përpiktë shqipe. (Angoni 1999: 59).

Në fokusin e interesimit tonë do të jenë termat gjuhësore që përdor autori në veprat e lartpërmendura. Si më karakteristike na duken termat në librin “Gramatika e serbokroatishtes” (Fonetikë I, Morfologji II) botuar nga Shtëpia botuese “Mustafa Bakija”, Prishtinë 1951. Me këtë vepër Selman Rizës është i pari dhe i vetmi gjuhëtar shqiptar që në rrafshin gjuhësor përqs dy gjuhë: shqipen me serbokroatishten. Është për t’u theksuar se një vepër e tillë del në dritë nga një gjuhëtar shqiptar i kalibrit të Selman Rizës, shumë vjet para hedhjes së themeleve teorike të gramatikës përqsëse. (Angoni 1999: 59).

Merita tjetër e Selman Rizës është se këtu përfshinë edhe karakterin e një studimi krahasues të serbokroatishtes dhe shqipes. Pikërisht në parathënien e kësaj gramatike, autori Selman Riza thekson se synimi i tij është “ *kalimthi t’i përmend pikëpamjet gramatikore të serbo-kroatishtes me shqipen, kurse bukur gjatë të ndalet në mospajtimet gramatikore ndërmjet këtyre dy gjuhëve...*”

Vetë gramatika përfshin këto kapituj: *Parathënia, Tre shënime rreth gegërishtes letrare, Fonetika, Morfologjia dhe Sintaksa.*

Në pjesën e parë *Fonetika*, autori shqipen dhe serbokroatishten i konsideron si dy gjuhë kushërira, kurse sllavishten e lashtë dhe ilirishten si dy gjuha motra, sepse së bashku me keltishten, gjermanishten e lashtë, latinishten, greqishten, armenishten, persishten e indishten e lashtë burojnë nga e njëjta familje indoevropianishten (Riza, Vepra-2:327).

Më tutje janë karakteristike emërtimet e termave gjuhësore dhe gramatikore. Ne do të ndalemi vetëm ato në gjuhën shqipe, pa hynë ato serbokroate.

Në pjesën e parë autori studion sistemin fonematik, ku zanoret i emërton si vetëtinguj, kurse bashkëtingëlloret si bashkëtinguj. Për secilën prej tyre jep edhe definicionin e tyre. (Riza, Vepra-2:331). Fjalë të reja paraqiten edhe në nënndarjet e tingujve, si: plasjorë a shpërtherë (për bashkëtingëlloret eksploziv), fërkorë (për ato frikative ose fërkimore).

Duke folur për rregullat e theksimit, autori për fjalët një e më tepër rrokëshe përdor termet: njërrrokjeshore, dyrrrokjeshore, shumërrrokjeshore. (Riza, Vepra-2:339). Duke folur për shqiptimin e fjalëve të patheksuara, Riza përdor edhe një term të ri lidhëfjalët (për lidhëzat). (Riza, Vepra-2:341). Selman Riza duke shqyrtuar ndarjen e fjalëve në rrokje, për velarin zanor përdor veglari zanuar (Riza, Vepra-2:342).

Në pjesën e dytë të veprës “Gramatika serbokroate”, në të cilën autori Selman Riza bën ndarjen në bazë të parimit morfologjik, jo vetëm se përmban definicione për çdo pjesë të ligjëratës, por arrijmë të zbulojmë fjalëformime të reja për pjesë të ndryshme gramatikore. Prej tyre më karakteristike janë Emrat (emënat) janë “*n’asosh që shfaqin një send, kah një gjë të gjallë a kah një vehtje*”; Mbiemrat (ndajemënat) janë “*n’asosh që zëvendësojnë kah një emën*”; Lidhëzat (lidhëfjalët) “*n’asosh që shfaqin kah një marrëdhënie ndërmjet dy mendimesh*”.

Në lidhje me fjalëformimin e pjesëve të ligjëratës, Selman Riza përsëri përdor dy terma të rinj. Për fjalën mbaresa përdor skajesa. P.sh. “*Farët e fjalëve që nuk bashkëmbartin dot elemente foljorë të pamvetësishëm, janë paraafjalët, ndajfoljet dhe lidhëfjalët; kurse farët e fjalëve që mund të marrin skajesa janë: emënat, ndajemënat, përemënat, numërorët dhe foljet*”. (Riza, Vepra-2:344).

Më pas autori shqyrton fjalët e ndryshueshme, duke filluar nga emrat dhe kategoritë gramatikore të tyre, me çka për *Tri gjinitë e emrit* shënon: Tri gjininat e

emënavet. Në vazhdim jep disa shembuj për shumësin e emrave të tri gjinive, duke përdorur fjalën mbrapangjesë për prapashtesën. P.sh. “*Emënat që mbarojnë me mbrapangjesën –nin vërte marrin në shumës skajesën –i, mirëpo atëherë humbin të dytin grup-ni.* (Riza,Vepra-2:349).

Autori në këtë gramatikë shqyrton edhe problemin e pashquarsisë së emrave në gjuhën serbokroate duke përdorur termin Mosshqimi i emënavet. (Riza,Vepra-2:352). Kur jemi tek lakimi i emrave, Selman Riza ndjek kryekëput traditën ruse (Ulçar 2006:127), pra përdor 7 rasa, duke lënë anash ablativin ose rasën rrjedhore dhe duke shtuar vokativin, instrumentalin dhe lokativin. Kështu për nominativin përdor rasa emënore, për gjenitivin – rasa gjindore, për dativin – rasa dhanjore, për akuzativin – Rasa kallxore, për vokativin – rasa thirrjore, për instrumentalin – rasa mjetore dhe për lokativin përdor rasa vendore. (Riza, Vepra-2:355).

Në kapitullin e ardhshëm flet për mbiemrat (ndajemënat) duke i ndarë në ndajemëna cilësorë dhe landoro-përkatësorët. (Riza, Vepra-2:362). Për shkallët e mbiemrit përdor termin Shkallëzimi i ndajemënavet, duke i ndarë në *Komparativi dhe Superlativi* (Riza, Vepra-2:372-375).

Për përemrat përdor dy terma përemënat dhe përemënorët. Me termin e parë përkthen sintagmën “imenicke zamenice” dhe për të dytin “pridevske zamenice”. (Riza, Vepra-2:377). Në vazhdim, autori Selman Riza bën klasifikimin e termit të parë, pra përemënat i ndan në: përemrat vetorë - Përemërat vehtjorë, përemrat vetvetorë – Përemërat vetëvehtjorë dhe përemrat pyetësor – Përemënat pyetjorë .

Termin e dytë përemënorët i ndanë në përemërorët pronorë, të cilët mund të jenë *vehtjorë* dhe *vetëvehtjues*, dhe Përemënorët pyetjorë të cilët i ndanë në *pyetjori për pronarin*, *pyetjori për shembëllarin*, *pyetjori për cilësinë* dhe *pyetjori për madhësinë*. (Riza,Vepra-2:393).

Përemënat dhe përemënorët i ndan në 1. *përgjegjorë përgjithësorë*, të cilët pastaj i ndanë në *përgjegjori përgjithësues*: të përemënavet pyetjorë, i pyetjorit për shembëllarin, i pyetjorit për pronarin, i pyetjorit për cilësinë, i pyetjorit për madhësinë. (Riza,Vepra-2:401-402). 2. *përgjegjorë mirakandjorë*, të cilët pastaj i ndanë në *përgjegjori mirakandjues*: përemënavet pyetjorë, i pyetjorit për shembëllarim, i pyetjorit për pronarin, i pyetjorit për farën e cilësisë, i pyetjorit për sasinë. (Riza,Vepra-2:402-403).

Foljet, siç thekson Selman Riza si lloj i pestë i fjalëve të ndryshueshme (*ndryshueshëme*) i quan si *fjalë të zgjedhueshëme*, kurse katër llojet (emënat, ndajemënat, përemënat e përemërorët dhe numërorët) i quan fjalë të *lakueshëme*. (Riza,Vepra-2:420). Foljet ashtu si në serbokroatishte trajtohen për shkak: *vehtjeje*, *numëri*, *kohe*, *mënyre*, *gjendjes veprorë apo pësore-vetëvehtjore*, *gjinije*, *shkallës ende të pakryeme apo tashma të kryeme*. (Riza,Vepra-2:422). Foljet e pakryera dhe të kryera i quan si *folje pakryemjore* dhe *folje kryemjore*, kurse për foljet jokalimtare dhe kalimtare përdor termet *folje patejshkore* dhe *tejshkore*. (Riza, Vepra-2:426).

Autori i përshkruan edhe kohët foljore (*kohërat foljore*) duke i ndarë në folje në kohën e tashme (*veprim i tashëm*), e shkuar (*veprim i kaluem*) dhe e ardhshme (*veprim i përtardhun* – “*Sipas autorit nuk bën “ i ardhshëm”, sepse t’ardhshëm është ajo që vërtetë mund të vij, por edhe mos të vij., kurse përkundrazi të përtardhën është diçka që dasht e mos dasht ka për të ardhë.* (Riza, Vepra-2: 434).

Koha e shkuar sipas Selman Rizës ka këto forma: koha e pakryeme (e pakryera), e kryemja (e kryer), koha e partashëme (e kryera e thjeshtë), koha e parpakryeme (më se e

kryera) dhe e parkryemja (e kryera e tejshkuar). Kurse për kohën e ardhshme përdoren termet koha e përtardhun (koha e ardhshme) dhe koha e parpërtardhun (e ardhme e përparme) (Riza, Vepra-2: 435-442).

Në ndarjen tjetër titulluar si *Mënyrat foljore*, autori i *Gramatikës serbo-kroatishtes* shqyrton mënyrat e foljes duke i ndarë në: mënyra kushtore a kondicionali (Mënyra kushtore), mënyra ndënlidhjore a subjektivi (Mënyra lidhore), Mënyra pacaktore a infinitivi (Mënyra e pacaktuar), Mënyra përsjelljore a gjerundivi (Përcjellorja), Mënyra pjesëmarrjore a participi (pjesorja), Mënyra dëshirore a optativi, Mënyra habitore (Mënyra habitore). (Riza, Vepra-2: 443-461). Vlen të përmenden edhe lidhafjalët (lidhëzat) duke i ndarë në *lidhafjalët bashkërendore* dhe *lidhafjalët ndënrëndore*. (Riza, Vepra-2: 495-496).

Në pjesën e tretë të veprës sintaksa (sintaksë), autori Selman Riza jep definicione dhe klasifikime të ndryshme për fjalinë. Fjalina (fjalja) definohet si “shfaqje foljore a shprehja e një mendimi”. Në përmbyllje thekson se fjalinat e thjeshta janë tre llojesh: *logjike, gramatikore dhe gramatikoro-logjike*. (Riza, Vepra-2: 515). Më tutje bën një studim për fjalitë në çdo aspekt, duke i emëruar si: fjalina e përbame (fjalja e përbërë), pjesëfjalinat dhe llojëfjalët (pjesët e fjalisë dhe llojet e fjalëve), bashkëbanimi (kongruenca), rendi i fjalëve në një fjali dhe shenjat e pikësimit. (Riza, Vepra-2: 501-538).

Në këtë pjesë është shtuar edhe një shtojcë me titullin Kuptimi i rasave (kuptimi i rasave) ku përshkruhet rëndësia e rasave dhe lakimit të emrave nëpër rase në të dy gjuhët, duke përpunuar këto rase: nominativi, vokativi, gjenitivi, dativi, akuzativi, instrumentali dhe lokativi. (Riza, Vepra-2: 546-558).

Në pjesën e katërt Selman Riza shqyrton formimin e fjalëve duke e titulluar Etimologjia ose Ndërtimi i fjalëve të pathjeshta, duke u ndalur në fjalët e përdhuna (fjalët e prejardhura) dhe fjalët e përbame (fjalët e përbëra) (Riza, Vepra-2: 559-586).

Përfundim

Gjithçka që thamë deri tani në lidhje me konceptet terminologjike që janë përdorur nga ana e Selman Rizës me rastin e krijimit të *Gramatikës së shkurtë të serbo-kroatishtes*, mund të konkludojmë se ka përdorur shumë terma të përkthyer si kalke nga gjuha serbo-kroate, por një numër të madh të kësaj terminologjie përdoret si rezultat i neologjizmave që krijon vetë Selman Riza, qoftë nga kreativiteti, por qoftë duke u bazuar në terminologjinë e Xhuanit, Samiut dhe bashkëkohësve të vet. Në këtë fjalor, nën ndikimin e serbokroatishtes në disa raste ka ndjekur edhe terminologjinë gjuhësore ruse. Por, më 1967, pas diskutimeve profesionale rreth hartimit të Fjalorit të gjuhës shqipe, kërkonte përqendrim më të madh në këtë punë dhe jo në fjalorët rusisht-shqip.

Nuk kanë mbetur pa u shënuar edhe kontributet e tij për studimin dhe shpjegimin e një vargu çështjesh të gramatikës aktuale e historike të shqipes, të shqipes së shkruar nga autorët e hershëm dhe të kritikës gjuhësore, të ndriçimit të aspekteve të ndryshme leksiko-semantike dhe të mbjelljes së farës së studimit dhe të hartimit të gramatikave të gjuhëve të huaja me një qëndrim anticipues- kontrastiv ndër ne.

Gjithsesi në mesin e tyre "Gramatikë e serbo-kroatishtes" zë një vend të veçantë jo vetëm në studimet albanologjike, por edhe në studimet sllavistike në përgjithësi. Me këtë gramatikë, nga njëra anë hapen horizonte të reja ndaj gjuhës së Selman Rizës, kurse nga ana tjetër me ndihmën e saj ndiqet zhvillimi i mendimit filologjik shqiptar në kontekst të rilindjes shqiptare, si dhe profili filologjik i Selman Rizës. Edhe pse periudha

kur veptoi Selman Riza, i takon kohës kur ende nuk ishin standardizuar termat nga fusha e gjuhësisë dhe fusha të tjera filologjike, megjithatë nga materiali gjuhësor i përfshirë në “Gramatikën e serbo-kroatishtes” , Selman Rizën lirisht mund ta përfshimë në fillet e para të filologjisë shqiptare, duke e konsideruar edhe si themelues i studimeve krahasuese gjuhësore, i kritikës gjuhësore dhe të tekstologjisë.

VLERËSIM TË PROFESOR SELMAN RIZËS NGA BASHKËKOHËS DHE BASHKËPUNËTORE TË TIJ

Unë personalisht i përkas një brezi për të cilin përmendja e emrit Selman Riza ishte tabu. Madje, kur mendohem sot, çuditem se në atë kohë, nga mesi i viteve '80, atë as nuk e shanin (jo kritikonin). Ç'kishte ndodhur? Selman Riza ishte dënuar me heshtje. Tingëllon si e çuditshme, por në këtë rast po synoj që të zinte vend mallkimi që peshon aq rëndë në gjuhën shqipe "T'u harroftë emri sa je gjallë"

"Heshtjen e kobshme zyrtare – thuhet në monografinë e Ëngjëll Angonit "*Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*" e prishi në çastin e fundit profesor Aleks Buda, Kryetari i Akademisë. Me një fjalë të shkurtër të improvizuar i dha lamtumirën kolegut, mikut të afërt.

Pas tij, i revoltuar nga heshtja zyrtare dr. Bexhet Reso, shpërtheu: "*Ç'po ndodh kështu?! Kë po varrosim?! Nuk mund të ndahemi kështu nga Selman Riza.*

Ai nuk është vetëm një gjuhëtar në zë, por, në radhë të parë, një patriot i shquar, idealet e të cilit janë edhe sot flamur i shqiptarizmit në Kosovë".¹⁹⁹

Në atë çast- shprehet Uran Butka "... folën e qanë zemrat e mijëra shqiptarëve, që e përcollën me nderim profesorin në banesën e fundit. **Foli vetë pavdekësin.**"²⁰⁰

Dhe me të vërtetë kështu ka ndodhur e po ndodh, veprimtaria e sotme, njëra nga të shumtat që janë kryer dhe do të kryhen këtë vit përkujtimor të Selman Rizës rrëfen qartë se ai, siç edhe e parathotë miku i tij Prof. Remzi Përnaska, (më lejoni të nderuar miq ta perifrazoj) qenkej në të vërtetë jo deti, por oqeani, se "*Selman Riza ka rekordin e dhimbshëm , por njëherazi lartësues, të jetë i burgosur dhe i internuar prej tri regjimeve diktatoriale.*

Mik i tejmë i së vërtetës shkencore dhe vetëm i saj, asket i shkencës, atë nuk e ndalën dot regjimet dhe ndjekësit e tyre në rrugën e vet, të zgjedhur me vetëdijën e një mendimtari. Vdekja dhe vetëm ajo bëri atë që s'mund ta bënin njerëzit.

...Deri tani shkenca gjuhësore ka parë det, por me botimin e këtyre shënimeve, ndoshta do të shohë edhe oqean."²⁰¹

Ne të gjithë i jemi borxhlinj atij për veprën që na la, qoftë shembullin e mënyrës se si jetoi e punoi, qoftë me punën e bërë në fushë të shkencës gjuhësore. Kaq e vërtetë është për mua kjo, sa që mendoj se figura e tij nuk ka nevojë edhe aq shumë për zbulime e fanfara se sa për studim e thellim të mëtejshëm në trashëgiminë e tij shkencore. Sepse, siç do të shprehej mjeshtërisht prof. Ali Dhimoja "*Selman Riza ishte si një diamant shumëfaqësh, i cili nga çdo anë që ta kthesh, rrezaton të njëjtën ngjyrë.*

... njeriu që do të orvatej të mblidhte gjithë mendimet e S. Rizës, do t'i ngjante një foshnjeje, e cila në një ditë me shi i shtrin doçkat të mbajë shiun që bie në to."²⁰²

¹⁹⁹ E. Angoni "Selman Riza- gjuhëtar dhe atdhetar i shquar" (Monografi), Botimet Toena, Tiranë 1999, f. 83

²⁰⁰ Uran Butka , Si e kam njohur unë Selman Rizën. " Albania", 18.2.1998

²⁰¹ R. Përnaska, Një atdhetar i flaktë dhe shkencëtar i madh jokonformist, " Ilyria", New York, 411,1995

²⁰² Ali Dhimo " Ç'i la Selman Riza shkencës shqiptare", Konferenca shkencore e ASHSH-së 24.12.1993

Dhe nuk e teproj po të them se ky xeheror i tokës shqiptare të tilla vlerësime i mori qysh në fëmijëri e në rini të tij, atëherë kur ishte nxënës e më vonë mësues në liceun e këtij qyteti që ka të drejtë të krenohet edhe me këtë figurë madhështore të historisë sonë.

Ja se si shprehet **Leon Perre**, Drejtor Teknik i Liceut të Korçës, në një shkresë Zyrtare drejtuar, Ministrit të Arsimit në Tiranë: “*Selman Riza është një i ri tepër i talentuar, shumë serioz, i cili do të mundë me të njëjtën lehtësi të kryejë çdo degë të studimeve universitare, dhe unë nuk dyshoj që të mos i bëjë më vonë nder atdheut me emrin e tij*”.²⁰³

Historia tregoi se z Perre kishte të drejtë. Dhe jo shumë vite më vonë, këtë radhë Selman Riza ishte mësues në atë lice, kemi këtë vlerësim nga një tjetër drejtor, Ksavie dë Kurvil, i cili do të shkruajë: “*Me diturinë dhe shpjegimin e përkushtuar, Profesor Selman Riza bënte xhelozë jo vetëm profesorët shqiptarë, por edhe ata francezë, për shkak të mbresave të pashlyeshme që linte te nxënësit si profesor iluminist me thellësinë dhe enciklopedizmin e tij*”.²⁰⁴

E, për këtë dhe për arritje të tjera më të mëdha, në vitet që do të vijnë vetë Prof. Riza do të shprehë: “Unë nuk jam talent, por unë jam punë”!

Por jo, kjo është thënë ashtu, për modesti, siç ai shfaqej çdo herë, ai që diti të çmojë veten dhe punën e të tjerëve përreth tij.

"Gjithmon' e jetës – shprehet Profeshori- kam synue e do të synoj me kontribue, makar modestisht, në mposhtjen e kompleksit të inferioritetit të bashkëkombasvet ndaj Ballkanasvet tjerë...". Dhe kjo sipas z. Behar Gjoka, “vetëm sa lajmëton vepra dhe qëndrimet e çmuara, që do të ndërmerre dhe realizonte në jetën e tij”.²⁰⁵

Dhe, kur përmend e analizon jetën dhe arritjet e këtij kolosi të gjuhësisë sonë, Uran Butka shtron pyetjen: *Kur e pati ai atë mundësi kohore dhe atë qetësi të domosdoshme për të krijuar veprën e tij, ndërkohë që gati gjithë jetën ka qenë i privuar lirie: i internuar, i burgosur dhe i përndjekur politik?* Sepse, siç dihet, koha fizike për të ndërtuar një ngrehinë të tillë shkencore qe mjaft e pakët, për gati 11 vjet, ai shkroi gjithçka që e ka parë dhe që nuk e ka parë ende dritën e botimit.

“Kjo vepër është produkt i një gjenialiteti dhe njëherësh, i një pune jashtëzakonisht intensive ; është rezultante e një misioni e paracaktuar që ai vetë e kish ndier dhe kuptuar e këmbëngulte ta arrinte.... ky është shkaku që S. Riza i vogël, i ri apo i moshuar përpigëj të fitonte kohë, luftonte që të mos humbte asnjë çast nga jeta e tij tmerrësisht mizore.

Ai e ndiente se koha ishte kudër tij dhe për këtë brenda një harku kohor prej 6 vjetësh mbaroi shkëlqyeshëm 9 klasat e Liceut të Korçës. Po kështu, brenda këtij harku kohor, 3 vjetësh, kreu dy fakultete njëherësh. Përvetësoi rrufeshëm gjuhët kryesore të Perëndimit e të Lindjes (studiuesit e jetës së tij thonë se ai zotëronte 12 gjuhë). Studioi në mënyrë kritike e rroku tërë përvojën e vendit dhe atë të huaj në lëmë të shqipes. Ai ngutej që të fitonte kohë e ta kthente në vepra atë.

²⁰³ E. Angoni, Vep.cit. f. 91

²⁰⁴ po aty

²⁰⁵ Selman Riza, “Kalvari i dhimbjeve dhe ëndrrat e dijetarit të madh” GSh, 16. 2.09

Dhe vlerësimet, edhe në atë pak kohë, edhe për ato pak vepra që panë diell me sy, ishin nga më të lartat që do ta bënë të jetonte i qetë që pa i shkaktuar “probleme” karrierës dhe jetës së tij Sizifiane.

Desnickaja shprehet: “Disertacioni që ka paraqitur Selman Riza... hyn në radhën e punëve gramatikale në fushën e albanologjisë, që, nga njëra anë, thellojnë kuptimin shkencor të ligjeve strukturale të shqipes e, nga ana tjetër, mund të ndihmojnë për përpilimin e gramatikave shkollore në bazë shkencore.”
... të gjitha këto të japin të drejtën për ta vlerësuar disertacionin e S. Rizës si një kontribut të çmueshëm në shkencën e albanologjisë.”²⁰⁶

Këto rreshta janë nga të paktat që u shkruan (për mirë) për Prof. Rizën dhe veprën me gjallje të tij. Se ky shqiptar i madh ishte përherë “delja e zezë” për Diktaturën dhe politikën që ndiqte ajo ndaj shkencëtarëve patriotë. Të më ndjejnë dëgjuesit, por nuk mund të rri pa citur disa “vlerësime”, kështu do t’i quaja unë, të bëra në atë kohë nga ish kolegët e tij të shkollës dhe, më vonë, edhe të punës në Institut e Fakultet. Aty gjejmë urrejtjen për “reaksionarin pseudo-demokrat Selman Riza, dishepull besnik i Zoi Fundos”

Dhe informacionin (spiunllëkun): “Pranë fakultetit tonë punon i quajturi Selman Riza, i cili vitet e fundit ka ardhur nga Jugosllavia. Gjatë punës së tij këtu, ka shfaqur mendime jo të drejta mbi kuadrin e vjetër e të ri, i akuzon se nuk dinë dhe se janë të paaftë të drejtojnë punën shkencore, këto i bën në mënyrë demonstrative”, ose diku tjetër: “...punonjësi shkencor S.R. ka qenë një nga aktivistët e organizatës tradhtare të B. Kombëtar, në ngarkim të të cilit nga një trakt që është lëshuar nga partia jonë gjatë luftës, demaskon të përmendurin si eksponent dhe armik në shërbim të Ballit e të okupatorëve.

Në një leksion për albanologjinë që ish ngarkuar ta bënte, nuk ka shkruar realitetin duke i dhënë një frymë në favor të Jugosllavëve... Na ka thënë:- Selmani nuk merremi me politikë, por jemi të pavarur si shkencëtarë. Ne jemi autoritete shkencore dhe jo administrative, nuk duhet bërë propagandë për çështjet shkencore ...Studimet i ka kryer në Francë, por nuk ka asnjë dokument për fakultetin e kryer. Është tip egoist dhe e mbivlerëson veten e tij. Qysh nga prishja e marrëdhënieve me BS, ka filluar të aktivizohet duke goditur sistematikisht punonjësit e tjerë të vjetër e të rinj... Me qenë se na prish punë, do t’i propozoj KQ për ta larguar nga Instituti.”²⁰⁷

Qaq zotërinj të nderuar. Të tjerat, vlerësimet e vërteta, vijnë pas vdekjes. Autori i monografisë “S. Riza- gjuhëtar dhe atdhetar i shquar”, E. Angoni, bën publik edhe një fakt tjetër. “Sa qe gjallë asnjë shkrim vlerësues për Selman Rizën, as si gjuhëtar, pa le si atdhetar”.

“Vdis pa të të dua” - thotë një fjalë e urtë. Prandaj e duam, se vdiq? Prandaj e lavdëruam se nuk na prish më punë me karakterin e tij, siç e thotë thuktazi Martin Camaj, “...pa zhigla, origjinal në ide dhe formulim mendimi ...”²⁰⁸

Jo, zotërinj të nderuar- nuk mund të ndahemi kështu prej Selman Rizës!

Nuk mund të ndahemi pa përmendur vlerësimin e merituar që i është bërë atij vetë si njeri dhe veprës së tij. Sepse, siç shprehet z. Behar Gjoka” ... Selman Riza bën pjesë në ato të

206 E. Angoni, Vep.cit. f. 92

207 Rexhep Ismajli “Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës”, Prishtinë 2009, f. 54

208 M. Camaj, “Vdiq gjuhëtari S. Riza”, “Dielli”, 28.04.1989

*paktë burra dhe shkencëtarë të mendimit dhe të gjuhës shqipe, të kulturës dhe atdheut, që me jetën dhe veprën e larmishme i përket të dy anëve të kufirit, ... të dy "dhenave" të përndarë padrejtësisht, duke u shndërruar kështu në një urë të fortë kalimi ndërmjet shqiptarëve të dy anëve, madje një promotor përndritës i ndërlidhjes së pashqitshme të tyre ...*²⁰⁹

*"...Në historinë e albanologjisë bashkëkohëse, shprehet ish- Kryeministri i Shqipërisë z. A. Meksi, një grup studiuesish shqiptarë, ndër të cilët shquhen Eqerem Çabej, Selman Riza, Kostaq Cipo, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli, jo vetëm që e bënë atë shkencë thellësisht shqiptare por dhe orientuan për kërkime të mëtejshme të gjithë albanologët e huaj... Ndër ta një vend të veçantë zë Selman Riza... Njerëz të tillë janë të rrallë në historinë e çdo kombi dhe duhet të mbeten frymëzues për brezat."*²¹⁰

Studiuesi i mirënjohur i veprës shkencore të Selman Rizës akademiku Rexhep Ismaili, përmes parathënies shumëdimensionale, është shprehur se *vepra e Selman Rizës është produkt i një gjenialiteti dhe i një pune jashtëzakonisht intensive e të vështirë, por edhe i një luftëtari të paepur. I një luftëtari kryengritës të lirisë, të mendimit e të fjalës së lirë, të punës shkencore të lirë, të kritikës shkencore të lirë, të së vërtetës, por edhe luftëtar i pashmëbështetshëm i Kosovës, i irredentizmit kosovar, i kundërkomunizmit, i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.*

Selman Riza vdiq në vitin 1988, i lënë në heshtje dhe i harruar nga diktatura komuniste, ...por ai vdiq i ngushëlluar nga puna e vet e pandërprerë dhe nga postulati i tij jetësor: *"Kush punon për Atdhe, nuk duhet të kërkojë shpërblim"*,

Prof. Mahir Domi thotë se "Selman Riza dha ndihmesa të rëndësishme për të ngritur studimet gramatikore shqiptare në rrafshin bashkëkohor, në aspektin sinkronik dhe diakronik, duke ndihmuar në hedhjen e bazave të gramatologjisë së mirëfilltë shkencore."²¹¹ Ndërsa për Prof. Fatmir Agalliun ai ishte shkencëtar i nivelit evropian "Gjuhëtari S. Riza zë një vend më vete, qoftë me shumëllojshmërinë e krijimtarisë së tij shkencore, qoftë me nivelin teorik të saj që nuk bie më poshtë se ai i shkencës gjuhësore evropiane."²¹²

Prof. Gjovalin Shkurtaj duke u ndalur në tezën e S. Rizës për rolin ndërtues e pasurues të folësve gegë në gjuhën letrare shqipe të njësuar është i bindur se ajo " ...mbetet një tezë frymëgjatë ndaj ardhshmërisë së gjuhës shqipe të njësuar, një tezë me rëndësi madhore... një tezë pune e formuluar nga një gjuhëtar e atdhetar si ai.

Prof. Begzad Baliu kur shkruan për konceptet shkencore të E. Çabejt dhe të S. Rizës për ribotimin e " Mesharit" del në këtë përfundim:

"Ai (S. Riza) është pionieri i monografisë gjuhësore në fushën e shqipes. Kështu, Eqerem Çabej mes bashkëkohësve do të bëhet ideali i gjuhësisë shqiptare, ndërsa Selman Riza kritiku i saj. Unë besoj se sot do të kuptohem drejt nëse konstatoj se në gjuhësinë

²⁰⁹ Behar Gjoka, " Selman Riza, dritë mbi letërsinë e vjetër shqipe". "Albania", 15.09.2009

²¹⁰ A. Meksi " Me Profesor Selman Rizën , njeriu- vepra", GSH, 15.09.2009

²¹¹ Mahir Domi, "Prof. Selman riza- studiues i shquar i gjuhës shqipe", "Drita", 25.12.1998

²¹² F. Agalli, "Mbi disa ndihmesa të prof. Selman Rizës në përpunimin e teorisë gjuhësore te ne.", " Rilindja", Tiranë, 1.9.1995

shqiptare aty ku mbaron shkolla historike e Eqrem Çabejt, fillon shkolla kritike e Selman Rizës.”²¹³

*“Nga jeta dhe vepra e tij në Shqipëri – shkruan Prof. Koli Xoxi – shumë mund të mësojnë, që nga mësuesi më i thjeshtë deri te shkencëtari këmbëngulës.”*²¹⁴

Po e mbyll këtë paraqitje të vlerësimeve për figurën e S. Rizës me fjalët e Prof. Sh. Demirajt : *“ Po të analizohet me kujdes jeta dhe puna e S. Rizës... nuk mund të mos vësh re se shtysa kryesore, që e vinte në lëvizje këtë zell të jashtëzakonshëm dhe zgjuarsis të rrallë, ishte dëshira e zjarhtë për t’u bërë sa më i vlefshëm për popullin e tij. Natyrisht kjo ishte e pandashme nga dashuria e tij për lirinë dhe ndershmërinë.”*²¹⁵

p.s. *Së fundi, do të doja të më ndjenin e të më mirëkuptonin edhe studiues dhe miq të tjerë që janë shprehur me konsideratat më të larta për veprën dhe jetën e e Prof. Rizës, por që për arsye të logjikës së shkrimit nuk janë cituar në këtë kumtesë.*

Si të tillë do të përmendja : Prof. B. Becin, Prof. R. Memushajn, Prof. Mehmet Çelikun, Prof. A. Dodin, Prof. Fadil Rakën, Prof. Irena Saëickan, Prof. Bujar Hoxhën , Prof. S. Mansakun e të tjerë.

Faleminderit!

²¹³ Begzad Baliu: “ Rreth koncepteve shkencore të Eqrem Çabejt dhe të Selman Rizës për ribotimin e "Mesharit" të Gjon Buzukut”, Prishtinë , “Gjuha shqipe” , IAP, nr. 2/2005

²¹⁴ Koli Xoxi, si e kam njohur profesor Selman Rizën, “ Rilindja Demokratike”, 9.1.1999

²¹⁵ Shaban Demiraj, Për veprimtarinë shkencore të prof. Selman Rizës. “ Gjuha jonë”, Tiranë, 1-4/1994

NDIHMESA E PROFESOR SELMAN RIZËS NË FUSHËN E TERMINOLOGJISË SË GRAMATIKËS

Sipas vlerësimit që i kishte bërë vetes rreth moshës 70-veçare²¹⁶, pra në kohën kur tashmë ishte në gjendje të bënte bilance, dy kanë qenë pasionet e mëdha të S. Rizës në jetën e tij: Gramatika dhe Kosova, d.m.th. shkenca, dija dhe atdhetaria. Ai tërë jetën ia kushtoi këtyre dy pasioneve. Sistemin gramatikor të shqipes e studioi me kompetencë të lartë shkencore. Brenda studimeve një vend të dukshëm zë interesimi për terminologjinë. Duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e terminologjisë në përgjithësi, dhe të terminografisë në veçanti, Riza më 1955, derisa ishte në krye të Seksionit Gjuhësor të Institutit Albanologjik, mori nismën për botimin e një Fjalori terminologjik shqip-serbisht-frëngjisht, që ka mbetur dorëshkrim. Teksti i paraparë për parathënie të Fjalorit me titull "Për plotësimin dhe qëndrueshëmimin të terminologjisë shqipe", i botuar për herë të parë nga ASHAK-ja, në vitin 2004, ndryshe nga përmbajtja e vetë fjalorit, është i një rëndësie të veçantë, sepse përmes saj shpalosen pikëpamjet e shëndosha shkencore të Rizës për terminologjinë. Të rikujtojmë që pikërisht këtë vit (1955) u themelua Sektori i Terminologjisë në Tiranë i cili do të nxirrte serinë e Fjalorëve terminologjikë më 1963, pra 8 vjet pas nismës së Rizës.

Në fillim të këtij teksti, Riza thotë se me këtë shkrim "...ne nuk kemi synue që terminologjinë shqipe ta krijojmë zanafilli. Përkundrazi, qëllimi i ynë ka qenë me kontribuue në qëndrueshëmimin e të gjitha atyne termave që vërte egzistojnë në gjuhën shqipe por që sidomos ndër ne janë ende sod e kësaj dite të panjësueme."²¹⁷ Të panjësueme(term që përdoret edhe sot) i konsideron termat me më shumë se një variant që për autorin "kjo shumësi, larg së përbami ndonji pasuni gjuhësore të vërtetë, përkundrazi shkakton vetëm pështjellim në të kuptuem, pengesë në marrëveshje ..." dhe merr si shembull termat e gramatikës *astjetër* dhe *ftillk*, të cilët "janë për t'u shporrë jo soll prej terminologjisë gramatikore, por edhe prej vetë fjalorit bashkëkohuer të gjuhës shqipe", kurse për termat *mbiemën* dhe *pyetës* thotë se mund të ruhen, ndonëse i qorton duke propozuar termat përkatës *ndajemën* dhe *pyetjuer* me arsytimin se mbiemër do të thotë "llagap" kurse *pyetës* do të thotë "njeri që pyet"²¹⁸. Riza nuk është kundër ndërkombëtarizmave, por thekson se shpesh është vështirë të përcaktohet ndërkombëtarësia e një fjale, sepse edhe fjalët e tilla nuk janë të paprekshme. Me këtë rast jep shembullin e fjalëve ndërkombëtare: *koncept*, *objekt*, *pasion* që janë përkthyer në gjuhët si gjermanishtja dhe serbokroatishtja përkatësisht: *Begriff*, *Gegenstand*, *Feidenschaft*; *pojam*, *predmet*, *strast*. Prandaj propozon: "Duhet papritueshëm me shqyrtue çdo rast konkret për të pa nëse një e kështuquejtun ndërkombëtare asht e papërkthyeshme në shqipe"²¹⁹. Natyrisht, ai kërkon përkrahjen e kolegëve të tij për të kryer me sukses këtë punë. Duke mbrojtur me ngulm luftën kundër fjalëve të huaja dhe

²¹⁶ Rexhep Ismajli, Pasionet dhe pësimete Selman Rizëz, ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 48

²¹⁷ Selman Riza, Për plotësimin dhe qëndrueshëmimin të terminologjisë shqipe, tekst i paraparë për parathënie të Fjalorit terminologjik shqip-serbisht-frangjisht, hartuar nga S. Riza e M. Bardhi më 1955, (dorëshkrim), Vepra 4, ASHAK, Prishtinë, 2004, f.157

²¹⁸ Po aty, f. 157

²¹⁹ Po aty, f. 160

zëvendësimin e tyre me neologjizma, ai mendon se mbron shqipen nga shterpësia: ”Tani, me denue parimisht çdo orvajtje që me elemente foljorë të gjuhës shqipe të ndërtojmë shqiptarizma të pathjeshtë(sot: fjalë jo të parme), e me parpëlqye me çdo kusht të kështuqjuntunat fjalë ndërkombëtare tani po thomi me veprue kështu asht nja si me dashtë njëherë me lanë djerrë e mandej me shterpëzue fare mundësinat që ka gjuha shqipe me u pasunue së mbrendshmi dmth. me plotësue të metat e veta me mjetet e veta”.²²⁰ Pikëpamjet e Rizës edhe sot e kësaj dite janë me mbështetje shkencore dhe nuk janë vjetëruar. Pra, ai nuk është purist i përbetuar, sepse pranon shtresën e ndërkombëtarizmave, sidomos në terminologji, por nuk i konsideron të paprekshëm.

Riza dallohet nga gjuhëtarët e tjerë, sepse, përveç që ka krijuar terma, ai është marrë edhe me përmbajtjen konceptore të tyre, sidomos ka diskutuar për termat që i ka gjetur të papërshtatshëm duke argumentuar qëndrimin e vet. Në këtë referim do të merremi me disa nga këta terma. Gjithashtu do të flasim për disa terma që dallohen për përmbajtjen konceptore të tyre.

Është për t’u theksuar para së gjithash se S. Riza²²¹ ka përdorur termin *gramatografi* dhe *gramatograf*, i pari për të emërtuar tërësinë e teksteve të gramatikës dhe i dyti për hartuesin e gramatikës, terma që nuk i gjejmë gjetiu në letërsinë tonë gjuhësore, por që sipas nesh janë të qëlluar dhe të krahasueshëm me termat *terminografi* dhe *terminograf* që në terminologjinë bashkëkohore, qoftë vendëse, qoftë jovendëse tashmë kanë zënë vendin e duhur. Së këndejmi, sipas nesh termat *gramatograf* dhe *gramatikan* nuk kanë përmbajtje të njëjtë konceptore. Gramatikan mund të quhet ai që merret me gramatikë, kurse gramatograf mund të quhet gramatikani që harton gramatikë.

Për të parë ndihmesën e prof. S. Rizës për terminologjinë gjuhësore kemi marrë në shqyrtim kryesisht dy veprat e tij: 1.Gramatikën e serbokroatishtes dhe 2. Monografinë mbi sistemin foljor të shqipes²²².

Në Gramatikën e serbokroatishtes, të shkruar në gjuhën shqipe, gjejmë shumë terma të krijuar prej tij. Aty kryesisht (jo gjithëherë) së pari është dhënë termi shqip, pastaj ai i huazuar (me prejardhje latine) dhe së fundi termi serbisht. Ka raste kur mungon termi shqip, por përdoret vetëm termi i huazuar b.f *komparativi*, *superlativi*, ose *determinat i predikativit*, por ka raste kur përdoret termi shqip dhe termi serbisht, pa termin e huazuar si: *përsjellorja e tashëme* dhe *glagolski prilog sadašnji*. Riza i ka krijuar termat shqip kryesisht përmes kalkimit dhe ata u përkasin fushave si morfologjia, sintaksa dhe etimologjia ose ndërtimi i fjalëve (sot fjalëformimi). Numri i termave të krijuar prej tij është relativisht i madh²²³.

²²⁰ Po aty, f. 161

²²¹ S. Riza, Vepra IV, Prishtinë, 2004, f.177 (7.VII. 1966)

²²² S.Riza, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, ASHAK, Vepra 2, Prishtinë, 1997

²²³ Këtu po i radhisim një numër të tyre (brenda kllapave po japim termin e sotëm), për të cilët mendojmë se janë krijime të tij, ose janë terma të modifikuar: emën përbashkqëm (i përgjithshëm), skajesë (mbaresë), skajesë lakore (mbaresë rasore), skajesë zgjedhore (mbaresë vetore), rasa mjetore (instrumentali), ndajemëni (mbiemri), emënisht (i emërzuar), komparativi i ultorësisë dhe i eprorësisë (shkalla krahasore e ultësisë dhe e epërsisë), folje ndihjore (folje ndihmëse), folje patejshkore (folje jokalimtare), folje tejshkore (folje kalimtare), koha e përtardhun (koha e ardhme), k. e parpërtardhun(k. e ardhme e përparme), k. e

Një burim tjetër për terminologjinë gramatikore, shumë i rëndësishëm dhe me interes të veçantë shkencor për ne ka qenë monografia e Rizës mbi sistemin foljor. Në vitin 1966 Riza kishte shkruar një punim të gjatë monografik (edhe pse ai nuk e quan monografi të mirëfilltë, por, një tekst sintetik) për foljet me rreth 300 faqe, i cili, siç mësojmë nga parathënia e botimit të Tiranës²²⁴, “ishte paraparë të botohej në vitin 1967, por ajo nuk u botua në atë kohë, sepse autori i saj, për shkak të bindjeve të tij, u përndoq dhe u transferua në Berat” Vepra u botua nga ASHRSH-ja në Tiranë, më 1994 dhe nga ASHAK-ja, në Prishtinë më 1997. Trajtimi i foljes dallon cilësisht nga ai që kishte bërë shumë vjet më parë (vitet ’50) në Gramatikën e serbokroatishtes, natyrisht edhe terminologjia është më e pasur dhe më e saktë.

Së pari do të shyrtojmë terminologjinë e strukturës së fjalës me termat: *formë e një fjale* (sot: *fjalëforma*); *morfema bazale* (sot: *morfema rrënjore*), “e cila çfaq kuptimin leksikor” dhe *morfema jo-bazale* (sot: *morfemat ndajshesore*) që mund të jetë: *fjalëndërtuese* (sot: *fjalëformuese*) dhe *formëndërtuese* (sot: *formëformuese*, *trajtëformuese*). Riza thotë se për termin e tij *morfemë jo-bazale* do të përdorte edhe termin e Brugmanit *formant*, kurse për termin *morfemë bazale* termin tradicional *temë*, ndërkohë që termin *rrënjë* nuk e parapëlqen sepse “koncepti përkatës është simbas nesh i tepërt e madje i huaj për trajtimin shkencor të çdo sistemi morfologjik”²²⁵. Në terminologjinë e sotme mbi strukturën morfologjike të fjalës²²⁶ tashmë janë përcaktuar qartë emërtimet për shumë koncepte, duke përfshirë edhe konceptet “temë e parme” që përkon me *rrënjën e fjalës* dhe “temë jo e parme” që përbëhet nga *rrënja* dhe *formanti fjalëformues*. Gjithashtu Riza, ka bërë dallimin midis koncepteve-termave *dekompozimi mekanik* (sot: *analiza morfemore*) dhe *analiza gjenetike* (sot: *analiza fjalëformuese*). Ai kritikon autorët e gramatikave që përdorin termin *prapashtim* në vend të termit *mbaresë* duke thënë se “prapashtimet (sot: *prapashtesat*) shërbejnë për të krijuar jo forma fjalësh, por fjalë të pathjeshta” (sot: *fjalë jo të parme*). Krahasuar me gjuhëtarët e tjerë shqiptarë të kohës së tij, Riza ka pasur njohuri të gjera, prandaj edhe ka paraqitur të dhëna të bollshme mbi strukturën e fjalës, të krahasueshme me po ato që qarkullonin edhe gjetiu deri në vitet ’60 të shek. XX. Ai kishte njohuri mbi shumë koncepte të strukturës së fjalës që përgjithësisht përkojnë me konceptet e sotme (madje e njëjte edhe konceptin e *alomorfit*, ndonëse nuk e emërtonte me këtë term). Megjithkëtë, terminologjia e tij nuk përkon plotësisht me terminologjinë e strukturës së fjalës që përdoret sot.

Siç theksuam më lart, Riza shquhet për qëndrimin kritik ndaj gjuhëtarëve të tjerë, qofshin ata të huaj ose shqiptarë lidhur me çështjet gjuhësore, madje si askush më parë

partashme (k. e kryer, koha e parkryeme (k. e kryer e tejshkuar), koha e parpakryeme (k. më se e kryer), mënyrë kushtësore, m. ndënlidhjore (lidhore), m. pacaktore (paskajorja), m. pjesëmarrjore (pjesorja), lidhfjala (lidhëza), lidhfjalët shpalljore (lidhëza ftilluese), kryefjali (fjali kryesore, pjesëfjalina (gjymtyrë), i përtukallxuem i a ndënana (kryefjala), kundranë (kundrinë), ana (kallëzuesi i fjalisë gramatikore), bashkëzanimi (përshtatja, bashkëpërkimi), ndërtimi i fjalëve të pathjeshta (fjalëformimi), fjalë të thjeshta (fjalë të parme), fjalë të pathjeshta (fjalë jo të parme), trajtëfjalë, për të cilën Murati²²³ ka mendim të gabuar (fjalëforma), rrënjori (tema), fjalët e përdardhuna (fjalë të prejardhura), mbrapangjesë (prapashtesë), parangjesë (parashtesë).

²²⁴ S. Riza, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, ASHRSH, 1994, f. 3

²²⁵ Sistemi foljor..., f.104

²²⁶ ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 43-58

merret edhe me terminologjinë gramatikore. Në këtë kumtesë kemi paraqitur disa terma, të cilët i kritikon duke dhënë arsyetimin me fakte shkencore dhe duke propozuar njëkohësisht termin që sipas tij është më i përshtatshëm.

Për mbiemrin Riza përdor termin *ndajemën*, një term i papërsëritur në traditën tonë gramatografike. Arsyet pse duhet përdorur këtë term: “Meqenëse çkah asht “ndajfolja” për foljen, ata asht edhe “mbiemëni” për emnin, për këte arsye: njana dysh: ja *ndajfolje* dhe *ndajemën*, ja *mbifolje* dhe *mbiemën*. Mirëpo meqenëse a) “mbiemën” ka marrë kuptimin llagap; b) “ndajfolje” ka hy tashma në përdorje dhe c) gjegjësjashtë e latinizmit ad. në adverb nuk asht “mbi”, por “ndaj”; për këto arsye: jo *mbifolje* dhe *mbiemën*, por *ndajfolje* dhe *ndajemën*. Zaten Latinët “adjektivin” quanjin edhe “adnomen”²²⁷ Riza përdor edhe termin e huazuar *adjektiv*, por vetëm kur jep përkufizimin.

Për *pjesoren e nyjzuar*, të cilën disa autorë gramatikash e trajtojnë në kapitullin e foljes, pra e trajtojnë si folje e jo si mbiemër, ai thotë: “Simbas nesh, në gjuhën shqipe, sintaksa e *pjesores së partashme* –si rregull shërben vetëm si komponente (me kuptim thjeshtë leksikor) e *trajtave foljore të pathjeshta* (sot: *kohët e përbëra*) e për pasojë këjo sintaksë e saj si rregull është vetëm foljore. Jashtë këtyre trajtave, pjesorja e partashme – si rregull pushon së qeni foljore për t’u kthyer në një pjesore plotësisht të adjektivuar; sepse të pajosur me *paranyjëzim*²²⁸ adjektivues e të nënshtruar përkimit gjiniro-numëror të mbiemrave të mirëfilltë edhe atëherë kur ajo bashkëbart plotës rrethanorë pikërisht foljesh.”

Riza dallon *adjektivimin*, siç e quan ai vetëm funksional të pjesores nga ai formal, i cili sipas tij²²⁹ “nuk do të përbënte kurrfarë çrregullsie në shqipen e sotme letrare madje... adjektivimi vetëm funksional i pjesores mund të jetë i parpëlqyeshëm ndaj adjektivimit të saj edhe formal (kupto pjesore e nyjzuar); shembulli: ...vështirësitë e tyre, shkaktuar nga lufta...”) Por ka vërejtur se “në bashkëbartje të një *kundrane të zhdrejtë* adjektivimi vetëm funksional i pjesores është simbas nesh i vetmi i rregullt (shembulli: Sesioni shkencor kushtuar 20-vjetorit të çlirimit...), prandaj kritikon gramatikën (të Kristoforidhit dhe të Samiut) që e trajtojnë pjesoren e paranyjzuar, pra të mbiemëruar brenda sistemit foljor, të ndikuar sigurisht nga greqishtja dhe latinishtja, gjuhë këto që njohin pjesoren e tashme, përkundrazi shqipja njeh vetëm pjesoren e kryer, të cilën Riza e quan *pjesore e partashme*.

Foljet funksionalisht të pavetëmjaftueshme (sot: *folje me kuptim të zbehur leksikor*) sipas Rizës paraqiten në gjuhë të ndryshme me inventar të ndryshëm, dhe sidomos me terminologji të ndryshme në gramatografi të ndryshme. Kështu, ai jep termat, me të cilët emërtohen këto folje në gjermanisht: *folje ndihmëse mënyrore* nga E. Jung; në rusisht: *çfaqëse të mënyrorësisë*; në frëngjisht: *ndihmëse sekundare* (të rastit) nga Dauzat dhe *folje gjymsë-ndihmëse* nga Fjalori terminologjik gjuhësor i Maruzos.. Të tilla për shqipen Riza i konsideron foljet dua, mund dhe duhet, prej të cilave mund dhe

²²⁷ S. Riza, Gramatika ..., f. 44

²²⁸ Ky term, si duket neologjizëm i krijuar nga Riza, përdoret edhe sot si mënyrë e fjalëformimit për mbiemrat prejpjesorë dhe emrat foljorë asnjansës (F.Ç.)

²²⁹ S. Riza, Sistemi foljor... f.152

duhet trajtohen si të tilla (nuk janë vetëm këto) në Gramatikën e Akademisë²³⁰, ndërkohë që dua del si e tillë në Gramatikën praktike të Çelikut²³¹. Është e vërtetë ajo që thotë Riza për këto folje dhe që e parashtron në pikën b: “Në sintaksë kallëzuesit e ndërtuar me këto folje janë të pavetëmjaftueshëm”, por ndryshe nga GA-ja ku këto folje ndërtojnë *kallëzuesin foljor të përbërë*, Riza thotë: “...secila prej këtyre foljeve plotësohet nga një *fjali e mvarur*, e cila kundrejt foljes së plotësuar luan rolin e *kundrinës së drejtë* prkt. të kryefjalës”²³².

Riza e gjen të kritikueshëm për këto folje termin *folje ndihmëse mënyrore* sepse: “te shembujt: dua, mund, duhet etj. -të shetitë...këto folje as nuk janë ndihmëse të foljes shëtitur as nuk çfaqin ndonjë mënyrë zhvillimi të kësaj së fundit...duke shtuar se... mënyrën e veprimit të kësaj foljeje mund të shprehin ndajfoljet si: unë dua të shetitë ngadalë, rehatshëm, parrezikshmërisht, etj”. Duke u nisur nga fakti se foljet e tilla nuk shfaqin vullnetin, aftësinë, nevojën etj. për vetvete dhe në vetvete, por në lidhje e për pasojë pikërisht në marrëdhënie me një fenomen të dytë, Riza kujton që ato(foljet) “janë për t’u tejkonceptuar dhe tejpagëzuar”²³³ pra, Riza kërkon që të ndryshojë përmbajtja konceptore, por edhe termi për këto folje. Prandaj propozon termin *folje të pavetëmjaftueshme marrëdhënore*.

Në grupin e *foljeve të pavetëmjaftueshme* ai fut edhe *foljet ndihmëse aspektive* për të cilat gjithashtu propozon termin e vet *folje të pavetëmjaftueshme fazore*, të cilat “çfaqin secila nga një etapë a fazë të procesit zhvillimor të një fenomeni...”²³⁴. Termin *fazore* e arsyeton me faktin se latinizmi *aspectus*, si term shkencor, është kalk i greqishtes *phasis* (shqip: fazis) që shënon çdonjërin nga dukjet e ndryshme a pamjet e njëmbasnjëshme, nëpër të cilat përshkohet procesi zhvillor i një fenomeni të vetëm... Në shembullin e dhënë prej tij: “Edhe në këtë fjalim të tij oratori i ynë filloi së trajtuari një temë, vazhdoi së trajtuari një temë tjetër, dhe mbaroi së trajtuari një temë të tretë pa ndonjë lidhje midis tyre” ne gjejmë një ndryshim në krahasim me trajtimin e sotëm që u bëhet foljeve të tilla në Gramatikën e Akademisë dhe gjetiu, të cilat madje edhe emërtohen me një term tjetër nga ai që kishte propozuar Riza, si edhe nga pikëpamja e gjymtyrës që vjen pas këtyre foljeve, të cilat, vetëm në “fazën e fundit” ndiqen nga një emër prejfoljor në rasën rrjedhore të pashquar të tipit *së vepruari*, ndërkohë që “faza e parë” dhe “faza e dytë” ndiqen nga folja kryesore në mënyrën lidhore, pra filloi të trajtojë ose të trajtonte dhe vazhdoi të trajtonte dhe vetëm faza e tretë mbaroi së trajtuari.

Foljet me kuptim leksikor të shlyer (sot: *me kuptim të humbur leksikor*) duke theksuar se shqipja dhe jo vetëm ajo “disa nga shkallët e kohës së kaluar të një foljeje, përveçse me morfemën përkatëse të foljes së zgjedhurar (kupto: *me mbaresa vetore*) çfaqen njëherazi edhe me nga një trajtë të plotë të një foljeje tjetër”²³⁵. Foljet ndihmëse kam e jam paraqiten të tilla “në shërbimin e tyre sekondar...anasjelltas të njëjtat folje kuptimin e tyre leksikor e kanë ruajtur të padobësuar në shërbimin e tyre origjinar “ dhe

²³⁰ Gramatika e Akademisë, f. 261

²³¹ M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1999, f.

²³² Sistemi foljor...f.89

²³³ Po aty, f. 90

²³⁴ Po aty, f. 91

²³⁵ Po aty, f.92

këtë e ilustron me faktin se folja jam zgjedhohet me ndihmën e foljes kam: kam qenë, kurse folja kam me ndihmën e vetvehtes: kam pasur. Riza ka theksuar se folja kam përveç me kuptim leksikor të ruajtur dhe me kuptim leksikor të shlyer “mund të përdoret si *folje e pavetëmjaftueshme e marrëdhënies së detyrimit të ardhshëm*: kam për të folur edhe unë”, prandaj e sheh të gabuar barazimin e këtij konstrukti me të ardhmen të tipit do të flas. Me po të njëjtin kuptim mund të përdoret edhe folja jam: je për t’u kritikuar që është i barazvlefshëm me: duhet të të kritikojnë. Një përdorim i tillë i foljes kam dhe jam del edhe në GA duke u klasifikuar në grupin e foljeve gjysmëndihmëse modale.

Për foljet tejvajtëse-jotevajtëse Riza shprehet kështu: “... jo të gjitha foljet marrin *plotës kundranorë a kundrana*. Plotës kundranorë a kundrana mund të marrin vetëm foljet e njërit nga 7 tipet leksikore të kësaj *pjese të ligjëratës*; e pikërisht vetëm foljet e atyre veprimeve, të cilët ushtrohen mbi sende kundranë” dhe vazhdon: “E meqë të ushtruarit (qoftë zhdrejtazi, qoftë drejtazi të këtyre veprimeve parafytyrohet si një kalim a tejvajtje e tyre nga sendet *ndënanë* tek sendet *kundranë*, për këtë arsye foljet përkatëse quhet *tranzitive a tejvajtëse*(qoftë të *zhdrejta*, qoftë të *drejta*); kurse foljet e atyre veprimeve, të cilët nuk ushtrohen dot mbi sende kundranë quhen *intransitive a jotevajtëse*. Këta terma i quan ”më pak të papërshtatshëm se termat *kalimtare-moskalimtare*”²³⁶. Siç shihet, Riza tashmë kishte hequr dorë nga termat e vet *tejshkore* *patejshkore* që i kishte përdorur në Gramatikë.

Mënyra kumtore Për mënyrën dëftore parapëlqen dhe propozon termin *mënyrë kumtore*. Këtë e argumenton me faktin se në asnjë gramatografi nuk janë paralele (kupto: në emërtim:F.Ç.) “përemri dëftor” me “mënyrën dëftore”, por kanë emërtime të ndryshme (i referohet greqishtes, latinishtes dhe gjermanishtes). Edhe termat e Xhuvanit *përemër dëftor* dhe *mënyrë dëftore* janë kalkuar nga italishtja, ku fjalët *dimostrativo* dhe *indikative* janë sinonime të pjesshme, nuk janë e njëjta fjalë. Prandaj përfundimisht mendon se duhet hequr dorë nga termi *dëftore* në të mirë të termit të Samiut *e preme*, ose të termit të vet *kumtore*. Një fakt tjetër për riemërtimin e kësaj mënyre e shpreh me këto fjalë: ”Prandaj edhe riemërtimi (i rekomanduar prej nesh) i mënyrës dëftore si mënyrë kumtore ka vlerën e treguesit të rrethanës se folja e mënyrës dëftore është gjymtyrë e një fjalie me karakter pikërisht kumtues”²³⁷.

Mënyra dëftore-mënyra jodëftore Sipas analogjive dhe divergjencave që kanë shtatë mënyrat vehtiore (Riza ndryshe nga Gramatika e serbokroatishtes ku pranon gjashtë mënyra tani shton edhe *mënyrën lidhore-habitore* si mënyrë të shtatë: F.Ç.) ndahen në dy grupe të mëdha. Grupit të parë i takon mënyra dëftore, ndërsa grupit të dytë të gjitha mënyrat e tjera, të cilat Riza i emërtin me termin *mënyra jo-dëftore* dhe i trajton me një, siç thotë edhe vetë:” rradhitje (sot radhitje) pjesërisht të re”: *mënyra habitore, kushtorja, lidhorja, dëshirorja, lidhore-habitorja* dhe *urdhërorja*. *Habitorja* dhe *kushtorja* përbëjnë sipas tij²³⁸ ”një si hallkë lidhjeje të dëftores me 4 mënyrë vehtiore jo-dëftore” sepse për gjuhëtarët janë paraqitur si problemore.

²³⁶ Po aty, f. 94

²³⁷ Po aty, f.133

²³⁸ Po aty, f.129

Kategorinë e kohës Riza e trajton pas kategorisë së mënyrës, diçka e pazakonshme në gramatografinë tonë, por edhe në atë të huaj.

Kohë e përtardhun Riza ka kritikuar termin e Xhuvanit *i ardhshëm* (term që i ka mbijetuar kohës) duke e quajtur xhuvanizëm, sepse kujton se është formuar prej tij, për arsye se” t’ ardhshëm asht çkah vërte mund të vijë por edhe mund të mos vijë, kurse përkundrazi *të përtardhun* asht çkah dashtë e pa dashtë ka për t’ardhë”. Po aty ai kritikon edhe termin *i pritmi*.²³⁹

Për të tashmen dallon *të tashëmen e shlrë* (ti lexon) dhe *të tashëmen e ngushtë* (ti po lexon; ti je kah lexon; ti je tue lexue; ti je në të lexuem e sipër). Koncepti mbi këto dy forma të së tashmes nuk ka qenë i panjohur për gramatikanët para Rizës, por ato nuk janë emërtuar me terma përkatës, madje as në GA. Gramatika Praktike e Çelikut²⁴⁰ ka emërtimet *e tashme e pacaktuar* dhe *e tashme e caktuar*. Me po këta përcaktorë shoqërohet edhe *koha e pakryer*.

Kundranë –ndënanë Sipas Rizës²⁴¹ termi *kundrinë* që është formim i Xhuvanit ndaj termit *kundranë* që është term i veti. Janë tri arsye pse duhet përdorur termi *kundranë*: 1) ...korelacioni nocional duhet të pasqyrohet në elementin prapashtesor. Prandaj ja: rrethinë/kundrinë, ja rrethanë/kundranë; 2) Termin *rrethinë* është vetëm i gjeografisë, prandaj edhe termini *kundrinë* është për t’u specializuar në kuptimin po gjeografik... 3) Në të mirë të terminit *kundranë* do të fliste edhe mundësia për të ndërtuar bashkëpalësin e tij nocional (sot marrëdhënie konceptore bashkëplotësuese²⁴²) *kundranë/ndënanë*, ngjashëm me greqishten: *antikeimenon/bykeimenon*, serbokroatisht: *predmet/podmet*...mundësi kjo që nuk ekziston për terminin *kundrinë*...”

Krejt në fund do t’ju lutja të më lejoni që të lexoj atë që ka thënë akademik B. Bokshi në intervistën dhënë një gazete²⁴³ me rastin e përrimit të veprave të S. Rizës: “... janë ekspozitë e qëndrueshme e shkëlqimit të mendimit shkencor ndër ne, një shkallë krenuese në të cilën arriti gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Profili shkencor i Rizës është i veçantë për gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave, për mënyrën gjithnjë rogorozisht logjike të zbërthimeve analitike, për konsideratën gjithnjë të pranishme ndaj koherencës së elementeve gjuhësore, për mënyrën e trajtimit të sinkronisë së shqipes në sqarimet diakronike të relikteve gjuhësore, për arsyetimet gjithëpërfshirëse, për metagjuhën saktësisht identifikuese, dhe për tehun e mbrehtë të kritikës ndaj pseudoshkencës.”

²³⁹ Po aty, f.116

²⁴⁰ M. Çeliku...Gramatika praktike...f.

²⁴¹ Sistemi foljor...f. 94

²⁴² F. Çitaku, Termet e gramatikës në rrafshin konceptor, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr.27/1, Prishtinë, 2008, f.143-144

²⁴³ Koha ditore, 20 dhjetor, 2008

Përfundimi

Riza dallohet nga gjuhëtarët e tjerë për përgatitjen teorike edhe në fushën e terminologjisë në përgjithësi dhe të terminologjisë gjuhësore në veçanti. Pikëpamjet e tij për terminologjinë, sidomos rreth ndërkombëtarizmave, të paraqitura në parathënien e Fjalorit terminologjik shqip-frëngjisht-serbisht, i cili mbeti dorëshkrim, nuk janë tejkaluar edhe sot e kësaj dite. Për këtë kumtesë janë marrë në shqyrtim termat e dy veprave të tij: Gramatika e serbo-kroatishtes (1952) dhe Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore (i përgatitur për botim më 1967). Riza ka diskutuar për termat e caktuar të traditës gramatografike, saherë që i ka gjetur të pasaktë ose të papërshtatshëm, duke kritikuar në të vërtetë autorin e tyre. Në këtë kumtesë kemi marrë në shqyrtim disa nga termat e tillë, si: *mbiemër*, *kundrinë*, *mënyrë dëftore*, *kohë e ardhshme*, etj. Gjithashtu jemi marrë me përmbajtjen konceptore të disa termave ndërkombëtarë ose të termave që i ka krijuar ai si: *morfema bazale*, *morfema jobazale*, *morfema formëndërtuese*, *morfema fjalëndërtuese*, *dekompozimi mekani*, *analiza gjenetike*, *foljet funksionalisht të pavetëmjaftueshme*, *folje të pavetëmjaftueshme fazore*, *foljet me kuptim leksikor të shlyer*, *foljet tejvajtëse-jotejvajtëse*, *e tashëmja e shlyrë* (ti lexon) dhe *e tashëmja e ngushtë* (ti po lexon), *kundranë-ndënanë*, *plotës kundranor*, *kohë e përtardhun*, etj. të cilët nuk përkojnë me termat e sotëm. Shumë nga termat e Rizës për emërtimin ose riemërtimin e koncepteve të ndryshme gramatikore, ndonëse nuk ishin të panjohura nga qarqet e ngushta shkencore, ata nuk e fituan “të drejtën e qytetarisë”, sepse veprat e tij nuk botoheshin. “Gramatika e serbokroatishtes” nuk u ribotua në Shqipëri, ndërsa “Sistemi foljor...” nuk u botua deri në vitin 1994. Një arsye tjetër mund të gjendet edhe te kritika me gjuhë të ashpër që u drejtonte disa kolegëve (të traditës dhe bashkëkohës), të cilët tashmë gëzonin prestigjin e gjuhëtarëve të mëdhenj. Sidoqoftë, arsyet ishin të natyrës jashtëgjuhësore.

STUDIMET E SELMAN RIZËS PËR NYJËN E GJUHËS SHQIPE

“Nyja është një fjalëz me të drejtë një element gjuhësor që shoqëron një emër të përgjithshëm, për të treguar se këtu ky emër nuk po përdoret për të përfaqësuar mbarë klasën përkatëse si një tip abstrakt të vetëm, por përkundrazi po përdoret për të përfaqësuar drejtpërdrejtë ekzemplarët konkret (...) nyja e pacaktuar absolute dhe relative”.²⁴⁴

Sistemi i nyjave të shqipes është njëri ndër me i ndërlikuari nga gjuhët indoevropiane. Studimi i nyjës së shqipes bashkëkohore është akoma një fenomen i kompleksuar. Kjo dukuri në aspektin historik të saj ka mjaft zbrazëtira për të ditur origjinën e saj. Autori (prof. Selman Riza) me të drejtë e ka menduar se nyjat e shqipes janë të shquara (apo të caktuara) dhe të pashquara (të pacaktuara).

“Formimi i fjalëve të reja me anë të nyjës është një mënyrë shumë prodhimtare në gjuhën e sotme”²⁴⁵. Kjo dukuri është vërtetuar edhe në gjuhë të tjera si prodhimtare. Nyjat (shquese) në gjuhën shqipe janë zhvilluar kryesisht nga përemrat dëftorë, të cilët janë përdorur pranë një emrit të përgjithshëm. Me të drejtë ka menduar Riza se në rasën emërore “ngjitet prapa emrave dhe ka këto trajta: -i (-u) për njëjtesin të gjinisë mashkullore p.sh. LisI, mikU, bregU, krahU, ndërsa -(j)a për gjininë femërore p.sh. punA, luljA; dhe për gjininë asnjësore p.sh. Ujët, mishTË, -t(ë). Kurse, për shumësin pa dallim gjinie p.sh. lisaT, miqTË etj.”²⁴⁶ Një mendim i drejtë është dhënë edhe për nyjën e pashquar një (nji). Nga shembujt në fjalë dëshmohet se kemi nyjë të studiuar nga S. Riza si të shquara dhe të pashquara, apo siç i ka quajtur autori “për nga kuptimi kemi nyje të pacaktuar absolute dhe relative. “Nyja joshquese “një”, e cila përdoret vetëm me emra në numrin njëjës, është e patheksuar dhe padyshim shumë më e re se nyja shquese e prapangjitur”²⁴⁷.

Studiuesit që kanë dhënë kontribut në këtë fushë të morfologjisë kanë shprehur mendimet e tyre se nyja ka një prejardhje nga përemri dëftorë. Mirëpo, zhvillimi dhe përbërja e saj fonetike qenë njësoj me atë të nyjës së pashquar. Andaj, “efekti pikërisht të sintaksës së tyre të kundërt ato pak a shumë janë diferencuar edhe nga pikëpamjet fonetike”²⁴⁸. Nga autori (S. Riza) në fjalë kemi mendim objektiv për nyjën e shquar –i, i cili ka theksuar se gjithë emrat e gjinisë mashkullore njëjës p.sh. burri, kavi, (kau) kanë ruajtur një –i, -v-i, por kanë dhënë edhe –u. Nga kjo e fundit autori ka menduar se fjalët që përfundojnë me një bashkëtingëllore grykore, të cilat për të ruajtur strukturën e tyre fonetike dalin me –u si furrik – furriku (ose do të ishte furrik – furriqe) etj.

Sipas Rizës, fjalët që mbarojnë me –ë, dhe –e historikisht janë rezultat i një –a-je. Për këtë mund ta dëshmojmë me përemrat ta dhe ma, të cilët kanë burimin nga një krasis (shkrirje), pra të+e=ta ose më+e=ma. Një mendim të tillë e ka dhënë edhe Pedersen, i cili ka shprehur mendimin se emrat e gjinisë femërore që mbarojnë –e, –ë në shquarsi kanë dhënë –a si të punë – puna. Mirëpo, jo çdoherë ky mendim është i saktësuar, sepse kemi mendim kontrastiv në mes gjuhës shqipe se disa emra të gjinisë mashkullore të cilët

²⁴⁴ Selman Riza, Studime albanologjike I, Prishtinë, 1979, f. 164.

²⁴⁵ Mahir Domi, Fatmir Agalliu, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f.69.

²⁴⁶ Selman Riza, Studime albanologjike I, Prishtinë, 1979, f. 164.

²⁴⁷ Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë, 2002, f. 153.

²⁴⁸ Po aty, f. 158.

në rasën emërore, njëjës mbarojnë më –ë, kështu që në shquarsi nuk kanë dhënë –a, por kanë dhënë –i si të burrë –burri; djalë-djali; kalë-kali etj. Varianti i –i-së mendon është përfituar nga përemri dëftorë a-i, por nyja e prapme nuk është shtrirë edhe tek emrat që përfundojnë me bashkëtingëllorët –k-, –g-, kjo si dukuri që mënjanon qiellzorizimin. Varianti i –u-së si nyja e prapme u ruajt edhe pas fundores –k- duke qenë se –u-ja si zanore e prapme përshtatet më mirë në bashkëtingëllore velarë.

S. Riza në punimin e tij të gjerë “Nyjat e shqipes”(1958) vjen në përfundim se nyja shquese në gjuhën shqipe ishte në fillim prepozitive ndaj emrit dhe mbiemrit. Sipas tij ajo do jetë krijuar, rreth dy mijë vjet më parë, ndërsa kalimi i saj në postpozicion dhe aglutinimi pas emrit do të jetë shkaktuar në mesjetën e hershme²⁴⁹. Miklosich-i është i pari, jo vetëm që në ballkanistikë e krijoi hipotezën e substratit për burimin e pikave të përbashkëta dhe të prapavendosjes se nyjës, por i pari që e orientoi zgjedhjen nga një substrat (fjala substrat, për shqipen mendoj se duhet merret si e rezervuar) që paraqet një fazë të lashtë të shqipes. F.Miklosich-i më 1862 shfaq mendimin se burimet, apo elementet gjuhësore të përbashkëta të gjuhëve ballkanike janë substrat paleoballkanike iliro-trakase²⁵⁰. Mirëpo, N.Jokli dukurinë e prapavendosjes se nyjës në gjuhën shqipe e konsideron të jetë e pavarur nga gjuhët e tjera. Pasi e pranoi mendimin e Pedersenit se nga nyja shquese që qëndronte para mbiemrit ndodhi aglutinimi i saj me emrin paraprijës (pus i thellë→ pusi thellë, pusi i thellë), këtu shihet se nyja shquese e kishte formën i në emërore, në gjininë mashkullore, para se të aglutinohej me emrin, kurse emri e kishte humbur vokalën tematikë bashkë me mbaresën e rasës (*-o-s), ndërsa në anën tjetër jep ulkos-so, nok’tis-sa, por sipas Pedersenit so do të kalojë gradualisht në u, pastaj kjo alternohet në i në procesin *u>y>i. Ky proces kishte përfunduar që në kohën kur në gjuhën shqipe kishin filluar të depërtonin huazimet e para nga latinishtja²⁵¹. Këtë mendim e ka pranuar edhe H. Bariçi, duke supozuar se nyja postpozitive në gjuhën shqipe është e vjetër, i cili e konsideron të kohës shqiptare-trake-armene.

M. La Piana më 1939 nyjën shquese në gjuhën shqipe e pa si proces paralatin, duke u bazuar, në trajtën e shquar të akuzativit njëjës. Në këtë aspekt shqipja ka ndikuar mbi rumanishten . M. La Piana dhe E. Çabej pozitën origjinale të nyjës në gjuhën shqipe e konsiderojnë postpozicionin dhe e çmojnë po ashtu si proces i lashtë dhe domosdo paralatin. Përemri dëftor u shoqërua me emër, e pastaj u bë nyjë- është shprehur Çabej. Të dy studiuesit La Piana dhe E. Çabej, mendojnë se nyja e prapme e gjuhës shqipe është me e lashtë se në gjuhën rumune, por kjo e fundit e ka burimin nga gjuha shqipe²⁵².

V. Georgievi ka shfaqur mendimin për ndikimin e greqishtes se vjetër në krijimin e nyjës në gjuhët ballkanike. Në të vërtetë për gjuhën shqipe ai është shprehur me parë se prapavendosja e cila përbën edhe substratin e rumanishtes se vetëm “prania e një gjuhë dake të pavarur mundëson të kujtojmë më mirë (...) relacionet midis rumanishtes e shqipes”²⁵³.

²⁴⁹ Në BUSHT SSHSH 2,1958 edhe Studime albanologjike, Prishtinë 1979, f. 168.

²⁵⁰ Die slavischen Elemente im Rumunischen, në Denkscher der wiener Akad. Phil.hist.cl.vol.12, f. 7 ose Besim Bokshi „Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike” Prishtinë 1984, f. 39.

²⁵¹ N. Jokli, Zur Geschichte des albanesischen Diphthong –ua,ue, f. 50 1932, ose Besim Bokshi “Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike” Prishtinë 1984, f. 19.

²⁵² Eqrem Çabej, Studime gjuhësore, IV, f.123.

²⁵³ Besim Bokshi, “Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike” Prishtinë 1984, f. 39.

Mendimi i shënuar i Papahagit-t se prapavendosja e nyjës në rumanishte do të jetë e shpjegueshme, tipike e lat. vulgare në fjalët e tipit ille, illu- lupu occidit dhe illa illu aqua versat që dha në rumanishte el el-lup unide dhe ea ea-apă varsă²⁵⁴.

W. Chimochofski si pikënisje për nyjën e shqipes ka marrë lakimin e përemrit dëftor, të shqyrtuar së bashku më disa trajta të përemrit pronor, kështu që bazë të kësaj trajte të nyjës së shqipes e interpreton si vazhdimësi të indoevropianes *so, *sa, *tod (greq. δ,ή, ό)²⁵⁵. Etimologjia e Skokut që ka dhënë si shembull *-a+ia >*-eie>-εe>-a, nuk është e pranuar, sepse i-ja fundore e patheksuar në gjuhën shqipe nuk mund të ketë dhënë ie>e, ajo ka përfunduar në –ë si dhe a-ja p.sh. bilia-biljë>bijë, penktia>pesë, familia—fëmiljë>fëmijë etj.

Në gjuhën shqipe është vështirë të dihet vjetërsia e nyjës: La Piana mendon se nyja e prapme e shqipes duhet të jetë përfituar para kontakteve të saj më latinishten. N. Jokli, për nyjën e prapme e ka menduar se i përket kohës romake. Çabej, Domi, Ajeti, Bokshi, mendojnë se nyja e shqipes është shumë e hershme. Nyja e prapme duhet të jetë edhe më e vjetër se dokumentimi i shkrimeve në gjuhën shqipe (shek. XIV), mendoj se kemi një element objektiv të dukurisë se rotacizmit –n-> në –r- zani-zëri etj. d.m.th. ka përfunduar se vepruari para shek. VII-VIII.

Në gjuhët sllave të Ballkanit nyja e prapavendosur nuk duhet të jetë e hershme. Mendohet se nyja e prapme në bullgarishte është shfaqur pas shek. IX të e.r., kurse në maqedonishte pas shek. XIII.

Për sa i takon rumanishtes nyja shquese është shfaqur pas shek. VII, gjithsesi siç citon Sandfeldi, përkimi midis degëve të ndryshme të rumanishtes tregon se zhvillimi duhet të ketë qenë një fakt i hershëm para shek. X.

H. Pedreseni mendon se forma burimore e nyjës në rasën emërore njëjës të gjinisë mashkullore ka qenë /u/. Kurse Riza për variantin /u/ është historikisht dytësor dhe është përfituar nëpërmjet vokalizimit të tingullit kundër hiatit -v- në forma të tipit ka-v-i>ka-u. Por, ky shpjegim nuk ka gjetur mbështetje. Kështu e njëjta vërejtje vlen edhe për hipotezën e Desnickajes, që ka cituar se varianti /u/ është përfituar nëpërmjet bashkëtingëlloreve velarë –k-, -g-²⁵⁶.

Gjithsesi në rast se –u është me e vjetër, ky variant duhet të jetë shfaqur para evolucionit *-u>y të përemrave dëftorë gjegjë, për ndryshe është më e vjetër varianti i –i-së²⁵⁷.

Varianti i –i-së është përfituar nga përemri dëftorë a-i, por nyja e prapme nuk u shtri edhe tek emrat me fundore –k-, -g-, si dukuri për të mënjeluar qiellzorizimin.

Varianti i –u-së, i nyjës se prapme është ruajtur edhe pas fundores –k- duke qenë se –u-ja si zanore e prapme përshtatet më mirë në bashkëtingëllore velarë.

Pedreseni mendon se –a-ja është përfituar nga shkrirja e fundores se temës –ë me formën burimore –e të nyjës se prapme duke u mbështetur fonetikisht khs. më+e=ma, të+e=ta²⁵⁸.

Si dëshmi për lashtësinë me se dymijëvjeçare të nyjës se përparme në gjuhën shqipe S. Riza i ka marrë këto argumente:

²⁵⁴ Po aty. f. 115.

²⁵⁵ Wasław Cimochofski, Gjuha shqipe, Prishtinë, 1988, f. 53.

²⁵⁶ Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë, 2002, f. 175.

²⁵⁷ Po aty. F.175

²⁵⁸ Po aty.f. 176

Përbërja fonetike të nyjës se përparme si të dëftorëve të thjeshtë brenda pronorëve të tipit ynë, jonë, tonë...etj, ku sipas tezës se H. Pedersenit që u pranua nga Riza „nyjat e përparme” y-, (j)o-, ta-, to etj, janë aglutinuar me vazhduesit e pronorëve primarë –n-²⁵⁹. Selman Riza mendon se emrat e shqipes se lashtë kishin një të përparme shquese si: të vëllazën- vëllazëritë, gjithashtu edhe të mbiemrat qëndronin midis nyjës e emrit, të mi vëllazën.

Siç dihet në shqipen bashkëkohore kemi nyjën e prapme, ose artikull postpozitiv, apo edhe të prapangjitur p.sh. burr-I, mik-U, vajz-A etj, kurse në bashkëvajtje ajo përkundrazi paradrejtohet, prandaj quhet prepozitive, ose nyjë e parme p.sh I/E mirë.

Kjo nyjë vlerën e saj e ka ruajtur në tri grupe:

1. Para numërorëve themelorë si: të dy, të gjashtë...etj.

2. Para përemrave të pacaktuar: të tërë, të gjithë...etj.

3. Para emrave të farefnisës i ati, i biri, e bija, të bijtë, të cilat vërtet biri i tij, i saj, i tyre. Para emrave si t’mi vëllazër, të tu motra, S. Riza nyjën –TË e ka menduar se nuk është e mbiemrave, por e emrave, “vëllazër, motra, që e cakton formën e përparme. Përbërja fonetike /të/ sipas S. Rizës është primare dhe rrjedh nga dëftori i thjeshtë ta, të²⁶⁰.

Po ky studiues, përbërjen fonetike e shfaqet vetëm atëherë, kur mbiemri është epitete p.sh. “Ty të gjithë ta lakmojnë vullnetin e fortë” pra të jetë:epitet, pasues, dhe i pandërmjetshëm me një emri të caktuar²⁶¹.

Mendimet e dhëna për rasën kallëzore si: burrin, vajzën etj, Pedersenit mendonte se ka burimin nga *burr(ë)nt, vajz(ë)nt etj., pastaj u shndërrua në burr(ë)n, vajz(ë)n>burr-ë, vajz-ë etj. (burrI, burrIn nga burrën), mikU, mikUn nga miknë.

Nyjat e parme rrjedhin nga dëftorët e thjeshtë si ky, ai, (ay),k(ë)jo, ajo, këta, ata, këto, ato, janë të përbërë,sepse k(ë)-a, *y, ose –I, *-a, *ta, *to, janë dëftorë të thjeshtë sipas Pedersenit.

Kurse për nyjën e prapme, apo e pacaktuar –e janë dhënë hipoteza të ndryshme, mirëpo mendoj se kjo nyjë burimin e ka të numër themelor /i pari/ një. Kjo dukuri ka dalë edhe të autorët e vjetër si të Buzuku në rasën gjinore dhe dhanore, njei(h)njanit, *njait. Të Budi emëroren dhe kallëzoren, nji, njaj etj.

Gjuhëtarët që janë marrë pak a shumë me historinë e nyjëve se shqipes janë: Fr. Boppi, Dh. Kamarada, G. Mayer-i, H. Pedersenit, Vilhem Thoms, N. Jokli, N. Mjeda, M. La Piana, S. Riza, M. Domi, E. Çabej, I Ajeti, Sh. Demiraj, B. Bokshi etj.

Për sa i takon raportit kronologjik midis nyjës se prapme dhe të përparmes, siç dihet janë shtruar disa teza kryesore, diametrikisht të kundërta. Nga njëra anë është teza e Pedersenit, që është mbrojtur edhe nga S. Riza, kështu që sipas kësaj teze në gjuhën shqipe nyja e përparme është më e vjetër, nga kjo nëpërmjet një aglutinimit ka lindur nyja e prapme. Kurse E. Çabej thekson se nyja e prapme është më e vjetër, sepse nga përsëritja e kësaj, është përfituar me vonë nyja e përparme.

Shembulli i Pedersenit për nyjën e prapme të shqipes është përfituar me togfjalëshin e tipit pus i thellë, ku nyja e përparme e mbiemrit me kohë iu prapangjiti emrit paraprijës, pastaj u rikthye nga kishte rrjedhur.

S. Riza ka pohuar se nyja e përparme tek mbiemrat i mirë, diku ka pasur fuksion caktues, ai shton se vlerën e saj caktuese e ka ruajtur ende edhe sot si: tek numërorët themelorë të tre, te përemrat e pacaktuar, të gjithë, të tërë; tek togfjalëshat të mi, të emrat

²⁵⁹ Selman Riza, Studime Albanologjike I, Prishtinë 1979, f.158.

²⁶⁰ Po aty. f. 159

²⁶¹ Po aty. f. 159

e lashtë të vëllazën, të tu motra, ku nyja /të/ sipas tij nuk është mi, tu, por e emrave vëllazën, motra. “Përbërjen fonetike të nyjes së përparme si te dëftorët e thjeshtë brenda pronorëve të tipit yni, jonë, tanë, tonë etj. ku, sipas tezës së Pedersenit, që është pranuar nga Riza, “nyja e përparme y-, (j)o-, ta-, to-, etj. janë aglutinuar me vazhduesit e pronorëve primarë –n- etj.”²⁶²

E. Çabej ka dhënë mendim se nyja që i prin numërorëve tregon në të parën totalitetin “të dy” d.m.th. “që të dy” e vetëm pastaj dha atë “që të dy” si në gjermanishte “që të dy” po keiner von beider” që d.m.th. “asnjëri nga ata të dy.”

Për sa i takon gjuhës shqipe mbetet historikisht jo e qartë nyja e përparme “të” e cila duhet të jetë relativisht shumë e vjetër, sepse ajo ndeshet rregullisht në të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë këtu edhe arbëreshët e Greqisë, të Italisë si dhe tek autorët tanë të vjetër të Buzuku “nvrap të dy...”, Matrenga “ndër të di urdhrit të të dashurit” kjo dukuri ka dalur edhe të Budi, Bardhi...etj.

“Nyja e përparme” i, e, të, para disa emrash të lashtë farefisi, si dhe para emrave zot- i, i zoti, zonjë- e zonja me vlerë pronori është historikisht e moçme dhe e paqartë²⁶³.

E. Çabej ka pohuar se nyja e gjinore ka dalë nga përsëritja e nyjës së parme të emrit që i paraprin, në të cilën përshtatet në gjini numër, mirëpo S. Riza është shprehur me një shembull “ky kalë është i Palit” në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një përdorim eliptik të rasës gjinore, përdorimi që është i kushtëzuar, pra nyja, apo dëftorthi, siç e quan ai, ka ruajtur “ende edhe sot e kësaj dite”²⁶⁴.

Forma nyjore e kallëzores njëjës –në, është vërtetuar së pari nga Pedersen i cili ka pohuar se është proces i asimilimit –nt, -nd në, -n*(-nd, - -nn, -n²⁶⁵) ose -om, tom përkatësisht –am, tam nëpërmjet evolucionit nga ky proces ka dhënë /në/ kallëzores e sotme.

Sidoqoftë, mund të pohohet që “Nyja përparme” tek mbiemrat ka zënë vend të shfaqet në shqipe para kontakteve me sllavishten, kurse nyja e gjinore mund të këtë filluar më vonë. Nyja e përparme tek i biri, e bija gjithashtu i takon periudhës parasllave të shqipes, kurse nyja “të” nga numërorët themelorë ka mundësi të jetë e vonë.

Duke u bazuar në shtjellimin e këtij vështirimi historik të nyjës së prapme të gjuhës shqipe mendoj se nyja ka lindur nga nevoja për të shprehur gjuhësisht kundërvënien kuptimore i caktuar – i pacaktuar të emrave të përgjithshëm që janë përdorur më kuptim individualizues. Pra, si mjet gjuhësor që shërben për të shprehur kategorinë e shquarsisë dhe të pashquarsisë.

Nyja e prapme e shqipes ka një zanafillë relativesh shumë të lashtë, është e vetmja nyjë shquese, që ka pasur gjuha shqipe dhe si rrjedhim është më e vjetër se “nyja e përparme”.

Zanafilla e “nyjës së përparme” është relativisht e vjetër, ajo duhet të jetë me e vjetër se fillimet e konteksteve të shqipes me sllavishten. “Nyja e përparme” kryen funksione të ndryshme dhe nuk është përfituar nga e njëjta rrugë.

Nyja e përparme e përcaktorëve të emrit, mbiemrit dhe rasës gjinore janë përfituar nga përsëritja e nyjës së prapme të emrit paraprijës. Nyja /të/ para numërorëve themelorë

²⁶² Besim Bokshi, Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike, Prishtinë, 1984, f. 81, i referohet Nyja e shqipes, Studime albanologjike, Prishtinë, 1979, f. 157.

²⁶⁴ Shaban Demiraj, Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe. Tiranë 1975, f. 162.

²⁶⁵ Besim Bokshi, Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike, Prishtinë, 1984, f. 54.

dhe para emrave të farefisit duhet të jenë përfituar nga një rrugë tjetër, në kohë të ndryshme.

Varianti –u-së dhe i –i-së të nyjës së prapme në rasën emërore njëjës, për gjininë mashkullore, mendoj duhet të jetë me e vjetër –u-ja, kurse varianti –i-së ngjanë të jetë përfituar nën ndikimin e përemrit dëftorë a–i, d.m.th. pas evolucionit u-y>i.

Nyja e përparme e gjinisë mashkullore është përfituar pasi ishte shtrirë varianti i nyjës së prapme.

Nyja e prapme –a është përfituar nga shkrirja e fundores –ë, të emrit me nyjë e prapme të dikurshme –e.

Mendoj, “Nyja e përparme” të dhe e, të rasës kallëzore njëjës (...) dhe nyja e prapme –në, janë të rasës kallëzore të dy gjinive, por mendohet historikisht janë sekondare.

Për nyjën e prapme siç dihet kjo dukuri është edhe në gjuhët e tjera si shqipe, rumanisht, bullgarisht etj. si:

Shqipe, mal-i, ujk-u, fushë-a.

Rumu. Lup (ujk), lupul, munte, (mal), muntele, apo (ujë).

Bullg. kon. (Kalë), kojot, voda (ujë), vodata.

Nga tri gjuhët në fjalë shqipja dhe rumanishtja janë më të afërta se me bullgarishten.

Duke e përfunduar një vështrim arbitrar (ndoshta mund ta quaj arbitrar), sepse gjatë këtij vështrimi idetë, qëllimet, rezultate të ndryshme ishin të ndryshme. Andaj, nuk mund të përfundojë këtë vështrim pa ripyetur se: A shfaqet kjo dukuri vetëm në gjuhët ballkanike, apo edhe në gjuhë të tjera joballkanike, objektivisht me cilën gjuhë ballkanike mund të jetë më e afërt? A është e mundur që nyja e prapme ballkanike (shqipe) të studiohet pa lidhshmëri me nyjën e përparme?

Si rrjedhim, prapavendosja e nyjës shquese në gjuhët ballkanike, si dukuri, nuk mund të kërkohet burim në gjuhën bullgare e maqedone siç janë munduar disa studiuese të huaj të japin shpjegime për këtë fenomen gjuhësor. Mirëpo, dy sistemet gjuhësore në fjalë, këtë fenomen gjuhësor duhet ta kenë marrë nga gjuha shqipe apo nga rumanishtja si gjuhë të lashta.

Përfundimisht, kjo dukuri është vërtetuar e lashtë dhe më përputhje më gjithë përcaktorët e pavetëmjaftueshëm të emrit, që një gjë e tillë është edhe në rumanisht. Mirëpo, këtu lindë një pyetje diskutuese se në cilën gjuhë në shq. apo ruma. kjo dukuri është më e vjetër? Kjo çështje meriton një trajtim të veçantë, duke mos anashkaluar interesin gjuhësor, pikëtakues me nyjën e përparme tek mbiemrat dhe tek rasa gjinore (njeri i mirë- omulcel bun).

PROBLEMET SINTAKSORE NË STUDIMET GJUHËSORE TË SELMAN RIZËS

Institucionet e larta akademike të arsimit dhe edukimit siç janë Fakulteti i Mësuesisë i Universitetit të Korçës dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, kur shënojnë përvjetorë të rëndësishëm siç është ky, me rastin e 100 - vjetorit të lindjes së Selman Rizës, të thuash, bëhen tempuj me ngjyime shenjtërie. Shkenctarët e mirëfilltë, qofshin fushash të ndryshme të kërkimtarisë, ata marrin cilësisht nisma të mbara. I tillë ishte edhe Prof. Selman Riza. Ata i prekupon vazhdimisht dhe gjithanshmërisht të kërkuarit të së vërtetës në gjirin e teorisë së njohjes. Dimensionet studimore të Prof. Selman Rizës gërmonin vazhdueshëm në thellimin e dijes, të njohjes, në fillim në lëmin e gramatikës, pastaj në teorinë e gjuhës duke shikuar atë jo vetëm në planin ngushtësisht mikrolinguistik (teoria e gjuhës të mos shihej si shkencë më vete dhe për vete), por edhe në atë makrolinguistik (teoria e gjuhës të gjurmohet edhe në raport me shkencat jogjuhësore) siç janë: sociolinguistika, psikolinguistika, etnolinguistika, teoria e komunikimit, pragmatika etj. Pragmatika studion gjuhën në raport me përdoruesin, pra është një mënyrë tjetër e vështrimit të gjuhës që lidhet me veprimin. Pikërisht me nocionin e veprimit lidhet edhe pasioni i Selman Rizës, i angazhimit për lirinë, për çlirimin. Pasioni i veprimit përshkohej nga aspekti perlokucionar i aktit të folurit. Përpjekja e tij ishte vazhdimisht jo vetëm në kërkim të së vërtetës, por edhe në të thënë e saj. Kjo bëhej pikë shqetësimi, pikë pakënaqësie për kohën dhe për pasojë ai shpallet desident. Për t'u përballur më vonë me burgosje, internime, por kurrë pa u ndalur nga puna e tij prej shkencëtari.

Përveç çështjeve tjera të gjuhësisë, ai është marrë edhe me çështje studimore të sintaksës. Sipas tij "Kundranë e syntaksës asht pra ndërtimi i fjalisë së thjeshtë dhe ai i fjalisë së përbame"[1]. Të qenët dhe të bërët janë pikat mbështetëse mbi bazën e të cilave ai bën klasifikimin e fjalisë së thjeshtë. Pra, sipas tij: mendime qenieje a esence dhe mendime bamjeje a fakti.

Me nocionin e parë shprehen fjali logjike, me të dytin fjali gramatikore. Ato dallojnë edhe për nga ndërtimi. Gjymtyrët themelore të një fjalie logjike janë tri: i përtukallxuemi a predikandumi (emri i sendit gjegjës), këpuja (gjymtyra themelore qendrore) dhe kallxuesi a predikati[2]. Sipas tij, në një fjali logjike i përtukallxuemi dhe kallxuesi janë dy gjymtyrë themelore të skajshme, kurse këpuja, gjymtyra themelore qendrore [p.sh.](#): Ai është i mëshirshëm (Vepra 2, fq.503).

Në gramatikat tona sot, këpuja trajtohet si pjesë e kallëzuesit emëror, pra është folja jam që në vetën e tretë njëjës del me formën është e cila në ndërtimet të tilla sintaksore dobësohet leksikalisht dhe përforcohet gramatikisht duke iu bashkëngjitur pjesës emërore si një tërësi. Autori, më tej, jep shembuj fjalish me zbrazëti eliptike të të cilat vihet re mungesa e foljes, por që plotësohet me komponente të tjera p.sh.: Pleqnija – ligështija. (Vepra 2, fq. 73). *Shtëpiza ime – liriza ime.* (Vepra 2 fq. 502). Fjalitë e këtilla edhe në mungesë të foljes stilistikisht janë të fuqishme dhe të efektshme. Edhe Naim Frashëri në disa vargje të poezisë së tij për t'i dhënë një karakteristikë shprehësie kryefjalës, herë – herë, përdor kallëzuesin emëror pa këpujë:

*Qielli është i qëruar,
I kulluar posi ari,
I gjetur e i qetuar,
Syri s'nginjetë së pari. (Lulet e verës fq. 91).*

Në vijim Selman Riza thekson se gjymtyrët plotësore të një fjalie logjike janë të llojllojshme rrethana të kallëzuesit: *Gjithkush është zot në shtëpi të vet. Atëherë ai ishte ende i papërvojë.*

Selman Riza nuk e tumir konstatimin e gramatikave shkollore në të cilat kallëzuesi emëror shihet i ndërtuar nga dy pjesë: këpuja dhe pjesa emërore.

Sa i përket fjalisë gramatikore, ndërtimin e saj e shoh të përbërë nga dy gjymtyrët themelore: 1) ndën-ana a subjekti dhe 2) ana a "jektit". Subjektin e përban emëni i sendit gjegjësisht i vehtjes që ban diçka kurse "jektin" e përban ajo trajtë e cilësdo folje qoftë që shfaq këtë të bame diçka[3]. P.sh. *Mësuesi ndëgjonte.* (Vepra 2, fq. 505). *Dielli ndrtitshonte.* (Vepra 2, fq.505). Duke lexuar veprën e S. Rizës venerojmë se gjymtyrët e fjalisë gramatikore janë trajtuar jo vetëm në aspektin sintaksor, por edhe në atë stilistik. Te bërthamat kallëzuesore të këtyre fjalive mbizotërojnë elementet afektive me ngjyrimet të figurshme. Kallëzues të tillë marrin përmasa stilistike përmes veprimeve si: anasjella, figuracioni, përsëritja etj. P.sh. *Ka ardhë një letër.* (Vepra 2, fq.505). *Do të vijë parvera.* (vepra 2. fq.505). dhe sipas S. Rizës me qëllime theksimi të "jektit" mund të përmbysset njambasnjajsimi i rendit të rëndomtë[4].

Përveç gjymtyrëve themelore, sipas autorit, fjalia gramatikore ka edhe gjymtyrët plotësore (të dyta) siç janë: rrethanat e llojllojshme, kundrana e drejtë kundrana e zhdrejtë (rrethanorët, kundrina e drejtë dhe e zhdrejtë), p.sh.: *Ai ka fjetë gjatë. Libri asht mbi tryezë. Nalt tryezës rri vjerrtë një llambë. Nana do fëminë e vet. I falemnderit asaj.* (Vepra 2, fq. 505). Selman Riza nga bashkëshkrimja e një fjalie gramatikore dhe e një tjetre logjike ka ndërtuar fjalinë gramatikore – logjike, p.sh. Puna ban njerinë të lumtun. Nga shembulli i sipërshënuar shihet se katër janë gjymtyrët themelore të një fjalie gramatikore – logjike: subjekti, jekti, objekti dhe predikati i objektit. Krahësuar me sintaksën e shqipes së sotme, gjymtyra e katërt e fjalisë së mësipërme emërtohet si përcaktor kallëzuesor i kundrinës, i cili mund të jetë edhe i kryefjalës. Dallimi qëndron në atë se në cilin zgjedhim përdoret folja kallëzues. Të tria llojet e fjalive: logjike, gramatikore dhe gramatikore-logjike ,sipas tij, mund të jenë: shpalljore (dëftore), pyetjore (pyetësore), habitjore (urdhërore) dhe dëshirore[5]. Një klasifikim i fjalive sipas synimit të thënies.

Selman Riza fjalinë bashkë me ndërtimin dhe gjymtyrëzimin e saj e shoh si bazën e sintaksës. Kjo bazë do të kuptohet më mirë në qoftë se lexuesi arrin të depërtojë në brendësinë e marrëdhënieve ndërmjet të folurit, të menduarit dhe të ekzistuarit.

Në përvijimin e studimeve në këtë fushë S. Riza shkon edhe tutje njësisive të thjeshta sintaksore e mendore, duke ndërtuar tërësi më të mëdha njësisish të tilla siç është periudha të cilën ai e quan fjali e përbame, p.sh.: *I dhimbijnin kambët dhe e ngiste kolli. Hecte sheshit kadalshëm poshtë nalt dhe shikonte dritaret.* (Vepra 2, fq.517). *Unë mblihdh, era zblidh! Unë grumbullo, era shpërndaj!* (Vepra 2, fq.517). *Ai shtëpinë e ka atje ku ndalet tramvaji. Kush guxon, fiton.* (Vepra 2, fq.520).

Rreth topikës së fjalëve në fjali

Vendi i fjalëve në fjali dhe i fjalive në periudhë, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera është në të mirë të studimeve filologjike. Në këtë pikë S. Riza thekson se rendi i fjalëve në fjali i gjegjet ndërtimit të elementeve mendore a koncepteve në vendin e shfaqur prej kësaj fjalie. Kjo do të thotë se modeli i ndërtimit të njësive sintaksore bëhet sipas një rendi të caktuar. Është edhe konstatimi i Xhevat Lloshit se tashmë edhe sintaksa e gjuhës shqipe e ka pranuar se në krahasim me gjuhët e tjera, rendi i gjymtyrëve është më i lirë në shqipen, sepse ka një sistem të pasur trajtash morfologjike dhe përdorim të gjerë të parafjalëve[6].

Prof. Selman Riza pohon se në gjuhën shqipe rendi është i rendomtë: ndënanë (kryefjalë), anë (kallëzues), kundranë (kundrinë), rrethanë (rrethanor), p.sh.: Frika ruan vneshtat. (Vepra 2, fq. 535). Ndeshim shembuj edhe me rend të përmbysur, i cili është rend paradalës, sepse përcaktuesi del para të përcaktuarit: “ Sidoqoftë, si një fjaluer që është vepra e Bardhit në vetveti përban ndër ne të parin libër me një përmbajtje jo propagandistike fetare, por praktike gjuhësore” [7].

Kemi të bëjmë këtu me anasjellën (inversionin) e mbiemrit që ka vlerë stilistike. Mbiemri që del para emrit merr ngjyrim vlerësues: “ Në përmbyllje do të vërejmë se edhe Lukë Matrangës ma të vjetrit shkrimtar të toskënishtes dhe ma të parit dretëshkrues shkencuer të shqipes ...”[8].

Anasjellën e ndeshim edhe te rendi i fjalive. Fjalia e nënrenditur del para fjalisë kryesore, p.sh.: *E njoha sa e pashë. Sa e pashë e njoha.* (Vepra 2, fq. 536).

Sa i përket rendit të fjalive në periudhë mund të themi se nënrenditja krijon mundësi të gjera në këtë drejtim.

Së fundi, ndërtimet sintaksore në veprën e S. Rizës nuk i shohim vetëm si model të shqipes së sotme letrare, një model të sintaksës së saj, sepse sintaksa e S. Rizës, të thuash, është një shestim i sintaksës së shqipes së sotme, por edhe si një produkt i procesit të standardizimit të saj.

[1] ASHAK, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 13, Selman Riza, Vepra 2, Prishtinë, 1997, fq. 501.

[2] Vepra e cituar, fq. 502.

[3] Vepra e cituar, fq. 504.

[4] Vepra e cituar, fq. 505.

[5] Vepra e cituar, fq. 505.

[6] Xhevat Lloshi, Stilistika dhe pragmatika, Toena, Tiranë, 1999, fq.88.

[7] ASHAK, Botimet të veçanta, 22, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Libri 11, Selman Riza, Vepra 1, Prishtinë 1996, fq.278.

[8] Vepra e cituar, fq.288.

PIKËPAMJE TË SELMAN RIZËS PËR “MESHARIN E BUZUKUT”

Veprat e para që shënojnë fillimet e dokumentimit shkrimor të shqipes janë studiuar herë pas here nga S.Riza.Ndër këto vepra një vend të veçantë zë edhe ajo e vitit 1555 e shkruar nga Gjon Buzuku.

Në studimet e tij mbi ndërtimin dhe përbërjen e veprës së Gjon Buzukut Riza flet për tri pjesë përbërëse të saj a më saktë për *tri vepra fetare* dhe ky emërtim i përdorur lidhet pas mendimit tonë me natyrën e ndryshme të teksteve biblike të përmbajtura në vepër. Riza flet për *Breviarin*, *Ritualin* dhe *Mesharin*, të tre të përmbajtur në veprën që edhe sot e kësaj dite sot njihet me emrin *Meshari* i Gjon Buzukut.²⁶⁶

Ky emërtim që është përdorur nga disa studiues që janë marrë me veprën dhe që adaptohet edhe në manuale të historisë së letërsisë së shqipes së vjetër mendojmë se respekton atë konsiderim të Gjon Nikollë Kazazit që pasi e zbulon më 1740 në Bibliotekën e *Propaganda Fide-s*, e quan *Missale albanese per antichità tutto stracciato*.²⁶⁷ Siç dihet, në këtë rast bëhet fjalë për përballjen e parë me veprën e Buzukut. Emërtimin *Meshar* e përdor Martin Camaj në studimin e tij të mirënjohur *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici alla genesi, Shêjzat*, Roma, 1960; Namik Ressuli në botimin e plotë të veprës, të titulluar *Il “Messale” di Giovanni Buzuku*, (riproduzione e trascrizione), Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.

Atë Luigj Marlekaj O.F.M., ndërsa boton në revistën *Shêjzat...*, disa vërejtje kritike mbi këtë botim të plotë të veprës nga Ressuli përdor sërish termin *Meshar*.Eqrem Çabej botimin kritik mbi këtë vepër e titullon pikërisht *Meshari i Gjon Buzukut (1555)*.²⁶⁸

Breviari, *Rituali* dhe *Meshari* për vetë natyrën e teksteve që përmbajnë janë të ndryshme midis tyre dhe të gjeturit e tyre në të njëjtën vepër siç ndodh me veprën e Buzukut nuk mund të mbetej jashtë vëmendjes së studiuesve të cilët e bënë objekt studimi atë në shumë pikëpamje.

Studimi i kësaj vepre nuk mund të mos fillojë me dallimin dhe hulumtimin e pjesëve që e përbëjnë veprën, aq më tepër që dallimi i këtyre pjesëve specifike është i pandashëm nga një dallim i dukshëm në pikëpamje gjuhësore.

²⁶⁶ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.403: Në veprën e Buzukut prej 110 fletësh (nga të cilat në ekzemplar in ekzistues janë ruajtur vetëm 94 fletë) përfaqësohen tri vepra fetare të ndryshme e pikërisht: *Breviari*, që zinte 20 fletët e para (nga të cilat në ekzemplar in ekzistues mungojnë fletët I-VIII); *Rituali* që zinte 9 fletët pasuese (nga të cilat në ekzemplar in ekzistues mungojnë fletët XXVII-XXIX); dhe *Meshari* që zinte 81 fletët e fundit (nga të cilat në ekzemplar in ekzistues mungojnë fletët XXXIII-XXXVI) dhe fleta bis LXIII).

²⁶⁷ Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, 1931, f.64: Questo è l'antichissimo *Messale Albanese per antichità tutto stracciato* che S.E. l'Arcivescovo di Scopia Monsignor Don Giovanni Battista di Nicola Casasi, Albanese di Giacova, verso l'anno 1740 aveva con meraviglia visto a Roma nel Collegio di Propaganda. Volle da esso trascrivere di proprio pugno un esemplare dell'ultima pagina, lieto di mandarlo in dono all'inclito P.Giorgio Guzzetta, fondatore del Seminario Albanese in Palermo e di altri Istituti albanesi, prototipo delli spiriti magnanimi e dell'animo e della generosità della nazione Albanese.

²⁶⁸ *Meshari i Gjon Buzukut, 1555, (botim kritik)*, punuar nga Eqrem Çabej, Tiranë, 1968.

Vetë Martin Camaj në studimin e sipërpërmendur dhe që mban titullin *Il Messale di Giovanni Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Romë, 1960, bën fjalë për një gjë të tillë. Një vërejtje me rëndësi e Camajt e që ka të bëjë drejtpërdrejt me gjuhën e Buzukut është edhe ajo në drejtim të dallimit a diferencimit të qartë të gjuhës dhe stilit së pjesëve biblike (nga Ungjijtë) nga ato të pjesëve të tjera të veprës siç janë lutjet e shumta, *Rituali katekistik* etj.²⁶⁹ Camaj këto vërejtje i bën edhe në drejtim të teknikës së përkthimit nga ana e autorit të veprës.

Me pak fjalë, studimi i veprës së Buzukut duhet nisur pikërisht nga identifikimi dhe dallimi i pjesëve përbërëse të saj. Ky diferencim i domosdoshëm diktoi në njëfarë mënyre edhe metodikisht punën studimore të Selman Rizës me këtë vepër.

Në studimet gjuhësore e kritike mbi veprën e Buzukut Riza ka pasur parasysh përpjesëtimin midis pjesëve të sipërpërmendura. Ai ruan për çdo kapitull të veçantë të studimit përkatës të tij mbi veprën titujt specifikë duke orientuar në këtë mënyrë edhe lexuesin e këtyre radhëve.

Po të vëmë re renditjen e pjesëve të studiuara nga Riza, ai ka ruajtur radhën me të cilat këto pjesë radhiten në vepër:

Breviari, nga i cili ka zgjedhur pjesë nga *Oficja e Zojës*, lutje të vendosura te *Psalmet e Pendës*(*Psalmi poenitentiales*), *Ofiqi i të vdekurvet* dhe *Litanitë e shenjtërvet*. Më tej vijon me elemente të Katekizmit; elemente të Ritualit dhe së fundi kalon në fragmente nga *Dhiata e Re* dhe *Dhiata e vjetër*. Në fillim të paraqitjes së këtyre pjesëve nga *Dhiata e Re* dhe *Dhiata e vjetër* ai vendos termin *Meshar*, duke na dhënë të kuptojmë se ai koncepton këto pjesë biblike, kuptohet bashkë me lutjet përkatëse shoqëruese si pjesë e *Mesharit*. Me këtë pjesë të veprës që ai e emërtonte *Meshar*, kanë të bëjnë një pjesë e mirë e shënimeve kritike që ai mban në lidhje me veprën e Buzukut dhe që tashmë kuptohet që nga pikëpamja e tij nuk është e tërë vepra, megjithëse përbën pjesën më të madhe të saj.²⁷⁰

Për t'iu kthyer asaj pjese të veprës që Riza e emërtonte *Meshar*, gjykojmë me vlerë faktin që edhe këtu jepen gjykime mbi përpjesëtimin apo më saktë raportin përpjesëtimor të pjesëve përkatëse biblike nga *Dhiata e Re* dhe *Dhiata e Vjetër*, duke u përfshirë këtu edhe lutjet që shoqërojnë, prijnë apo pasojnë leximin e pjesës biblike të paraqitur në meshën e rritit katolik.

Ashtu si Martin Camaj në studimin e sipërpërmendur, edhe Riza bën një diferencim të gjuhës të lutjeve të përmbajtura në *Meshar* nga ajo e pjesëve të *Dhiatës së Vjetër* apo *Dhiatës së Re*. Riza këto lutje nuk i përfshin në krestomacinë e tij duke

²⁶⁹ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici alla genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, f.31: Come si è già notato, molti brani del Vangelo e del Vecchio Testamento, eccettuando qualche salmo, differiscono in lingua e stile in primo luogo dalle preghiere di tutta l'opera e poi dagli *Uffici* e dal *Rituale cum catechesi*. Difatti le preghiere del "Messale" risentono molto dell'influsso del testo latino sia nel lessico, sia nella costruzione, così che assomigliano più a un primo abbozzo che a una vera e propria traduzione.

²⁷⁰ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.403: Pra, në "veprën" e Buzukut, *breviari* dhe *rituali* zinin afro një të katërtën e fletëve, kurse *meshari* afro tri të katërtat e tyre. Tani, ky përpjesëtim në përfaqësimin e këtyre tri veprave mund të thuhet se është ruajtur edhe në krestomacinë e pranishme, ku fragmentet nga *breviari* dhe *rituali* zënë gjithashtu afro një të katërtën, kurse ata nga *meshari* afro tri të katërtat.

gjykuar ndër të tjera se në to nuk respektohen rregullat sintaksore të lidhjes së fjalëve në fjalinë shqipe. Devijime të tilla në sintaksën e fjalisë të Buzuku vërehen edhe në pjesët nga ungjijtë apo Psalmet, sidomos kur Buzuku ka ndeshur vështrirësi serioze në përkthimin e frazës latine. Pavarësisht faktit se latinishtja edhe shqipja janë gjuhë i.e., e që për më tepër kanë pasur mundësi kontaktesh për arsye të ndryshme, bile edhe historike, gjithsecila ka ndjekur një rrugë të vetën evolutive që ka përfshirë mjaft nënsisteme gjuhësore përkatëse, ndër të tjera, edhe të sintaksës. Mendojmë që për Gjon Buzukun gjithsesi ka qenë e vështirë detyra e përkthimit të tekstit biblik të *Vulgatës* apo të pjesëve të tjera liturgjike që gjenden përkatësisht të *Breviari* apo *Rituali roman*. Vështrirësi të tilla reflektohen në strukturat sintaksore të adaptuara prej tij në tekstet e lutjeve apo edhe të pjesëve biblike.

Camaj shkon më tej në gjykimin e tij duke shprehur dyshimin nëse lutjet e sipërpërmendura si dhe pjesë të tjera përbërëse të veprës jashtë *Mesharit* mund t'i ketë shkruar e njëjta dorë.

Pavarësisht nga raporti real përpjesëtimor midis pjesëve nga *Dhiata e vjetër* dhe *Dhiata e re* në veprën e Buzukut, Riza e ka parë të arsyeshme të pasqyrojë në punimin e tij krestomatik më tepër pjesë nga *Dhiata e vjetër* sesa nga *Dhiata e Re*.²⁷¹ Me të drejtë ai gjykon që *Dhiata e re* është bërë më tepër objekt përkthimi nga ana e studiuesve tanë sesa *Dhiata e Vjetër*. Një kriter tjetër që ka udhëhequr Rizën në këtë zgjedhje është edhe çështja e interesit historiko-kulturor dhe e vlerës letrare që paraqet *Dhiata e Vjetër* në krahasim me *Dhiatën e re*.

Një vërejtje me rëndësi e bërë nga Riza pikërisht në drejtim të studimit të tekstit të Buzukut ka të bëjë edhe me raportin me tekstin latin. Ai shprehet: Krahasimi i përkthimit të Buzukut me origjinalin latin është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për çdo studim filologjik të mëvehtësishëm të tekstit të Buzukut.²⁷² Kjo vërejtje nuk mund të mos na kujtojë konsiderata të tjera të studiuesve që kanë konsideruar veprën e Buzukut një përkthim kryesisht nga latinishtja. Këto konsiderata jepen nga Martin Camaj, nga Namik Ressuli, i cili në fund të veprës së sipërpërmendur radhit me saktësi lutjet përgjegjëse në gjuhën latine, si dhe tekste të plota në gjuhën latine të marra përkatësisht nga *Breviari* apo *Rituali roman*.

Në analizat me të cilat Riza shoqëron pjesët e caktuara të marra nga vepra e Buzukut, vërejmë se ai ka bërë objekt studimi mjaft aspekte të anës gjuhësore të veprës: trajtat emërore, mbiemërore dhe trajtat foljore; reksionin e parafjalëve; paravendosjen apo parandejtimin me vlerë stilistikore të mbiemrave të caktuar ndaj emrave që përcaktojnë; origjinën e fjalëve të caktuara, siç është rasti i identifikimit të prejardhjes venete të trajtave të caktuara mbiemërore etj. Në këto analiza të Rizës nuk mungon përqasja me tekste të ngjashme përgjegjëse në veprat e autorëve të tjerë që shënojnë arritje të traditës shkrimore të shqipes. Autorët me të cilët përqasen ndërtime të caktuara janë: Budi, Matrënga etj. Riza ka qenë një studiues i ndërgjegjshëm se vepra e Buzukut

²⁷¹ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.404: E tërë *Dhiata e Re* është përkthyer në gjuhën tonë dy herësh (së pari nga Meksi, pastaj nga Kristoforidhi); kurse nga *Dhiata e vjetër* Kristoforidhi ka shqipëruar vetëm pak pjesë. Pra, edhe prej kësaj pikëpamjeje, *Dhiata e vjetër* duhej përfaqësuar në krestomaci diçka më gjerësisht se *Dhiata e re* (e jo anasjelltas, d.m.th. ashtu siç ndodh në *mesharin roman*, e për pasojë edhe në tekstin e Buzukut).

²⁷² Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.404.

është pjesë e një tradite të veçantë shkrimore të shqipes, pjesë e së cilës janë edhe autorët e tjerë të sipërpërmendur.

Nga *Rituali* Riza ka bërë objekt shqyrtimi rreth pesë pjesë të gjitha të lidhura me rite të rëndësishme siç janë pagëzimi i fëmijëve; bekimi i kripës (lat. *Benedictio salis*); riti i fejesës (*Ordo desponsandi*)²⁷³ etj.

Vërejtjet kryesore të Rizës mbi tekstin e Buzukut kanë të bëjnë kryesisht:

1. Kuptimet e trajtave të caktuara foljore²⁷⁴ apo ndërtimeve prejfoljore (*shih p.sh. të bandizuom*); kuptimet e paskajoreve si në rastin *me ndërequnë e me governuom*..²⁷⁵
2. Gjinia e emrave të caktuar ashtu siç paraqitet në përdorimet konkrete të Buzukut²⁷⁶.
3. Kuptimi i termave të caktuar liturgjike (*ordënë, religjion* etj.)
4. Kalke sintaksore dhe strukturore nga italishtja²⁷⁷.
5. Rendi i përcaktorëve si pronorët apo mbiemrat e ndryshëm ndaj emrave që përcaktojnë.
6. Shpjegime të nevojshme mbi fjalët që kanë mes tyre lidhje fjalëformimi²⁷⁸.
7. Vërejtje të karakterit kritik-tekstologjik që kanë të bëjnë edhe me respektimin e përmbajtjes së tekstit nga ana e Buzukut²⁷⁹.

²⁷³ Buzuku Gj., *Meshari*, Tiranë, 1968, f.423: *Këtu u mbaruo bagmi, e tash të zanë nfill të vumitë e kunorësë*.

²⁷⁴ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.413. Këtu do veçonim ndër të tjera kuptimet e dhëna për trajtat foljore si *grëshitetë- quhet* apo *fëjenjënë: bëjnë faj, mkatërojnë*. Riza nënvizon që kuptimi themelor i foljes *grishur* është *thirrur*, jo *ftuar*. Edhe në këtë rast ai i referohet përdorimeve të kësaj foljeje brenda veprës së Buzukut. Kjo folje gjithashtu përdoret edhe me kuptimin *ftoj*.

²⁷⁵ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.412: *me ndërequnë e me governuom: të drejtosh e të qeverisësh*.

²⁷⁶ Shih ndër të tjera trajtimin e emrit *vollëndetja* në Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.412: *Vollëndetja (o-ja rezulton nga një rindërtim etimologjizues buzukjan: lat. voluntatem, gjinia femërore e këtij emri si dhe e disa të tjerëve gjithashtu të huazuar nga latinishtja, p.sh. qytet, virtyt, pushtet etj., pasqyron gjendjen në gjuhën origjinare): vullneti*.

²⁷⁷ Veçojmë këtu ndërtimin *a më do mirë*, apo *a më do mā mirë?*, interpretuar nga Riza si kalk idiomatik nga italishtja. Riza këtu i referohet ndërtimit të njohur të italishtes *voler bene*. Te Buzuku ndeshet gjithashtu ndërtimi *me dashtë keq*, si në fjalinë: *E patmë na shpëtuom n anëmishit sinësh e n duorshit s atynesh qi neve na deshnë keq...* (Buzuku Gj., *Meshari*, Tiranë, 1968, f.13/a)/ lat. *salutem ex inimicis nostris et de manu omnium qui oderunt nos...* (*Evangelium secundum Lucam*, 1, 70-71.)

²⁷⁸ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.415, shënimi n.77: *dëshmī – dëshmitar (kurse: dëshminjëni- dëshmi)*.

²⁷⁹ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.419, shënim n.115: Vërejtjet kanë të bëjnë me respektimin e titullit që Buzuku i ka vënë pjesës. Pjesa titullohet prej tij *Shtatë vepëratë mishëriersë./ lat. De septem operibus misericordiae*. Riza vëren se në kundërshtim me titullin e fragmentit, Buzuku ka folur (jo për vetë veprat e mëshirës), por për shkeljen e porosivet që të kryhen vepra mëshire.

8. Çështje të reksionit të parafjalëve të caktuara, siç është rasti i parafjalës **prej**,²⁸⁰ e cila në tekstin e Buzukut ka vlerën e parafjalës **drejt** në shqipen e sotme.
9. Ndikimi i frazës së Buzukut nga ajo përgjësë latine. Ky ndikim vihet re në rendin e fjalëve në përbërje të fjalisë, në përdorimin e foljeve të caktuara që kërkojnë rasi të zhdrejta të emrit apo përemrit, siç ndodh afërsisht edhe në gjuhën latine etj.²⁸¹ Ndër të tjera, trajtohet si i ndikuar nga ndërtimi përgjegjës sintaksor latin shprehja **kī mishërier η shpirtit së tatësë sim e të mamësë sime...** Riza do ta trajtojë këtë përkim si ndikim të latinishtes, duke sjellë po aty edhe foljen përkatëse latine **misereri** e cila kërkon pikërisht gjinore. Në gjuhën shqipe folja përkatëse do të duhej të merrte një kallëzore (**për shpirtinë**), por merr rrjedhoren e prirë nga parafjala përkatëse **η**. Përdorime të tilla të foljeve që kërkojnë rasi të zhdrejta vihen re edhe në pjesë të tjera të veprës, si në Kankën e Xakarisë, në të cilën gjejmë ndërtimin **..e me ua rekorduom η testamentit shenjtë së tī.**²⁸² / lat. **..et memorari testamenti sui sancti.**²⁸³
10. Trajtimi i formave të mbiemrave të Buzuku, në pikëpamje formale dhe kuptimore. Me vëmendje duhen parë gjykimet mbi karakterin analogjik të disa përdorimeve si p.sh.: **Krishtëna të rrëshim e profetë të falsa.**²⁸⁴ Riza jep këtë shpjegim: për analogji me nyjshmërinë e mbiemrit shqip **të rrëshim**, autori edhe mbiemrin lat.ital. **fals** e ka bërë të nyjshëm (lat.pseudochristi et pseudoprophetae= krishtër të rrem e profetë të rrem).²⁸⁵

²⁸⁰ Riza S., Vepra 4, Prishtinë, 2004, f.409: *O gojëtareja jonë, ata sytë e tū të përmishëriershim rrutollo prej nesh.*

²⁸¹ Riza S., Vepra 4, Prishtinë, 2004, f.411: *O zot, ti qi ordhënove na me nderunë atënë e amënë, kī mishërier, tī tue t’u pëlqyem, n shpirtit së tatësë tim e të mamësë sime; e atyne u ndije kuatetë e tyne; e mue e atyne na ban neve na me pasunë gazëmendnë e dritësë jetësë glatë.*

²⁸² Buzuku Gj., Meshari, Tiranë, 1968, f.13/a.

²⁸³ *Evangelium secundum Lucam*, 1, 72.

²⁸⁴ Buzuku Gj., Meshari, Tiranë, 1968, f.315/a: *Përse kanë me u ngritunë Krishtëna të rrëshim e profetë të falsa, e t u apënë shenjë të mëdhā, e mërekullī, mbë mëndyrë qi shumë kanë me u ngënjyem (në mundë ish) edhe të zgiedhunitë./ lat.: surgent enim pseudochristi et pseudoprophetae et dabunt signa magna et prodigia, ita ut in errorem inducantur si fieri potest etiam electi.(Secundum Matthaeum, 24, 24).*

²⁸⁵ Riza S., Vepra 4, Prishtinë, 2004, f.428.

SMILARI FJALËKRIJUES I PROFESOR SELMAN RIZËS

Shpesh dhe shumëkujt mund t'i ketë ndodhur që rastësia t'i sjellë diçka të bukshme dhe të domosdoshme.

Kështu më ndodhi dhe mua për të përgatitur këtë kumtesë për profesor Selman Rizën në këtë konferencë shkencore, që po kryhet falë idesë dhe projektit të profesor Begzad Baliut më 9 maj të këtij viti, tek u takuam dhe po bisedonim në Prishtinë, si dhe gatishmërisë së menjëhershme të të gjithë profesorëve shqiptarë nga Prishtina, Tirana, Shkupi, Elbasani dhe Korça, që bashkë me kumtimet, më së pari sollën zemrat e tyre dhe nderimin e pamatë për të kujtuar 100-vjetorin e lindjes së profesorit të shquar shqiptar, që Korça dhe korçarët do ta nderojnë për jetë të jetëve.

Thashë rastësi e bukur dhe e bukshme, sepse kur nisa të mbledhja materialet për kumtesën, në bibliotekën time hapa librin e profesor Selman Rizës *“Emrat në shqipë: sistemi i rasave dhe tipat e lakimit”*²⁸⁶, në të cilin, qysh kur isha student i filologjisë në vitet '70, gjatë përgatitjes për seminarët e gramatikës historike, kisha nënvizuar shumë fjalë e shprehje që atëherë më kishin bërë përshtypje, sepse i perceptoja si të reja dhe të bukura, pavarësisht se shumë syresh nuk i gjeje të shpjeguara në fjalorë, pra ishin krijime të profesor Rizës. Me të njëjtin synim vola dhe librin *“Tri monografina”*²⁸⁷. Por kaq do të kishte qenë e mangët, sikur të mos më kishte rënë në dorë libri i ri *“Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme”*²⁸⁸, ku përfaqet gjithandej smilari fjalëkrijues i profesor Rizës.

Më pëlqeu të përdor fjalën “smilar”, jo vetëm ngaqë është një term i figurshëm që kuptimisht lidhet me mjeshtërinë krijuese të një artisti, jo vetëm ngaqë kjo fjalë jo shumë e përdorshme shënon *“një daltë hekuri me bisht druri që përdoret për të gdhendur”*²⁸⁹, por smilari i profesor Selman Rizës ishte mendja e tij gjeniale dhe pena e tij patharëboje, që krijuan me qindra e qindra fjalë të reja me brumin e shqipes, për të mbushur mjeshtërisht ato golle në leksikun e shqipes, të pavënare derimëatëherë, kur profesor Selman Riza shkruante, lexonte dhe përkthente nga shumë gjuhë simotra të shqipes, për të krijuar “Intelektologjinë” e tij tërësisht shqiptare.

Mendjeanimet e mia për të shkruar mbi një temë të tillë u bënë edhe më të plota kur lexova vlerësimin e prof. Rexhep Ismajlit, në parathënien e librit *“Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme”*, ku thuhet: *“...në tërë veprimtarinë intelektuale të S. Rizës rol me rëndësi të veçantë do të ketë luajtur nevoja që do të ketë ndjerë për ta theksuar vetanaken, origjinalen, krijimin, të renë, çka mund të shihet dhe në krijimet e pafund leksikore”*.²⁹⁰

²⁸⁶ Prof. Selman Riza, *Emrat në shqipë: sistemi i rasave dhe tipat e lakimit* (punim historik me dy shtojca kritike), Tiranë, 1965

²⁸⁷ Prof. Selman Riza, *Tri monografina albanologjike-Abeceja-Drejtëshkrimi-Çështja gjuhësore*, Mesazheritë shqiptare, Tiranë, 1944

²⁸⁸ Selman Riza, *Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme*, Dukagjini, 2009, përgatitur nga dorëshkrimi Rexhep Ismajli

²⁸⁹ Shih *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 2002, fq. 1193

²⁹⁰ Selman Riza, *Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme*, Dukagjini, 2009, fq. 41

Ky pohim i plotgojshëm i profesor Rexhep Ismajlit kudogjendet në veprën “*Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme*”, që është një enciklopedi njohëse dhe këshilluese, të cilën, pasi e ke lexuar shterueshëm, do të bindesh se pikërisht nga kredoja e Selman Rizës se tërë punimet albanistike do t’i trajtonte nga pozitat metodologjike dhe gnoseologjike vetjake, natyrshëm do të krijonte smilarin e tij fjalëkrijues të pakundshoq në gjuhësinë shqiptare dhe më tutje.

Nga materiali i vjelë dhe i skeduar që përpunuam për të shkruar këtë kumtesë (rreth 1100 faqe, me rreth 2500 skeda) bie në sy se fjalëkrijimet e profesor Rizës në të shumtën e rasjeve janë krijime vetjake me mjetet e shqipes, apo krijime intelektuale të gjuhës së librave, siç gjen gjithandej edhe kalkime fjalësh nga gjuhë të tjera, të cilat ai i njihte me themeli.

Siç dëftojnë dhe shembujt e shumtë (nga të cilët në këtë kumtesë do të përmendim vetëm pak, për t’i dhënë në variantin e plotë të kumtesës në formën e një fjalorthi), *fjalëkrijimet e profesor Rizës formojnë një sistem të tërë të karakterit fjalëformues*. Ky përfundim mbështetet në disa argumente:

Së pari, krijimi i fjalëve të reja bëhet sipas natyrës së shqipes dhe ligjësive të brendshme të saj. Mjafton të marrim në sy disa shembuj që tregojnë prirjen e autorit për t’i përdorur njësh, pra si fjalë të përngjitura mjaft lokucione, si: *mësëforti, mënëfund, përmëtepër, përnga, sidhe, nëvendqë, aspërsëlargu, prejse, mësëmiri, mësësakti, jodomosdo, atypëraty, mjaftqë, rrallë-e-tek, shpesh-e-dendur, më-se-një-njësitore, më-se-një-shqisor* etj.

Së dyti, gjedhet fjalëformuese që ka kalibruar profesor Selman Riza janë vetjake dhe të papërsëritshme. Aty nisen dhe burojnë nga synimi i tij i kahershëm për ta bërë ligjërimin sa më të thukët dhe kuptmplotë. Ndryshe, nuk kishte si të flisnin shqip konceptet dhe termat e Aristotelit, Hegelit, Sosyrit dhe të mjaft dijetarëve të tjerë.

Mjaft krijime të tij sillen në formën e togjeve të qëndrueshme deri në vlerën e fjalurtave a proverbave, si: *vullnet-qullti nuk mund të mos jetë mendjelehtë; mendjemadhi-lumëmadhi; stërvogëlimet dhe strëmadhimet janë bashkufitare me gënjeshtat; vesepakti jodomosdo është dhe virtyteshumtë; fjalëbartësi, mendimshtrembëruesi; punëngutësi-punëmosdashësi; mendjepambushuri nuk flet dot mendjembushshëm* etj.

Edhe fjalët e reja të krijuara me anë ndajshitesash të shqipes a të huaja kanë një rregullsi deri në përkryerje, si: *ligjërimtar, përpjekëtar; fajtar (punuesi, gabuesi; guximtari, fajtari); zbutjetar (zbutjetarët heroikë të bishave); dëftorth, i vetëmth, çastth, grupth, atëherëz, unëz, rrjetëz, urëz, e metëz (e metë e vogël), rrymëz, gjë-zë, pëlhurëz; pikëz* etj.

Karakter i sistemor i fjalëkrijimeve mund të përligjet edhe numerikisht: vetëm me prapashtesat –*shëm* dhe –*isht* (kryesisht mbiemra dhe ndajfolje) autori ka krijuar përmbi 99 të tilla, çka do të thotë se ato nuk janë krijime të fëtfëtshme apo për deledukje, të tilla si: *i përgjegjësishëm, i gjithësishëm, i gratshëm, i drejtpërdrejtshëm, i tjetërlllojshëm, e kryekëputshme, e dykuptimshme, e njëfjalshme, e interesshme, e njësisshme, e vetëmjetueshme, e plotvlershëm, e krejtshëm, e shpërfillshëm, i treplanshëm, i përtubueshëm, i bukurshumshëm, i përgjegjësishëm, e fëtfëtshme, i mirësjesllshëm, i jashtëvullnetshëm, e pashpërkuptueshme, e dikurshëmje, e deritanishëmja;*

kritikueshëm, mbizotërueshëm, pandërmjetshëm, shterrueshëm, bukursueshëm, pamungueshëm, njëdrejtimshëm,

vrazhdësisht, paradoksalisht, njëmënyrësisht, primarisht, sekundarisht, pastërtisht, konsiderushmërisht, pamungushmërisht, ndërkohësisht, pretendimisht, pamëshirshmërisht, vërtedukshëmrisht, pakundërshtueshmërisht, vërtetësisht, skajshmërisht, pakrasueshmërisht, përjashtimisht, plotvlefshmërisht, pabarazisht, gjithanshmërisht, padallimisht, përsosurisht, pandryshueshmërisht, ideorisht, themelësisht, klithshmërisht, filozofikisht, shpërdorimisht, origjinarisht, ndërmjetmërisht, thjeshtësisht, shumëfishueshmërisht, përkufishmërisht, gjymtimisht, dëshprimisht, përhershmërisht, bashkësiarisht, çastthpërçastthshmërisht, vetëmjaftueshmërisht, pareduktueshmërisht, letrarisht(e) etj.

Së treti, karakteri sistemor i fjalëkrijimeve të profesor Rizës duket edhe në faktin se për shumë tema fjalëformuese ai ka krijuar çerdhen e plotë të fjalës, si: *kumt, kumtoj, kumtim, kumtues, i kumtuar, kumtesë, kumtimdhënie, kumtimmarrie; njerëzore, ndërnyerësor, çnjerëzim, njerëzorësoj, çnjerëzues, jonjeriu, kundërnjeriu etj.*

Së katërti, zakonisht në krijimin e fjalëve të reja, të prejardhura a të përbëra, profesor Riza mbështetet në dy binarë: në sinonimi dhe antonimi, të cilat, siç dihet, sjellin lidhje të brendshme kuptimore dhe e bëjnë ligjërimin edhe më të drejtkuptueshëm. Edhe për dukuri po sjellim disa shembuj: *shenjëdhënia, shenjëdhënës-shenjëmarrja, shenjëmarrës; barazimi i të gjitha barazivet të pabarazueshme; për të bredhëritur e çbredhëritur; tejndryshëmin, mostejndryshënim, i përkohshëm, i përhershëm; rrit-çrrit; përkufizim, përdallim; përngjizet, përngjitet; përngjasje, ngjashmëri, i patendosur, i riçtendosur etj.*

Së fundi, fjalët e krijuara nga profesor Riza kanë vetmeveti veti dëlirësuese për shqipen, duke iu kundërvënë njemendësisht babëzisë për të përdorur fjalë të huaja të panevojshme poshtelart. Në këtë anë profesor Riza është një shkencëtar dhe atdhetar ballëlarë ndaj brezave të mëpastajmë, sepse ndihmoi konkretisht në shqipërimin e mjaft fjalëve të huaja, që edhe pse disa nuk kanë hyrë në përdorim, janë të mundshme të marrin të drejtën e qytetarisë së shqipes, të tilla si *mendjeanim për opinion, shprimje për deduksion, mprimje për induksion* e shumë të tjera.

Mënëfund, në qoftë se ai flet për *bogdanizma, matrëngizma, gojirizma etj.*, nuk është e tepërt që për gjithë fjalëkrijimet e tij t'i quajmë *selmanrizma*, ndoshta një krijim jo shumë i qëlluar, por që shpreh një të vërtetë të madhe. Ai e ka shprehur vetë këtë: “*Vetëm skamnorët e të menduarit ankohen nga varfëria e kësaj apo asaj gjuhe e madje e mbarë të folurit njerëzor*”²⁹¹

Profesor Selman Riza ishte mendjeplotë dhe mendjendritur.

²⁹¹ Selman Riza, *Mendime të shkëputura të një vazhde së vetme*, Dukagjini, 2009, fq. 123

Prof. **BEGZAD BALIU**

LAMTUMIRË, TY, BIRI I KOSOVËS SË SHEKULLIT XXI!
(Fjala përfundimtare)

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj

Konferenca shkencore kushtuar Profesor Selman Rizës po i mbyll punimet me sukses.

Brenda tri seancave janë lexuar pesë fjalë përruese, një referat, shtatëmbëdhjetë kumtesa, dhe dy diskutime rasti.

Kjo konferencë shkencore synonte të përcaktojë kontributin e Profesor Selman Rizës në fushë të gjuhësisë. Gjatë një ditë punimesh janë sheshuar kontributet e tij për metodologjinë shkencore, për studimet sociolinguistike, për marrëdhëniet e gjuhës së shkruar apo standardit me gjuhën e folur dhe dialektet, për studimet në fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes, për studimet ballkanike, për kulturën e gjuhës; për shqipen standarde; për shkrimtarët e vjetër të shqipes, për sistemin foljor të shqipes, për vendin e tij në jetën kulturore dhe arsimore të Korçës, për vlerësimet e rij nga bashkëkohësit, për ndihmesat në fushën e terminologjisë e të morfologjisë, për problemet sintaksore, për botimin filologjik të "Mesharit", për smilarin fjalëkrijues, për konceptet teorike të tij mbi gjuhën dhe historinë e saj, për artin, për historinë, për atdhetarinë dhe përgjithësisht vendin e tij në studimet albanologjike.

Siç është thënë edhe në projektin arsyetues, qëllimi i kësaj konference ishte të nxisë kërkimet e përbashkëta studimore mes studiuesve dhe institucioneve shkencore e arsimore për probleme të caktuara historiko-gjuhësore, në interes të ndërtimit të një pamjeje sa më të plotë të historisë së albanologjisë, mbështetur në përmasa europiane të dijes që shquante mendimin shkencor të Profesor Selman Rizës.

Le të jetë prandaj kjo konferencë përpjekje jona për të afirmuar mendimin shkencor ndërmjet mësimdhënësve të universiteteve të hapësirës shqiptare, përpjekje për të përcjellë kërkimet shkencore në fushë të albanologjisë, përpjekje për të ndërtuar modelet sinkronike dhe diakronike të një pamjeje historike të zhvillimit të mendimit shkencor në fushë të albanologjisë në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Botimi i materialeve të kësaj konference në shqip dhe në gjuhë të huaj do të jetë një ndihmesë e vyer për studentët e filologjisë dhe studiuesit e rinj, për njohjen e trashëgimisë shkencore të profesor Selman Rizës.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj

Këto ditë, sikur keni dëgjuar, krahas botimit të veprave të tij të njohura deri më tash në gjashtë vëllime, është përmbushur edhe një amanet i Profesor Rizës: pushimin e eshtrave të tij në vendlindje, pra në Gjakovë.

Le të jetë prandaj edhe kjo konferencë, homazh për vlerësimin e tij e të veprës së tij, një homazh lamtumire, të cilën nuk kemi mundur t'ia bënim as në Prishtinë, përkatësisht në Gjakovë ku ai dëshironte, as në Korçë e madje as në Tiranë ku qe varrosur dy dekada më parë.

Le të jetë prandaj kjo Konferencë një homazh ndarjeje për të gjithë ne, tani që ai pushon në vendlindjen e tij në Gjakovë.

Profesor i nderuar, Kosova tashmë ka realizuar njërën prej dashurive tuaja “pavarësinë, përmes shkëputjes kryengritëse”, sikur shpreheshit Ju një gjysmë shekulli më parë, prandaj Profesor i dashur, prehu në dheun e lirë të saj.

Pusho i qetë, atje ku deshe!

Lamtumirë, Ty, biri i Kosovës së shekullit XXI.

Lamtumirë!

Korçë, 4 dhjetor 2009

PROFESSOR SELMAN RIZA AND ALBANOLOGY

On the occasion of 100 years from his birth (1909-2009)

Korça, 4 December 2009

Introduction

One of the greatest personalities of the Albanian linguistics, professor Selman Riza, was born a century ago from today. When anthropologists and experts of other fields shall deal with his personality, I believe that in his epic character they will find many sparks of his era, which were deeply engraved in his soul. It is the time of great rebellion for the independence of Albania. A South-Eastern Empire was setting down and a North-Eastern one was in the rising. And the latter, just like the former, was closing the last western horizon in the outer borders of the Albanian world.

Gjakova, the childhood home place of Selman Riza, which had two decades earlier broken the myth of the untouchable Ottoman Pashas, became a target of attacks, murders, burnings and destructions by Serb soldiers.

It is therefore obvious why during his life, and with the critical persistent devotion to the scientific research, he will become an example of patriotic endeavor aspiring three pillars which influenced most the establishment of the national awakening among Albanians in the early 20th century: language, ethnology, (The Kanun and Scanderbeg) and Kosova.

Based on these three pillars Professor Selman Riza erected his stature as a linguist, scientist, patriot, opponent of fascism, Nazism and communism.

Based on those principles and circumstances, which were difficult ever since the birth of Professor Riza, he became one of the most prominent thinkers of the 20th century in the entire Albanian world. The scientific oeuvre of Professor Selman Riza spreads in many fields and disciplines, such as grammar, text analysis, terminology, literary criticism, language history, general linguistics, standard language, etc.

He united in his oeuvre the power of argument with the iron logic and sharp scientific criticism, intellectual courage and self-denial for the nation aspiring towards the truth. This entire project he managed by walking one single path: devoted hard work. If in an introduction like this I am allowed to do a re-dimensioning of his oeuvre in the context of historical developments, I would observe two parameters here: the life and the research, which often complement each-other.

In his life's dimension we see the period of his scientific beginnings: orthography, ethnology and Kosova, and a life which often clashed between political developments between Albanians and Yugoslavs.

At the same time Selman Riza constructed the model of living and being: his patriotism and the scientific model of his oeuvre: description, criticism, evaluation, study and reconstruction, wherever he worked and whatever he undertook.

In language: in describing the orthography or the grammar of literary texts, to the historic critique addressed at his contemporaries, to the theoretical reconstruction of the heterodonomist course.

At the same time, under very difficult circumstances, he was erecting the Institute of Albanology: from being the Establisher of a small Center of Kosovar Studies, to being 'Scientific Director' of the Albanological Institute of Prishtina and continuing with the

attempt to reorganize the philosophy of heading the Institute of History and Albanology in Tirana.

In the typology of his scientific oeuvre the orthographic studies assume the top place: with them he researched and synthesized between history and language, sociolinguistics and even ethnography;

- Critical and historic-linguistic studies, with which Selman Riza makes the first systematic steps towards the critical thought in the field of studies in the linguistic and literary history of the early authors;
- theoretic-linguistic studies, which he started in the beginnings of his scientific thoughts and which he ended towards the end of his life, with an interruption in-between, perhaps while dealing exclusively with grammar;
- Grammatical studies, “one of his two loves”, are the most important monument which remains as a legacy of Professor Riza. The fundamental monographs of his achievements, which represent models to this day contemporary of researching in the field of morphology. These were achievements which, Professor Riza says, if not surpassing, are at least of the level of European theoretical knowledge;
- Ethno-historical, philosophical and political studies, which are yet another love of his life, as Professor Riza expressed himself, and which I would like to term ‘the great subject of Kosova and the world around it’. It is surely the most unknown contribution in his fields of studies.

In the Albanian scientific world the personality of Professor Selman Riza and his oeuvre have not been subjected to thorough studies or even reference, compared to the paths he opened up in the field of Albanology and the scientific concepts which he used in his oeuvre. In this respect, there was more talk about the scholar “with extreme cultural and scientific inclination”, “about his cognitive and scientific caprice”, “his methodical and scientific persistence”, through which he tried to sketch up all of the scientific values, without exemption.

Therefore, his critical-scientific concepts regarding the research and scientific method of his contemporaries, have nothing to do with confronting more advanced scientific concepts of Professor Selman Riza vis-à-vis the concepts of the time, but with concepts of purely linguistic nature which insisted that he dictated in the field of 20th century Albanology, and which linked to the history of Albanian linguistics, today’s Albanian grammar, the philological study of the early literary oeuvre and especially with the methodology of contemporary research in this field.

PAMJE NGA DITA E KONFERENCËS



Prof.dr. SHEZAI RROKAJ, Dekan i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, duke dhënë intervistë për “Vizion Plus”, pas përfundimit të seancës së parë të Konferencës.



Nga séanca plenare









Një kujtim me profesorët Remzi Pernaska dhe Gjovalin Shkurtaj në hotel “Konti”